

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i shtatë)

Nga ajeti 82 i sures "El Maide" deri te ajeti 110 i sures "El En'am"

TIRANË, 2016

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i shtatë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Vullnet MERJA***

E redaktoi: ***Liseda RAMAJ***

Korrektura letrare: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILLO***

Ajeti 82

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَلَتَجِدَنَّ أَشَدَّ النَّاسِ عَدَاوَةً لِلَّذِينَ ءَامَنُوا الْيَهُودَ وَالَّذِينَ أَشْرَكُوا
وَلَتَجِدَنَّ أَقْرَبَهُم مَّوَدَّةً لِلَّذِينَ ءَامَنُوا الَّذِينَ قَالُوا إِنَّا نَصْرِي ذَلِكَ بِأَنَّنَا
مِنْهُمْ قَسِيسِينَ وَرُهَبَانًا وَأَنَّهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ ﴿٨٢﴾

“Me siguri do të vëresh se armiqtë më të ashpër të besimtarëve janë hebrenjtë dhe idhujtarët dhe se miqtë më të afërt të tyre janë ata që thonë: ‘Ne jemi të krishterë.’ Kjo për shkak se ndër ta ka priftërinj (të dhënë mbas dijes) e murgjër (të përkushtuar ndaj adhurimit) dhe se ata nuk janë kryelartë (ndaj së vërtetës).”

Emigruesit janë të parët që e kanë pranuar Islamin

Shumë komentues të Kur’anit – prej tyre Tabarsijj në tefsirin “Mexhmaul Bejjan” dhe Fakhri Raziu dhe autori i tefsirit “El Manar” - transmetojnë në tefsiret e tyre se këto ajete kanë zbritur për “Nexhashiun”, të parin (e Habeshive) në kohën e të Dërguarit të All’liahut të Lartësuar Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All’liahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ndjekësve të tij. Në tefsirin “Burhan” transmetohet një hadith që e

shpjegon plotësisht këtë tematikë.¹ Mund t'i përmbledhin transmetimet islame nga librat e historisë dhe nga thëniet komentuese të Kur'anit për këtë tematikë, siç vijon:

Në vitet e para të dërgimit të të Dërguarit të All'llahut të Lartësuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe thirrjes së tij të përgjithshme, myslimanët kanë qenë të paktë në numër dhe të dobët. Kurejshët i kanë persekutuar besimtarët dhe ndjekësit e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kështu që çdo mysliman në atë kohë jetonte nën presionin e fisit dhe të popullit të tij. Numri i myslimanëve në atë kohë nuk ka qenë i mjaftueshëm që të ngriheshin në luftë për liri. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të mbrojtur jetën e këtij grupi të vogël në numër, u zgjodhi myslimanëve një udhëheqës që t'i largonte jashtë tokës së Hixhazit dhe i urdhëroi që të emigronin në Habesh, duke thënë: "Me të vërtetë, në atë vend është një mbret (prijës) i drejtë, që nuk bën padrejtësi dhe askujt nuk i bëhet padrejtësi. Shkoni tek ai, derisa All'llahu t'u japë myslimanëve një rrugëzgjidhje!"²

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me këto fjalë ka pasur për qëllim Nexhashiun (Emri Nexhash është i përgjithshëm për të gjithë mbretërit e Habeshëve, si emri Kisra për mbretërit e Iranit. Nexhashiu ka qenë bashkëkohës me të Dërguarin e All'llahut dhe është quajtur As'hametu, që do të thotë dhënës dhe bujar në gjuhën e habeshëve).

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan"; tefsiri "Kebir", fundi i ajetit në fjalë; tefsiri "Burhan", vëll. 2, faqe 344.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 3 faqe 400; tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 18, faqe 412.

Nga myslimanët emigruan njëmbëdhjetë burra dhe tetë gra, me një varkë të vogël, të cilën e morën me qera. Kjo ka ndodhur në muajin Rexhep, në vitin e pestë të Shpalljes dhe ata janë quajtur emigruesit e parë. Nuk kaloi shumë kohë kur atyre iu bashkua Xhafer ibn Ebu Talibi me një grup tjetër myslimanësh. Ky ishte grupi i parë emigrues i myslimanëve, që përbëhej prej 82 burrash dhe po aq gra dhe fëmijë.

Ky grup ka formuar bërthamën e shoqërisë së parë të sistemit islam. Emigrimi i myslimanëve ka qenë një dukuri e ashpër ndaj adhuruesve të idhujve, sepse ata e kanë ditur shumë mirë se nuk do të kalonte shumë kohë, derisa të përballonin një grup të fortë myslimanësh, të cilët e kishin përqafuar gradualisht këtë fe, në tokën e Habeshëve, ku kanë gjetur besim e siguri. Kurejshët u përgatitën për ta prishur atë mendim dhe zgjodhën dy djelmosha të zgjuar dhe të njohur për intrigat e tyre. Ata të dy ishin Amr ibn Asi dhe Amr ibn Velidi. Ata u nisën drejt Habeshit me dhurata të ndryshme për Nexhashiun me qëllim që ai t'i dëbonte myslimanët nga vendi i tij. Udhëtuan me anije për në Habesh, pinë dhe u dehën. Kishin mosmarrëveshje mes e tyre, por për të kryer misionin për të cilin ata ishin nisur, u distancuan nga mosmarrëveshjet dhe konfliktet. Kur zbritën në tokën e Habeshëve, u paraqitën në tubimin e Nexhashiut (vendi ku qëndronte ai me këshilltarët e tij dhe me shumë personalitete), pasi kishin blerë e korruptuar ndërgjegjen e bordit të Nexhashiut me dhurata. Bordi u kishte premtuar se do të qëndronte në anën e tyre e do t'i ndihmonte. Amru ibn Asi filloi fjalën e tij duke iu drejtuar Nexhashiut: "O prijës, me të vërtetë ata janë njerëzit që kanë kundërshtuar fenë tonë dhe kanë fyer zotat tanë e kanë ardhur tek ti. Të lutem që të na i kthesh!" Pastaj i paraqitën dhuratat që i kishin sjellë atij. Ai u premtoi se do t'u kthente

përgjigje për këtë çështje pasi ta kishte shqyrtuar me këshilltarët e tij. Të nesërmen u bë një mbledhje tjetër, ku u mbledh Nexhashiu me këshilltarët e tij dhe një grup prej dijetarëve të krishterë.

Përfaqësuesi i myslimanëve ishte Xhafer Ibn Ebu Talibi dhe dy të dërguarit e kurejshëve. Fillimisht, Nexhashiu dëgjoi fjalët e dy të dërguarve të kurejshëve, u kthye nga Xhaferi dhe i kërkoi që t'i shpjegonte fjalët që dëgjoi.

Xhaferi tha: "O mbret! Pyeti ata: 'A jemi ne robër të tyre?'"

Amru iu përgjigj: "Jo. Jeni të lirë e të respektuar."

Xhaferri: "Pyeti ata nëse na kanë borxhe që na i kërkojnë!"

Amri: "Ne nuk kemi borxhe ndaj tyre."

Xhaferri: "A keni hasmëri?"

Amri: "Jo."

Xhaferri: "Atëherë çfarë kërkonin prej nesh? Na persekutuat dhe na nxorët nga shtëpitë tona. Me të vërtetë, o Mbret, ne i kundërshtuam ata dhe All'llahu na ka dërguar një Profet (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), na ka urdhëruar të mos i bëjmë ortak All'llahut e të mos u përbetohemi idhujve, na ka urdhëruar të falim namaz, të japim zekat, na ka ndaluar padrejtësinë, na ka ndaluar të derdhim gjakun padrejtësisht, na ka ndaluar imoralitetin dhe kamatën, na ka ndaluar të hamë coftinën, gjakun dhe mishin e derrit dhe na ka urdhëruar për drejtësi e për sinqeritet, të sillemi mirë me të afërmit dhe na ka ndaluar nga veprat të këqija e të shëmtuara.

Nexhashiu tha: "Me këtë mesazh ka dërguar All'llahu Isanë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pastaj, shtoi: "A ke mësuar gjë nga ajo çfarë i ka zbritur All'llahu Profetit tuaj?" Xhaferri pohoi dhe lexoi suren "Merjem". Kur arriti te fjala e All'llahut, ku thuhej: "**Shkunde trungun e palmës, që të bien**

mbi ty hurma të freskëta", Amru tha: "Me të vërtetë, Xhaferri është kundër nesh dhe ktheje tek ne!". Nexhashiu e ngriti dorën dhe e goditi në fytyrë Amrun dhe i tha: "Pusho! Betohem në All'llahun se nëse e kujton më me të keq, do të të ndëshkoj!" Nexhashiu tha: "Kthejani dhuratat e tyre!". Ndërsa Xhaferrit dhe shokëve të tyre u tha: "Qëndroni, se me të vërtetë ju jeni të sigurt!".

Kjo ngjarje ka pasur një ndikim shumë të fortë, duke pasur mirësinë për ndikimin e informacionit të thellë në njohjen e Islamit nga populli i Habeshit. Kjo ishte një fitore për myslimanët e Mekës e një qetësi e besim për udhëheqësin e Habeshit, për t'i dërguar myslimanët e rinj atje, derisa t'i shtohet besimi dhe të qetësoheshin.

Kaluan vite dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) emigroi për në Medine dhe çështja e Islamit u lartësua dhe u plotësua me paktin e Hudejbijes. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u drejtua për çlirimin e Hajberit. Kjo ditë ka qenë dita më e gëzueshme e myslimanëve. Ata fluturonin nga gëzimi për shkatërrimin e kalasë më të madhe të jehudinëve. Në ato çaste ata panë nga larg një grup njerëzish që po vinin drejt tyre. Ata mësuan se ishin emigrantët e parë për në tokën e Habeshesë. Atë ditë ata u kthyen në vendet tyre, pasi u shkatërrua armiku djallëzor dhe u forcuan rrënjët e pemës së Islamit. Kur i ka vërejtur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) emigrantët të kthyer nga Habeshi ka thënë thënien e tij historike: "Unë nuk e di, a të gëzohem për çlirimin e Hajberit apo për ardhjen e Xhaferrit."¹

¹ "Uesailu Shia", vëll. 8, faqe 52.

Transmetohet se Xhaferri dhe shokët e tij kanë udhëtuar tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe me ta shtatëdhjetë burra: gjashtëdhjetë e dy nga Habeshi dhe tetë burra nga banorët e Shamit. Me ta kishte edhe priftërinj. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u lexoi suren "Junus" nga fillimi në fund e të gjithë qanë kur e dëgjuan Kur'anin. Ata thanë se kjo i ngjante asaj që i ishte shpallur Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe All'llahu i Lartësuar zbriti këto ajete.

Transmetohet nga Sajid Ibn Xhubejr për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, se Nexhashiu dërgoi tridhjetë persona nga më të sinqertit që e ndiqnin atë për në Medine, për të shprehur dashurinë e tij për të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për Islamin. Ata që i dëgjuan ajetet e sures "Junus", e përqafuan Islamin. Këto ajete zbritën për respekt të atyre besimtarëve.¹

Shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve nuk është në kundërshtim me thënien se surja "El Maide" ka zbritur në fund të jetës së të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo thënie bazohet shumë ajete të kësaj sureje. Disa ajete kanë zbritur për ndodhi të mëparshme, e më pas janë vendosur në këtë sure me urdhër të të Dërguarit të All'llahut.

¹ "Biharul Enuar", vëll.18, faqe 410.

Komentimi

Urrejtja e jehudinjeve, dashamirësia e të krishterëve

Le t'i krahasojmë këto ajete ndërmjet jehudinjeve dhe të krishterëve. Ata kanë jetuar në kohën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajeti i parë i ka vendosur jehudinjtë dhe idhujtarët në një anë dhe të krishterët në një anë tjetër, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“Me siguri do të vëresh se armiqtë më të ashpër të besimtarëve janë hebrenjtë dhe idhujtarët dhe miqtë e tyre më të afërt të tyre janë ata që thonë: ‘Ne jemi të krishterë’.”**

Historia islame e dëshmon qartë këtë të vërtetë dhe në shumë luftra të zhvilluara kundër myslimanëve jehudinjtë dhe idhujtarët kanë pasur dorë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Nuk janë kursyer për të gjetur forma e mënyra për të bërë komplete dhe shumë pak prej tyre e kanë pranuar Islamin. Por ne gjejmë shumë pak myslimanë që u bëjnë ballë të krishterëve në luftrat e tyre, ku shumë prej tyre u renditën në rreshtat e myslimanëve (në luftë).

Pastaj Kur'ani e përforcon këtë ndryshim në sjellje, veprime dhe reagime individuale e shoqërore, ku ekzistojnë veçori të të krishterët që kanë qenë bashkëkohës të të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por që nuk kanë ekzistuar te jehudinjtë.

Si fillim, në mesin e tyre ka pasur dijetarë, të cilët nuk kanë garuar – sikurse kanë bërë dijetarët e jehudinjeve – për të fshehur të vërtetën, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“Kjo për shkak se ndër ta ka priftërinj (të dhënë pas dijes)”**. Duke pasur parasysh se në mesin e tyre ka pasur asketë, që bënë adhurim dhe u ishin

distancuar mirësive të kësaj bote, kjo është absolutisht në kundërshtim me atë çfarë kanë bërë koprracët e pashpirt jehudinj, që e kanë devijuar të vërtetën.

Duke pasur parasysh devijimin e tyre, ata kanë qenë në një gradë më të lartë se jehudinjtë, ku ajeti thotë: **“e murgj** (të përkushtuar ndaj adhurimit)”.

Shumë prej tyre i janë bindur së vërtetës dhe nuk kanë qenë kryelartë, por shumë prej jehudinjve kanë menduar se janë më lart se të gjithë dhe kanë refuzuar ta pranojnë Islamin, i cili nuk ka ardhur sipas dëshirës dhe llojit të jehudinjve. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“...dhe se ata nuk janë kryelartë** (ndaj të vërtetës).”.

Ajetet 83 - 86

وَإِذَا سَمِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَى الرَّسُولِ تَرَى أَعْيُنُهُمْ تَفِيضُ مِنَ
 الدَّمْعِ مِمَّا عَرَفُوا مِنَ الْحَقِّ يَقُولُونَ رَبَّنَا ءَامَنَّا فَاكْتُبْنَا مَعَ
 الشَّاهِدِينَ ﴿٨٣﴾ وَمَا لَنَا لَا نُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا جَاءَنَا مِنَ
 الْحَقِّ وَنَطْمَعُ أَنْ يُدْخِلَنَا رَبُّنَا مَعَ الْقَوْمِ الصَّالِحِينَ ﴿٨٤﴾
 فَأَثْبَتَهُمُ اللَّهُ بِمَا قَالُوا جَنَّاتٍ تَجْرَى مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ
 فِيهَا ۚ وَذَٰلِكَ جَزَاءُ الْمُحْسِنِينَ ﴿٨٥﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا
 بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿٨٦﴾

“Kur dëgjojnë për atë (Kur'anin) që i është zbritur të Dërguarit, i sheh se si u rrjedhin lotët nga sytë, për shkak të së vërtetës që kuptuan. Ata thonë: ‘O Zoti ynë! Ne besojmë, prandaj na llogarit ndër dëshmitarët e Tu!’”

“E përse të mos besojmë All’Ilahun dhe të Vërtetën, që na ka ardhur, kur shpresojmë se Zoti Ynë do të na çojë edhe ne me njerëzit e mirë?!”

“Për fjalët e tyre, All’Ilahu do t’i shpërblejë me kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku ata do të qëndrojnë përgjithmonë. Ky është shpërblimi i punëmireve.”

“Ndërsa ata që mohuan dhe i përgënjeshtroan shpalljet Tona, do të jenë banorë të Zjarrit.”

Komentimi

Ajeti i fundit i xhuzit të gjashtë trajtoi çështjen e urrejtjes së jehudinjve dhe të dashurisë së të krishterëve ndaj besimtarëve. Ajetet në fjalë flasin për gjendjen e atyre që besojnë dhe të atyre që nuk besojnë, si dhe për fundin e secilit grup.

Disa prej tyre qanin kur dëgjonin ajetet e Kur'anit, si rasti i shoqëruesve të Xhaferrit prej habeshinjve, sepse ata e pranonin të vërtetën kur e dëgjonin: **“Kur dëgjojnë për atë (Kur'anin) që i është zbritur të Dërguarit, i sheh se si u rrjedhin lotët nga sytë, për shkak të së vërtetës që kuptuan...”** Ata ftonin haptazi, me singëritet e trimëri, siç thotë ajeti: **“...Ata thonë: ‘O Zoti ynë! Ne besojmë, prandaj na llogarit ndër dëshmitarët e Tu!’”**

Ata ndikoheshin aq shumë nga ajetet e Kur'anit, sa thonin: **“E përse të mos besojmë All'llahun dhe të Vërtetën që na ka ardhur, kur shpresojmë se Zoti Ynë do të na çojë edhe ne me njerëzit e mirë?!”**

Më parë thamë se ky krahasim ndërmjet jehudinjve dhe të krishterëve ka qenë për ata që jetuan në kohën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Jehudinjtë, edhe pse ishin prej ithtarëve të librave qiellorë, kapeshin pas anës materiale, saqë hynin në grupin e idhujtarëve, të cilët nuk kishin asnjë lidhje të përbashkët me ta.

Në fillim jehudinjtë ishin përgëzues me ardhjen e Islamit, sepse në mesin e tyre nuk kishte hyrë devijimi i trinitetit dhe ekzagjerimi që ekzistonte te të krishterët, por dashuria e zjarhtë e

tyre ndaj kësaj bote ishte dashuri adhurimi që i largoi nga e vërteta. Bashkëkohësit e tyre, të krishterët e asaj kohe, nuk kanë qenë të tillë.

Historia e shkuar dhe e sotmja, na thotë se të krishterët, në shekujt më pas, kanë bërë krime ndaj Islamit dhe ndaj myslimanëve, që nuk janë më të pakta se të jehudinjeve në këtë fushë.

Luftrat e gjata dhe të përgjakshme të kryqëzatave në shekujt e kaluar dhe provokimet e shumta që bënë uzurpuesit kundër Islamit dhe myslimanëve edhe në ditët e sotme nuk janë të fshehta për askënd. Për këtë, ne mund t'i marrim këto ajete ligj apo rregull të përgjithshëm për të gjithë të krishterët, sepse ajeti: **“Kur dëgjojnë për atë (Kur'anin) që i është zbritur të Dërguarit...”** është argument se ka zbritur për një grup të krishterësh që kanë jetuar në kohën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Dy ajetet e fundit tregojnë për të ardhmen e këtyre dy grupeve, ndëshkimin dhe shpërblimin e tyre. Për ata që e kanë shprehur dashamirësinë e tyre dhe miqësinë ndaj myslimanëve, u janë bindur ajeteve të All'llahut dhe e kanë shprehur besimin me sinqeritet, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Për fjalët e tyre, All'llahu do t'i shpërblejë me kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku ata do të qëndrojnë përgjithmonë. Ky është shpërblimi i punëmirëve.”**

Ndërsa për ata që e kanë vazhduar rrugën e urrejtjes e të armiqësisë, ajeti thotë: **“Ndërsa ata që mohuan dhe i përgënjeshtroan shpalljet Tona, do të jenë banorë të Zjarrit.”**

Ajetet 87 - 89

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَحْرِمُوا طَيِّبَاتِ مَا أَحَلَّ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ ﴿٨٧﴾ وَكُلُوا مِمَّا رَزَقَكُمْ اللَّهُ حَلَالًا طَيِّبًا ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي أَنْتُمْ بِهِء مُؤْمِنُونَ ﴿٨٨﴾ لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا عَقَدْتُمُ الْاَيْمَانَ ۖ فَكَفَرْتُمْ ۖ إِطْعَامُ عَشْرَةِ مَسْكِينٍ مِنْ أَوْسَطِ مَا تُطْعَمُونَ أَهْلِيكُمْ أَوْ كِسْوَتُهُمْ أَوْ تَحْرِيرُ رَقَبَةٍ ۖ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ ۚ ذَلِكَ كَفَرَةُ أَيْمَانِكُمْ إِذَا حَلَفْتُمْ ۚ وَاحْفَظُوا أَيْمَانَكُمْ ۚ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ ءَايَاتِهِ ۚ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٨٩﴾

“O ju që keni besuar! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat All’lhu ju ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, All’lhu nuk i do ata që e kapërcejn kufirin.”

“Hani nga ato gjëra të lejuara e të mira që ju ka dhënë All’lhu! Frikësojuni All’llahut, të Cilit ju i keni besuar!”

“All’lhu nuk ju ndëshkon për betimin që e bëni pa qëllim, por ju ndëshkon për betimin e bërë me qëllim. Larja e gjynahut për thyerjen e betimit është: ushqyerja e dhjetë të varfërve me mesataren e ushqimit të familjes suaj ose t’i vishni ata, ose të lironi një skllav. Ai që nuk gjen mundësi për këto, le të agjërojë

tri ditë. Kjo është shlyerja për thyerjen e betimeve tuaja, nëse betoheni. Mbani betimet tuaja! Kështu jua shpjegon All'llahu Fjalët dhe ligjet e Veta, që të jeni mirënjohës."

Shkaku i zbritjes

Mos i tejkaloni kufijtë

Transmetime të shumta kanë ardhur për shkaku të zbritjes së këtyre ajeteve. Një ditë prej ditëve, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po tregonte disa gjëra që do të ndodhnin në Ditën e Gjykimit dhe po shpjegonte gjendjen e njerëzve përpara atij gjykimi të madh të All'llahut. Zemrat e njerëzve dridheshin dhe disa filluan të qanin. Ky ndikim i bëri disa nga ndjekësit e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i linin kënaqësitë e kësaj bote dhe të distancoheshin për adhurim.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) u betua që natën do të flinte një pjesë të vogël të saj, e më pas ta kalonte atë në adhurim. Bilali u betua që do të agjëronte çdo ditë. Uthman ibn Medh'un u betua që të mos i afrohej gruas së vet dhe të veçohej për adhurim. Një ditë, bashkëshortja e Uthman ibn Medh'un (që ka qenë një grua shumë e bukur) shkoi tek Aishja, e cila u habit nga gjendja e saj dhe i tha: "Përse të shoh kaq të parregullt?" Ajo iu përgjigj: "Për kë të zbukurohem? Betohem në All'llahun se bashkëshorti im ka kohë që nuk më është afruar. Ai është bërë prift, ka veshur petk të rëndomtë dhe është bërë zahid (asket) në këtë jetë." Për këtë u lajmërua i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i

cili shkoi tek ata dhe i lajmëroi se kjo është në kundërshtim me synetin e tij. Ai u tha: *“Ai i cili e kundërshton synetin tim, nuk është prej meje.”*

Pastaj grumbulloi njerëzit dhe u mbajti një fjalim, ku tha: *“Si është puna e njerëzve që e kanë bërë të ndaluar fjetjen me gratë, ushqimin, gjërat e mira që i ka lejuar All’llahu i Lartësuar, gjumin dhe kënaqësitë e kësaj bote? Unë nuk iu kam urdhëruar që të bëheni priftërinj e murgj, nuk është prej fesë sime që të lëmë mishin dhe gratë dhe të veçohemi vetëm në vendadhurime. Në të vërtetë, turizmi i ymetit tim është agjërimi dhe murgjëria e tij është xhihadi. Adhurojeni All’llahun e Lartësuar dhe mos i shoqëroni Atij asgjë e askënd, kryejeni haxhin dhe umren, faleni namazin, jepeni zekatin, agjëroni muajin e Ramazanit, bëni drejtësi, qëndroni në rrugë të drejtë që Ai t’ju forcojë në këtë rrugë! Sigurisht, janë shkatërruar ata që kanë qenë përpara jush për shkak të vështirësisë dhe të ashpërsisë. Ata ashpërsuan vetat e tyre dhe All’llahu ua vështirësoi atyre...”*

Ata që u betuan se do t’i braktisnin këto gjëra, thanë: *“O i Dërguari i All’llahut! Ne jemi betuar për këto gjëra, çfarë të bëjmë?”* Dhe kanë zbritur këto ajete duke iu përgjigjur atyre.¹

Patjetër duhet të themi se betimi i disave, si Othman ibn Medh’un, nuk ka qenë i lejuar, sepse i janë mohuar të drejtat e bashkëshortes së tij. Ndërsa betimi i Imam Aliut për ta kaluar natën me adhurim, ka qenë i lejuar. Por ajo që përfitohet nga këto ajete është se është më parësore që të mos jetë në formë të vazhdueshme dhe të mos jetë në kundërshtim me pagabueshmërinë e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse të njëjtën

¹ Tefsiri “Ali ibn Ibrahim”, vëll. 1, f. 179-180. Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”.

gjë ne e lexojmë për Profetin Muhammed në ajetin 1 (një) të sures “Tahrim”, ku thuhet: **“O Profet! Përse po ia ndalon vetes atë që ta ka lejuar All’llahu, duke kërkuar t’u bësh qejfin grave të tua?!”**

Komentimi

Betimi dhe shpagimi i tij

Në këtë ajet dhe në ajetet në vijim ka një mori rregullash të rëndësishme islame. Disa janë legjitimuar për herë të parë dhe disa të tjera kanë ardhur për përforsim dhe sqarim për rregullat e mëparshme që kanë ardhur në ajetet e tjera të Kur’anit, sepse kjo sure, siç kemi thënë edhe më parë, ka zbritur nga fundi i jetës së të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Për këtë, ishte i domosdoshëm përforsimi i rregullave të ndryshme islame.

Ajeti i parë tregon për veprën që bënë disa myslimanë duke ndaluar disa mirësi të All’llahut. All’llahu i Lartësuar ua ka ndaluar atyre këtë vepër, duke thënë: **“O ju që keni besuar! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat All’llahu jua ka lejuar...”**

Përmendja e këtij rregulli, duke marrë në konsideratë edhe shkakun e zbritjes, mund të jetë tregues se nëse në ajetet e mëparshme gjendej diçka prej falënderimit për një grup dijetarësh të krishterë, për shkak të solidarizimit të tyre ndaj drejtësisë dhe së vërtetës, Islami e ndalon murgërinë dhe braktisjen e kësaj jete, sikurse bëjnë të krishterët. Në ajetin 27 të sures “El Hadid”, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Sa për murgërinë, ne nuk ua dhuruam atë, por ata e shpikën vetë.”**

Pastaj, për ta përforcuar këtë çështje, ajeti ndalon tejkalimin e kufijve, sepse All'Ilahu nuk i do ata që e bëjnë këtë. Ajeti thotë: **"...dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, All'Ilahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin."**

Ajeti në vazhdim përforcon një çështje tjetër, ku thotë: **"Hani nga ato gjëra të lejuara e të mira që ju ka dhënë All'Ilahu!..."** Pra, këtu ka urdhër për të përfituar nga mirësitë e All'Ilahut. Kushti i vetëm për këtë është drejtësia, balancimi dhe devotshmëria, kur i gëzon këto mirësi. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...Frikësojuni All'Ilahut, të Cilit ju i keni besuar!"** Kjo do të thotë se besimi juaj në All'Ilahun ju detyron që të respektoni urdhrat e Tij në kënaqësi e drejtësi, në ekuilibër e frikë.

Është edhe një alternativë tjetër në komentimin e këtij ajeti, që është: Urdhri për t'iu frikësuar All'Ilahut do të thotë se ndalimi i të lejuarave nuk bashkohet me gradat e devotshmërisë së përsosur, sepse devotshmëria e detyron njeriun që të mos e tejkalojë kufirin e balancimit në të gjitha çështjet.

Ajeti në vijim trajton betimin kur njeriu betohet në rastin e ndalimit të të lejuarave e në raste të tjera të përgjithshme. Mund të thuhet se betimi ndahet në dy grupe:

I pari, betimi pa qëllim, për të cilin All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"All'Ilahu nuk ju ndëshkon për betimin që e bëni pa qëllim..."** Në komentimin e ajetit 225 të sures "El Bekare", i cili trajton tematikën e mosndëshkimit ndaj betimit të paqëllimtë thamë se kuptimi i betimit të paqëllimtë, siç kanë thënë komentuesit dhe juristët islamë, është betimi që nuk ka qëllim të caktuar dhe bëhet me pavetëdije dhe pa vullnet nga njeriu kur thotë *uall'lah bil'lah* ose *jo uall'lahi, jo bil'lah*; ose betimi kur është

një gjendje mërzie, hidhërimi apo nervozizmi që bëhet pa vetëdije.¹

Disa thonë: “Nëse njeriu është i sigurt për një çështje dhe betohet e më pas i qartësohet se ai ka gabuar në këtë gjë, betimi i tij, gjithashtu, konsiderohet si betim i paqëllimtë. Për shembull, nëse dikush është i sigurt për tradhtinë e bashkëshortes së tij nga thashethemet dhe fjalët e disa njerëzve dhe betohet për t’u divorcuar nga ajo, e pastaj i qartësohet se çfarë ka dëgjuar për bashkëshorten e tij është gënjeshtër dhe trillim, në të vërtetë, ky lloj betimi nuk merret në konsideratë. Ne e dimë se në shtesë të qëllimit dhe vendosmërisë në betimin e vërtetë, duhet që përmbajtja e betimit të mos jetë përbuzëse e as haram (e ndaluar).

Nëse dikush betohet për të bërë një vepër të ndaluar ose të urryer, me të vërtetë, betimi i tij nuk ka vlerë dhe nuk është i detyrueshëm që ta zbatojë. Ka mundësi që kuptimi i fjalës *el legvu*, që ka ardhur në këtë ajet, të ketë shumë kuptime, ku mund të përfshijë edhe këtë lloj betimi.

I dyti, betimi me qëllim dhe me vullnet, të cilin personi e bën me vetëdije të plotë. Ky lloj betimi është ai, për të cilin All’llahu ndëshkon nëse njeriu nuk e mban premtimin e zbatimit të tij. Ajeti thotë: **“...por ju ndëshkon për betimin e bërë me qëllim...”**

Fjala *“ahd”* në këtë ajet, do të thotë, siç e kemi thënë në fillim të kësaj sureje (Maide), bashkimi i dy anëve të diçkaje me lidhje të fortë. Nga kjo ka ardhur edhe emërtimi i lidhjes së dy anëve të litarit me fjalën *“el ukdetu”*. Më pas, ky emërtim është përdorur për anën shpirtërore. Fjala *el akd* përdoret për çdo

¹ “Usulul Kafij”, vëll. 7, f. 443.

marrëveshje dhe zotim. Kështu që fjala *akdul ejman* (betimi me qëllim), që përmendet në këtë ajet, do të thotë zbatimi i çdo betimi që bëhet me vullnet, vendosmëri dhe seriozitet.

Është e pakundërshtueshme se vetëm vendosmëria në betim nuk mjafton në saktësinë e betimit, por patjetër duhet edhe vërtetësia e përmbajtjes së tij. Sikurse e thamë, duhet që të jetë në çështje të lejuara, përndryshe betimi në të tjerë, përveç All'llahut, nuk ka vlerë. Kur një njeri betohet në All'llahun se do të bëjë vepra të pëlqyera ose së paku vepra të lejuara, është detyrim që ta zbatojë betimin e tij. Nëse nuk e bën, duhet që të shlyejë shpagimin. Shpagimi i betimit, siç ka ardhur në këtë ajet, është një nga këto tri gjëra:

E para: Thënia e All'llahut të Lartësuar: **“...Larja e gjynahut për thyerjen e betimit është: ushqyerja e dhjetë të varfërve...”** Me qëllim që ky rregull të mos merret si rregull i përgjithshëm, ku të përfshijë të gjitha ushqimet, të mira e të këqija, ka ardhur shpjegimi i llojit të ushqimit, i cili nuk duhet të jetë më i paktë sesa mesatarja e ushqimit që ushqehen pjesëtarët e një familjeje të zakonshme, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“...me mesataren e ushqimit të familjes suaj...”**

Në dukje ajeti tregon për një lloj mesatareje ushqimi, por mundet që të tregojë për sasinë dhe cilësinë. Ka ardhur nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se kufiri mesatar është cilësia, ndërsa nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet se kufiri mesatar është sasia, pra, e mesmja në sasi dhe në cilësi.¹

Nuk është nevoja që të thuhet se kufiri mesatar në cilësi apo në sasi ndryshon me ndryshimin e vendeve e kohëve.

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 666. Tefsiri “Burhan”, vëll. 1, f. 496.

E dyta: Fjala e All'llahut të Lartësuar: “...ose t'i vishni ata...” Është e natyrshme se kjo ka kuptimin e rrobave që mbulohet trupi sipas zakonisht. Për këtë kanë ardhur disa transmetime nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), që e kanë qartësuar se qëllimi me veshjen në këtë ajet janë dy pjesë rrobash (pantallonat dhe një rrobë tjetër). Ndërsa transmetimi i ardhur nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), në të cilin thuhet se një petk i vetëm mjafton, ndoshta tregon për rrobën (deshdashen) e gjatë e të njohur arabe që mbulon të gjithë trupin. Sa u përket grave, nuk ka dyshim se një petk nuk mjafton, por patjetër duhet që të mbulohet koka, qafa e deri te këmbët. Pra, ky është kufiri për sa i përket rrobës së femrës. Petku që i dhurohet për shpëtim të betimit ndryshon edhe sipas stinëve, vendit e kohës.

Ndërsa për sa i përket cilësisë, a është i mjaftueshëm kufiri më i ulët apo duhet të ruhet kufiri i mesatares? Për këtë çështje, komentuesit kanë dy mendime:

1- Çdo veshje është e mjaftueshme, nëse merret ajeti në kuptimin e tij të përgjithshëm.

2- Meqenëse ruhet kufiri i mesatares në dhënien e ushqimit, patjetër që duhet të ruhet ky kufi edhe në veshje. Mendimi i parë përputhet më shumë me kuptimin e ajetit.

E treta: Thënia e All'llahut të Lartësuar: “...ose të lironi një skllav...” Në mesin e juristëve islamë ka një mendim të veçantë për fjalën skllav se vallë, a kushtëzohet në të besimi dhe Islami, apo jo? Shpjegimi i këtij mendimi ndodhet në librat e jurisprudencës islame, edhe nëse ajeti në dukje ka kuptimin e përgjithshëm.

Kjo tregon se Islami ndërmjetëson në rrugë e forma të ndryshme për t'i dhënë lirinë skllavit.

Ndërsa në kohët e sotme, ku duket se nuk ekziston skllavëria, është detyrim i myslimanëve që të zgjedhin njërën nga këto të dy shpagime: të ushqyerit ose të veshurit e nevojtarit. Nuk ka dyshim se këto tri tematika janë të ndryshme për nga vlera e tyre. Ndoshta qëllimi i këtij ndryshimi është liria e njeriut për të zgjedhur llojin e shpagimit që i përshtatet mundësisë së tij materiale. Por, mund të gjenden njerëz të cilët nuk i kanë këto mundësi. Për këtë, pasi i ka shpjeguar ato rregulla, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Ai që nuk gjen mundësi për këto, le të agjërojë tri ditë..."**

Pra, agjërimi i tri ditëve është detyrim për ata që nuk janë në gjendje t'i shlyejnë tri shpagimet e mëparshme. Pastaj, All'llahu përforcon dhe thotë: **"...Kjo është shlyerja për thyerjen e betimeve tuaja, nëse betoheni..."**

Mirëpo, me qëllim që askush të mos mendojë se me shlyerjen e shpagimit i lejohet personit që të kthehet nga betimi i vërtetë, që ai është betuar se All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Mbani betimet tuaja!..."**

Thënë ndryshe: Zbatimi i betimit është detyrim i domosdoshëm dhe moszbatimi i tij është i ndaluar (haram). Shpagimi kryhet kur nuk zbatohet betimi.

Në mbyllje të këtyre ajeteve, Kur'ani na qartëson se këto ajete u shtjellojnë juve rregulla të cilat përmbajnë kënaqësinë e individit e të shoqërisë dhe siguria e tyre që ta falënderoni All'llahun e Lartësuar për këtë gjë, ku ai thotë: **"...Kështu jua shpjegon All'llahu Fjalët dhe ligjet e Veta, që të jeni mirënjohës."**

Ajetet 90 - 92

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْحَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَمُ
 رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٩٠﴾
 إِنَّمَا يُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ يُوقَعَ بَيْنَكُمْ اَلْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ فِي الْحَمْرِ
 وَالْمَيْسِرِ وَيُصَدِّكُمْ عَنِ ذِكْرِ اللَّهِ وَعَنِ الصَّلَاةِ ۖ فَهَلْ أَنْتُمْ مُنْتَهُونَ
 ﴿٩١﴾ وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأَحْذَرُوا ۚ فَإِن تَوَلَّيْتُمْ
 فَأَعْلَمُوا أَنَّمَا عَلَى رَسُولِنَا الْبَلْغُ الْمُبِينُ ﴿٩٢﴾

“O ju që keni besuar! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e shejtanit. Prandaj largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!”

“Vërtet, shejtani me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e All’liahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”

“Bindjuni All’liahut dhe bindjuni të Dërguarit! Kujdes! Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë Shpalljen e qartë!”

Shkaku i zbritjes

Komentimet shiite dhe ato synite përmendin transmetime të ndryshme për shkakun e zbritjes së ajetit të parë, që janë pothuajse të ngjashme me njëra-tjetrën. Prej këtyre transmetimeve është ai që përmendet në tefsirin “Ed Durrul Menthur”, se Sad ibn Ebi Uekas ka thënë: “Me të vërtetë, ky ajet ka zbritur për mua, ku një ensar (përkrahës) kishte përgatitur ushqim dhe më ftoi bashkë me disa të tjerë. E hëngrëm ushqimin dhe pimë alkool. Kjo ndodhi përpara se ta ndalonte Islami alkoolin. Kur u ra pija në kokë e u dehën, filluan që të krenoheshin dhe fjalët u ngritën pak e nga pak, derisa njëri prej tyre mori një kockë deveje dhe më goditi në hundë e ma theu atë. Shkova tek i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i tregova se çfarë ndodhi dhe zbriti ky ajet.¹

Në “Musnedin” e imam Ahmedit, “Sunen” e Ebu Daud, “Nisaij” dhe “Termidhij” thuhet se Omeri (pinte shumë alkool, siç thuhet në tefsirin “Dhilalul Kur’an”, vëll. 3, f. 33), i lutej All’llahut që t’i zbriste një rregull i qartë për alkoolin. Kur zbriti ajeti 219 i sures “El Bekare”, që thotë: **“Të pyesin ty për verën dhe kumarin”**, dhe i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua lexoi, ai (Omeri) vazhdonte të lutej dhe të kërkonte më shumë sqarime, derisa zbriti ajeti 43 i sures “En Nisa”, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar, mos u falni kur jeni të dehur!”** Sërish i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua lexoi, mirëpo ai vazhdonte të lutej, derisa zbriti ky ajet që e qartësoi rregullin e alkoolit në formë të plotë. Kur i

¹ Tefsiri “Durul Menthur”, vëll. 2, f. 315. Tefsiri “Mijzan”, vëll. 6, f. 132.

Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia lexoi këtë ajet Omerit, ai tha: "Hoqëm dorë. Hoqëm dorë."¹

Komentimi

Periudhat e ndalimit të alkoolit dhe rregulli i tij përfundimtar

Në komentimin e ajetit 43 të sures "En Nisa" thamë se alkooli në kohën e injorancës (para Islamit) dhe në fillim të Islamit ka qenë i përhapur si një epidemi e përgjithshme, saqë thuhej se dashuria e arabëve në kohën e injorancës ka qenë e kufizuar në tri gjëra: poezi, alkool dhe luftra.

Nga disa transmetime përfitohet se edhe pas ndalimit të alkoolit, heqja dorë nga ai ka qenë shumë e vështirë për disa myslimanë, saqë kanë thënë: "Nuk na është ndaluar gjë më e vështirë se sa alkooli."²

Është më se e qartë se nëse Islami do të dëshironte që ta luftonte këtë sëmundje të madhe e gjithëpërfshirëse, pa marrë parasysh gjendjen shpirtërore e shoqërore, ndalimi do të ishte i vështirë të zbatohet. Për këtë arsye, Islami ka mënyrën graduale të ndalimit duke përgatitur mendjet dhe zemrat për ta çrrënjësuar këtë epidemi nga rrënjët saj. Pirja e alkoolit ishte një zakon që kishte lëshuar rrënjë në zemrat dhe gjakun e tyre. Shenjat e para në ajetet e shëmtimit të pirjes së alkoolit erdhën në ajetin 67 të

¹ Tefsiri "El Manar", vëll. 7, f. 50.

² Tefsiri "El Manar", vëll. 3, f. 51.

suress “En Nahl”, ku thuhet: **“Ndërsa nga frutat e palmave dhe të hardhisë, ju përgatitni pije dhe furnizim të mirë...”**

Fjala *sikr*, që ka kuptimin e pijes dehëse, të cilën e prodhonin nga hurmat dhe rrushi, është vendosur në anë të furnizimit të mirë dhe pijen jo të mirë e konsideronin furnizim jo të mirë. Mirëpo, ai zakon i shëmtuar (zakoni i dhënies pas alkoolit) ka qenë shumë i thellë dhe ishte e vështirë që të rrënjosej vetëm me këto sinjale. Alkooli ishte mjeti i tyre ekonomik. Për këtë arsye, kur myslimanët emigruan në Medine dhe formuan bazat e para të shtetit islam, zbriti ajeti i dytë më i rreptë në ndalim sesa ajeti i parë, që t’i përgatiste mendjet e tyre më shumë për ta ndaluar përfundimisht. Ajeti 219 i sures “El Bekare”, thotë: **“Të pyesin ty për verën dhe kumarin, thuaju: ‘Ato u sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi njerëzve, megjithatë dëmi i tyre është më i madh se dobia’.”**

Këtu tregohet për dobitë ekonomike të alkoolit për disa shoqëri, siç ishte ajo e xhahilijetit, por më pas tregohet për rreziqet e saj të mëdha dhe të dëmshme, që ua kalojnë shumë herë dobive të saj ekonomike dhe fitimprurëse.

Pastaj, në ajetin 43 të sures “El Nisa”, All’llahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar! Mos u falni kur jeni të dehur, prisni sa të kthjelloheni e të dini se çfarë flisni!”**, i urdhëron myslimanët, me urdhër të qartë, që të mos e falin namazin kur janë nën ndikimin e pijes alkoolike, derisa të dinë çfarë të flasin përpara All’llahut.

Është e qartë se kjo nuk do të thotë se lejohet pirja e alkoolit jashtë namazit, por ajo është çështje e përshkallëzimit të ndalimit të alkoolit. Pra, ky ajet sikur hesht dhe nuk thotë asgjë të qartë jashtë kohës së namazit.

Vërtet, ecuria e myslimanëve në njohjen e rregullave islame dhe përgatitja e tyre mendore për të zhdukur këtë shkatërrues të madh shoqëror që ka qenë i rrënjosur në zemrat e tyre, u bënë shkak për zbritjen e këtij ajeti që flet qartë për ndalimin e alkoolit.

Ky ajet ia mbylli rrugët të gjithë atyre të cilët sillnin arsye dhe shfajësime rreth dobive të alkoolit.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ndalimi i alkoolit në këtë ajet përshkruhet në forma të llojllojshme:

1- Ajeti fillon duke iu drejtuar besimtarëve, ku thotë: **“O ju që keni besuar!”**, që do të thotë se moszbatimi i këtij urdhri nuk përshtatet me shpirtin e besimit.

2- Përdorimi i fjalës *“innema”*, e cila ka kuptimin e kufizimit dhe të përforcimit.

3- Alkooli dhe bixhozi janë vendosur në anë të idhujve për të argumentuar se alkooli dhe bixhozi nuk kanë më pak dëm sesa adhurimi i idhujve. Për këtë ka ardhur një hadith nga i Dërguari All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): *“Pirësi i alkoolit është si adhuruesi i idhujve.”*¹

4- Pirjen e alkoolit, bixhozin, adhurimin e idhujve dhe hedhjen e lojërave të fatit, Kur’ani i ka konsideruar vepra të ndyta, ku thotë: **“Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta...”**

5- Të gjitha këto vepra të shëmtuara janë prej veprave të shejtanit: **“...nga punët e shejtanit.”**

6- Në fund sjell një urdhër të prerë që duhet ndjekur, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“...prandaj largohuni nga këto!”**. Patjetër, duhet patur kujdes se fjalia **“...prandaj largohuni nga këto!”**, ka një kuptim më të gjerë, sepse fjala *“ixhtinab”*, do të

¹ Tefsiri “Xhamiul Bejjan”, vëll. 7, f. 31, tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 669.

thotë të largohesh, të ndahesh e të mos i afrohesh kurrë këtyre veprave, gjë që është më e rreptë dhe më e prerë se ndalimi i pirjes së alkoolit.

7- Në mbyllje, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Me qëllim që të shpëtoni!”**, e sigurisht përveç kësaj, ju nuk keni shpëtim.

8- Ajeti në vazhdim përcakton disa dëme të alkoolit dhe të bixhozit, ku shejtani dëshiron që t'i fusë njerëzit në kurth, ku thotë: **“Vërtet, shejtani, me pije alkoolike dhe me bixhoz, kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e All'llahut dhe kryerja e namazit...”**

9- Në mbyllje të këtij ajeti, shfaqet një pyetësor i qartë dhe vendimtar që thotë: **“...Prandaj, a po hiqni dorë?”** Vallë, pas gjithë këtij sqarimi dhe përforcimi, a ka vend për shfajësime dhe dyshime rreth largimit nga këto dy gjynahe të mëdha? Për këtë, ne shohim se Omeri, i cili ka qenë i dhënë pas alkoolit (sikurse kanë treguar komentuesit e Ehli Syneetit), nuk i ka konsideruar ajetet e mëparshme si të mjaftueshme për ndalimin e alkoolit. Kur e ka dëgjuar këtë ajet, ka thënë: “Hoqëm dorë. Hoqëm dorë.” Në këtë ajet ai pa argument të mjaftueshëm për t'u larguar nga alkooli.

10- Ajeti i tretë, i cili e përforcon këtë rregull, i urdhëron myslimanët duke thënë: **“Bindjuni All'llahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe bëni kujdes!”**.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar i paralajmëron devijuesit me ndëshkim dhe se misioni i të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është ta përcjellë fjalën e All'llahut të Lartësuar, ku thotë: **“...Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë!”**

Hulumtime

Ndikimet shkatërruese të alkoolit dhe të bixhozit

Edhe pse në komentimin e ajetit 219 të sures “El Bekare”, në vëllimin e dytë të këtij komentimi, treguam shkurtimisht për dëmet e këtyre dy epidemive shoqërore (alkooli dhe bixhozi), për ta përforcuar këtë çështje, po shtojmë edhe disa çështje të tjera, të cilat janë disa statistika të ndryshme, ku secila prej tyre konsiderohet si dëshmi e plotë që tregon madhështinë e dëmeve që shkaktojnë (alkooli dhe bixhozi) dhe ndikimin e thellë negativ që lënë në ndërgjegjen e njeriut.

1- Në një statistikë të dalë në Britani për çështjen e çmendurisë alkoolike dhe krahasimi i saj me çmendurinë e zakonshme, thuhet se nga 2249 të çmendur për shkak të alkoolit, vetëm 53 janë të çmendur nga shkaqe të ndryshme.¹

2- Në një statistikë tjetër në Amerikë thuhet se 85% e të prekurve nga sëmundjet shpirtërore e psikike janë ata të varurit pas alkoolit.²

3- Dijetari anglez Benton thotë: “Pijet alkoolike i kanë ndryshuar banorët e veriut në njerëz të çmendur dhe banorët e jugut në njerëz budallenj.” Pastaj shton: “Me të vërtetë, feja islame i ka ndaluar të gjitha llojet e pijeve dehëse dhe kjo është një prej veçorive të Islamit.”³

¹ Seminari i alkoolit, f. 65.

² Seminari i alkoolit, f. 65.

³ Tefsiri “Tantaujj”, vëll. 1 f. 165.

4- Nëse do të bënim statistika për të dehurit (apo të atyre që janë të dhënë pas alkoolit), të cilët janë vetëvrarë, kanë kryer krime dhe kanë shkatërruar familjet, do të kishim një numër të madh e të frikshëm.¹

5- Në Francë vdesin çdo ditë 440 persona nga alkooli.²

6- Statistika të tjera nga Amerika thonë se numri i të sëmurëve psikikë gjatë një viti arrin dy herë më shumë se të vrarët në Luftën e Dytë Botërore. Dijetarët amerikanë mendojnë se shkaku për këtë është pirja e alkoolit dhe tymosja (duhani dhe llojet e drogave që pihen me anë të tymosjes).³

7- Në disa statistika të kryera nga shkencëtari i njohur Huger, që i ka botuar në revistën "El Ulum" me rastin e 20-vjetorit të themelimit të kësaj reviste, thuhet se 60% e vrasjeve të qëllimshme, 75% të rrahjeve dhe plagosjeve, 30% e krimeve morale (që përfshin edhe kurvëri me të afërmit) dhe 20% e vjedhjeve kanë si shkak pirjen e alkoolit. Po nga ky dijetar thuhet se 40% e fëmijëve kriminelë kanë trashëguar ndikimet e alkoolit.⁴

8- Vërtet, humbjet që godasin ekonominë britanike për shkak të mosshkuarjes në punë të punëtorëve për shkak se janë të alkoolizuar, arrin shifrën vjetore rreth 50 milionë dollarë, çka do të mjaftonte për të ngritur mijëra kopshte për fëmijë, shkolla fillore e të mesme.

9- Statistikat që janë botuar rreth humbjeve nga përdorimi i madh i alkoolit në Francë thonë se bankat franceze japin një buxhet vjetor që e arrin shumën 137 milionë franga, duke shtuar edhe 60 miliardë franga që shpenzohen për gjyqtarët dhe burgjet,

¹ Enciklopedia "Ferijd Vexhdij", vëll. 3, f. 790.

² "Epidemitë shoqërore në këtë shekull", f. 205.

³ Botime dhe shpërndarje "Bota e re".

⁴ Seminari i alkoolit, f. 66.

60 miliardë franga për ndihmat e përgjithshme (ndihmë sociale) dhe shoqata bamirësie, 10 miliardë franga për spitalet, veçanërisht për ata të dhënë pas alkoolit, 70 miliardë franga për sigurimet shoqërore. Kështu qartësohet se numri i të sëmurëve psikikë dhe spitalet e sëmundjeve mendore, krimet e vrasjeve, sherret, vjedhjet, aksidentet e ndryshme janë në përputhje me numrin e bareve dhe klubeve të alkoolit.¹

10- Qendrat statistikore në Amerikë kanë konstatuar se bixhozi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në 30% të krimeve. Në një statistikë tjetër thuhet se 40% e vjedhjeve, 50% e krimeve seksuale, 10% e shkatërrimit moral, 30% e divorceve, 40% e rrahjeve dhe e plagosjeve dhe 5% e aksidenteve e vetëvrasjeve ndodhin për shkak të bixhozit.

¹ Seminar i alkoolit, f. 66.

Ajeti 93

لَيْسَ عَلَى الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ جُنَاحٌ فِيمَا
 طَعِمُوا إِذَا مَا اتَّقَوْا وَءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ ثُمَّ اتَّقَوْا
 وَءَامَنُوا ثُمَّ اتَّقَوْا وَأَحْسَنُوا ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿٩٣﴾

“Nuk ka gjynah për ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, për atë që kanë ngrënë, për sa kohë që ata ruhen (nga të ndaluarat), besojnë dhe bëjnë vepra të mira, e sërish ruhen dhe besojnë e vazhdimisht ruhen dhe bëjnë vepra të mira. All’llahu i do punëmirët.”

Shkaku i zbritjes

Ka ardhur në tefsirin “Mexhmaul Bejjan”, në tefsirin “Tabarij”, në tefsirin “Kurtubij” e në tefsire të tjera, se pas zbritjes së ajetit të ndalimit të alkoolit dhe të bixhozit, disa shokë të të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë thënë: “Nëse këto dy vepra janë kaq të rënda, si do të jetë gjendja e myslimanëve të cilët vdiqën para zbritjes së këtij ajeti dhe që i vepronin ato?” Atëherë zbriti ky ajet si përgjigje për ata.¹

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 412.

Komentimi

Ky ajet u përgjigjet atyre që pyetën për të kaluarën, përpara se të zbriste ajeti i ndalimit të alkoolit e bixhozit, e madje, edhe për ata që nuk e kanë dëgjuar këtë ajet për shkak të largësisë së vendeve ku banojnë, duke thënë: **“Nuk ka gjynah për ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira për atë që kanë ngrënë...”** Mirëpo, këtë e kushtëzon me devotshmërinë, besimin dhe veprat e mira, ku thotë: **“...për sa kohë që ata ruhen** (nga të ndaluarat), **besojnë dhe bëjnë vepra të mira...”** Pastaj përsërit: **“...e sërish ruhen dhe besojnë...”** Edhe një herë përsërit, por me një ndryshim të vogël, e thotë: **“...e pastaj ruhen dhe bëjnë vepra të mira...”**. Ajeti përfundon me përforcimin se **“...All’llahu i do punëmirët.”**

Ndërmjet komentuesve të mëparshëm dhe atyre të sotëm ka shumë fjalë rreth këtyre përsëritjeve në këtë ajet. Disa e shohin si përforcim dhe thonë se rëndësia e devotshmërisë, e besimit dhe e kryerjes se veprave të mira e bën të domosdoshëm kthimin, përsëritjen dhe përforcimin.

Mirëpo një grup tjetër komentuesish besojnë se çdo fjalë në këtë fjali të përsëritur tregon një të vërtetë të ndarë e të veçuar nga tjetra. Ka mendime të ndryshme rreth ndryshimit të çdo fjalie nga njëra-tjetra, por shumica e këtyre mendimeve nuk bazohet në ndonjë argument.

Ndoshta më e mira çfarë thuhet për këtë tematikë është thënia se qëllimi me fjalën *tekua* herën e parë, është ndjenja e brendshme për përgjegjësinë, e cila e nxit njeriun për të kërkuar e për të vërtetuar në fe, për t’u njohur me mrekullitë e të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për të hulumtuar rreth njohjes së All’llahut.

Atëherë, rezultati i kësaj është besimi dhe kryerja e veprave të mira.

Thënë ndryshe: Nëse tek njeriu nuk gjendet diçka nga *tekua*ja, *ruajtja*, *devotshmëria*, ai nuk do të drejtohej për të kërkuar të vërtetën. Për këtë, ardhja e fjalës *tekua* herën e parë në këtë ajet, tregon sasinë e *tekua*s. Këtu nuk ka kundërshtim me fillimin e ajetit që thotë: **“Nuk ka gjynah për ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira...”** sepse, besimi këtu mund të ketë kuptimin e *dorëzimit të dukshëm*, kurse besimi që arrihet pas devotshmërisë, është besimi i vërtetë.

Përsëritja e *tekua*s, *devotshmërisë*, *ruajtjes*, për herë të dytë, tregon për *tekuanë* që gjendet në thellësinë e njeriut dhe shtohet ndikimi i saj. Rezultati i kësaj *tekua*je është besimi i fortë që nxit dhe inkurajon për të bërë vepra të mira. Për këtë arsye, në fjalinë e dytë, togfjalëshi *vepra të mira* nuk ka ardhur pas fjalës *besim* **“...e sërish ruhen dhe besojnë...”** Që do të thotë se ky besim është i fortë dhe nuk është nevoja që të përmenden veprat e mira.

Ndërsa në herën e tretë bëhet fjalë për *tekuanë*, *devotshmërinë*, *ruajtjen*, që ka arritur në gradën më të lartë, e cila përveç nxitjes për të kryer detyrimet, gjithashtu, nxit për të bërë vepra të mira, të cilat nuk janë të detyrueshme.

Sido që të jetë, këto tre shembuj rreth *tekua*së tregojnë për tri periudhat e ndjenjës ndaj përgjegjësisë dhe çdo periudhë që tregohet në këtë ajet argumentohet.

Ndërsa për atë që kanë thënë disa komentues të tjerë rreth trajtimit të këtij ajeti, për tre llojet e *tekua*së, devotshmërisë dhe tre llojet e *imanit* (besimit), nuk ka as argument e as dëshmi.

Ajetet 94 - 96

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لِيَبْلُوكُمْ اللَّهُ بَشَىءٍ مِّنَ الصَّيْدِ تَنَالُهُ
 أَيْدِيكُمْ وَرِمَاحُكُمْ لِيَعْلَمَ اللَّهُ مَن خَافَهُ بِالْغَيْبِ ۚ فَمَن اَعْتَدَىٰ
 بَعْدَ ذَلِكَ فَلَهُ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٩٤﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَقْتُلُوا
 الصَّيْدَ وَأَنتُمْ حُرُمٌ ۚ وَمَن قَتَلَهُ مِنكُم مُّتَعَمِّدًا فَجَزَاءٌ مِّثْلُ مَا
 قَتَلَ مِنَ النَّعْمِ تَحَكُّمٌ بِهِ ذَوَا عَدْلٍ مِّنكُم هَدِيًّا بَلِغِ الْكَعْبَةَ
 أَوْ كَفَرَةً طَعَامُ مَسْكِينٍ أَوْ عَدْلُ ذَلِكَ صِيَامًا لِّيَذُوقَ وَبَالَ
 أَمْرِهِ ۚ عَفَا اللَّهُ عَمَّا سَلَفَ ۚ وَمَن عَادَ فَيَنْتَقِمُ اللَّهُ مِنْهُ ۚ وَاللَّهُ
 عَزِيزٌ ذُو انْتِقَامٍ ﴿٩٥﴾ أُحِلَّ لَكُم صَيْدُ الْبَحْرِ وَطَعَامُهُ مَتَعًا
 لَّكُمْ وَلِلسَّيَّارَةِ ۚ وَحُرِّمَ عَلَيْكُم صَيْدُ الْبَرِّ مَا دُمْتُمْ حُرُمًا ۚ
 وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٩٦﴾

“O ju që keni besuar! All’Ilahu do t’ju provojë me ndalim nga një gjueti që e arrijnë duart dhe shigjetat tuaja, që All’Ilahu ta njohë atë që i frikësohet Atij, kur askush nuk e sheh. E, kushdo që kalon kufirin, për të ka dënim pikëllues.”

“O ju që keni besuar! Mos gjuani, duke qenë në *ihram*! Kushdo që e vret gjahun me paramendim, për dënim duhet të therë si

kurban në Qabe, një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën e gjuajtur, sipas vlerësimit të dy njerëzve të drejtë midis jush; ose të ushqejë disa të varfër për të larë gjynahun; ose të agjërojë në atë masë, që ta ndiejë ndëshkimin për gjynahun e bërë. All'llahu e fal atë që ka kaluar (para ndalimit). Ndërsa atë që vepron pas ndalimit, All'llahu do të hakmerret ndaj tij. All'llahu është i Plotfuqishëm Hakmarrës."

"Ju është lejuar gjuetia e detit dhe ushqimi nga deti është për t'u kënaqur ju dhe udhëtarët, por ju është ndaluar gjuetia e tokës, deri sa të gjendeni në *ihram*. Kijeni frikë All'llahun, para të Cilit do të tuboheni!"

Shkaku i zbritjes

Në librin "El Kafij" dhe në shumë tefsire të tjera thuhet se në vitin e ndodhisë së Hudejbijes, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) së bashku me disa myslimanë kishin veshur ihramin dhe ishin drejtuar për të kryer Umren. Gjatë udhëtimit ata u ndeshën me shumë kafshë të egra dhe kishin mundësinë që t'i gjuanin ato kafshë me dorë ose me shtiza. Kafshët ishin aq shumë, saqë vinin rreth çadrave dhe lëviznin në mesin e njerëzve. Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, ka zbritur në këtë kohë dhe u tërheq vëmendjen myslimanëve për gjuetinë e kafshëve dhe e konsideron ndalimin e tyre nga gjuetia një lloj sprove për ta.¹

¹ "Usulul Kafij", vëll. 4, f. 396. "Uesailu Shia", vëll. 12, f. 415 dhe 417.

Komentimi

Rregullat e gjuetisë kur vishet ihrami

Këto ajete tregojnë rregullat e gjuetisë gjatë ritualit të Haxhit dhe të Umres, qoftë kjo gjueti në tokë apo në det. Ajeti i parë fillon duke treguar se çfarë u ndodhi myslimanëve në Umren e Hudejbijes, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar! All'Ilahu do t'ju provojë me ndalim nga një gjueti që e arrijnë duart dhe shigjetat tuaja...”**

Nga përshkimi i këtij ajeti përfitohet se All'Ilahu i Lartësuar do që t'i lajmërojë njerëzit për diçka që do të ndodhë në të ardhmen. Gjithashtu, duket se gjuetia në atë vend nuk ishte një çështje e njohur dhe e zakonshme. Ky ka qenë një provim për myslimanët, veçanërisht nëse merret në kosideratë nevoja e madhe që kishin ata për të gjetur ushqimin e tyre nga ajo gjueti, e cila ishte e sigurtë në duart e tyre. Vërtet, në atë kohë, privimi i njerëzve nga ky ushqim i afërt, konsiderohet një provim i madh për ta.

Disa kanë thënë se qëllimi me fjalinë **“që e arrijnë duart”** është se ata mund t'i gjuanin me rrjetë apo me kurth. Ndërsa ajeti tregon se me të vërtetë, ata ishin në gjendje që ta kapnin gjahun me dorë. Pastaj, për ta përforcuar, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“...që All'Ilahu ta njohë atë që i frikësohet Atij...”** Më parë kemi shpjeguar në vëllimin e parë të këtij komentimi, në fund të ajetit 143 të sures “El Bekare” se fraza **“që t'i njohim”** ose **“që t'i njohë”**, e të ngjashme me këto, nuk kanë për qëllim se All'Ilahu

nuk ka ditur asgjë dhe se Ai do të dijë nëpërmjet sprovimit të njerëzve, por qëllimi është se All'llahu është i Gjithëditur për të vërtetat e brendshme dhe të jashtme të njerëzve. Vetëm qëllimi i brendshëm i njerëzve dhe gatishmëria e tyre e brendshme nuk mjaftojnë në plotësimin e ndëshkimit apo të shpërblimit. Por duhet që ai qëllim dhe ajo gatishmëri të shfaqet nëpërmjet punëve të jashtme që të kenë ndikim. (Për sqarim më të mjaftueshëm, shih ajetin 143 të sures "El Bekare").

Në mbyllje, ajeti u tërheq vëmendjen atyre që e kundërshtojnë këtë rregull të All'llahut me një ndëshkim të rreptë, ku thotë: **"...E, kushdo që ta kalojë kufirin, për të ka dënim pikëllues."**

Edhe pse fjalja e fundit e ajeti tregon ndalimin e gjuetisë gjatë kohës së veshjes së ihramit, ajeti në vazhdim paraqet një rregull të qartë, të prerë e të përgjithshëm për çështjen e ndalimit të gjuetisë kur është veshur ihrami (në Umre dhe Haxh), ku thotë: **"O ju që keni besuar! Mos gjuani, duke qenë në ihram!..."**

Vallë, ndalimi i gjuetisë (që është gjuetia në tokë, siç tregon ajeti që vjen në vijim) përfshin të gjitha llojet e kafshëve të tokës, qoftë mishi i tyre i lejuar apo i ndaluar, apo është i veçantë për ato që lejohet ngrënia e mishit të tyre?

Në këtë çështje, komentuesit dhe juristët nuk kanë mendim të përbashkët. Mirëpo është e njohur në mesin e juristëve (fukahave) Imamitë dhe komentuesve të tyre se ky rregull është i

përgjithshëm. Këtë gjë e përforcojnë edhe transmetimet e ardhura nga Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).¹

Ndërsa juristët e Ehli synetit, si Ebu Hanifja, janë të një mendimi me Imamitë. Prej tyre, edhe Shafiu ka mendimin se rregulli është i kufizuar për kafshët që lejohet ngrënia e mishit të tyre. Sido që të jetë, rregulli nuk përfshin kafshët shtëpiake, sepse kafshët shtëpiake nuk cilësohen me gjueti. Ajo që tërheq vëmendjen në transmetimet tona është se gjuetia nuk konsiderohet e ndaluar vetëm gjatë ihramit, por ndalimi përfshin edhe atë që ndihmon për të bërë gjueti, apo atë që tregon, gjithashtu.²

Disa mendojnë se gjuetia nuk përfshin kafshët, mishi i të cilave ndalohet për t'u ngrënë. Por, në të vërtetë çështja nuk është kështu, sepse qëllimi i gjuetisë është i ndryshëm, ndonjëherë është për mishin e tyre, herë tjetër, bëhet për lëkurën e gëzofin e tyre e herë tjetër, gjuetia ka për qëllim mbrojtjen prej tyre.

Për të mësuar më tepër rreth rregullave të gjuetisë së lejuar e të ndaluar, mund t'u ktheheni librave të jurisprudencës islame.

Pas kësaj, ajeti tregon për shpagimin e gjuetisë kur kryhet në kohën e ihramit, ku thotë: **"Kushdo që e vret gjahun me paramendim, për dënim duhet të thërë si kurban në Qabe, një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën e gjuajtur."**

Vallë, a është qëllimi i fjalës *mithl*, për ngjashmërinë në formë dhe në madhësi. Që do të thotë, se kur dikush gjuan një

¹ "Tehdhijb", vëll. 5, f. 300. "Uesailu Shia", vëll. 12, f. 415-416.

² "Uesailu Shia", vëll. 12, f. 415.

kafshë të madhe e të egër si struci, për shembull, a është detyrim që të zgjedhë si shlyerje një kafshë të madhe si deveja? Ose, nëse ka gjuajtur një kaproll, a duhet të jetë shlyerja e tij me një dash, i cili i afrohet kaprollit në masë e në formë? Apo ka si qëllim ngjashmërinë në vlerë?

Në mesin e juristëve dhe komentuesve të Kur'anit është i njohur mendimi i parë, sepse edhe aparenca e ajetit është më afër këtij kuptimi. E kjo se duke patur parasysh përgjithësinë e rregullit për kafshët që u lejohet ngrënia e mishit dhe atyre që u ndalohet ngrënia e mishit, në të vërtetë, shumica e këtyre kafshëve nuk e kanë vlerën e njëjtë, ku mund të zgjedhim të ngjashëm me të një kafshë shtëpiake.

Si do që të jetë, kjo mund të jetë e mundur në rast se ekziston e njëjta kafshë si nga forma e ashtu edhe nga masa. Ndërsa kur nuk ekziston i ngjashëm, nuk parapëlqehet që të vlerësohet gjuetia në asnjë formë prej formave dhe mund të zgjidhet një kafshë shtëpiake, mishi i së cilës është i lejuar, e cila i afrohet vlerës së gjahut.

Meqenëse çështja e ngjashmërisë mund të jetë e dyshimtë tek disa, Kur'ani ka sjellë një rregull: duhet që këtë çështje ta gjykojnë dy persona që janë të ditur dhe të drejtë. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Sipas vlerësimit të dy njerëzve të drejtë midis jush..."**

Në mesin e juristëve tanë është e njohur se shpagimi për gjuetinë kur është veshur ihrami për Umre, duhet të bëhet kurban në Mekë, kurse shpagimi për gjuetinë kur është veshur ihrami për të kryer Haxhin, duhet që kurban i për këtë të theret në Mina. Kjo

nuk bie në kundërshtim me ajetin, sepse, siç e tregon ky ajet, ai ka zbritur në kryerjen e Umresë.

Pastaj, All'Ilahu i Lartësuar thotë se nuk është e domosdoshme që shpagimi i gjuetisë kur është veshur ihrami të jetë në formën e kurbanit. Por mund të kompensohet me një nga këto dy gjëra, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...ose të ushqejë disa të varfër për të larë gjynahun; ose të agjërojë në atë masë..."**

Në të vërtetë, ajeti nuk tregon numrin e të varfërve të cilët duhet të ushqehen dhe as numrin e ditëve që duhen agjëruar. Përmendja e këtyre dy shpagimeve pranë njëri-tjetrit, tregon se qëllimi nuk është caktimi i numrit të mjëranëve që duhet të ushqehen, por qëllimi dhe përcaktimi i vlerës së kurbanit.

Përsa i përket arritjes së ekuilibrit mes agjërimit dhe ushqimit të të varfërve, kjo gjendet e sqaruar në librat e jurisprudencës islame.

Përsa i përket çështjes së nëse njeriu i veshur me ihram kryen gjueti, a duhet të zgjedhë një prej këtyre tre shpagimeve apo të zgjedhë me renditje një prej tyre, pra, në fillim kurbanin, nëse nuk mundet ushqimin e të varfërve dhe nëse nuk mundet agjërimin, juristët (fukahatë) kanë mendime të ndryshme rreth saj. Mirëpo, pamja e jashtëmje e ajetit tregon për lirinë e zgjedhjes.

Me të vërtetë, qëllimi në këtë shpagim është: **"...që ta ndiejë ndëshkimin për gjynahun e bërë..."**

Pastaj, përderisa asnjë rregull nuk ka ndikim kthimi në të shkuarën, All'Ilahu vazhdon e thotë: **"...All'Ilahu e fal atë që ka kaluar (para ndalimit)..."**

Ndërsa për atë që nuk i dëgjon e nuk i zbaton këto këshilla e vërejtje që janë përsëritur, nuk interesohet për rregullat e shpagimit dhe vazhdon të kundërshtojë rregullat e gjuetisë me ihram të veshur, atëherë, All'llahu i Lartësuar do të hakmerret në momentin e përshtatshëm. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“...Ndërsa për atë që vepron pas ndalimit, All'llahu do të hakmerret ndaj tij. All'llahu është i Plotfuqishëm, Hakmarrës.”**

Ka diskutime mes komentuesve të Kur'anit nëse shpagimi për gjuetinë që bëhet me ihram të veshur përsëritet me përsëritjen e veprimit apo jo. Në pamje të jashtme, ajeti tregon se përsëritja sjell hakmarrjen e All'llahut. Nëse do të përsëritej shpagimi, nuk duhet të përmendej hakmarrja e All'llahut, por do të përmendej përsëritja e shpagimit. Kjo është ajo çfarë ka ardhur nga fragmentet, të cilat kanë ardhur tek ne nga Ehli Bejti.¹

Pas kësaj, ajeti trajton gjuetinë e detit, ku thotë: **“Ju është lejuar gjuetia e detit dhe çdo ushqim nga deti...”** Cili është qëllimi i fjalës *ushqim*? Disa komentues mendojnë se është një lloj peshku që ngordh pa gjueti dhe del mbi sipërfaqen e ujit në det. Ne e dimë se kjo thënie nuk është e vërtetë, sepse peshku i ngordhur në këtë formë është i ndaluar, edhe pse disa transmetime të ardhura nga Ehli Syneti tregojnë se është i lejuar.²

Ajeti do që të lejojë dy gjëra: e para, gjuetinë në det; e dyta, ushqimin që merret nga kjo gjueti.

Pastaj ajeti tregon urtësinë në këtë rregull, ku thotë: **“...është për t'u kënaqur ju dhe udhëtarët...”**, që do të thotë: që ju

¹ “Usulul Kafij”, vëll. 4, f. 394. “Uesailu Shia”, vëll. 13, f. 93-95.

² “Sunen Kubra”, i El Bajhakij, f. 255.

të mos keni vështirësi në ushqimin tuaj, kur ju jeni të veshur me ihram (pra duke kryer Haxhin ose Umren); atëherë ju përfitoni nga një lloj i vetëm i gjuetisë, e cila është gjuetia në det.

Meqenëse ishte e njohur që peshku të cilin e mbarte udhëtari ishte peshk i kripur, për këtë disa komentues në komentimin e këtij ajeti kanë thënë se i lejohet vendasit që të ushqehet me peshk të freskët, ndërsa udhëtarit, me peshk të kripur.

Duhet patur parasysh se rregulli **“...ju është lejuar gjuetia e detit dhe ushqimi nga deti...”** nuk është rregull i përgjithshëm në lejin e gjuetisë së detit në përgjithësi, sikurse e mendojnë disa. Por qëllimi i ajetit është që t’i sqarojë atij që ka veshur ihram se gjuetia në det, e cila ka qenë e lejuar para ihramit, edhe në kohën e ihramit gjithashtu është e lejuar. Me fjalë të tjera, ajeti nuk qartëson thelbin e lejit të këtij ligji, por tregon veçoritë e ligjit që përpara është bërë legjitim. Ajeti nuk paraqet përgjithësimin e rregullit, por sqaron vetëm rregullën e ndalimit të gjuetisë në kohën e veshjes së ihramit.

Për ta përforcuar rregullin e mëparshëm, ajeti përsërit: **“...por ju është ndaluar gjuetia e tokës, deri sa të gjendeni në ihram...”** Dhe për të përforcuar të gjitha rregullat që përmendi, në mbyllje ajeti thotë: **“...Kijeni frikë All’lahun, para të Cilit do të tuboheni!”**

Hulumtime

Urtësia e ndalimit të gjuetisë në gjendjen e ihramit

Është e ditur se Haxhi dhe Umra janë adhurime që e largojnë njeriun nga bota materiale dhe e çojnë atë në një mjedis të mbushur me spiritualitet. Veçoritë e kësaj bote, polemikat, fyerjet, dëshirat seksuale dhe kënaqësitë materiale braktisen nga njeriu në periudhën kur kryen ritualet e Haxhit dhe të Umres. Në kryerjen e këtyre adhurimeve njeriu fillon një lloj aktiviteti fizik për Krijuesin e tij të lejueshëm. Mesa duket, ndalimi i gjuetisë së kafshëve në tokë në gjendjen e ihramit ka po të njëjtin qëllim.

Nëse do të ishte e lejueshme gjuetia për vizitorët e shtëpisë së All'Ilahut (Qabesë), duke patur parasysh numrin e madh të vizitorëve që shkojnë çdo vit në këtë Tokë të shenjtë e të bekuar, do të eliminoheshin shumë kafshë, të cilat janë të pakta në numër në atë tokë të djegur, që nuk ka ujë dhe bimësi. Ky ligj ka ardhur për të garantuar ekzistencën e këtyre kafshëve në këtë zonë dhe për t'i ruajtur nga zhdukja.

Nëse do ta merrnim në konsideratë se edhe jashtë gjendjes së ihramit ndalohet gjuetia, gjithashtu prerja e pemëve, mbytja e insekteve, atëherë a qartësohet se ky ligj ka lidhje të fortë me çështjen e ruajtjes së mjedisit, të pemëve dhe të kopshteve në atë zonë dhe ruajtja e tij nga zhdukja?

Me të vërtetë, ky rregull është aq i përpikët, sa që ndalon edhe udhëzimin e gjuetarit në vendin e gjuetisë. Ka ardhur në disa

transmetime se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë një shoku të vet: *“Mos e vepro gjuetinë kur ti je në ihram (duke kryer Haxhin dhe Umrën) dhe as kur e ke hequr ihramin në Qabe! Mos ia trego asnjë personi vendgjuetinë, qoftë me ihram apo jo...”*¹

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 5, f. 75.

Ajetet 97 - 99

﴿ جَعَلَ اللَّهُ الْكَعْبَةَ الْبَيْتَ الْحَرَامَ قِيَمًا لِّلنَّاسِ وَالشَّهْرَ الْحَرَامَ
 وَاهْدَىٰ وَٱلْفَلَاحِ ۚ ذَٰلِكَ لِتَعْلَمُوٓا۟ أَنَّ ٱللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ
 وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ وَأَنَّ ٱللَّهَ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ۝٩٧
 إِنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ ٱلْعِقَابِ وَأَنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ۝٩٨
 ٱلرَّسُولِ إِلَّا ٱلْبَلَّغُ ۚ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا تَكْتُمُونَ ۝٩٩

“All’llahu e ka bërë Shtëpinë e Shenjtë të Qabesë, muajin e shenjtë, kurbanin dhe shenjat e tyre vlere të përhershme për njerëzimin, në mënyrë që ju ta dini se All’llahu di gjithçka që gjendet në qiej e në Tokë dhe se Ai është i Gjithëditur për çdo gjë.”

“Ta dini se All’llahu është i Ashpër në ndëshkim, por njëkohësisht është edhe Falës e Mëshirëplotë.”

“I Dërguari ka për detyrë vetëm t’ju kumtojë Shpalljen. Por All’llahu e di çfarë bëni haptazi e çfarë fshehurazi.”

Komentimi

Ajetet e mëparshme folën për ndalimin e gjuetisë në gjendjen e ihramit. Në këtë ajet Kur’ani Famëlartë tregon rëndësinë e Mekës dhe ndikimin e saj në ndërtimin e jetës shoqërore të myslimanëve. Për këtë, në fillim, All’llahu i Lartësuar thotë: **“All’llahu e ka bërë Shtëpinë e Shenjtë të Qabesë, muajin e shenjtë, kurbanin dhe shenjat e tyre vlere të përhershme për njerëzimin...”**

Kjo shtëpi e shenjtë është simboli i unitetit të njerëzimit, qendra e bashkimit të zemrave rreth saj, dhe kongresi madhështor për të forcuar lidhjet dhe marrëdhëniet e ndryshme. Nën hijen e kësaj Shtëpie të Shenjtë, në vatrën e saj shpirtërore, njerëzit mund të rregullojnë e të përmirësojnë shumë gjëra në jetën e tyre dhe të ndërtojnë lumturinë e tyre mbi baza të forta. Për këtë, All’llahu e cilëson këtë shtëpi në ajetin 96 të sures “Ali Imran”, ku thotë: **“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë) e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt”**.

Në të vërtetë, duke u nisur nga kuptimi i gjerë i thënies së All’llahut **“...vlere të përhershme për njerëzimin...”**, myslimanët mund t’i rregullojnë të gjitha çështjet e tyre duke u mbështetur te kjo Shtëpi dhe në kornizën e mësimave përmirësuese të Haxhit.

Përderisa ky rit duhet të kryhet në ambient të sigurt, të zbrazët nga luftrat, përçarjet, dhe konfliktet, ajeti tregon vlerën e muajve të ndaluar (të cilët janë ato muaj në të cilët ndalohej rreptësisht lufta), ku thotë: **“...muajin e shenjtë...”**¹ Sikurse ka

¹ Muajt e shenjtë janë përmendur në komentimin e ajetit 194 të sures “El Bekare” në këtë komentim.

treguar edhe për kurbanet, të cilat nuk kanë shenja dhe kurbanet të cilat kanë shenja, nga të cilët ushqehen njerëzit në periudhën e Haxhit, dhe u siguron nevojat haxhinjve për të kryer ritet e haxhit. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...kurbanin dhe shenjat e tyre..."**

Të gjitha këto rregulla dhe ligje ishin për çështjen e gjuetisë, për shenjtërinë e Mekës dhe për muajt e ndaluar. Më pas ajeti tregon për dijen e gjerë të All'llahut dhe administrimin e Tij, ku thotë: **"...në mënyrë që ju ta dini se All'llahu di gjithçka që gjendet në qiej e në Tokë dhe se Ai është i Gjithëditur për çdo gjë."**

Duke u bazuar në atë çfarë tregohet në komentimin e këtij ajeti, qartësohet lidhja ndërmjet fillimit dhe fundit të këtij ajeti, se këto rregulla legislative nuk mundet që t'i sistemojë askush përveç Atij që njeh thellësinë e këtyre ligjeve krijimtare. Ai që nuk ka njohuri të sakta për atë çfarë ka në qiell, në tokë dhe në atë çfarë është e vendosur në shpirtin e njeriut dhe trupin e tij, veçanërisht në krijimin e tij, nuk është në gjendje që të përcaktojë këto lloj rregullash dhe ligjesh. Rregulli i saktë dhe i drejtë është ai që përshtatet me ligjin e krijimit dhe të natyrës së lindur (el fitratu).

Ajeti në vazhdim përforcon këto legjislacione, i nxit njerëzit për t'i ndjekur ato dhe kërcënon ata që devijojnë dhe nuk u binden këtyre rregullave dhe ligjeve, ku thotë: **"Ta dini se All'llahu është i Ashpër në ndëshkim, por njëkohësisht është edhe Falës e Mëshirëplotë."**

Ndoshta përmendja e fjalisë “...është i Ashpër në ndëshkim...” përpara fjalisë “...Falës e Mëshirëplotë.” tregon se ndëshkimi i ashpër i All’llahut mund të shuhet me ujin e pendimit dhe me hyrjen në mëshirën dhe faljen e Tij.

Edhe njëherë, ajeti përforcon se njerëzit janë përgjegjës për veprat e tyre dhe se i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është përgjegjës vetëm për përcjelljen e mesazhit. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: “**I Dërguari ka për detyrë vetëm t’ju kumtojë Shpalljen...**” dhe në të njëjtën kohë thotë: “...Por All’llahu e di çfarë bëni haptazi e çfarë fshehurazi.”

Hulumtime

Rëndësia e Qabesë

Me të vërtetë fjala *Qabe*, e cila përmendet në këtë ajet dhe në ajetet e mëparshme, rrjedh nga rrënja e fjalës *ka’bun* që do të thotë thembra. Pastaj është përdorur për çdo të dalë ose të dukur e të shfaqur. Po kështu edhe “el muka’ab” kubi, sepse të katër anët e tij janë të dukura. Fjala *kaibun* është në njëjës dhe shumësi i saj është *kauaib*, që ka kuptimin e femrës me gjoks të dukshëm e të madh (jo të zbuluar).

Me sa duket, të quajturit e shtëpisë së All’llahut me emrin Qabe përsëri kthehet te lartësia e saj e jashtme dhe te dukshmëria e saj. Po ashtu, lartësia e saj është simbol i madhështisë dhe i pozitës së saj.

Me të vërtetë, Qabja ka historinë e saj të vjetër të mbushur me ngjarje, të cilat burojnë nga madhështia dhe pozicioni i saj. Rëndësia e Qabesë i kalon kufijtë. Hadithet islame e konsiderojnë shkatërrimin e saj në të njëjtën gradë me vrasjen e Profetëve dhe Imamëve.¹ Shikimi tek ajo është adhurim. Tauafi rreth saj është prej veprave më të mira. Në një transmetim të ardhur nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Nuk i lejohet askujt që të ndërtojë ndërtesën e tij më të lartë se Qabeja.”²

Është e natyrshme se rëndësia dhe respekti i Qabesë nuk vjen nga ndërtesa e saj. Për këtë, prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në hytben e quajtur “El Kasiatu”, ka thënë: “A nuk po e shikoni se All’llahu i Lartësuar i ka sprovuar të parët që nga Ademi (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) e deri te të fundit në këtë botë, me gurë që nuk bëjnë dëm e as dobi, as nuk shohin e as nuk dëgjojnë dhe me to kanë bërë atë shtëpinë e Tij të Shenjtë, pastaj e ka vendosur në vendin më të ashpër të tokës...”³

Rëndësia e pozitës së Qabesë tek All’llahu ka të bëjë me faktin se ajo është epiqendra më e vjetër për adhurimin dhe njëtimin. Ajo është pika tërheqëse që thith popuj dhe kombe të ndryshëm.

¹ “Uesailu Shia”, vëll. 4, f. 299.

² “Sefijnetul Bihar”, vëll. 2, f. 482.

³ “Nehxhul Belaga”, fjalimi 19.

Ajeti 100

قُلْ لَا يَسْتَوِي الْخَبِيثُ وَالطَّيِّبُ وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ الْخَبِيثِ
فَاتَّقُوا اللَّهَ يَتَأُولَى الْأَلْبَبِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١٠٠﴾

“Thuaju: ‘Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes. Prandaj kijeni frikë All’llahun, o njerëz me intelekt, me qëllim që të shpëtoni!’”

Komentimi

Mazhoranca nuk është argument i së drejtës dhe i së vërtetës

Ajetet e mëparshme folën rreth ndalimit të alkoolit, kumarit, adhurimit të idhujve, lojërave të fatit dhe gjuetisë në tokë në kohën e veshjes së ihramit. Por, mund të gjejmë njerëz që shfajësohen për t’i bërë këto gjynahe, sepse shumica e njerëzve në disa vende e zona i bëjnë këto. Ata thonë se shumica e njerëzve në filan vend e pijnë alkoolin dhe luajnë bixhoz. Ose thonë se shumica e njerëzve, në kushte të veçanta, nuk e vlerësojnë ndalimin e gjuetisë e të tjera si këto. Pra, ata ecin në gjurmët e shumicës dhe e neglizhojnë zbatimin e ligjeve dhe rregullave të Sheriatit.

Me qëllim që njerëzit të mos shfajësohen me këto lloj pretekstesh, All'Ilahu i Lartësuar ka vendosur një rregull të përgjithshëm në një fjali të shkurtër e përmbledhëse, ku i drejtohet të Dërguarit të ndershëm (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke i thënë: **“Thuaju: ‘Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes...’”**

E keqja dhe e mira – në këtë ajet – përfshijnë çdo gjë që ka lidhje me njeriun, qoftë ai ushqim apo mendim.

Në mbyllje, All'Ilahu i Lartësuar u drejtohet dijetarëve, mendimtarëve dhe të zgjuarve: **“...Prandaj kijeni frikë All'Ilahun, o njerëz me intelekt, me qëllim që të shpëtoni!”** Përsa i përket thënies se përmbajtja e ajetit është prej sqarimit të të qartave, kjo sepse ka prej tyre që mendojnë se një e keqe që pasohet nga shumica, ajo është e ngjashme me të mirën. Nganjëherë ndodh të shohim disa njerëz që ndikohen nga një grup dhe nga epshet e shumicës, duke menduar se ngado që të anojë shumica, ai është argument i prerë dhe i saktë në atë çfarë ata anojnë. Por çështja nuk është e tillë, sepse të shumta janë çështjet e miratuara nga shumica e më pas është dukur parregullsia e atyre çështjeve.

Në të vërtetë, ajo çfarë e dallon të keqen nga e mira është shumica në ciësi e jo në sasi. Pra, kërkohen mendime më të forta, më të larta dhe më të pastërta dhe jo shumicë sasiore.

Në këtë kohë, kjo çështje nuk përshtatet me shijet e disa njerëzve, pasi janë çorientuar mendjet e tyre nga ndikimi i mjeteve të informacionit që thonë se shumica është standard për të njohur të keqen nga e mira. Kjo ka arritur deri në gradën e besimit se “e

vërteta" është ajo çfarë do shumica dhe "e mira" është në atë që anon shumica. E vërteta nuk është kështu, sepse problemet më të mëdha sot në botë janë si rezultat i kësaj mënyre të menduari.

Vërtet, nëse shumica gëzon udhëheqje të vërtetë dhe mësim të sakta, të cilat formojnë një shumicë të pjekur me plot kuptimin e fjalës, atëherë kjo shumicë dhe idetë e saj mund të konsiderohen etalon dallueshmërie i së keqes nga e mira.

Si do që të jetë, në këtë ajet Kur'ani Famëlartë tregon për këtë çështje dhe i paralajmëron njerëzit që të mos shkojnë pas shumicës së keqe. Në vende të tjera, ku mund të arrijnë në dhjetra, All'llahu i Lartësuar thotë: në suren "El Araf" në ajetin 187: **"ndërsa shumica e njerëzve nuk e dinë."**¹

Ndërsa përmendja e fjalës *khabijs* (e keqja), përpara fjalës *tajib* (e mira), në këtë ajet, është se fjala i drejtohet atyre të cilët e konsiderojnë shumicën si argument të saktë për atë që bëjnë.

Patjetër atyre u duhet dhënë përgjigje dhe t'u mësohet se etaloni i së keqes dhe i së mirës në asnjë kohë nuk ka qenë as shumica e as pakica, por në çdo kohë dhe në çdo vend është se e mira ka qenë më e mirë se e keqja dhe se mendimtarët dhe poseduesit e mendjes nuk mashtrohen me shumicën. Ata, gjithmonë, i largohen së keqes, edhe nëse ndoten të gjithë ata që i rrethojnë. Ata gjithmonë ftojnë në të mirë, edhe nëse largohen të gjithë nga e mira.

¹ Sure "A'raf", ajeti 187; sure "Jusuf", ajetet 21, 40, 68; sure "Nahl", ajeti 38; sure "Rum", ajetet 6, 30; sure "Sebe", ajetet 28, 37; sure "Gafir", ajeti 57; sure "Xhathije", ajeti 26.

Ajetet 101 - 102

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَسْأَلُوا عَنَ أَشْيَاءَ إِن تُبَدَ لَكُمْ تَسْؤُكُمْ
وَإِن تَسْأَلُوا عَنْهَا حِينَ يُنَزَّلُ الْقُرْءَانُ تُبَدَ لَكُمْ عَفَا ٱللَّهُ عَنْهَا ^ق
وَٱللَّهُ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿١٠١﴾
قَدْ سَأَلَهَا قَوْمٌ مِّن قَبْلِكُمْ ثُمَّ
أَصْبَحُوا بِهَا كَافِرِينَ ﴿١٠٢﴾

“O ju që keni besuar! Mos pyesni për gjëra, që, sikur t’ju thuheshin haptazi, nuk do t’ju pëlqenin e, nëse do të pyesnit për to kur ju shpallet Kur’ani, do t’ju bëheshin të qarta. All’llahu jua ka falur kërshërinë. Se All’llahu është Falës dhe i Butë.”

“Disa njerëz i kanë bërë pyetje të tilla para jush e pastaj u bënë jobesimtarë.”

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve ka thënie të ndryshme në librat e hadithit dhe të tefsirit, por më shumë përshtatet ajo çfarë ka ardhur në tefsirin “Mexhmaul Bejjan” nga Ali ibn Ebi Talibi, se ka thënë: “I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ligjëroi dhe tha: ‘Me të vërtetë, All’llahu ju ka detyruar që ta kryeni Haxhin.’ U

ngrit Ukashe ibn Muhsin (thuhet se ka qenë Suraka ibn Malik) dhe tha: *‘Për çdo vit (ta kryejmë Haxhin), o i Dërguari i All’llahut?’* I Dërguari i All’llahut *(Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk iu përgjigj, derisa e përsëriti dy apo tri herë. I Dërguari i All’llahut i tha: *“I mjeri ti. Çfarë të siguron ty nëse të them po? Beto hem në All’llahun! Nëse do të thosha po, do të bëhej detyrim për çdo vit. Nëse do të bëhej detyrim (për të bërë Haxhin çdo vit), nuk do të kishit mundësi. Nëse nuk do ta kryenit Haxhin, do të bëheshit mohues. Më lini mua ashtu siç ju lashë unë juve. Vërtet, janë shkatërruar popujt që kanë qenë përpara jush, për shkak të pyetjeve të shumta dhe kundërshtimit të të Dërguarve të tyre. Nëse ju urdhëroj që të bëni ndonjë gjë, bëni atë që sa ju keni mundësi. Nëse ju ndaloj për diçka, atëherë hiqni dorë.”*¹

Askush nuk duhet të mendojë se shkak i zbritjes së këtyre dy ajeteve, siç do ta shpjegojmë në komentim, nuk është mbyllja e portës së pyetjeve dhe e portës së sqarimit të çështjeve për njerëzit, sepse Kur’ani në ajetet e tij i urdhëron qartë njerëzit që të kthehen tek ata që kanë dituri në kuptimin e çështjeve. Këtë e lexojmë në ajetin 43 të sures “En Nahl” që thotë: **“Prandaj pyetni dijetarët e Librit, nëse nuk e dini...”** Por qëllimi është për pyetjet e pakuptimta e të kota dhe këmbëngulja, e cila në të shumtën e rasteve çon në paqartësinë e mendimeve dhe në ndërprerjen e mendimit e të idesë së ligjëruesit.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Beijan”, vëll. 3, f. 428. “Durul Menthur”, vëll. 2, f. 335.

Komentimi

Pyetjet kureshtare

Nuk ka dyshim se pyetja është çelësi i diturisë. Ai që pyet pak, i pakësohet dituria. Në Kur'an dhe në transmetime të shumta gjejmë që njerëzit duhet të pyesin për ato gjëra që nuk i dinë.¹ Por për çdo rregull ka përjashtim. Edhe për këtë parim edukues ka përjashtime. Prej tyre, në disa raste është më mirë që disa çështje shoqërore të fshihen për të ruajtur rregullin e shoqërisë dhe interesat e individëve të saj. Në këto raste nuk është në interes të individëve këmbëngulja në pyetje dhe përpjekja për të zbuluar të vërtetën e asaj pyetjeje. Nuk duhet të përdoret kureshtja në këto raste, sepse nuk është e pëlqyeshme.

Shumica e mjekëve e shohin si të domosdoshme fshehjen nga i sëmuri të sëmundjes që është e vështirë të kurohet dhe që është e frikshme. Ata i lajmërojnë familjarët e tij me kusht që ta fshehin këtë çështje nga i sëmuri. Shkak për këtë është fakti se eksperiencia ka treguar se të sëmurin do ta kaplonte frika nëse sëmundja e tij nuk do të shërohej me shpejtësi. Kjo çon në vonesën e shërimit të tij. Nëse sëmundja e tij nuk është vdekjeprurëse, i sëmuri nuk duhet që të këmbëngulë me pyetje ndaj mjekut, sepse mund ta vendosë në pozitë të vështirë atë, i cili mund t'i tregojë të sëmurit atë çfarë nuk duhet t'i tregojë.

Gjithashtu, edhe njerëzit në përgjithësi. Në bashkëpunimin ndërmjet njëri-tjetrit kanë nevojë që të përmirësojnë mendimet për

¹ "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 211 dhe 212.

njëri-tjetrin. Për këtë arsye është më mirë për ta që të mos i dinë të fshehtat e të tjerëve. Çdo person ka pikat e veta të dobëta dhe zbulimi i tyre dëmton bashkëpunimin ndërmjet njerëzve. Ka raste që një njeri të jetë një personalitet që ka lindur në një familje të rëndomtë e të devijuar. Nëse zbulohet kjo gjë mund të tronditet pozicioni i tij në shoqëri. Prandaj, njerëzit nuk duhet të këmbëngulin në pyetje dhe në zbulimin e çështjes.

Gjithashtu, shumë planprograme shoqërore duhet të fshihen derisa të zbatohen. Lajmërimi për këto planprograme do të konsiderohej si një goditje që mund të ngadalësojë realizimin e kësaj vepre. Te këta shembuj nuk duhet që të këmbëngulet me pyetje. Është obligim i drejtuesve që të mos i përhapin të tilla të fshehta, përderisa nuk bien nën trysinë e ashpër.

Kur'ani, me anë të këtij ajeti tregon po këtë tematikë, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar! Mos pyesni për gjëra, që, sikur t’ju thuheshin haptazi, nuk do t’ju pëlqenin...”**

Por, nga njëra anë këmbëngulja e disa njerëzve në pyetje dhe mospërgjigjja e pyetjeve të tyre nga ana tjetër, mund të çojnë në lindjen e dyshimit tek të tjerët, gjë që çon në shumë të këqija. Për këtë, ajeti thotë: **“...e, nëse do të pyesnit për to kur ju shpallet Kur’ani, do t’ju bëheshin të qarta...”**

Pastaj mos e mendoni All'llahun të pavetëdijsëm nga përmendja e disa çështjeve, nëse Ai hesht ndaj tyre, sepse: **“...All'llahu jua ka falur kërshtërinë. Se All'llahu është Falës dhe i Butë.”**

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Me të vërtetë, All'llahu ju ka obliguar juve me detyrime që të mos i humbisni ato; e ka*

vendosur kufirin që të mos e kaloni atë; jua ka ndaluar disa gjëra që të hiqni dorë prej tyre; ka heshtur për disa çështje, por nuk i ka harruar ato, prandaj mos ia ngarkoni ato vetes!”¹

Pyetje: Dikush mund të pyesë: Nëse përhapja e këtyre çështjeve bie në kundërshtim me interesat e njerëzve, atëherë përse përhapen nga ndikimi i këmbënguljes?

Përgjigja: Shkaku i kësaj është ajo çfarë treguam më lart, se nëse drejtuesi ka vendosur të heshtë, me gjithë insistimin për pyetje, ai mund të parandalojë dëme më të rrezikshme, përndryshe, mendimi për keq apo hamendësimi mund të njollosin mendjet e njerëzve, siç është heshtja e mjekut përpara insistimit të të sëmurit në pyetje për sëmundjen e tij. Me të vërtetë, kjo e fut në dyshim të sëmurin, që mund të mendojë se mjeku nuk e ka zbuluar ende sëmundjen e tij dhe e neglizhon në dhënien e kurimit të tij. Atëherë mjeku nuk ka rrugë tjetër vetëm se t'i tregojë të fshehtën e sëmundjes së tij, edhe sikur t'i shkaktonte atij disa probleme.

Ajeti në vazhdim e përforcon këtë të vërtetë dhe qartëson se popujt e mëparshëm bënë kësaj pyetjesh dhe pasi i dëgjuan përgjigjet e tyre, i kundërshtuan dhe i mohuan ato. Ajeti thotë: **“Disa njerëz i kanë bërë pyetje të tilla para jush e pastaj u bënë jobesimtarë.”**

Për çështjen e atyre popujve, komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme. Disa prej tyre kanë thënë se kjo çështje veçon nxënësit e Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kur i kërkuan t'u zbriste një sofër prej qielli dhe kur u realizua ajo çfarë

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 429.

dëshiruan, ata kundërshtuan. Disa të tjerë thonë: Ai është tregimi i Profetit Salih (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), të cilit njerëzit i kërkuan një mrekulli. Por, në dukje të gjitha këto mendime janë larg nga e vërteta, sepse ajeti flet për pyetjen, për të panjohurën që duhet të zbulohet dhe jo për kërkesën e diçkaje. Ndoshta përdorimi i fjalës pyetje në këto dy raste është shkak i këtij gabimi.

Popujt mund të jenë nga bijtë e Izraelit, të cilët u urdhëruan për të therur një lopë, për të zbuluar krimin (Shih ajetin 77, 78, 79 të sures "El Bekare" në vëllimin e parë të këtij komentimi). Ata e rrethuan Musain (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) me pyetje rreth veçorive të kësaj lope, për të cilën nuk kishte zbritur akoma asgjë për çështjen e saj, se ku dallonte nga lopët e tjera. Por, me pyetjet e tyre të njëpasnjëshme, të cilat nuk ishin të domosdoshme, ata ia vështirësuan vetave të tyre, ku gjetja e kësaj lope me këto veçori u bë e vështirë në atë vend dhe shpenzuan shumë në këtë rrugë, aq sa pothuajse dëshiruan që të largoheshin e të mos e zbatonin atë urdhër të All'Ilahut. Në komentimin e Fjalës së All'Ilahut të Lartësuar thuhet: "...u bënë jobesimtarë.", ka dy alternativa:

E para: Qëllimi me mosbesim në këtë ajet është kundërshtimi, sikurse u tha më lart.

E dyta: Qëllimi me mosbesim është për kuptimin e tij të njohur, kjo sepse dëgjimi i përgjigjeve të mërzitshme, të cilat janë të rënda për dëgjuesin, mund të nxisë për të mohuar thelbin e tematikës dhe dobinë e përgjigjes. Ashtu ndodh kur i sëmuri dëgjon nga mjeku përgjigjen që nuk i pëlqen, e kjo e shtyn t'i mohojë kompetencat e mjekut dhe ta akuzojë atë për paaftësi.

Në mbyllje të këtij hulumtimi gjejmë të domosdoshme që ta përsërisim atë çfarë thamë në fillim: Këto ajete nuk na ndalojnë asnjëherë që të bëhen pyetje të ligjshme, edukative e përfituese.

Por, i përkufizon ato pyetje të cilat nuk janë të domosdoshme dhe urdhëron për të mos u thelluar në çështje të cilat nuk janë të domosdoshme dhe, nganjëherë, më e mira është që të qëndrojnë të fshehura.

Ajetet 103 - 104

مَا جَعَلَ اللَّهُ مِنْ نَحِيرَةٍ وَلَا سَائِبَةٍ وَلَا وَصِيلَةٍ وَلَا حَامٍ^ل وَلَكِنَّ
 الَّذِينَ كَفَرُوا يَفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ^ط وَأَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿١٣﴾
 وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا إِلَى مَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَإِلَى الرَّسُولِ قَالُوا
 حَسْبُنَا مَا وَجَدْنَا عَلَيْهِ آبَاءَنَا^ع أَوَلَوْ كَانَ آبَاؤُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ
 شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ ﴿١٤﴾

“All’lillahu nuk e përligj as *Behirën*, as *Saibën*, as *Vesilën*, as *Hamin*. Por femohuesit trillojnë gënjeshtër për All’lilahun. Shumica syresh nuk kanë mend.”

“Kur u thuhet: ‘Ejani në atë që ka zbritur All’lillahu dhe ejani tek i Dërguari!’, ata thonë: ‘Neve na mjafton rruga që kemi gjetur nga etërit tanë.’, edhe pse etërit e tyre nuk kanë ditur asgjë e as nuk kanë qenë në udhën e vërtetë?!”

Komentimi

Ajeti i parë tregon katër bidate të përhapura në kohën paraislamit. Ata u vendosnin disa kafshëve shenja dhe emra për shkaqe të ndryshme dhe e ndalonin ngrënien e mishit, pirjen e

qumështit të tyre, përdorimin e leshit të tyre dhe shfrytëzimin e tyre për punë. Ndonjëherë i linin të lira të ecnin e të kullosnin pa i ndaluar askush. Pra, i linin si të shenjta dhe nuk përfitonin asgjë prej tyre. Për këtë, All'illahu i Lartësuar thotë: **"All'illahu nuk e përlligj as Behirën, as Saibën, as Vesilën, as Hamin."**

Hulumtime

1- El Behira është deve që ka lindur pesë barqe dhe herën e pestë lind femër, por thuhet edhe mashkull. Njerëzit në atë kohë ua çanin veshët, i linin të lira dhe nuk i thernin. Fjala *behira* rrjedh nga fjala "*bahr*", që do të thotë i gjerë. Për këtë gjë është përdorur edhe në emërtimin e detit. Deveja është quajtur *behire*, sepse asaj ia çanin veshin për së gjeri.

2- Es Saiba është deve që ka lindur dymbëdhjetë herë dhe thuhet dhjetë barqe. Këtë deve e quanin *saiba*, dhe, nuk i vihej samari për përdorim; ushqehet ku të donte nuk e pengonte askush. Nganjëherë e milnin për të ushqyer mysafirët. Fjala *es saiba* rrjedh nga fjala *sejb*, që do të thotë rrjedhë uji ose ecje e lirë.

3- El Uesila është dele që ka lindur shtatë herë. Thuhet se është ajo dele që lind nga dy qingja. Rrjedh nga fjala *uesele*. Njerëzit e kishin ndaluar therjen e saj.

4- El Ham rrjedh nga fjala *hama*. Përdoret për mëzatin që mbahet për ndërzim. Kur përdorej për ndërzimin e dhjetë lopëve dhe lindnin prej tij, thonin që ka mbrojt kurrizin e tij dhe nuk i lejohej askujt që ta ngiste. Nga kuptimet e saj janë: i mbrojtur, i lejuar dhe i ndaluar.

Ka alternativa të tjera te komentuesit e Kur'anit dhe te dijetarët e haditheve për çështjen e përkufizimit të këtyre katër emrave. Por e përbashkëta mes gjithë këtyre kuptimeve është se të gjithë këto emra tregojnë për kafshët të cilat i shërbyen shumë të zotëve të tyre në prodhim. Njerëzit i respektonin ato kafshë dhe i linin të lira.

Vërtet, ky veprim i tyre është një lloj mirënjohjeje ndaj të mirës dhe dukuri prej dukurive të falënderimit; madje edhe ndaj bagëtive, çka është për t'u vlerësuar. Mirëpo ky ishte një respekt i pakuptimtë për kafshët që nuk e kuptojnë këtë veprim. Përveç kësaj, ky veprim i tyre ishte humbje e pasurisë, shpërdorim i mirësisë së All'llahut dhe pezullim i prodhimtarisë së dobishme. Pastaj, këto kafshë, për shkak të respektit dhe të vlerësimit të tyre, kanë vuajtur nga uria dhe etja, sepse kanë qenë të paktë ata që u kanë dhënë ushqim dhe janë kujdesur për to.

Zakonisht, këto kafshë kanë qenë të mëdha në moshë dhe i kanë kaluar ditët e fundit të jetës së tyre në privim dhe në nevojë, derisa kanë ngordhur. Për këtë shkak, Islami e ka ndaluar këtë zakon të shëmtuar të kohës së injorancës (paraislamit). Në shtesë të kësaj, nga disa transmetime dhe komentime përfitohet se ata janë afruar me këto kafshë tek idhujt e tyre ose ia kanë zotuar idhujve të tyre. Për këtë arsye, ndalimi i këtij zakoni ishte përforcim i luftimit të çdo mbeturine të idhujtarisë.

E habitshmja në këtë çështje është se njerëzit e hanin mishin e këtyre kafshëve, nëse ato ngordhnin nga shkaqe natyrore (sikur kërkon bereqet e mirësi prej tyre).

Kjo ishte një tjetër vepër e shpifur e tyre.¹

Pastaj, All'Ilahu i Lartësuar në këtë ajet thotë: **“Por femohuesit trillojnë gënjeshtër për All'Ilahun!...”** duke thënë se këto ligje janë nga All'Ilahu pa u menduar e pa arsyetuar. Ata imitonin të tjerët verbërisht. Ajeti thotë për ata: **“...Shumica syresh nuk kanë mend.”**

Ajeti i dytë tregon logjikën dhe argumentin e tyre për kryerjen e këtyre veprave, ku thotë: **“Kur u thuhet: ‘Ejani në atë që ka zbritur All'Ilahu dhe ejani tek i Dërguari!’”, ata thonë: ‘Neve na mjafton rruga që kemi gjetur nga etërit tanë...’”.**

Në realitet, mosbesimi i tyre dhe adhurimi i idhujve buron nga një lloj tjetër idhujtarie që është pranimi dhe dorëzimi i verbër përpara traditave pagane të të parëve, duke i konsideruar veprat e tyre argument të prerë për saktësinë e saj. Kur'ani u përgjigjet me qartësi për këtë gjë, duke thënë: **“...Edhe pse etërit e tyre nuk kanë ditur asgjë e as nuk kanë qenë në udhën e vërtetë?!”. Nëse të parët tuaj, te të cilët ju po mbështeteni në besim e punë, do të ishin nga dijetarët dhe të udhëzuarit, kjo ndjekje do të ishte një ndjekje për dije, por ju me të vërtetë e dini se ata nuk dinin më shumë se ju dhe ndoshta ata ishin më të devijuar se ju. Kështu që imitimi i tyre nga ana juaj është ndjekje e injorantit, e cila është e refuzuar dhe e shëmtuar në peshoren e logjikës. Përqendrimi i Kur'anit famëlartë në këtë ajet te fjala *shumica* tregon se në atë mjedis injorant e të errët ka pasur një grup – edhe nëse ka qenë i pakët –, i cili i ka parë këto vepra me syrin e përçmimit e të urrejtjes.**

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 684.

Dy hulumtime

1- Idhulli, që quhej “El Eslaf”

Prej çështjeve të përhapura në kohën e injorancës dhe që janë përsëritur disa herë në Kur’anin Famëlartë, është krenaria me baballarët, me gjyshërit e tyre, deri në atë gradë sa që i shenjtëronin verbërisht dhe i ndiqnin mendimet dhe zakonet e tyre. Kjo nuk është e kufizuar vetëm për kohën e injorancës së parë, por ekziston në shumë popuj edhe në kohën e sotme.

Nuk ka dyshim se shpirti i mirënjohjes dhe ruajtja e parimeve njerëzore na detyron që ta respektojmë të kaluarën e të parëve tanë. Por, nuk duhet që t’i konsiderojmë si të ruajtur nga çdo gabim dhe të mbrojtur nga çdo kritikë dhe të ndiqen verbërisht legendat dhe zakonet e tyre. Kjo, në të vërtetë, nuk është veçse një ngjyrë prej ngjyrave të idhujtarisë dhe e logjikës së injorancës. Ne mund t’i respektojmë mendimet dhe zakonet e tyre të dobishme dhe në të njëjtën kohë, t’i shkatërrojmë zakonet, të cilat nuk janë të mira e të drejta. Brezat e sotëm kanë dije më të gjerë e më të thellë se brezat e shkuar për shkak të përparimit të shkencës e të teknologjisë. Nuk ka mendje të ndritur që ta pranojë imitimin e verbër.

Është i habitshëm fakti që sot shohim disa dijetarë dhe profesorë të universiteteve të ndjekin verbërisht zakonet e të parëve dhe të kapen pas zakoneve të injorancës, gjë që ka çuar në fanatizmin racor.

2- Papajtueshmëri pa justifikim

Ka ardhur në tefsirin “Mijzan”, në tefsirin “Durul Menthur” nga një numër transmetuesish, si Tirmidhij në “Neuadirul Usul” nga Ubij El Ehvas nga babai i tij, i cili ka thënë: “Shkova tek i Dërguari i All’llahut me dy rroba të vjetra dhe ai më tha: ‘A ke pasuri?’ I thashë! ‘Po.’ Ai më tha: ‘Çfarë pasurie?’ I thashë: ‘Çdo pasuri nga deveja, të imtat (dhen e dhi), kuaj dhe robër.’ Ai më tha: ‘Meqenëse të ka dhënë All’llahu pasuri, nuk duhet që të jetosh si mjeran.’ Pastaj Profeti më tha: ‘A të lind deveja me veshë të plotë?’ –‘Po.’- i thashë. ‘A lind deveja përveçse kështu?’ Profeti tha: ‘Ndoshta ti merr thikë dhe ua pret veshët një grupi dhe thua kjo është *Behira*, dhe një grupi tjetër ia çan veshët dhe thua kjo është *Saiba*?’ I thashë: ‘Po.’ Profeti më tha: ‘Mos bëj si idhujtërët (idhutarët ua prisnin dhe çanin veshët bagëtive), se çdo gjë që të ka dhuruar All’llahu është e lejuar.’ Pastaj Profeti tha: ‘All’llahu nuk e ka përligjur as Behirën, as Saibën, as Vesilën, as Harmin.’”¹

Nga ky transmetim kuptojmë se ata lartësonin një pjesë të pasurisë, por në të njëjtën kohë, bënë ekonomi në veshjet e tyre. Jo vetëm kaq, por bënë koprraci. Kjo është një lloj papajtueshmërie, e cila nuk justifikohet.

¹ Tefsiri “Mijzan”, vëll. 6, f. 161.

Ajeti 105

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا عَلَيْكُمْ أَنْفُسُكُمْ^ط لَا يَضُرُّكُمْ مِّنْ ضَلٍّ إِذَا
 أَهْتَدَيْتُمْ^ج إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيَنْبِئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٠٥﴾

“O ju që keni besuar! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj. Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek All’lillahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar.”

Komentimi

Çdo njeri është përgjegjës për veprat e tij

Ajetet e mëparshme trajtuan imitimin që i bënin injorantët të parëve të tyre të humbur. Kur’ani u ka hequr vërejtjen duke u thënë se kjo vepër e tyre nuk përputhet me logjikën e shëndoshë. Është më se e natyrshme që në mendjet e tyre të lindë pyetja: Nëse na kërkohet që të shkëputemi nga të parët tanë në këtë çështje, atëherë cili do të jetë fundi i tyre? Cili është fundi i shumicës që në realitet është ende e lidhur me këto zakone dhe me ndikimin e tyre? Kur’ani u përgjigjet atyre dhe u thotë: **“O ju që keni besuar! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj. Ai që është i humbur**

nuk mund t'ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë...” Pastaj Kur'ani tregon për Ringjalljen, kthimin tek All'llahu dhe se të gjithë do japin llogari para All'llahut, ku thotë: **“...Tek All'llahu do të ktheheni të gjithë e do t'ju lajmërojë për atë që keni punuar.”**

Përgjigjja e kundërshtimit

Disa kanë hedhur dyshime rreth këtij ajeti dhe menduan se mes këtij ajeti dhe *urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja* – që është prej çështjeve të domosdoshme në shariatën islam – ka një lloj kundërshtimi, sepse ky ajet thotë: **“...Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj. Ai që është i humbur, nuk mund t'ju dëmtojë nëse jeni në rrugë të drejtë...”**

Ka hadithe dhe transmetime që tregojnë se për këtë tematikë kanë lindur dyshime edhe në kohën kur ka zbritur ky ajet. Xhubejr ibn Nufejl thotë: “Isha me një grup shokësh tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke ndenjur në praninë e tij. Unë isha më i riu në moshë. Ne po flisnim për urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja. I ndërpreva ata dhe u thashë: A nuk ka ardhur në Kur'an thënia: **“O ju që keni besuar! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur, nuk mund t'ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë...”** Pra, me këtë ajet nuk mbetet çfarë të urdhërosh në të mirë e të ndalosh nga e keqja. Atëherë, ata që ishin të pranishëm, u grumbulluan dhe më qortuan duke më thënë: ‘Si mund të sjellësh një pjesë nga Kur'anit pa e ditur kuptimin dhe komentimin e saj?’ Unë u pendova me një pendim të madh për

atë që thashë dhe ata u kthyen në bisedën e mëparshme. Në përfundim të bisedës mu drejtuan mua duke më thënë: *‘Vërtet, ti je një djalë i ri në moshë. Shkëpute një pjesë ajeti prej ajeteve të Kur’anit pa e ditur kuptimin e saj. Ndoshta do të jetosh gjatë derisa të shohësh se si do të mbizotërojë mbi njerëzit koprracia, egoja dhe epshi i tyre. Gjithkush do të drejtohet me mendimet e veta. Atëherë ki kujdes që mos të të dëmtojë ai që është i humbur prej tyre (sigurisht që ajeti tregon për atë kohë)!’*”

Sot gjejmë njerëz të mbështetur në butësi e urtësi dhe që kërkojnë rehatinë, kur bëhet fjalë për kryerjen e këtyre dy detyrimeve të mëdha të All’llahut – urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja. Ata shfajësohen me këtë ajet dhe e devijojnë atë nga thelbi i tij. Me pak vështirim të thellë mund të mësojnë se nuk ka kundërshtim në këto lloj detyrimesh dhe në atë çfarë ka ardhur në këtë ajet. Në këtë ajet lexojmë:

Së pari: Ajeti shpjegon se çdo njeri do të llogaritet i vetëm. Humbja e të tjerëve nga të parët, apo jo, nuk ndikon në udhëzimin e atyre që janë të udhëzuar, edhe nëse janë nga të afërmit, si: babai, vëllai ose djali. Mos i ndiq ata dhe ke shpëtuar veten!

Së dyti: Ky ajet tregon për gjendjen që urdhri në të mirë dhe ndalimi nga e keqja nuk kanë asnjë ndikim ose kushtet e ndikimit të tyre janë të paplotësuar për t’u vepruar. Në të tilla gjendje, disa besimtarë ndiejnë dhimbje dhe pyesin se çfarë duhet të bëjnë. Ajeti u përgjigjet e u thotë të mos shqetësohen, sepse ata e kanë kryer punën e tyre: **“...Ai që është i humbur, nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë...”** Këtë kuptim e gjejmë edhe në hadithin që përmendëm më lart e gjithashtu, në disa hadithe të tjera. I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është pyetur për këtë ajet dhe ka thënë: “Urdhëroni në të mirë dhe ndaloni nga e keqja. Kur e shikon botën që ka ndikuar te ti në koprraci e bindje dhe kur e shikon se ndiqet egoja dhe gjithsecili është i mahnitur me mendimin e vet, atëherë veçojë veten dhe lëre shumicën”.¹

Ka transmetime të tjera që tregojnë po të njëjtën përmbajtje, që e vërtetojnë këtë të vërtetë. Fakhrudin Razi – sipas zakonit të tij – tregon disa forma në përgjigjen e kësaj pyetjeje dhe pothuajse të gjitha kthehen te çështja që e shpjeguan. Ndoshta ai i ka sjellë të gjitha këto sugjerime për ta qartësuar më shumë.²

Si do që të jetë, nuk ka dyshim se çështja e urdhërimit në të mirë dhe ndalimi nga e keqja janë prej bazave të fesë islame, të cilat nuk mund të neglizhohen e të nënvlerësohen në asnjë mënyrë e asnjë formë.

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 684.

² Tefsiri “Kebijr”, vëll. 12, f. 112.

Ajetet 106 - 108

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا شَهَدَةُ بَيْنِكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ
 حِينَ الْوَصِيَّةِ أَثْنَانِ ذَوَا عَدْلٍ مِّنْكُمْ أَوْ ءَاخِرَانِ مِّنْ غَيْرِكُمْ إِنْ
 أَنْتُمْ ضَرَبْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَأَصَبْتَكُمْ مُصِيبَةُ الْمَوْتِ تَحْسِبُونَهُمَا
 مِنْ بَعْدِ الصَّلَاةِ فَيُقْسِمَانِ بِاللَّهِ إِنْ أَرْتَبْتُمْ لَا نَشْتَرِي بِهِ ثَمَنًا
 وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ وَلَا نَكْتُمُ شَهَدَةَ اللَّهِ إِنَّآ إِذَا لَّمِنَ الْآثِمِينَ ﴿١٠٦﴾
 فَإِنْ عُثِرَ عَلَىٰ أَنَّهُمَا أَسْتَحَقَّا إِثْمًا فَءَاخِرَانِ يَقُومَانِ مَقَامَهُمَا مِنَ
 الَّذِينَ اسْتَحَقَّ عَلَيْهِمُ الْأَوَّلَيْنِ فَيُقْسِمَانِ بِاللَّهِ لَشَهِدْتُنَا أَحَقُّ مِنْ
 شَهِدَتِيهِمَا وَمَا أَعْتَدَيْنَا إِنَّآ إِذَا لَّمِنَ الظَّالِمِينَ ﴿١٠٧﴾ ذَلِكَ أَذْنَىٰ أَنْ
 يَأْتُوا بِالشَّهَدَةِ عَلَىٰ وَجْهٍ أَوْ يَخَافُوا أَنْ تُرَدَّ أَيْمَنٌ بَعْدَ أَيْمَنِهِمْ
 وَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَسْمِعُوا وَلِلَّهِ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ ﴿١٠٨﴾

“O ju që keni besuar! Kur t’ju afrohet vdekja, me rastin e lënies së testamentit, le të dëshmojnë dy të ndershëm prej jush ose dy të tjerë që nuk janë prej jush, nëse fatkeqësia e vdekjes ju zë ndërsa jeni duke udhëtuar nëpër botë. Mbajini ata pas namazit dhe, nëse dyshoni në ndershmërinë e tyre, le të betohen në

All'llahun (duke thënë): 'Ne nuk do ta shesim betimin me kurrfarë çmimi edhe nëse është fjala për cilindo të afërm dhe dëshminë që na urdhëron All'llahu nuk do ta fshehim, sepse, atëherë do të ishim vërtet keqbërës.'

"Nëse më pas zbulohet se këta dy dëshmues kanë bërë gjynah, atëherë le të zëvendësohen nga dy të tjerë prej atyre që këta u kanë bërë padrejtësi! Pastaj, dy dëshmitarët e fundit le të betohen në All'llahun (duke thënë): 'Pa dyshim, dëshmia jonë është më e drejtë se dëshmia e tyre. Ne nuk gënjejme, sepse përndryshe do të ishim keqbërës.'

"Kështu është më e lehtë që ata të bëjnë dëshminë e tyre të saktë ose të frikësohen nëse betimet e tyre do të dalin në kundërshtim me betime të tjera. Frikësojuni All'llahut dhe dëgjoni! All'llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit ngatërrestarë."

Shkaku i zbritjes

Ka ardhur në tefsirin "Mexhmaul Bejjan" dhe në disa tefsire të tjera se shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve është se një mysliman, i quajtur ibn Ebi Marijetu, së bashku me dy vëllezër të krishterë arabë, që quheshin Temijm dhe Udej, dolën nga Medina për tregti. Në rrugë u sëmur ibn Ebi Marijetu. Ai shkroi testamentin e tij dhe e fshehu në plaçkat e veta dhe ua besoi sendet e veta dy shokëve të tij të krishterë. U kërkoi atyre që t'ia dorëzonin familjes të tij. Pasi vdiq, dy të krishterët i hapën plaçkat e tij dhe morën gjërat më me vlerë, ndërsa pjesën tjetër ia dorëzuan trashëgimtarëve të tij. Pasi trashëgimtarët e tij i hapën plaçkat e tij, nuk gjetën disa gjëra që ibn Ebi Marijetu i kishte

marrë në udhëtim. Papritur, ata gjetën testamentin dhe zbuluan çdo gjë që ishte vjedhur. Të afërmit e Ebi Marijetu e biseduan çështjen me dy të krishterët. Ata të dy e mohuan dhe thanë se ua kishin dorëzuar çdo gjë që kishin marrë nga ai, si dhe u ankuan tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Atëherë zbritën këto ajete që qartësojnë rregullin e kësaj çështjeje.¹

Mirëpo shkaku i zbritjes që përmendet në librin “El Kafij” thotë se ata të dy e mohuan fillimisht ekzistencën e plaçkave të tjera dhe çështja arriti tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Meqë nuk kishte argument kundër atyre të dyve, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u kërkoi që të betoheshin dhe i la të lirë. Por, pas pak ditësh u shfaqën disa plaçka të vjedhura nga dy të krishterët dhe u vërtetua gënjeshtria e tyre. Për këtë u informua i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që priti derisa zbritën këto ajete. Atëherë i urdhëroi trashëgimtarët e të vdekurit që ta ndanin pasurinë.

Komentimi

Prej çështjeve më të rëndësishme, të cilën e përforcon Islami, është çështja e ruajtjes së të drejtave të njeriut, e pasurisë së tyre dhe realizimi i drejtësisë shoqërore. Këto ajete shpjegojnë një anë të veçantë të legjislacionit të këtyre të drejtave. Me qëllim që të mos përçmohen të drejtat e trashëgimtarëve të të vdekurit dhe

¹ “Usulul Kafij”, vëll. 7, f. 5.

jetimëve të tij të vegjël vjen urdhri për myslimanët duke u thënë: **“O ju që keni besuar! Kur t’ju afrohet vdekja, me rastin e lënies së testamentit, le të dëshmojnë dy të ndershëm prej jush...”** Qëllimi me ndershmërinë në këtë ajet është drejtësia, e cila i largon mëkatet e mëdha dhe të ngjashmet me to. Ka gjasa që kuptimi në këtë ajet të jetë amaneti në çështjet financiare. Fjala *minkum* (ndërmjet jush), do të thotë *prej myslimanëve* dhe jo prej jomyslimanëve, e cila do të tregohet në vazhdim të ajetit.

Duhet të thuhet se çështja këtu nuk ka lidhje me dëshminë e zakonshme, por ajo është dëshmia e shoqëruar me testamentin, pra, këta dy dëshmitarë dhe të porositur duhet të jenë në të njëjtën kohë. Ndërsa alternativa e thënësit për të zgjedhur një person të tretë si vasij¹, në shtesë të dy dëshmitarëve, në të vërtetë, kjo bie në kundërshtim me pamjen e jashtme të këtij ajetit dhe me shkakun e zbritjes, në të cilin thuhet se ibn Ebu Marijetun e kanë shoqëruar në udhëtim vetëm dy persona që i ka zgjedhur vasij dhe dëshmitarë.

Pastaj ajeti thotë se nëse jeni në udhëtim dhe ju vjen vdekja dhe nuk gjeni vasij e dëshmitarë prej myslimanëve, atëherë zgjidhni dy persona jomyslimanë, për të cilët All’llahu i Lartësuar thotë: **“...ose dy të tjerë që nuk janë prej jush, nëse fatkeqësia e vdekjes ju zë, ndërsa jeni duke udhëtuar nëpër botë...”**

Pavarësisht nga mosekzistenca e myslimanit, ajo çfarë kuptohet nga ky ajet është fakti se përzgjedhja e një vasiji dhe e një dëshmitari nga jomyslimanët, është e kushtëzuar me mosekzistencën e atyre dy personave prej myslimanëve.

¹ Vasij këtu ka kuptimin e personit të ngarkuar për zbatimin e testamentit.

Shembulli i këtij kushti është i qartë, sepse zëvendësimi bëhet atëherë kur nuk gjenden dëshmitarë myslimanë që të shkruajnë testamentin.

Gjithashtu, përmendja e kushtit të udhëtimit e qartëson këtë kuptim. Megjithëse nga fjala *eu*, që do të thotë *ose*, zakonisht përfitohet përzgjedhje, por në këtë ajet dhe në shumë vende të tjera në Kur'an, ka edhe kuptimin e renditjes, që do të thotë: fillimisht zgjidh dy myslimanë, e nëse nuk gjenden të tillë, zgjidh prej jomyslimanëve.

Sigurisht, qëllimi me jomyslimanë është për ithtarët e Librit nga jehudinjtë dhe të krishterët, sepse Islami nuk i vlerëson kurrë politeistët dhe adhuresit e idhujve.

Më pas ajeti e tregon se dy dëshmitarët duhet të mbahen për t'u betuar në All'llahun pas namazi, në rast dyshimi e mëdyshjeje për dëshminë e tyre, ku thotë: **"...Mbajini ata pas namazit dhe, nëse dyshoni në ndershmërinë e tyre, le të betohen në All'llahun...!" dhe dëshminë që na urdhëron All'llahu nuk do ta fshehim, sepse, atëherë do të ishim vërtet keqbërës.**" Duhet që përmbajtja e dëshmisë së tyre të jetë: Ne nuk jemi të gatshëm ta shesim të vërtetën për përfitime materiale dhe të dëshmojnë kundër të vërtetës edhe nëse dëshmia do të jetë kundër të afërmeve tanë, siç thotë edhe ajeti: **"...Ne nuk do ta shesim betimin me kurrfarë çmimi, edhe nëse është fjala për cilindo të afërmi..."** Ne kurrë nuk do ta fshehim dëshminë e All'llahut, se përndryshe do të jemi prej gjynahqarëve. Ajeti thotë: **"...dhe dëshminë që na urdhëron All'llahu nuk do ta fshehim, sepse, atëherë do të ishim vërtet keqbërës."**

Patjetër duhet që të vërejmë:

Së pari: Këto detaje në dhënien e dëshmisë qëndrojnë në rastin e dyshimit dhe të hezitimit.

Së dyti: Nuk ka ndryshim mes myslimanit dhe jomyslimanit në këtë çështje, sikurse duket në këtë ajet. Ajo, në të vërtetë, është mënyrë për rregullat që urdhërojnë për të ruajtur pasurinë nga abuzimi dhe në të nuk ka kundërshtim për pranimin e dëshmisë së dy personave të drejtë, pa u betuar, sepse kjo është kur nuk ka dyshim tek të dy dëshmitarët. Prandaj, ai as nuk e anullos ajetin dhe as nuk është i veçantë për jomyslimanët.

Së treti: Qëllimi me namazin e jomyslimanëve, është për namazin e tyre, me anë të të cilit i drejtohen All'llahut dhe i frikësohen Atij. Ndërsa, për sa u përket myslimanëve, disa thonë që bëhet fjalë veçanërisht për namazin e ikindisë. Edhe disa transmetime të ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi të!*) e tregojnë këtë gjë. Mirëpo, përgjithësimi i përfshin të gjitha namazet. Ndoshta, përmendja e namazit të ikindisë në transmetimet tona ka anë të pëlqyeshme, ku njerëzit tubohen më së shumti në namazin e ikindisë, koha e së cilës ka qenë koha e njohur për të gjykuar ndërmjet myslimanëve.

Së katërti: Shkaku i përzgjedhjes së kohës së namazit për të dëshmuar është se personi në këtë kohë përjeton ndikimet e namazit, siç thuhet në ajetin 45 të sures "El Ankebut": **"...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..."** Sigurisht, në këtë kohë e në këtë vend, njeriu është më pranë të vërtetës. Disa kanë thënë se më e mira dëshmi është në Mekë, te Qabja dhe ndërmjet "*Ruknit*" dhe "*Mekamit*", duke qenë se është vendi më i shenjtë. Në Medine, betimi të jetë në anë të varrit të të

Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në ajetin vijues flitet për konstatimin e tradhëtisë së dy dëshmitarëve kur dëshmojnë të pavërtetën, siç ka ardhur në shkakun e zbritjes së këtij ajeti. Rregulli, në rastin kur zbulohet se dy dëshmitarët kanë kryer mëkat ndaj së vërtetës, është që të ndërrohen me dy dëshmitarë të tjerë, të cilët dëshmojnë për të zbatuar të drejtën e trashëgimtarëve. Ajeti thotë: **“Nëse më pas zbulohet se këta dy dëshmues kanë bërë gjynah, atëherë le të zëvendësohen nga dy të tjerë prej atyre që këta u kanë bërë padrejtësi...”**

Dijetari i shquar Tabarsij në tefsirin “Mexhmaul Bejjan” ka thënë se ky ajet konsiderohet nga ana sintaksore si një nga ajetet më të ndërlikuar e më të vështirë.¹ Por, nëse i vërejmë këto dy pika kryesore, do të shohim se ky ajet nuk është edhe aq i vështirë e i ndërlikuar:

Pika e parë: Kuptimi i fjalës *istehakke*, e shoqëruar me fjalën *ithm* është për gjynahin e shkeljes së të drejtës së të tjerëve.

Pika e dytë: Fjala *eulijan* ka për qëllim dy dëshmitarët e parë, të cilët duhet të dëshmonin të vërtetën, mirëpo devijuan nga rruga e vërtetë. Për këtë, kuptimi kësaj është: Nëse vërtetohet se dy të parët kanë devijuar, atëherë, në vend të tyre, merren dy dëshmitarë të tjerë, për atë që ka ndodhur nga padrejtësia e dy dëshmitarëve të parë.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 441.

Pastaj ajeti shpjegon se çfarë duhet të bëjnë këta dy dëshmitarë, ku thotë: **“Pastaj, dy dëshmitarët e fundit le të betohen në All’llahun (duke thënë): ‘Pa dyshim, dëshmia jonë është më e drejtë se dëshmia e tyre. Ne nuk gënjejmë, sepse përndryshe do të ishim keqbërës.’”**

Meqenëse të afërmit e të vdekurit kanë qenë në dijeni për pasurinë dhe plaçkat që ka marrë i vdekuri në udhëtim, ose ato që i zotëron në përgjithësi, mund të dëshmojnë se dy dëshmitarët e parë kanë mashtruar dhe kanë bërë padrejtësi, kjo dëshmi duhet të jetë e bazuar në argumente e jo mbi ndjesi.

Ajeti i fundit shpjegon urtësinë e rregullave që kanë ardhur në ajetet e mëparshme për çështjen e dëshmisë. Ajeti thotë: **“Kështu është më e lehtë që ata ta bëjnë dëshminë e tyre të saktë ose të frikësohen nëse betimet e tyre do të dalin në kundërshtim me betime të tjera...”**

Me të vërtetë, ky duhet të jetë shkak i vërtetë i frikës ndaj përgjegjësisë përpara All’llahut dhe përpara njerëzve dhe të mos devijojnë nga argumenti i saktë.

Duke përforcuar rregullat e lartpërmendura, All’llahu i Lartësuar i urdhëron njerëzit duke u thënë: **“...Frikësojuni All’llahut dhe dëgjoni! All’llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit ngatërrestarë.”**

Ajeti 109

﴿يَوْمَ تَجْمَعُ اللَّهُ الرُّسُلَ فَيَقُولُ مَاذَا أُجِبْتُمْ﴾ ^ص قَالُوا لَا عِلْمَ
لَنَا ^ص إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّمُ الْغُيُوبِ ﴿١٠٩﴾

“Një ditë All’llahu do t’i tubojë të Dërguarit e do t’u thotë: ‘Si ju janë përgjigjur?’ Ata do të thonë: ‘Ne s’kemi dijeni; vetëm Ti i di të gjitha fshehtësitë.’”

Komentimi

Në të vërtetë, ky ajet është plotësues i ajeteve të mëparshme. Në fund të atyre ajeteve që flitej për dëshminë e vërtetë dhe atë të rreme, All’llahu urdhëronte për devotshmëri dhe për frikë ndaj thyerjes së urdhrit të All’llahut. Në këtë ajet përmendet dita kur All’llahu i Lartësuar do t’i tubojë të Dërguarit dhe do t’i pyesë ata për mesazhin e tyre dhe atë se çfarë u kanë thënë njerëzve për t’iu përgjigjur pretendimeve të tyre. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: “Një ditë All’llahu do t’i tubojë të Dërguarit e do t’u thotë: ‘Si ju janë përgjigjur?’

Ata i mohuan vetes së tyre dijen, duke thënë se të gjitha të vërtetat janë te dija e All’llahut të Lartësuar ku thotë: “Ata do të thonë: ‘Ne s’kemi dijeni; vetëm Ti i di të gjitha fshehtësitë.’” Atëherë me të vërtetë, ju jeni përpara të Gjithëditurit të të fshehtave dhe përpara Gjykatës madhështore, prandaj kini kujdes që ta devijoni dëshminë tuaj nga e drejta dhe e vërteta!

Këtu shfaqen dy pyetje:

Pyetja e parë: Nga ajetet e Kur'anit përftohet se Profetët janë dëshmitarë për popujt e tyre, ndërsa në këtë ajet zbulojmë se ata popuj e mohojnë çdo dije dhe thonë se çdo gjë është tek All'Ilahu.

Mirëpo, këtu nuk ka mospajtim e kundërshti, por bën fjalë për dy faza:

Faza e parë: Në këtë fazë ajeti shpjegon kohën kur Profetët paraqiten me moral e edukatë të lartë para pyetjes së All'Ilahut të Lartësuar dhe e mohojnë dijen për vetveten e tyre dhe thonë se çdo gjë është te dija e All'Ilahut të Lartësuar.

Faza e dytë: Në këtë fazë Profetët shfaqin atë që dinë për popujt e tyre dhe dëshmojnë për ta. Kjo pothuajse ngjan me mësuesin që kërkon nga nxënësit e tij që t'i përgjigjen pyetjes së tij dhe nxënësi në fillim tregohet i sjellshëm dhe thotë se dija e tij nuk është asgjë para dijes së mësuesit dhe pas kësaj thotë atë çfarë ai di.

Pyetja e dytë: Si është e mundur që Profetët të mohojnë dijen e tyre, ndërkohë që ata përveç dijeve të zakonshme dinë shumë nga të vërtetat e fshehta që All'Ilau ua ka mësuar atyre?

Megjithëse në përgjigje të kësaj pyetjeje, komentuesit e Kur'anit kanë shumë thënie, ne mendojmë se tematika është e qartë dhe ajo është se Profetët e shikojnë dijen e tyre si asgjë, përballë dijes së All'Ilahut dhe kjo është e vërtetë. Ekzistenca jonë nuk është asgjë përballë ekzistencës së All'Ilahut, që nuk ka fillim dhe as mbarim. Dija jonë nuk është asgjë përpara dijes së All'Ilahut. Thënë ndryshe: Dija e Profetëve, sado e madhe të jetë,

ajo nuk është asgjë para dijes së All'llahut. Pra, asnjë dije nuk mund të barazohet me dijen e All'llahut të Lartësuar.

Në të vërtetë, i dituri i vërtetë është ai që është i pranishëm dhe mbikëqyrës në çdo vend e në çdo kohë. Kjo cilësi e diturisë është e veçantë vetëm për All'llahun Madhëruar.

Nga ajo çfarë thamë, sqarohet se ky ajet nuk është argument i mohimit të dijes së fshehtë që kanë Profetët dhe Imamët, siç thonë disa se “ilmul gajb” (dija për të fshehtën) dallon në vetvete. Ajo është e veçantë për atë që është e pranishme në çdo vend dhe në çdo kohë, ndërsa përveç All'llahut askush nuk i di të fshehtat, me përjashtim të atyre që i ka mësuar All'llahu i Lartësuar.

Kjo thamë më lartë është marrë nga ajetet e Kur'anit, si ajeti 26-27 i sures “El Xhin”, ku thuhet: **“Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të Dërguarve që ka zgjedhur. Para dhe pas tyre Ai vë mbikëqyrës.”**; në ajetin 49 të sures “Hud”, ku thuhet: **“Këto janë (disa) nga lajmet e fshehta që Ne t'i shpallim ty.”**

Nga këto ajete dhe të tjera si këto përfitohet se dija e fshehtë është specifike dhe veçori e All'llahut të Lartësuar, por Ai ia mëson atij që dëshiron dhe aq sa Ai dëshiron.

Ajete 110

إِذْ قَالَ اللَّهُ يَٰعِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ اذْكُرْ نِعْمَتِي عَلَيْكَ وَعَلَىٰ
 وَالِدَتِكَ إِذْ أَيَّدْتُكَ بِرُوحِ الْقُدُسِ تُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ
 وَكَهْلًا ^ط وَإِذْ عَلَّمْتُكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ
 وَإِذْ تَخْلُقُ مِنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ بِإِذْنِي فَتَنفُخُ فِيهَا فَتَكُونُ طَيْرًا
 بِإِذْنِي ^ط وَتُبْرِئُ الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ بِإِذْنِي ^ط وَإِذْ تُخْرِجُ الْمَوْتَىٰ
 بِإِذْنِي ^ط وَإِذْ كَفَفْتُ بَنِيَ إِسْرَءِيلَ عَنْكَ إِذْ جِئْتَهُم بِالْبَيِّنَاتِ
 فَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ إِنْ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُبِينٌ ﴿١١﴾

“All’l-lahu do të thotë: O Isa, i biri Merjemes, kujtoje mirësinë
 Time ndaj teje dhe nënës sate: se si të forcova ty me Shpirtin e
 Shenjtë (Xhebrailin), kështu që ti u predikojë njerëzve, kur ishe
 foshnjë në djep dhe i rritur; se si të mësova Librin dhe Urtësinë,
 Teuratin dhe Ungjillin; se si me vullnetin Tim krijojë një figurë
 shpendi prej balte, pastaj fryje në të dhe ajo bëhej zog me
 vullnetin Tim; se si me vullnetin Tim i shëroje të lindurit të
 verbër e të lebrosurit; se si me vullnetin Tim i ngjallje të
 vdekurit; se si i pengova sulmet e izraelitëve kundër teje,
 atëherë kur iu solle atyre prova të qarta e mohuesit në radhët e
 tyre thanë: ‘Kjo është vetëm magji e kulluar!’”

Komentimi

Mirësia e All'llahut ndaj Mesihut

Ky ajet dhe ajetet deri në fund të sures “El Maide” flasin për jetën e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për mirësitë që All'llahu i ka dhënë atij dhe nënës së tij. All'llahu e qartëson këtu për t'i ndërgjegjësuar dhe për t'i zgjuar myslimanët. Për këtë, All'llahu thotë: **“All'llahu do të thotë: ‘O Isa, i biri Merjemes, kujtoje mirësinë Time ndaj teje dhe nënës sate...”**” Dhe kuptimi i thënies “idh kale” është: *përmend kur All'llahu...*

Sipas këtij komentimi, ky ajet dhe të tjerët në vijim, fillojnë me një hulumtim të pavarur që përfshin anën edukative për myslimanët dhe ka lidhje me këtë botë. Ndërsa një grup komentuesish si Tabarsij, Bejdavij, Ebi el Futuh dhe Er Rrazi mendojnë se ky ajet është ndjekës i ajetit të mëparshëm që përmbante dialogun mes All'llahut dhe të Dërguarve të tij Ditën e Gjykimit.¹

Duke u bazuar në këtë, folja që ka ardhur në kohën e shkuar *kale*, do të thotë *ka thënë*, ka ardhur me kuptimin e foljes në kohën e tashme *jekul* që do të thotë *ai thotë*. Mirëpo, kjo bie në kundërshtim me aparencën e ajetit. Mirësitë e shumta që i vijnë një njeriu kanë për qëllim ringjalljen e shpirtit të mirënjohjes e të falënderimit. E kjo nuk ka vend në Ditën e Gjykimit.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 448.

Pas kësaj, ajeti fillon me përmendjen e mirësive, ku thotë: **“...se si të forcova ty me Shpirtin e Shenjtë (Xhebrailin)...”** Ne e kemi shpjeguar me detaje kuptimin e fjalës “Shpirti i shenjtë” në vëllimin e parë të këtij tefsiri, ku një nga këto alternativa tregon se është meleku i zbritjes së Revelatës, Xhebraili. Alternativa tjetër është ajo fuqi e fshehtë, e cila e ndihmonte Isanë (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) për të shfaqur mrekullitë dhe për të realizuar mesazhin e tij të rëndësishëm. Ky kuptim ekziston edhe për Profetët e tjerë, por në një gradë më të ulët.

Nga mirësitë e tjera të All'Ilahut për Isanë (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) janë: **“...kështu që ti u predikojë njerëzve, kur ishe foshnjë në djep dhe i rritur...”** pra, të folurit tënd në djep është njësoj si të folurit tënd i rritur. Me një fjalë, janë fjalë të pjekura dhe të matura dhe nuk janë fjalë fëmijësh.

Pastaj, All'Ilahu i Lartësuar, gjithashtu, vazhdon e thotë: **“...se si të mësova Librin dhe Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin...”**. Me të vërtetë, përmendja e Teuratis dhe e Ungjillit pas përmendjes së fjalës *libër*, megjithëse të dy janë libra qiellorë, është bërë për shkak të sqarimit pas përmendjes në përgjithësi.

Nga mirësitë e tjera të All'Ilahut për Isanë (*Paqja qoftë mbi të!*) janë: **“...se si me vullnetin Tim krijoje një figure shpendi prej balte, pastaj fryje në të dhe ajo bëhej zog me vullnetin Tim...”**

Përveç këtyre, ti (o Isa), me vullnetin dhe lejen e All'Ilahut shëron të verbërit e lindur dhe lebroset, siç thotë ajeti: **“...se si me vullnetin Tim i shëroje të lindurit të verbër e të lebrosurit...”**

Më poshtë, përsëri All'llahu i Lartësuar thotë: **“...se si me vullnetin Tim i ngjallje të vdekurit...”**

Së fundmi, prej mirësive të Mia ndaj teje, o Isa, është se Unë ta ndalova të keqen që ta drejtuan ty bijtë e izraelit atë ditë kur mohuesit thanë se ajo çfarë ti vepron është magji e qartë. Unë të mbrojta nga e keqja e atyre kundërshtarëve dhe të kam ruajtur ty që të vazhdosh rrugën e thirrjes. Për këtë ajeti thotë: **“...se si i pengova sulmet e izraelitëve kundër teje, atëherë kur iu solle atyre prova të qarta e mohuesit në radhët e tyre thanë: ‘Kjo është vetëm magji e kulluar!’”**

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se në të përsëritet katër herë fraza *“me lejen Time”*, me qëllim që të mos mbesë vend për hyjnizimin e Isasë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe të mos thuhet së Isai është zot. Pra, të gjitha ato që veproi Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) prej mrekullive mahnitëse, nuk kanë buruar nga ai, por të gjitha kanë qenë prej All'llahut dhe me vullnetin dhe lejen e Tij. Isai nuk ka qenë veçse rob prej robve të All'llahut, i bindur ndaj urdhrave të Tij dhe ai nuk zotëronte asgjë përveç asaj që mbështetej në fuqinë e përhershme të All'llahut.

Dikush mund të pyesë: Nëse të gjitha këto mirësi kanë qenë specifike për Isanë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), përse ajeti thotë se janë, gjithashtu, edhe për nënën e tij?

Nuk ka dyshim se çdo mirësi që i arrin të birit, i arrin dhe së ëmës. Të dy janë nga e njëjta origjinë dhe nga e njëjta pemë.

Sikurse e kemi përmendur në fundin e ajetit e 49 të sures “Ali Imran”, në të vërtetë, ky ajet dhe ajetet e tjera të ngjashme, tregojnë se vilajeti i eulijave (të dashurve) të All'llahut gjendet që në krijim. Në historinë e jetës së Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi*

të!), atij *i* atribuohen ringjallja e të vdekurve, shërimi i të verbërve të lindur dhe i leprosës dhe të gjitha këto janë realizuar me lejen dhe vullnetin e All'llahut. Nga kjo qartësohet se është e mundur që All'llahu t'i japë mirësi e dhunti atij që Ai dëshiron. Kjo forcë i jep mundësi njeriut që të reagojë në këtë botë dhe të kryejë këto veprime.

Kurse komentimi i këtij ajeti që thotë se flet për lutjet e Profetëve dhe se All'llahu i përgjigjet lutjes së tyre, është në kundërshtim me pamjen e jashtme të këtij ajeti. Ndërsa ajo që thamë për vilajetin e të dashurve të All'llahut, është ajo që përmendëm më lart, sepse nuk ka asnjë tregues që të flasë më shumë se kaq (Për më tepër, shih komentimin e ajetit 49 të sures "Ali Imran").

Ajetet 111 - 115

وَإِذْ أَوْحَيْتُ إِلَى الْحَوَارِيِّينَ أَنْ ءَامِنُوا بِي وَبِرَسُولِي قَالُوا
 ءَامِنَا وَأَشْهَدُ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿١١١﴾ إِذْ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ يَٰعِيسَى
 ابْنَ مَرْيَمَ هَلْ يَسْتَطِيعُ رَبُّكَ أَنْ يُنْزِلَ عَلَيْنَا مَائِدَةً مِّنَ
 السَّمَاءِ ۖ قَالَ اتَّقُوا اللَّهَ إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿١١٢﴾ قَالُوا نُرِيدُ
 أَنْ نَأْكُلَ مِنْهَا وَتَطْمَئِنَّ قُلُوبُنَا وَنَعْلَمَ أَنْ قَدْ صَدَقْتُنَا وَنَكُونَ
 عَلَيْهَا مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿١١٣﴾ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ اٱللَّهُمَّ رَبَّنَا
 أَنْزِلْ عَلَيْنَا مَائِدَةً مِّنَ السَّمَاءِ تَكُونُ لَنَا عِيدًا لِأَوَّلِنَا وَءَاخِرِنَا
 وَءَايَةً مِّنكَ ۖ وَارْزُقْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّزَاقِينَ ﴿١١٤﴾ قَالَ ٱللَّهُ إِنِّي
 مُنْزِلُهَا عَلَيْكُمْ ۖ فَمَنْ يَكْفُرْ بَعْدُ مِنكُمْ فَإِنِّي أُعَذِّبُهُ عَذَابًا لَّا
 أُعَذِّبُهُ أَحَدًا مِّنَ ٱلْعٰلَمِينَ ﴿١١٥﴾

“Dhe se si kur i urdhërova dishepujt: ‘Besomëni Mua dhe të Dërguarin Tim!’ - ata u përgjigjën: ‘Ne besojmë, prandaj dëshmo se Ty të jemi dorëzuar!’”

“Kujto kur dishepujt thanë: ‘O Isa, i biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na zbresë një sofër prej qielli?’ Ai tha: ‘Kini frikë All’llahun, nëse jeni besimtarë të vërtetë!’”

“Ne dëshirojmë të hamë nga ajo – thanë ata –, me qëllim që të na qetësohen zemrat dhe ta dimë se na ke thënë të vërtetën dhe për atë të jemi dëshmitarë.”

“O All’llah, o Zoti ynë – tha Isai, i biri i Merjemes – zbritna një sofër nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë dhe të jetë mrekulli prej Teje dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë!”

“All’llahu u përgjigj: ‘Unë do t’jua zbres sofrën. Por cilindo nga ju që nuk beson pas kësaj, do ta dënoj ashtu siç nuk kam dënuar askënd në botë.’”

Komentimi

Tregimi i zbritjes së sofrës për dishepujt

Pas asaj që u përmend në ajetet e mëparshme rreth mirësive të All’llahut për Isanë (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe për nënën e tij, ky ajet flet për mirësitë e All’llahut për dishepujt, shokët dhe ndjekësit e Isait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*).

Në fillim, ajeti tregon për atë çfarë iu shpall dishepujve që të besojnë në All’llahun dhe në të Dërguarin e tij, Isanë ku thotë: **“Dhe se si kur i urdhërova dishepujt: ‘Besomëni Mua dhe të Dërguarin Tim!’ - ata u përgjigjën: ‘Ne besojmë, prandaj dëshmo se Ty të jemi dorëzuar!’”**.

Fjala “el uahju” në Kur’an ka kuptim të gjerë dhe nuk kufizohet vetëm në Revelatën që i zbret Profetëve, por edhe frymëzimi që zbret në zemrat e njerëzve konsiderohet, gjithashtu, një prej të vërtetave të “el uahju”. Për këtë, ky kuptim gjendet edhe në ajetin e 7 të sures “El Kasas” në çështjen e nënës së Musait (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!), i cili thotë: **“Kështu, ne e frymëzuam nënën e Musait...”** Përveç kësaj, kjo fjalë përdoret në Kur’an edhe për instinktin krijimtar te gjallesat, siç është bleta.

Gjendet alternativë tjetër që thotë se qëllimi me fjalën “el ijha’u” është për inspirimin që i vinte Isait (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) nëpërmjet e mrekullive.

Çështjen e dishepujve dhe shokëve të Isait e kemi trajtuar në komentimin e ajetit 52 të sures “Ali Imran” në këtë tefsir.

Pastaj, ajeti përmend zbritjen e sofrës nga qielli, ku thotë: **“Kujto kur dishepujt thanë: ‘O Isa, i biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na zbresë një sofër prej qielli?...’”**

Fjala *Maide* nga ana gjuhësore do të thotë *sofër, tryezë dhe tabak*. Po ashtu, ka kuptimin e ushqimit që vendoset mbi të. Rrënja e saj është *mejd*, që do të thotë *lëvizje dhe lëkundje*. Ndoshta shkak u përdorimit të fjalës *Maide* për sofrën dhe ushqimin është ajo e cila e detyron atë të lëvizë e të transportohet.

Isai (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) u shqetësua nga kërkesa e dishepujve, sepse kjo tregon dyshim, edhe pse ai u kishte sjell argumente dhe shenja të shumta. Ai u drejtohet atyre duke u thënë: **“...Ai tha: ‘Kini frikë All’llahun, nëse jeni besimtarë të vërtetë!’”** Por ata shumë shpejt i argumentuan Isait (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) se qëllimi i tyre ishte i pastër e i sinqertë dhe

se nuk kishin për qëllim mosbesimin e kokëfortësinë, por dëshironin që të ushqeheshin nga ajo sofrë. Ajeti thotë: **“Ne dëshirojmë të hamë nga ajo – thanë ata –, me qëllim që të na qetësohen zemrat dhe ta dimë se na ke thënë të vërtetën dhe për atë të jemi dëshmitarë.”**

Me këtë thënie ata qartësuan qëllimin e tyre se e kërkuan sofrën për ushqimin që të qetësoheshin zemrat e tyre dhe se ky ushqim i All'llahut do të ndikonte në shpirt dhe në shtimin e bindjes e të vetëbesimit.

Kur e mësoi Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) qëllimin e mirë të tyre në këtë kërkesë, iu lut All'llahut duke thënë: **“O All'llah, o Zoti ynë! – tha Isai, i biri i Merjemes – Zbritna një sofrë nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë dhe të jetë mrekulli prej Teje dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë!”**

Është e qartë këtu se mënyra se si ia prezantoi Isai, i biri i Merjemes (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) All'llahut Fuqiplotë këtë çështje, ka qenë mëse e përshtatshme dhe tregon shpirtin e hulumtimit rreth të vërtetës dhe kujdesjen për çështjet e përgjithshme të shoqërisë. All'llahu iu përgjigj kësaj kërkesë që buronte nga qëllimi i mirë dhe i sinqertë. Ajeti thotë: **“All'llahu u përgjigj: ‘Unë do t’jua zbres sofrën. Por cilindo nga ju që nuk beson pas kësaj, do ta dënoj ashtu siç nuk kam dënuar askënd në botë.’”** Pas zbritjes së sofrës nga qielli, përgjegjësia e tyre shtohet, argumenti i tyre forcohet, gjithashtu ndëshkimi shtohet, në rast se ata mohojnë dhe devijojnë.

Hulumtime

Në këto ajete duhet të shpjegohen disa pika:

1- Cili është qëllimi i kërkesës së sofrës?

Nuk ka dyshim se dishepujt nuk kanë qenë të nxitur nga qëllimi i keq në kërkesën e tyre dhe as nuk kanë dashur që të tregojnë kokëfortësi e mosbindje, por kanë dëshiruar të arrijnë në një shkallë më të fortë bindjeje dhe të largonin çdo grimcë dyshimi dhe vesveset në brendinë e tyre. Shumë shpesh ndodh që njeriu e vërteton diçka me logjikë dhe përvojë. Por, nëse një çështje është shumë e rëndësishme, me të vërtetë, mbetjet e dyshimit qëndrojnë në thellësinë e zemrës. Për këtë, njeriu ka një dëshirë shumë e fortë që të përsëriten eksperimentet, derisa të shndërrohen në argumente logjike të cilat ja sheh syri, që të depërtojnë në thellësinë e zemrës dhe të shkulin nga rrënjët atë dyshim apo vesves të mbetur në të.

Por këtë, vërejmë Ibrahimin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i cili edhe pse kishte atë pozitë të lartë (khalilull'llah), i kërkoi All'llahut të Lartësuar që ta shihte Ringjalljen me sytë e tij, me qëllim që besimi i tij i bazuar në dije, të shndërrohej në besim të vërtetë e të bindur me anën e të shikuarit.

Por mënyra e kërkesës së dishepujve kishte diçka prej largpamësie, prandaj Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) mendoi se ata kërkonin shfaqësim dhe argument dhe i këshilloi ata, sikurse thoshte ajeti, që të frikësoheshin. Pasi ia sqaruan atij të vërtetën e qëndrimit të tyre, ai ua pranoi atyre kërkesën.

2 - Cili është qëllimi i thënies “A mundet Zoti yt”?

Nuk ka dyshim se në dukje kjo thënie tregon se dishepujt dyshonin në fuqinë e All'Ilahut për të zbritur nga qielli sofrën. Mirëpo komentuesit myslimanë kanë mendime të tjera në komentimin e këtij ajeti. Prej tyre është se kjo kërkesë ka ndodhur në fillim të çështjes së tyre dhe para se të mësonin cilësitë e All'Ilahut.¹

Një mendim tjetër thotë se pyetja e tyre do të thotë: A mendon All'Ilahu se është me dobi që t'ua zbresë atyre atë sofër nga qielli? Kjo është njësoj sikur dikush thotë: 'Nuk mund t'ia lë filanit të gjithë pasurinë time'. Kjo nuk do të thotë se nuk është në gjendje për ta bërë këtë, por e shikon se nuk ka dobi në këtë çështje.”²

Mendimi i tretë thotë se pyetja “a mundet”, do të thotë “a na përgjigjet.” Kuptimi i saj është: “A i përgjigjet All'Ilahu kërkesës sonë në çështjen e zbritjes së sofrës nga qielli?”³

3- Cila është ajo sofër që ka zbritur nga qielli?

Kur'ani Famëlartë nuk ka përmendur asgjë rreth përbërjes së kësaj sofre. Por nga disa hadithe përfitohet, veçanërisht në hadithin e transmetuar nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), se ajo sofër ka pasur bukë dhe peshk. Ndoshta shkak i kërkesës së kësaj mrekullie ka qenë ajo çfarë kanë dëgjuar për sofrën e zbritur nga qielli për bijtë e Izraelit nëpërmjet mrekullisë së Musait (*Paqja*

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 452.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 452.

³ Tefsiri “Tibjan”, vëll. 4, f. 58.

e All'llahut qoftë mbi të!), kështu që edhe ata i kërkuar të njëjtën gjë Isait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).¹

4- A i zbriti atyre sofrat?

Pavarësisht se ajetet e lartpërmendura na tregojnë me qartësi zbritjen e sofrës nga qielli, sepse All'llahu nuk e thyen fjalën e Tij, është e habitshme se disa komentues dyshojnë për këtë. Ata thonë se dishepujt, pasi e mësuan përgjegjësinë që do të binte mbi ta pas zbritjes së sofrës, u distancuan nga kërkesa e tyre. Por, në të vërtetë, sofrat ka zbritur.

5- Çfarë është festa?

Fjala *el ijd* rrjedh nga fjala *el aud*, që nga ana gjuhësore do të thotë kthim, rikthim. Për këtë përmendja e ditëve në të cilat largohen problemet te popujt apo shoqëritë, dhe rikthehet fitorja dhe gëzimi, kjo është festë. Po kështu janë edhe festat islame, ku pas agjërimit të Muajit të Ramazanit, ose pas kryerjes së Haxhit, njeriu kthehet në të njëjtën pastërti, pastërtinë e parë të natyrës së lindur (fitratu), e kjo është festë. Përderisa dita e zbritjes së sofrës nga qielli ka qenë ditë e kthimit në fitore, pastërti dhe besim, këtë ditë Isai (Mesia) (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) e quajti festë. Ka ardhur në transmetime se zbritja e sofrës ka ndodhur ditën e dielë. Ndoshta, për këtë arsye të krishterët e respektojnë këtë ditë.²

Në thënien e prijësit të besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ne lexojmë: "...se çdo ditë që nuk i bëhet mëkat All'llahut të Lartësuar, ajo ditë është festë."³

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 3, f. 455.

² Tefsiri "Biharul Enuar", vëll. 14, f. 262.

³ "Nehxhul Belaga", "Fjalë të Shkurtra", fjala 428.

Ky hadith tregon të njëjtën gjë se lënia e mëkatit është ditë fitoreje dhe kthimi në besim e në pastërti është kthim në natyrën e pastër krijuese (el fitratu).

6- Përse ndëshkimi është i rreptë?

Këtu është një çështje e rëndësishme që duhet të mos anashkalohet. Ajo është se kur besimi arrin deri në shkallën e dëshmisë dhe të bindjes së fortë, pra kur shihet me shikimin e syrit, nuk mbetet asnjë dyshim dhe përgjegjësia e njeriut shtohet dhe rëndohet me shumë. Sepse, pas kësaj ky njeriu që pushtohet nga vesvesi dhe dyshimi, ka arritur në një gradë të re besimi dhe mban tërë përgjegjësinë. Sikur të neglizhojë e të jetë i pavëmendshëm, atë e pret ndëshkimi i rreptë. Për këtë, përgjegjësia e Profetëve dhe e të dashurve të All'llahut është më e madhe, sepse ata kanë qenë gjithmonë të frikësuar. Në jetën tonë të përditshme ne befasohe mi me këto gjëra, ku për shembull, çdo njeri e di se në vendin e vet apo qytetin e vet ka të uritur dhe ai ka përgjegjësi ndaj tyre. Por, kur njeriu shikon një person të pafajshëm e të uritur me sytë e tij, atëherë përgjegjësia e tij është më e madhe.

7- Dhjata e Re dhe sofra

Në katër Ungjihtë që ekzistojnë dhe janë të përhapur sot nuk gjejmë asnjë fjalë që flet për sofrën, siç ka ardhur në Kur'anin famëlartë, përveçse çfarë ka ardhur në Ungjillin e Gjonit në kapitullin 21, që bën fjalë për mrekullinë e Isait, që pret një grup mysafirësh më bukë e me peshk. Por nëse e

vërejmë këtë me kujdes, do të mësojmë se kjo nuk ka lidhje me sofrën që u ka zbritur All'llahu i Lartësuar dishepujve.¹

Në librin “**Veprat e të Dërguarve**”, që është nga librat e Dhjatës së Re, thuhet se sofrë i ka zbritur njërit prej dishepujve, emri i të cilit është Butrus. Por edhe kjo nuk ka lidhje me tematikën tonë. Ne e dimë se shumë të vërteta, të cilat i janë shpallur Isait, nuk gjenden në Ungjijtë e sotëm. Po ashtu, në këto Ungjij ka shumë gjëra që nuk i kanë zbritur Isait (*Paqja qoftë bi të!*)²

¹ “El Huda ila dijnul Mustafa”, vëll. 2, f. 239.

² “El Huda ila dijnul Mustafa”, vëll. 2, f. 239.

Ajetet 116 - 118

وَإِذْ قَالَ اللَّهُ يَعْيسَى ابْنَ مَرْيَمَ ءَأَنْتَ قُلْتُ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمِّي
 إِلَهَيْنِ مِنْ دُونِ اللَّهِ ^ط قَالَ سُبْحَنَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا
 لَيْسَ لِي بِحَقِّ ^ج إِنْ كُنْتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ ^ح تَعْلَمُ مَا فِي
 نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ ^ج إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ ﴿١١٦﴾
 مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا أَمَرْتَنِي بِهِ أَنْ أَعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ ^ج
 وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا مَّا دُمْتُ فِيهِمْ ^ط فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتُ أَنْتَ
 الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ ^ج وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿١١٧﴾ إِنْ تُعَذِّبْهُمْ
 فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ ^ط وَإِنْ تَغْفِرْ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١١٨﴾

“Pastaj All’llahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): ‘O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas All’llahut?!’ Isai do të thotë: ‘Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat.’”

“Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: ‘Adhuroni All’llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!’ Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë.”

“Nëse Ti i dënon ata - robtë e Tu janë; e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”

Komentimi

Pafajësia e Isait nga shirku i ndjekësve të tij

Këto ajete tregojnë bashkëbisedimin mes All’llahut të Lartësuar dhe Isait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) Ditën e Gjykimit. Argument për këtë është se në ajetin 119 do të lexojmë: **“...Kjo është Dita në të cilën të singertëve u sjell dobi singëriteti i tyre...”** Nuk ka dyshim se ajo është Dita e Gjykimit.

Edhe fjalia: **“...qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre...”** është një argument tjetër se dialogu është bërë pas kryerjes së profetësisë së Isait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*). Folia *kale* (tha), që është në kohën e shkuar, nuk bie në kundërshtim me mendimin tonë, sepse Kur’ani është i mbushur plot me tregime që përmendin Ditën e Gjykimit dhe në to është përdorur koha e shkuar. Kjo tregon se do të ndodhë patjetër. Që do të thotë, se ky dialog në të ardhmen është në atë shkallë

konstatimi dhe patjetërsie saqë duket sikur vërtet ndodhi dhe për këtë përdoret koha e shkuar.

Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë thotë: **“Pastaj All’llahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): ‘O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas All’llahut?!’”**

Nuk ka dyshim se Isai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) nuk e ka thënë një gjë të tillë, por ka thirrur për Njëtimim dhe adhurimin e All’llahut. Qëllimi në këtë pyetje është përgjigja e tij përpara popullit së tij dhe shpjegimi i kundërshtimit të tij. Isai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) i përgjigjet kësaj pyetjeje me disa fjali dhe me shumë respekt:

1- Së pari, e paston All’llahun nga çdo idhujtari dhe ngjashmëri, ku thotë: “...Isai do të thotë: ‘Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar!...”

2- Pastaj thotë: “...Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë!...” pra, unë nuk kam të drejtë që të them atë çfarë nuk më takon mua.

3- Pastaj, për të përforcuar pafajësinë e tij, Isai mbështetet te dija absolute dhe e pakufizuar e All’llahut dhe thotë: “...Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat.”

4- Më pas thotë: “Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: ‘Adhuroni All’llahun, Zotin tim dhe

Zotin tuaj!...”, dhe Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) thotë: vetëm këtë kam thënë, as më shumë e as më pak.

5- Pastaj vazhdon e thotë: **“...Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe Mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë.”** Pra, unë, për aq kohë sa qëndrova në mesin e tyre, i pengoja ata që të bien në humnrenë e shirkut dhe isha mbikëqyrës dhe dëshmitar për ata. Mirëpo, pasi më ngrite (më more mua) tek Ti, ishe Ti Mbikëqyrës dhe Dëshmitar për ata.

6- Në ajetin e fundit të ajeteve në fjalë Kur'ani thotë: **“Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”**

Sido që të jetë, çdo gjë është nën urdhrin Tënd dhe nën vullnetin Tënd. Nëse do, ndëshkoji për shkak të devijimit të tyre të madh. Ata janë robtë e Tu dhe nuk kanë mundësi që t'i shpëtojnë ndëshkimit Tënd. Kjo është e drejta Jote për robtë e Tu. Nëse dëshiron, ua fal atyre mëkatet dhe, me të vërtetë, Ti je i Plotfuqishëm e i Urtë. Nëse nuk i fal, nuk është argument i dobësisë Tënde dhe ndëshkimi Yt nuk është i zbrazët nga urtësia dhe llogaria.

Këtu mund të lindin dy pyetje:

Pyetja e parë: A ka argument në historinë e të krishterëve se ata e kanë adhuruar Merjemen? Apo kanë thënë vetëm trinitetin (ati, biri dhe shpirti i shenjtë) duke e konsideruar shpirtin e shenjtë ndërmjetës mes atit dhe birit, i cili (shpirti i shenjtë) nuk është Merjemja?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, themi: Është e vërtetë se të krishterët nuk e kanë hyjnizuar Merjemen, por para skulpturës së saj ata kryenin rite adhurimi sikurse idhujtarët, të cilët nuk i konsideronin idhujt zota, por i konsideroni ortakë të All'llahut në adhurim.

Ka dallim mes fjalës *All'llah*, me kuptim *Krijues* dhe fjalës *ilah*, me kuptim *Adhures*. Kështu që Merjemja ka qenë te të krishterët në pozitën e zotave (*alihatu*) dhe jo në pozitën e All'llahut.

Një nga komentuesit e Kur'anit thotë: "Të krishterët, megjithë ndryshimet e tyre, edhe nëse nuk e kanë quajtur Merjemen "ilahun" (Zot apo i adhuruar), ata e kanë konsideruar nëna e Zotit e jo gjë tjetër, në realitet para saj luten dhe adhurojnë..." Pastaj shton e thotë: "Para pak kohësh ka dalë në Bejrut numri i shtatë i revistës kristiane "El Mashrik" për të përkujtuar 50-vjetorin e Papës (Bijus i shtatë). Në këtë revistë kishte tematika edhe për Merjemen. Prej tyre ishte thënia se të dyja Kishat, si ajo e Lindjes, ashtu edhe ajo e Perëndimit, e adhurojnë Merjemen. Në numrin e katërmbëdhjetë të vitit të pestë të po kësaj reviste, u botua artikulli i shkruar nga Baba Anastas Kermelij, në të cilin ai kishte sjellë argumente për adhurimin e Merjemes edhe në Dhjatë e Vjetër.¹

Me të vërtetë, adhurimi i Merjemes ekziston në mesin e tyre.

Pyetja e dytë: Si mund të flasë Isai (Mesihu) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për idhujtarët nga populli i tij me fjalë nga

¹ Tefsiri "El Manar", vëll. 8, f. 263.

të cilat ndihet era e ndërmjetësimit për ata, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"...e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti."**? A mund të jetë idhujtari meritues i ndërmjetësimit dhe i faljes?

Në përgjigje të pyetjes themi: Nëse qëllimi i Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ka qenë ndërmjetësimi për ta, ai do të thoshte *"me të vërtetë, Ti je Falës dhe Mëshirues"*, sepse falja e All'llahut dhe mëshira e Tij janë ato që përshtaten në pozitën e ndërmjetësimit. Por, ne shohim se ai thotë: **"...Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti."** Nga këtu vërehet se ai nuk ka qenë në pozicionin e ndërmjetësimit të tyre, por ka dashur që të mohojë për veten çdo zgjedhje dhe të gjitha çështjet t'i lërë në dorën e All'llahut, i Cili nëse do, i fal, nëse do, i ndëshkon. E gjithë dëshira dhe vullneti i Tij mbështeten tek urtësia e Tij. Ndoshta kjo thënie është thënë për një grup prej tyre, të cilët e kuptuan gabimin dhe u penduan për gabimet e tyre.

Ajetet 119 - 120

قَالَ اللَّهُ هَذَا يَوْمُ الصَّادِقِينَ يَنْفَعُ صِدْقُهُمْ ۚ هُمْ جَنَّتْ تَجْرَى
 مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۚ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا
 عَنْهُ ۚ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١١٩﴾ لِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ
 وَمَا فِيهِنَّ ۚ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٢٠﴾

“All’llahu thotë: ‘Kjo është Dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. All’llahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe!’”

“All’llahut i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe gjithçka që ato përmbajnë. Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”

Komentimi

Fitorja e madhe

Pas dialogut mes All'llahut dhe Mesisë (Isait) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në Ditën e Gjykimit, siç shpjeguar në komentimin e ajeteve të mëparshme, në ajetin e parë prej dy ajeteve në fjalë, thotë: **“All'llahu thotë: ‘Kjo është Dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre...”**”

Natyrisht, qëllimi në këtë ajet është se sinqeriteti në thënie e në punë në këtë jetë është ai që ka dobi në Jetën Tjetër sepse, sinqeriteti në Jetën Tjetër, në të cilën nuk ka detyrime, nuk ka dobi për asgjë. Në të vërtetë, gjendja në atë Botë është e ndryshme, dhe askush nuk mund të thotë asgjë tjetër përveç të vërtetës. Madje edhe mëkatari i pranon mëkatet që ka bërë. Në atë Botë nuk ekziston mashtrimi.

Me të vërtetë, atë që kanë kryer detyrat dhe përgjegjësië ndaj mesazhit dhe nuk kanë ecur vetëm se në rrugën e sinqertë, siç bëri Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe ndjekësit e tij të sinqertë, apo ndjekësit e të gjithë Profetëve të tjerë, të cilët ecën me sinqeritet, do ta marrin shpërblimin e tyre.

Nga këtu na qartësohet se të gjitha veprat e mira mund të shpalosen nën hijen e *sinqeritetit në thënie dhe në punë*. Ai është kapitali përfitues në Ditën e Gjykimit dhe asgjë tjetër.

Për ata të sinqertë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë...”** Për ata gjendet një mirësi më e mirë si ajo materiale, që është: **“...All'llahu është i kënaqur me ata dhe**

ata janë të kënaqur me Atë...” Nuk ka dyshim se kjo mirësi e madhe është ajo që bashkon mirësinë materiale me atë shpirtërore. Kjo është diçka e madhe, për të cilën All'llahu i Lartësuar thotë: **“...Kjo është fitorja e madhe!”**

Ajo çfarë tërheq vëmendjen në këtë ajet është se pas përmendjes të kopshteve (në Xhennet) dhe mirësitë e tij të shumta, përmend mirësinë e kënaqësisë së All'llahut nga robtë e Tij dhe kënaqësinë e robve të All'llahut ndaj Tij, duke e cilësuar si një fitore të madhe. Kjo tregon rëndësinë e madhe të kësaj kënaqësie të shkëmbyer. Ka mundësi që një njeri të jetë i zhytur në mirësitë e All'llahut, por kur ndien se Zoti i tij, i Dashuri i tij, nuk është i kënaqur me të, me të vërtetë të gjithë ato mirësi mbesin të hidhura në shijen e shpirtit të tij.

Po ashtu, ka njerëz që kanë gjithçka, por në të vërtetë, nuk janë të kënaqur me atë çfarë zotërojnë. Është më se e qartë se të gjitha këto mirësi nuk janë në gjendje që ta kënaqin e ta lumturojnë shpirtin e këtij lloj njeriu. Ai është gjithnjë në përballje me vuajtjen dhe shqetësimin, të cilat e ekzekutojnë qetësinë që është prej mirësive të mëdha të All'llahut për njeriun.

Por, nëse All'llahu është i kënaqur me njeriun, i jep atij çfarë të dojë. E nëse Ai i jep njeriut çfarë të dojë, edhe ai është i kënaqur nga Zoti i tij. Nga këtu kuptohet se mirësia më e madhe është që All'llahu i Lartësuar të jetë i kënaqur me njeriun dhe njeriu të jetë i kënaqur nga Zoti i tij.

Në ajetin e fundit thuhet se All'llahu zotëron çdo gjë që ndodhet në qiej e në Tokë. Fuqia e Tij absolute përfshin çdo gjë. Për këtë ajet thotë: **“All'llahut i takon sundimi i qiejve dhe i**

Tokës dhe gjithçka që ato përmbajnë. Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”

Ky ajet, në të vërtetë, konsiderohet shkak i kënaqësisë së robit nga All’llahu. Kjo për faktin se Ai që zotëron çdo gjë në këtë ekzistencë, ka fuqi t’u japë robve të Vet atë çfarë duan. Ua fal atyre mëkatet, i gëzon dhe i kënaq ata. Po ashtu, në ajet nënkuptohet mossinqeriteti i veprave të të krishterëve në adhurimin e Merjemes, sepse adhurimi i vlefshëm është për Atë që e drejton botën në përgjithësi dhe i jo Merjemes, e cila është krijesë sikurse ata.

Surja “El En’am”

E zbritur në Mekë

Numri i ajeteve: 165

Lufta kundër politeizmit dhe idhujtarisë

Thuhet se surja “El En’am” ka zbritur në Mekë. Ajo është e 69-ta në renditjen e zbritjes së sureve të Kur’anit. Disa komentues thonë se një pjesë e ajeteve të saj kanë zbritur në Medine. Por sipas lajmeve që na kanë mbërritur nga Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) përftohet se karakteristikë e kësaj sureje është se të gjitha ajetet e saj kanë zbritur në një vend të vetëm¹, pra në Mekë.

Qëllimi i kryesor i kësaj sureje është si qëllimi i sureve të tjera mekase. Ajo përforcon Njëshmërinë (Njëtimin) (Teuhidin), profetësinë (Nubu’uetin) dhe Ringjalljen (Meadin). Por, më tepër ajo përforcon çështjen e adhurimit të All’llahut të Vetëm e të Pashoq dhe luftën kundër politeizmit (shirkut) dhe idhujtarisë. Shumica e ajeteve të kësaj sureje u drejtohet mushrikëve dhe idhujtarëve. Kështu që shumica e hulumtimeve të saj ka lidhje me veprat e politeistëve dhe me risitë e tyre.

Studimi dhe zbatimi i ajeteve të kësaj sureje dhe vëmendshmëria në argumentet e tyre, ngjall shpirtin e teuhidit e të adhurimit të All’llahut, shkatërron të gjitha bazat e shirkut dhe zhduk rrënjët e tij. Ndoshta shkak i zbritjes së saj në një vend të vetëm ka të bëjë me këtë pasim shpirtëror dhe dhënies përparësi çështjes së teuhidit. Prej mirësive të kësaj sureje thuhet se kur shpallej, shoqërohej nga 70000 (shtatëdhjetë mijë) melekë. Atij që e lexon këtë sure, etja e shpirtit do t’i shuhet tek burimi i teuhidit dhe melekët do të kërkojnë falje për atë lexues.²

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 5 dhe 6.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 5 dhe 6.

S'ka dyshim se thellimi në ajetet e kësaj sureje shfaros hipokrizinë dhe përçarjen, duke i bërë veshët sa më dëgjues, sytë sa më shikues dhe zemrat sa më njohëse.

Por, është çudi se shohim disa që mjaftohen me leximin e fjalëve dhe fjalive të kësaj sureje dhe organizohen tubime (mexhlise) për leximin e ajeteve të saj me qëllim që të zgjidhen problemet personale. Sikur në këto tubime (mexhlise), pjesëmarrësit do të interesoheshin për përmbajtjen e sures, nuk do të zgjidheshin vetëm problemet personale, por do të zgjidheshin të gjitha problemet e myslimanëve në tërësi. Është për të ardhur keq se një pjesë njerëzish e konsiderojnë Kur'anin si një mori çështjesh që kanë veçanti të pazbuluara dhe e lexojnë atë pa përqendrim e pa vëmendje dhe nuk ndalojnë në kuptimet e tij. Por, Kur'ani, i tëri pa përjashtim, është shkollë, udhëzim, zgjim, mesazh dhe largpamësi.

Ajetet 1 - 2

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَجَعَلَ الظُّلُمَاتِ
وَالنُّورَ ۖ ثُمَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِرَبِّهِمْ يَعْدِلُونَ ﴿١﴾ هُوَ الَّذِي
خَلَقَكُمْ مِنْ طِينٍ ثُمَّ قَضَىٰ أَجَلًا ۖ وَأَجَلٌ مُّسَمًّىٰ عِنْدَهُ ۖ ثُمَّ
أَنْتُمْ تَمْتَرُونَ ﴿٢﴾

“Qoftë lavdëruar All’llahu që krijoi qiejt dhe Tokën dhe bëri errësirën dhe dritën. E megjithatë, ata që nuk besojnë, sajojnë zota të tjerë si të barabartë me Zotin e tyre.”

“Është Ai që ju krijoi nga balta dhe pastaj caktoi një afat në këtë botë dhe një tjetër në Botën e Përtejme (Ditën e Kiametit). Por përsëri ju dyshoni.”

Komentimi

Surja fillon me lëvdatën dhe falënderimin e All’llahut. Më pas vazhdon që t’u qartësojë njerëzve parimin e teuhidit, së pari nëpërmjet krijimit të botës së madhe (qiejt dhe Toka); së dyti nëpërmjet krijimit të botës së vogël (njeriu). Ajeti i parë thotë: “Qoftë lavdëruar All’llahu që krijoi qiejt dhe Tokën...” All’llahu

është Gjetësi i errësirës dhe i dritës, në kundërshtim me besimin e idhujtarëve. Ai dhe vetëm Ai është Krijuesi i gjithçkaje. Më pas ajeti thotë: **“...dhe bëri errësirën dhe dritën...”** Mirëpo mohuesit dhe politeistët, në vend që të mësojnë Njëtimin (teuhidin) nëpërmjet këtij sistemi unik, ata i sajojnë shok dhe të ngjashëm All'llahut, siç thotë ajeti **“...E megjithatë, ata që nuk besojnë, sajojnë zota të tjerë si të barabartë me Zotin e tyre...”**¹

Këtu vërejmë se Kur'ani e përmend besimin e politeistëve pas shkronjës lidhëse “thumme”, e cila në gjuhën arabe tregon për renditje dhe vonesë. Kjo tregon që teuhidi (monoteizmi) është zanafilla e natyrshme dhe besimi i të gjithë njerëzve. Pas kësaj ka ndodh politeizmi si devijim prej zanafillës së natyrës krijuese (fitrah).

Lind pyetja: Përse në ajet përmendet fjala “krijim” për qiejt dhe Tokën, dhe për errësirën dhe dritën përmendet fjala “bëri”?

Komentuesit kanë folur shumë rreth kësaj çështjeje, por ajo që është më afër me arsyen është thënia se fjala “khalk” (krijim) në origjinalitet do të thotë gjetja e diçkaje. Ndërsa fjala “el xhe'al” (bërje) është për karakteristikat, ndikimet dhe mënyrat, që janë rezultat i krijimit të atyre krijesave. Përderisa errësira dhe drita janë dy gjendje pasuese, për ato është përdorur fjala “xheale” (bëri).

¹ Fjala arabe “ja’ dilune” rrjedh nga fjala “adele”, me kuptimin “et tesau”, që do të thotë barazi. Në këtë ajet ka kuptimin e “el adijl”, shok, të ngjashëm dhe të njëjtë.

Për komentin e këtij ajeti është transmetuar nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i cili ka thënë: “Në këtë ajet ka përgjigje për tre grupe. Prej tyre: Kur ajeti thotë: **“Qoftë lavdëruar All’llahu që krijoi qiejt dhe Tokën...”**, ai u përgjigjet jobesimtarëve, të cilët thonë se gjërat duhet të jenë të përhershme. Kur ajeti thotë: **“...dhe bëri errësirën dhe dritën...”**, u përgjigjet idhujtarëve që thonë se errësira dhe drita janë zanafilla. Kur ajeti thotë: **“...E megjithatë, ata që nuk besojnë, sajojnë zota të tjerë si të barabartë me Zotin e tyre.”** u përgjigjet politeistëve arabë që thonë se idhujt tanë janë zota”¹

A është errësira prej krijesave?

Nga ajeti kuptohet se ashtu si drita, që është prej krijesave të All’llahut, gjithashtu, edhe errësira është prej krijesave të All’llahut. Filozofët dhe specialistët në shkencat e natyrës e përshkruajnë errësirën duke thënë se ajo është mosekzistenca e dritës, për këtë, nuk mund të cilësohet diçka që nuk ekziston me cilësinë e të krijuarës. Atëherë, si e konsideron ajeti i lartpërmendur errësirën prej të krijuarave?

Në përgjigje të këtij kundërshtimi themi:

Së pari: Errësira nuk ka gjithmonë kuptimin e errësirës absolute, sepse në shumë raste edhe dritës shumë të dobët i thuhet errësirë në krahasim me dritën e fortë. Për shembull: Të gjithë ne themi natë e errët, edhe pse nuk mund të jetë absolutisht e errët, por është e përzier me dritën e dobët të yjeve apo me burime të tjera të dritës. Sipas kësaj, kuptimi i ajetit është se All’llahu e bëri për ju dritën e ditës dhe errësirën e natës. Pra, e para është drita e

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 701.

fortë dhe tjetra drita e dobët. Me këtë kuptim errësira është prej krijesave.

Së dyti: Është e drejtë se errësira absolute është çështje joekzistente, mirëpo çështja jokzistente, në situatë të veçanta, është ndjekëse e çështjes ekzistente. Kjo do të thotë se kur një njeri don të krijojë një errësirë absolute për një qëllim të caktuar, patjetër që ai do të përfitojë prej mjeteve që ekzistojnë. Kështu që nëse duam ta bëjmë një dhomë plotësisht të errët për të larë fotot, atëherë ne duhet të pengojmë dritën që të mos hyjë në atë dhomë. Kjo lloj errësire është si errësira e krijuar. Nëse mosekzistenca absolute nuk është e krijuar, mosekzistenca e veçantë ka pjesë në ekzistencë dhe është e krijuar.

Drita është simbol i unitetit, kurse errësira është simbol i përçarjes

Një çështje tjetër që duhet patur parasysh këtu është se fjala “nurun” (dritë), në Kur'an përmendet në numrin njëjës, ndërsa fjala errësirë përmendet në numrin shumës “dhulumat” (errësirat).

Kjo ka mundësi të tregojë për diçka interesante se me të vërtetë, errësira materiale dhe shpirtërore është burim i përhershëm i përçarjes, ndarjes dhe largimit, ndërsa drita është gjithmonë burimi i unitetit i bashkimit dhe i afrimit.

Në netët e verës, kur ndezim një kandil në shtëpi, pas pak kohe do të shohim lloje të ndryshme insektesh të mbledhura rreth kandilit me dritë. Mirëpo, kur e fikim kandilin, ato shpërndahen në drejtime të ndryshme. E tillë është gjendja edhe për çështjet

shpirtërore e sociale. Drita e dijes, e Kur'anit dhe e besimit është themeli i unitetit. Ndërsa errësira e paditurisë, mohimit dhe e dyfytërisë janë themeli i ndarjes dhe i përçarjes.

Thamë se kjo sure i tërheq vëmendjen njeriut kah bota e madhe me qëlim që të forcohen bazat e adhurimit të All'llahut dhe të Teuhidit (Njëtimin) në zemra nëpërmjet të menduarit rreth botës së madhe.

Ajeti pasardhës i tërheq vëmendjen njeriut dhe i thotë që të vështrojë botën e vogël (vetë njeriu) duke i treguar për gjënë më të habitshme e cila është krijimi i tij prej balte. Ajeti thotë: **“Është Ai që ju krijoi nga balta...”**

Është e vërtetë se ne kemi lindur prej dy prindërve dhe jo prej baltës por, përderisa krijimi i njeriut të parë ka qenë prej balte, atëherë, po ashtu është e rregullt që të thuhet edhe për ne se jemi të krijuar prej balte.

Surja vazhdon të tregojë për fazat e plotësimit të jetës së njeriut duke thënë se All'llahu pas krijimit ka caktuar një kohë të posaçme që njeriu ta kalojë në këtë tokë për t'u zhvilluar e për t'u plotësuar. Ajeti thotë: **“...dhe pastaj caktoi një afat në këtë botë...”**

Në origjinalitet fjala *“el exhel”* ka kuptimin e një kohe të caktuar dhe fraza *“kada exhelen”*, do të thotë caktimi i asaj kohe ose mbarimi i saj. Mirëpo, në shumë raste, kohës së fundit i thuhet *“exhel.”* Përshembull: *“xhae exhelu dejni”* (erdhi koha e borxhit), pra koha e fundit e pagesës së borxhit. Po ashtu edhe momentit të fundit të jetës së njeriut i thuhet *“exhel”*, sepse është koha e ardhjes së vdekjes.

Më pas, për ta plotësuar çështjen, ajeti thotë: **“...dhe një tjetër në Botën e Përtejme (Ditën e Kiametit)...”**

Pas kësaj, në fund ajeti u drejtohet politeistëve e u thotë: **“...Por përsëri ju dyshoni.”**, që do të thotë se ju dyshoni në fuqinë e All'llahut, i Cili e krijoi njeriun prej kësaj lënde të pavlerë (balte) dhe pastaj i caktoi atij këto faza të habitshme në jetën e tij dhe adhuron krijesa të pavlefshme siç janë idhujt në vend që të adhuron All'llahun Fuqiplotë.

Çfarë kuptimi ka fraza “exhelun musemma”?

S'ka dyshim se frazat *“el exhelul musemma”* dhe *“exhelen”*, që përmenden në këtë ajet, janë të ndryshme në kuptim. Të konsideruarit e dy frazave me të njëjtin kuptim, nuk është në përputhje me përsëritjen e fjalës *“exhel”*, veçanërisht me përmendjen e dytë të kushtëzuar me fjalën *“el musemma”*.

Për këtë komentuesit kanë bërë hulumtime të shumta në ndryshimin mes frazave. Argumentet që ndodhen në Kur'an dhe në transmetimet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) na sqarojnë se fjala *“exhel”* e pa shoqëruar, ka kuptimin e kohës jo të caktuar në moshë, kohë e afat. Kurse *“el exhelul musemma”* ka kuptimin e fundit të pashmangshëm. Thënë ndryshe: *“el exhelul musemma”* është vdekja e zakonshme, ndërsa *“el exhel”* është vdekja jo e zakonshme.¹

Për sqarim të mëtejshëm themi: Shumë prej krijesave, në bazë të përbërjes natyrore tek ato, kanë aftësi dhe gatishmëri që të

¹ Tefsiri “Biharul Enuar”; vëll. 4, f. 116 dhe 117. Tefsiri “Nuruth Thekalejn”; vëll. 1, f. 703.

qëndrojmë për një kohë të gjatë. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe mund të ndodhin pengesa mes tyre dhe arritjes në afatin më të largët natyror. P.sh, një kandil me naftë ka mundësi të qëndrojë 20 orë i ndezur, duke marrë parasysh cilësinë e naftës dhe sasinë që nxë kandili. Porse, era e fortë, shiu dhe mosinteresimi ndaj kandilit, janë shkak i shkurtimit të kohës së ndriçimit. Nëse kandili nuk përballet me asnjë pengesë dhe qëndron i ndezur deri në pikën e fundit të naftës, atëherë themi se ai arriti kohën e fundit të ndriçimit. Por, kur e fikin shkaqet, themi se u fik para kohës së caktuar.

E njëjta gjendje është edhe për njeriun. Nëse plotësohen të gjitha rrethanat e qëndrimit i gjallë dhe nuk gjenden pengesa në rrugën e jetës së tij, atëherë ai do të jetojë deri në afatin e caktuar. Ndërsa kur përballet me ushqimin e keq apo goditet nga një lloj sëmundje apo vetëvritet apo dënohet me vdekje, për shkak të një krimi, dhe vdes para afatit të caktuar, atëherë vdekja e parë është e zakonshme kurse e dyta është jo e zakonshme.

Bazuar në këto dy lloj afatesh, na sqarohen shumë çështje. P.sh, në transmetime thuhet se mbajtja e lidhjeve farefisnore zgjat jetën ndërsa shkëputja e tyre e shkurton jetën.

Përsa i përket thënies së All'Ilahut: **"...Kur t'i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë."**¹, ajo flet për afatin e caktuar, pra njeriu arrin në fundin e jetës së tij. Ajo nuk përfshin afatin e parakohshëm.

¹ Sure "A'raf", ajeti 34.

Si do që të jetë, ne duhet të dimë se të dy afatet i cakton All'Ilahu. Të parin në formë të pakushtëzuar dhe të dytin në formë të kufizuar e të kushtëzuar. Kjo është e ngjashme me thënien se kandili do të fiket pas njëzet orësh pa ndodhur asnjë shkak. Po ashtu, me thënien se kandili do të fiket pas dy orësh kur fryn erë.

E tillë është çështja edhe për njeriun dhe për popujt. Themi: Nëse don All'Ilahu, një njeri vdes apo një popull zhduket pas kaq vitesh. Sikurse themi se: Njerëzit apo popujt që ndjekin rrugën e padrejtësisë, hipokrizisë, përçarjes, dembelizmit, naivitetit, ata do të jetojnë sa 2/3 e kohës së caktuar.

Rreth këtij ajeti Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Ato janë dy afate. Afat i shmangshëm dhe i pashmangshëm."*¹

Po ashtu ka thënë se afati i shmangshëm mund të afrohet e të vonohet, ndërsa i pashmangshmi nuk ndryshohet.²

¹ Tesiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 703.

² Tesiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 703.

Ajeti 3

وَهُوَ اللَّهُ فِي السَّمَوَاتِ وَفِي الْأَرْضِ ^ط يَعْلَمُ سِرَّكُمْ وَجَهْرَكُمْ وَيَعْلَمُ
مَا تَكْسِبُونَ ﴿٣﴾

“Ai është All’llahu në qiej dhe në Tokë; Ai di çfarë fshihni dhe çfarë tregoni, si dhe di atë që arrini të fitoni.”

Komentimi

Ky ajet plotëson thëniet e ajeteve të mëparshme rreth Njëtimimit të All’llahut. Ky ajet u përgjigjet të gjithë atyre që thonë se për çdo grup krijesash apo dukuri ka nga një zot, si për shembull: zoti i shiut, zoti i luftës, zoti i paqes, zoti i qiellit, etj. Ajeti thotë: **“Ai është All’llahu në qiej dhe në Tokë...”** Që do të thotë se All’llahu i Madhëruar ashtu siç është Krijuesi i gjithçkaje, Ai është Sunduesi dhe Rregulluesi i gjithçkaje. Në këtë mënyrë ajeti u përgjigjet politeistëve injorantë, të cilët besonin se Krijuesi është “All’llahu”, mirëpo ata besonin se rregullimi i çështjeve është në dorë të idhujve.

Ka një alernativë tjetër në komentimin e ajetit që është se ajeti ka kuptimin e pranisë së All’llahut në çdo vend: në qiej dhe në Tokë. Asnjë vend nuk është i zbrazët nga prania e Tij. Ai nuk është trup që të zë një vend të caktuar, por Ai është Mbikëqyrës i të gjitha vendeve.

Është e natyrshme që Sunduesi i gjithçkaje, Rregulluesi i të gjitha çështjeve dhe i Pranishmi në çdo vend, të jetë i Gjithëditur për të gjitha sekretet dhe të fshehtat. Për këtë ajeti thotë: **“...Ai di çfarë fshihni dhe çfarë tregoni, si dhe di atë që arrini të fitoni.”**

Mund të thuhet se “e fshehta” dhe e “shfaqura” përfshijnë punët dhe qëllimet e njeriut, prandaj, nuk është nevoja që të përmendet thënia: **“...si dhe di atë që arrini të fitoni.”**

Por duhet patur parasysh se “fitimi” është produkt i punës dhe i gjendjeve shpirtërore të bazuara në punët e mira dhe të këqija. Që do të thotë, se All’llahu i Madhëruar është i Ditur për punët dhe qëllimet tuaja. Po ashtu, është i Ditur për ndikimet shpirtërore që vijnë prej punëve dhe qëllimeve tuaja. Sido që të jetë, përmendja e kësaj fraze përforcon pozitën e veprave të njeriut.

Ajetet 4 - 5

وَمَا تَأْتِيهِمْ مِّنْ ءَايَةٍ مِّنْ ءَايَاتِ رَبِّهِمْ إِلَّا كَانُوا عَنْهَا مُعْرِضِينَ
 ﴿٤﴾ فَقَدْ كَذَّبُوا بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ ۖ فَسَوْفَ يَأْتِيهِمْ أَنبُؤٌ مَّا
 كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٥﴾

“Sa herë që atyre u vjen ndonjë varg nga shpallja e Zotit të tyre, ata ia kthejnë shpinën.”

“Kështu, ata e mohojnë të vërtetën, posa u shpallet, por së shpejti do t’u vijë lajmet e asaj me të cilën talleshin.”

Komentimi

Më parë thamë se surja “En’am” më shumë u drejtohet politeistëve. Kur’ani përdor disa metoda që t’i zgjojë ata dhe t’i bëjë të vëmendshëm. Ky ajet, si dhe shumë ajete të tjera që e pasojnë, flasin rreth kësaj çështjeje.

Ajeti i parë tregon për shpirtin e kokëfortësisë dhe mendjemadhësisë tek politeistët ndaj së vërtetës dhe ajeteve të All’llahut të Madhëruar. Ajeti thotë: **“Sa herë që atyre u vjen ndonjë varg nga shpallja e Zotit të tyre, ata ia kthejnë shpinën.”**¹

¹ Fjala “ajet” këtu përmendet e pashquar dhe në kontekstin mohues. Atëherë kuptimi është se ata ia kthejnë shpinën çdo ajeti dhe nuk mendojnë në të.

Kushti më i lehtë i udhëzimit është kërkimi dhe verifikimi. Tek ata politeistë nuk ekzistonte asnjë lloj inkurajimi për të njohur të vërtetën dhe nuk e ndienin etjen e të vërtetës që ta kërkonin. Edhe sikur uji i kthjellët i burimit të ecte para pragut të derës së tyre, ata do t'ia kthenin shpinën sapo ta shikonin. Po ashtu, ata ua kthejnë shpinën ajeteve të All'llahut të zbritura për t'i edukuar ata që të arrijnë në shkallët e përsosurisë.

E njëjta gjendje shpirtërore nuk është e kufizuar vetëm me kohën para Islamit dhe për politeistët arabë, sepse sot gjejmë njerëz që kanë arritur në moshën gjashtëdhjetë vjeçare apo më shumë dhe nuk kanë guxuar për asnjë çast, qoftë një orë në ditë, që ta kërkojnë të vërtetën rreth All'llahut dhe fesë. Edhe nëse u bien në dorë libra që flasin për këtë çështje, nuk ia hedhin sytë asnjëherë. Edhe nëse dikush u flet, nuk ia vënë veshin. Këta janë të paditurit kokëfortë e të pavëmendshëm, të cilët, në disa raste, shfaqen para njerëzve me pamjen e dijetarëve mendjemëdhenj.

Më pas, ajeti flet për rezultatin e punëve të tyre që është se kur e panë të vërtetën e përgënjeshtroan dhe e mohuan atë. Sikur ata të mendonin thellë në ajetet e All'llahut, do ta kuptonin të vërtetën dhe do ta besonin atë. Ajeti thotë: **“Kështu, ata e mohojnë të vërtetën, posa u shpallet...”** Pa dyshim, fundi i këtij përgënjeshtrimi e talljeje do t'u vijë atyre: **“...por së shpejti do t'u vijë lajmet e asaj me të cilën talleshin.”**

Në këto dy ajete tregohet për tri faza të mosbesimit, i cili bëhet më i fortë fazë pas faze. Faza e parë e mosbesimit është kundërshtimi, e dyta përgënjeshtrimi dhe e treta është tallja me shpalljet e All'llahut.

Kjo tregon se njeriu që nuk beson nuk qëndron në një fazë të vetme, por gjithmonë e shton mohimin e së vërtetës, shton armiqësinë ndaj All'llahut dhe largohet më shumë prej Tij.

Qëllimi i kërcënimit që përmendet në fund të këtij ajeti është se të këqijat e mosbesimit, herët a vonë, do të shihen në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Ajetet e ardhshme e vërtetojnë më shumë këtë çështje.

Ajeti 6

أَلَمْ يَرَوْا كَمْ أَهْلَكْنَا مِنْ قَبْلِهِمْ مِنْ قَرْنٍ مَكَّنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ
 مَا لَمْ يُمْكِنْ لَكُمْ وَأَرْسَلْنَا السَّمَاءَ عَلَيْهِمْ مِدْرَارًا وَجَعَلْنَا
 الْأَنْهَارَ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهِمْ فَأَهْلَكْنَاهُمْ بِذُنُوبِهِمْ وَأَنْشَأْنَا مِنْ بَعْدِهِمْ
 قَرْنًا آخَرِينَ ﴿٦﴾

“A nuk e shohin ata se sa brezni i kemi zhdukur para tyre?! Ata ishin njerëz që i kishim dhënë më shumë pushtet në tokë sesa ju kemi dhënë ju (mekasve)? Ne u sollëm atyre shira të bollshëm dhe bëmë që të rrjedhin lumenj nëpër viset e tyre; por, për shkak të gjynaheve të veta, i shfarosëm dhe, më pas, krijuam brezni të tjera.”

Komentimi

Fundi i të padrejtëve

Duke filluar nga ky ajet, e më pas, Kur'ani paraqet planin edukativ për zgjimin e adhuruesve të idhujve dhe politeistëve në përputhje me rrethanat e ndryshme të secilit grup. Së pari, fillon me luftimin e faktorit të vetpëlqimit dhe egos, që është prej faktorëve të rëndësishëm të padrejtësisë, mosbindjes dhe devijimit. Kur'ani u kujton atyre popujt e mëparshëm dhe fundin

e dhimbshëm të tyre. Me këtë përmendje ai u tërheq vëmendjen atyre që vetpëlqimi e egoja ua ka mbuluar të shikuarit e të menduarit. Ajeti thotë: **“A nuk e shohin ata se sa brezni i kemi zhdukur para tyre?! Ata ishin njerëz që i kishim dhënë më shumë pushtet në tokë sesa ju kemi dhënë ju (mekasve)? Ne u sollëm atyre shira të bollshëm dhe bëmë që të rrjedhin lumenj nëpër viset e tyre...”**

Mirëpo, duke vazhduar rrugën e tiranisë e të padrejtësisë, ato të mira e mundësi nuk mundën që t'i shpëtonin prej dënimit të All'llahut, siç thotë ajeti **“...por, për shkak të gjynaheve të veta, i shfarosëm dhe, më pas, krijuam brezni të tjera.”**

A nuk duhet të ishte njohja e tyre me fundin e të shkuarve mësim për ata që të zgjoheshin nga gjumi i pavëmendshmërisë dhe prej shkujdesjes? A nuk është All'llahu, Ai i cili i shkatërroi dhe i shfarosi të shkuarit, i Plotfuqishëm për t'i shkatërruar dhe për t'i shfarosur edhe këta?

Hulumtime

1- Edhe pse fjala *“karnun”* ka kuptimin e një kohe të gjatë (100 vjet, apo 70 vjet, apo 30 vjet), sipas gjuhëtarëve, ajo ka edhe kuptimin e një populli apo grupi njerëzish në një kohë të caktuar. (Fjala *“el karn”* rrjedh nga *“el iktiran”*, që do të thotë afrim, afrimet. Duke parë që banorët e një kohe të përbashkët apo të

kohëve të afërta, janë të afërt me njëri-tjetrin, këto kohë quhen dhe koha e tyre “karnun”).¹

2- Në Kur'an përsëritet shpesh se mundësitë e shumta materiale janë shkak i vetëpëlqimit dhe i pavëmendshmërisë të njerëzit me shpirt të dobët, siç thotë All'llahu i Madhëruar: **“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”**² Kjo sepse, duke i siguruar mundësitë materiale, mendon se nuk ia ka nevojën All'llahut të Vetmjaftueshëm. Këto lloj njerëzish janë të pavëmendshëm ndaj mirësive të All'llahut që i mbulojnë në çdo cast. Po të mos jenë ato mirësi, jeta e tyre nuk do të vazhdonte.

3- Tërheqja e vëmendjes nuk është e posaçme vetëm për idhujtarët, sepse Kur'ani u flet popujve të çdo kohë. Fjalët e tij janë edhe për kohën e sotme të përparuar teknologjikisht, e cila e ka mbushur botën me vetpëlqim e mendjemadhësi. Kur'ani i paralajmëron dhe u thotë që të mos i harrojnë popujt e shkuar dhe fundin e dhembshëm që i goditi ata për shkak të gjynaheve që bënë.

Vërtet, studimi i historisë së faronëve të Egjiptit, mbretërve të Sebe-së, të romakëve, etj, dhe i jetës marramendëse që jetonin, i të mirave të shumta që kishin në kohët e tyre, por si pasojë e padrejtësisë dhe tiranisë u goditën me ndëshkime shumë të rënda, të gjitha këto janë mësim i madh për çdo kohë.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 11.

² Sure “Alak”, ajetet 6-7.

Ajeti 7

وَلَوْ نَزَّلْنَاهُ عَلَيْكَ كِتَابًا فِي قِرْطَاسٍ فَلَمَسُوهُ بِأَيْدِيهِمْ لَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنَّ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ مُبِينٌ ﴿٧﴾

“Sikur Ne të të zbritnim ty një Libër të shkruar në letër e ata ta preknin me duart e tyre, mosbesimtarët me siguri që do të thoshin: ‘Kjo s’është gjë tjetër, veçse një magji e hapur.’”

Komentimi

Fundi i kokëfortësisë

Prej faktorëve të devijimit të jobesimtarëve është mendjemadhësia dhe kokëfortësia, të cilat i përmend ajeti në fjalë. Në të shumtën e rasteve mendjemadhi është edhe kokëfortë. Kjo, sepse mendjemadhësia nuk i lejon ata që ta pranojnë të vërtetën dhe të drejtën. Njerëzit mendjemëdhenj mohojnë deri edhe çështjet e qarta që janë të bazuara në fakte dhe argumente. Jo vetëm kaq, ata arrijnë të mojnë edhe më elementaret, siç i shohim me sytë tanë mendjemëdhenjtë në shoqëritë e sotme.

Këtu, Kur’ani tregon për një kërkesë të një grupi idhujtarësh (thuhet se kanë qenë Nudhr ibn Harith, Abdullah ibn Ebi Umejeh dhe Neufel ibn Khuvejlid), të cilët i thanë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi*

familjen e tij!): 'Ne nuk besojmë derisa All'llahu të zbresë një libër të shoqëruar nga katër melekë (engjuj)'¹ Ajeti thotë: **"Sikur Ne të të zbritnim ty një Libër të shkruar në letër e ata ta preknin me duart e tyre, mosbesimtarët me siguri që do të thoshin: 'Kjo s'është gjë tjetër, veçse një magji e hapur.'"**

Vërtet, kokëfortësia e tyre arriti deri në mohimin e atyre që i shohin me sytë e tyre dhe i preknin me duart e tyre duke i konsideruar magji. Këtë e bënin që të mos e pranonin të vërtetën.

Fjala "*el kirtasu*" ka kuptimin e çdo gjëje që shkruhet mbi të, qoftë letër, apo lëkurë apo tabelë. Përdorimi i kësaj fjale në këto ditë më shumë është për letrën për shkak të përdorimit të gjerë të saj.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 12.

Ajetet 8 - 10

وَقَالُوا لَوْلَا أُنزِلَ عَلَيْهِ مَلَكٌ ۖ وَلَوْ أَنْزَلْنَا مَلَكَ لَقُضِيَ الْآمْرُ ثُمَّ
لَا يُنظَرُونَ ﴿٨﴾ وَلَوْ جَعَلْنَاهُ مَلَكَ لَجَعَلْنَاهُ رَجُلًا وَلَلَبَسْنَا
عَلَيْهِمْ مَا يَلْبَسُونَ ﴿٩﴾ وَلَقَدْ آسْتَهْزِئَ بِرُسُلٍ مِّن قَبْلِكَ فَحَاقَ
بِالَّذِينَ سَخِرُوا مِنْهُمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ﴿١٠﴾

“Ata thonë: ‘Sikur t’i kishte zbritur atij një melek?! Por po të dërgonim Ne melekun, puna do të merrte fund dhe nuk do t’u jepej asnjë afat.’”

“Edhe sikur Ne ta bënim atë melek, me siguri që do t’i jepnim atij pamje njeriu dhe, kështu, do të bënim që të ngatërroheshin në lidhje me mesazhin, për të cilin tashmë ata janë të ngatërruar.”

“Me të vërtetë, janë përqeshur shumë të Dërguar para teje, por ata që përqeshnin i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin.”

Komentimi

Shpikja e shfajësimeve

Prej faktorëve të mohimit dhe mospranimit është edhe shpirti i shpikjes dhe gjetja e shfajësimeve, edhe pse ka faktorë të tjerë si mendjemadhësia apo egoizmi.

Prej fakteve me të cilat politeistët polemizuan me profetin Muhammed (*Paqja dhe nekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilët përmenden shumë në Kur'an, ndër to edhe në këtë ajet, është se ata thonin: Përse i Dërguari i All'llahut e bën vetëm këtë mision madhështor? Përse nuk e shoqëron atë në këtë mision një njeri apo engjull? A mundet që njeriu ta mbajë këtë mesazh mbi supet e tij? Ajeti thotë: **“Ata thonë: ‘Sikur t’i kishte zbritur atij një melek?!...’”**

Me praninë e argumenteve të qarta, nuk gjendet vend për këtë debat rreth profetësisë së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pastaj, meleku nuk është më i mundshëm se njeriu dhe nuk ka aftësi më shumë se njeriu për të mbajtur mesazhin, sepse aftësitë e njeriut janë më të shumta se të melekëve.

Kur'ani u përgjigjet atyre me dy fjali dhe secila prej tyre përmban argument:

E para: “...Por po të dërgonim Ne engjëllin, puna do të merrte fund dhe nuk do t’u jepej asnjë afat.” Që do të thotë, se po të zbritnim melek që të ndihmonte të Dërguarin e All'llahut, të

pafetë do të shkatërroheshin. Shkaku i kësaj përmendet në ajetet e mëparshme që thoshte se nëse gajbi (e fshehta) do të shndërrohej në të dukshme, me zbritjen e melekut, ku gjithçka të shihet me sy drejtpërsëdrejti, atëherë kjo do të ishte faza e fundit e plotësimit të argumentit dhe treguesi më i qartë. Bazuar në këtë, mëkati, pa dyshim, e meriton prerazi ndëshkimin; pra kush mëkaton menjëherë ndëshkohet. Mirëpo, All'llahu i Madhëruar me mirësinë dhe butësinë e Tij ndaj robëve të Vet dhe me qëllim që t'u japë kohë për t'u menduar e për të logjikuar, nuk e bën këtë, me përjashtim të gjendjeve të veçanta ku kërkuesi i argumentit e meriton shkatërrimin. Që do të thotë, se ai ka bërë mëkat që e meriton dënimin e All'llahut.

E dyta: Profetin që e dërgon All'llahu për udhëheqjen e njerëzve dhe për edukimin e tyre, që të jetë model dhe shembull për ta, patjetër që duhet të jetë prej llojit të tyre (njerëzve) me të gjitha tiparet dhe pasionet njerëzore. Ndërsa melekun nuk e shohin sytë e njerëzve. Gjithashtu, ai nuk mund të jetë shembull praktik i tyre sepse, ai nuk i njeh as nevojat e njerëzve, as dhimbjet, as pasionet dhe as kërkesat e tyre. Për këtë, udhëheqja e tij për një lloj tjetër që ndryshon totalisht nga ai, nuk e realizon qëllimin.

Prandaj, Kur'ani në përgjigjen e dytë thotë: Sikur të duam që i Dërguari ynë të jetë melek, siç dëshironi, duhet që ky melek të ketë cilësitë e njeriut dhe të shfaqet me pamje njeriu: **“Edhe sikur**

Ne ta bënim atë melek, me siguri që do t'i jepnim atij pamje njeriu..."¹

Nga ato që thamë, sqarohet se fjalia **"le xhealnahu rexlhulen"**, nuk ka kuptimin që ne do t'i japim atij pamje njeriu, siç e përfytyruan disa komentues, por ka kuptimin që ne i japim atij pamje njeriu me të gjitha cilësitë e dukshme e të padukshme. Nga kjo konkludohet se ata, edhe në këtë gjendje, përsëri do ta kundërshtojnë njësoj si kundërshtimi i mëparshëm duke thënë: Përse All'llahu ia ka caktuar udhëheqjen e njerëzve dhe e ka fshehur për ne të vërtetën? **"...dhe, kështu, do të bënim që të ngatërroheshin në lidhje me mesazhin, për të cilin tashmë ata janë të ngatërruar."**

Fjala **"el libsu"** ka kuptimin e ngatërrimit të çështjes dhe të bërit e saj, fshehurazi, të ngjashme me diçka tjetër. Po ashtu, kjo fjalë ka kuptimin e veshjes. Është e qartë se qëllimi i ajetit është për kuptimin e parë që do të thotë: sikur të duam të dërgojmë një engjull, duhet që ai të jetë me pamje njeriu dhe të ketë sjellje njeriu. Në këtë gjendje ata do të besojnë se ne e kemi ngatërruar çështjen për njerëzit dhe i kemi çuar ata në dyshime. Ka të paditur nga njerëzit të cilët bien në gabime e në paqartësi për shkak se atyre ua ngatërrojnë çështjen dhe ua fshehin pamjen e të vërtetës. Mirëpo, të ngatërruarit dhe të fshehurit ndaj All'llahut është pikëpamja e tyre e posaçme sepse All'llahut asgjë nuk i fshihet.

¹ Përemri pronor te fjala **"xhealnahu"** ka mundësi të jetë për të Dërguarin ose për atë që dërgohet më të për ta përkrahur në konstatimin e profetësisë së tij. Sipas alternativës së dytë, sugjerimi i tyre realizohet dhe me alternativën e parë mund të realizohet më shumë se çfarë kërkuan.

Në fund, All'llahu ia lehtëson çështjen të Dërguarit dhe i thotë atij: **“Me të vërtetë, janë përqeshur shumë të Dërguar para teje, por ata që përqeshnin i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin.”**

Në realitet, ky ajet është ngushëllues për Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në këtë ajet All'llahu i kërkon atij që të mos mërzitet dhe në të njëjtën kohë, Ai i kërcënon kundërshtarët dhe kokëfortët duke i kërkuar atyre që të mendojnë për fundin e çështjes së tyre të dhimbshme.¹

¹ Fjala “háka” ka kuptimin “ehata bihi” / e rrethon atë dhe fjalia “i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin” , do të thotë për ato që talleshin kur dëgjonin tërheqjen e vëmendjes dhe kërcënimet e të Dërguarve të All'llahut, siç ishte tërheqja e vëmendjes që i bëri Hazreti Nuhu popullit të tij për ndodhinë e përmytjes. Mirëpo, idhujtarët prej popullit të tij talleshin me të.

Ajeti 11

قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ ثُمَّ أَنْظِرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ
الْمُكَذِّبِينَ ﴿١١﴾

“Thuaj: ‘Udhëtoni nëpër botë e shihni çfarë dënimi kanë marrë ata që përgënjeshtrojnë.”

Komentimi

Me qëllim që t’i zgjonte ata mendjemëdhenj, Kur’ani përdor një metodë tjetër në këtë ajet. Ai e urdhëron të Dërguarin e Tij që t’i këshillojë ata për të shëtitur nëpër tokë që ta shohin me sytë e tyre fundin e atyre që përgënjeshtrojnë të vërtetat. Dhe ndoshta do t’i zgjonte ata. Ajeti thotë: **“Thuaj: ‘Udhëtoni nëpër botë e shihni çfarë dënimi kanë marrë ata që përgënjeshtrojnë.”**

S’ka dyshim se të shikuarit e gjurmëve të popujve të shkuar, të cilët u dënuan dhe u shkatërruan për shkak se mohuan të vërtetat, ndikon shumë në thellësi të njerëzve. Sepse, këto gjurmë që ndodhen në librat e historisë, trupëzojnë të vërtetën folëse dhe të prekshme. Për këtë, Kur’ani thotë “shikoni” dhe nuk thotë “mendoni”.

Ka mundësi që përdorimi i fjalës “thumme” (pastaj), që në gjuhën arabe ka kuptimin e vonesës kohore, ka për qëllim që ata të mos nxitojnë në ecjen e tyre dhe të mos nxitojnë në dhënien e gjykimeve, por të mendojnë thellë në ato gjurmë të popujve të shkuar dhe në fundin e punëve të tyre si dhe të nxjerrin mësimë prej tyre.

(Përsa i përket të ecurit dhe të shëtiturit në tokë dhe ndikimin e tyre në rizgjimin e mendimeve e të ndërgjegjeve, shih komentimin e ajetit 137 të sures “Ali Imran” po në këtë tefsir.)

Ajetet 12 - 13

قُلْ لِّمَن مَّا فِي السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۖ قُلْ لِلّٰهِ ۚ كَتَبَ عَلٰی نَفْسِهٖ
 الرِّحْمَةَ ۚ لِيَجْمَعَٰكُمْ اِلٰی يَوْمِ الْقِيَمَةِ لَا رَيْبَ فِيْهِ ۚ الَّذِيْنَ
 خَسِرُوْا اَنْفُسَهُمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُوْنَ ﴿١٢﴾ وَلَهُ مَا سَكَنَ فِي
 الْاٰلِ وَالنَّهَارِ ۚ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيْمُ ﴿١٣﴾

“Thuaj: ‘Kujt i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë?’
 Thuaj: ‘All’lilahun!’ Ai ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën dhe,
 me siguri, do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka
 pikë dyshimi. Ata që kanë humbur shpirtrat e tyre, në të vërtetë
 nuk do të besojnë asnjëherë.”

“E Tij është çdo gjë që pushon natën dhe ditën. Ai dëgjon dhe
 di çdo gjë.”

Komentimi

Kur’ani vazhdon t’u flasë politestëve. Në ajetet e
 mëparshme, fjalët ishin rreth teuhidit (Njëtim) dhe adhurimit të
 një Zoti të vetëm. Këtu flitet për Ringjalljen. Duke treguar bazën e
 teuhidit, Kur’ani në këto ajete flet edhe për Ringjalljen me një
 metodë të mrekullueshme, e cila është ajo e pyetjes dhe e
 përgjigjes. Pyetësi dhe përgjigjësi është një dhe kjo është prej
 metodave të bukura letrare.

Argumentimi i Ringjalljes këtu përbehet prej dy parahyrjesh:

E para thotë: “**Thuaj: ‘Kujt i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë?...’**” Pastaj menjëherë thotë: “**...Thuaj: ‘All’llahut!...**” Sipas kësaj parahyrjeje, e gjithë bota ekzistuese është pronë e All’llahut. Në dorën e Tij është gjithçka dhe Ai është Rregulluesi.

E dyta thotë: Vërtet, All’llahu i Vetëm dhe i Pashoq, është burimi i gjithë mëshirës. Ai ia ka bërë detyrim Vetes së Tij mëshirën dhe u jep të gjithëve prej mirësive të Tij. “**...Ai ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën...**” A është e mundur për një Zot si ky që ta ndërpresë serialin e jetës së njerëzve me vdekjen, duke e ndaluar përsosurinë dhe vazhdimin e jetës? A është në përputhje kjo me të qenit e All’llahut “Begatues” dhe “Posedues i mëshirës së gjerë?” A mund të jetë aq i ashpër ndaj robve të Tij, që t’i zhdukë ata pas një periudhe kohe dhe të shndërrohen në asgjë, ndërkohë që Ai është Sunduesi i tyre dhe Rregulluesi i çështjeve të tyre?

Sigurisht që jo. Sepse, mëshira e Tij e gjerë bën që krijesat në përgjithësi dhe njeriu në veçanti, të drejtohen kah rruga e plotësimit dhe e përsosurisë - njësoj siç vepron me mëshirën e Tij ndaj farës së vogël, e cila shndërrohet në peme të madhe e të fortë, apo kur me mëshirën e Tij, e shndërron spermën e pavlerë në njeri të plotë. Po, kjo mëshirë e bën njeriun, i cili në të ka mundësinë e përhershmerisë, që të veshë petkun e një jete të re pas vdekjes së tij në botën më të madhe. Dora e mëshirës e shtyn njeriun në rrugën e plotësimit e të përsosurisë së përhershme. Prandaj, pas këtyre dy parahyrjeve, ajeti thotë: “**...dhe, me siguri, do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka pikë dyshimi...**”

Vërtet, ajeti fillon me pyetësor konstatues nëpërmjet të cilit kërkohet që dëgjuesi të konstatojë. Përderisa kjo është e natyrshme, njësoj siç ishte tek politeistët, të cilët pohonin se Sunduesi i kësaj gjithësie nuk janë idhujt, por All'llahu, atëherë përgjigjja vjen menjëherë. E kjo është një metodë e bukur për paraqitjen e çështjeve.

Në vende të tjera të Kur'anit, Ringjallja argumentohet me rrugë dhe metoda të tjera: me rrugën e ligjit të drejtësisë, të përsosurisë dhe të urtësisë së All'llahut. Mirëpo, argumentimi me mëshirën që e përmend ky ajët është argumentim i ri. Në fund të ajetit tregohet për fundin e politeistëve kokëfortë e kryeneçë. Ata të cilët e humbën kapitalin e ekzistencës së tyre në tregun e kësaj jete, ata nuk u besojnë të vërtetave: **"...Ata që kanë humbur shpirtat e tyre, në të vërtetë nuk do të besojnë asnjëherë."**

Sa e habithshme kjo shprehje! Ka raste që njeriu humbet pasurinë e tij, ose postin e tij, ose një lloj prej llojeve të kapitaleve të tij. Në këtë gjendje ai humbet diçka që nuk është pjesë e ekzistencës së tij. Mirëpo, humbja reale, e vërtetë dhe më e madhe është kur njeriu humbet origjinën e ekzistencës së tij.

Vërtet, armiqtë e së vërtetës dhe kryeneçët, ata e humbasin plotësisht kapitalin e moshës; humbasin të menduarit, të arsyetuarit, si dhe të gjitha dhuntitë shpirtërore dhe materiale që duhet t'i shfrytëzojnë në rrugën e së vërtetës për të arritur shkallën e përsosurisë. Kështu që për ata nuk mbetet asnjë lloj kapitali.

Kjo thënie është përmendur në disa ajete të Kur'anit fisnik. Kjo është thënie e frikshme për fundin e dhembshëm që i pret mohuesit e të vërtetës, mëkatarët dhe të njollosurit me gjynahe.

Pyetje: A mund të thuhet se jeta e përhershme është vërtetuese e mëshirës së All'llahut të Madhëruar vetëm për besimtarët, ndërsa për të tjerët ajo mund të jetë fatkeqësi dhe vështirësi?

Përgjigje: S'ka dyshim se All'llahu është Ai, i Cili mëshiron, sepse Ai e krijoi njeriun dhe i dha atij mendjen, i dërgoi Profetët për ta udhëzuar e udhëhequr, i dhuron lloje të ndryshme mirësish dhe ka hapur para tij rrugën për Jetën e Përhershme. Të gjitha këto janë prej ngjyrave të mëshirës.

Njeriu, gjatë rrugëtimit për të arritur këto fryte të kësaj mëshire, mund të devijojë nga rruga dhe e shndërron këtë mëshirë në fatkeqësi dhe dhimbje. Mirëpo, kjo nuk ia mohon të vërtetën mëshirës, sepse është njeriu ai që fajësohet për devijimin prej kësaj mëshire dhe për shndërrimin e saj në ndëshkim dhe dhimbje.

Ajeti pasardhës plotëson ajetin paraardhës, sepse ajeti paraardhës tregon se All'llahu është Sunduesi dhe Pronari i gjithçkaje, të cilën e sqaron edhe prania e ndajfoljes "vendore": **"Thuaj: 'Kujt i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë...?'"**

Kurse, ajeti në fjalë tregon për sundimin dhe pronësinë absolute të All'llahut, të cilën e sqaron prania e ndajfoljes "kohore": **"...E Tij është çdo gjë që pushon natën dhe ditën..."**

Bota materiale kufizohet me kohën dhe me vendin. Të gjitha krijesat që përfshihen në harkun vendor dhe kohor, pra e gjithë bota materiale është pronësi e All'llahut.

Nata dhe dita nuk janë të posaçme vetëm për sistemin diellor, sepse të gjitha krijesat që gjenden në qiej dhe në Tokë kanë ditë dhe natë. Disa kanë ditë të përhershme e disa natë të përhershme. P.sh, te dielli ka ditë të përhershme dhe s'ka errësirë. Në disa galaktika të errëta, në të cilët nuk gjendet dritë e as yjet nuk janë afër, ka natë të përhershme. Të gjitha këto përfshihen në këtë ajet.

Këtu duhet të vërejmë se fjala "*sekenë*" vjen nga fjala "*sukun*" që do të thotë pushim, qëndrim në një vend, qoftë ajo krijesë e qëndrueshme në gjendje lëvizjeje apo qetësie. P.sh., ne themi që filani banon në filan qytet, që do të thotë se ai është i stabilizuar atje, megjithëse ai mund të lëvizë nëpër rrugët e atij qyteti.

Ka mundësi që e kundërta e fjalës "*sukun*", që përmendet në këtë ajet, të jetë fjala "*hareketun*" (lëvizje). Përderisa pushimi dhe lëvizja janë prej gjendjes relative, atëherë përmendja e njëres prej tyre është e mjaftueshme. Kështu që kuptimi i ajetit është: Çdo krijesë, qoftë në ditë apo në natë, brenda harkut vendor apo kohor, i palëvizshëm apo i lëvizshëm, është pronësi e All'llahut të Madhëruar.

Me këtë, ajeti tregon për një nga argumentet e teuhidit sepse "*lëvizja*" dhe "*pushimi*" janë dy gjendje të krijuara dhe nuk mund të kenë qenë përpara krijimit dhe do të qëndrojnë pas shkatërrimit të gjithçkaje. Kjo sepse fjala "*hareke*" (lëvizje) ka

kuptimin e pranisë së diçkaje në dy vende të ndryshme dhe në dy kohë të ndryshme. Ndërsa fjala “sukun” (pushim) ka kuptimin e pranisë së diçkaje në një vend gjatë dy kohëve. Ne e dimë se nëse një gjë ka patur gjendje të mëparshme, ajo nuk mund të jetë e përhershme.

Nga këto fjalë konkludojmë se trupat janë në gjendjen e *sukunit* dhe të *harekes*. Duke qenë të tillë ata nuk mund të jenë të përhershëm. Kështu që çdo trup është i krijuar dhe çdo krijim duhet patjetër të ketë një Krijues. Mirëpo, All’llahu nuk është trup. Ai nuk ka as gjendjen e lëvizjes as të pushimit. Për Atë nuk gjendet as vend e as kohë. Për këtë Ai ka qenë para krijesave dhe do të qëndrojë pas zhdukjes së krijesave.

Në fund të ajetit, pas përmendjes së teuhidit, ajeti tregon për dy cilësi të larta të All’llahut. Ajeti thotë: “**...Ai dëgjon dhe di çdo gjë.**” Që do të thotë, se All’llahu është i Gjithëditur për të fshehtat e të gjitha krijesave. Ai dëgjon çdo gjë. Ai është i Gjithëditur për lëvizjen e milingonës mbi shkëmbinjt memecë, në errësirat e natës dhe në thellësi të luginave. Ai i di nevojat e saj dhe nevojat e krijesave të tjera. Ai e di se çfarë punojnë.

Ajetet 14 - 16

قُلْ أَغَيَّرَ اللَّهُ أَخِيذُ وَلِيًّا فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ يُطْعِمُ
 وَلَا يُطْعَمُ ۚ قُلْ إِنِّي أُمِرْتُ أَنْ أَكُونَ أَوَّلَ مَنْ أَسْلَمَ ۖ وَلَا
 تَكُونَنَّ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٤﴾ قُلْ إِنِّي أَخَافُ إِنْ عَصَيْتُ رَبِّي
 عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿١٥﴾ مَنْ يُصْرِفْ عَنْهُ يَوْمَئِذٍ فَقَدْ رَحِمَهُ ۚ
 وَذَلِكَ الْفَوْزُ الْمُبِينُ ﴿١٦﴾

“Thuaj: ‘A të marr mbrojtës tjetër, përveç All’lilaut, Krijuesit të
 qiejve dhe të Tokës? Ai ushqen, ndërsa Vetë nuk ushqehet.’
 Thuaj: ‘Unë jam urdhëruar që të jem i pari që t’i nënshtrohem
 Atij dhe kurrsesi mos u bë idhujtar!’”

“Thuaj: ‘Unë kurrë nuk e kundërshtoj Zotin tim, sepse i
 frikësohem dënimit të Ditës së Madhe.’”

“Atë që shpëton nga dënimi i kësaj Dite, vërtet, Zoti e ka
 mëshiruar. Ky është shpëtimi i vërtetë.”

Komentimi

S'ka mbrojtje, përveç mbrojtjes së All'llahut

Ka prej komentuesve që përmendin se shkak i zbritjes së ajetit është se një grup banorësh nga Meka shkuan te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thanë: “O Muhammed! Ti e le fenë e popullit tënd dhe kjo vetëm për shkak të varfërisë tënde. Prandaj, pranoje prej nesh gjysmën e pasurive tona që të pasurohesh, të mos flasësh për zotat tanë dhe të kthehesh në fenë tonë.” Atëherë, All'llahu zbriti ajetin që u përgjigjet atyre.¹

Më parë thamë se ajetet e kësaj sureje kanë zbritur njëherazi në Mekë, siç thuhet në transmetime. Për këtë, nuk mund të ketë për çdo ajet shkak të veçantë zbritjeje. Ndërsa bisedat mes Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe politeistëve kanë ndodhur para zbritjes së kësaj sureje dhe disa ajete të saj i tregojnë ato biseda dhe u përgjigjen atyre.

Sido që të jetë, qëllimi i zbritjes së këtyre ajeteve është konstatimi i teuhidit (Njëtimin të All'llahut) dhe luftimi i politeizmit (shirkut) dhe i idhujtarisë (ibadetul esnam). Megjithatë, politeistët, besonin se All'llahu është Krijuesi i gjithësisë, ata u kërkonin mbrojtje idhujve dhe strehoheshin tek ata. Për çdo nevojë kishin si zot nga një idhull si: për shiun, për

¹ Tefsiri “Ruhul Xhinan”, Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 18.

dritën, për luftën, për paqen, për riskun, etj. Këto gjendeshin edhe në Greqinë e lashtë.

Për ta hequr këtë mendim të gabuar, Kur'ani e urdhëron Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e i thotë: **“Thua: ‘A të marr mbrojtës tjetër, përveç All'llahut, Krijuesit të qiejve dhe Tokës? Ai ushqen, ndërsa Vetë nuk ushqehet.’”**

Përderisa Ai është Krijuesi i gjithçkaje, pa u mbështur në fuqinë e askujt, dhe Ai është Furnizuesi i krijesave të Tij, atëherë çfarë e shtyn njeriun që të adhurojë tjetërkënd përveç All'llahut dhe ta marrë mbrojtës dhe padron? Vërtet, gjithçka që shohim, janë krijesat e Tij dhe ato kanë nevojë në çdo moment për Të. Atëherë, si është e mundur që ato krijesa të përmbushin nevojat e tjerëve, ndërkohë që ato vetë janë nevojtare?

Ky ajet, në bisedën për Krijuesin e qiejve dhe të Tokës, përdor fjalën “fatirun”. Origjinali i kësaj fjale është *çarje*. Transmetohet nga ibn Abasi, i cili ka thënë: “Nuk e kam ditur kuptimin e thënies “*fatiru semauati uel errd*”, deri kur pashë dy beduinë që po grindeshin për një pus. Njëri prej tyre tha: ‘Unë “fatartuhu”, që do të thotë unë e hapa atë.’”¹

Mirëpo, ne sot jemi më të aftë se ibn Abasi në njohjen e kuptimit të fjalës “fatiru”, e kjo falë ndihmës së shkencës moderne. Ajo është një fjalë, e cila përputhet saktësisht me teoritë shkencore moderne që flasin për formimin e botës. Studimet e dijetarëve kanë nxjerrë në pah se bota e madhe (universi) dhe bota

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 18. Tefsiri “Biharul Enuar”; vëll. 81, f. 369.

e vogël (sistemet diellore) kanë qenë të gjitha një pjesë e përbashkët dhe u çanë për shkak të shpërthimeve të njëpasnjëshme duke u formuar yjet dhe planetet. Në ajetin 30 të sures “Enbija” gjendet sqarim për këtë çështje, ku thuhet: **“A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë...”**

Një pikë tjetër që nuk duhet lënë pa përmendur këtu është se ky ajet flet vetëm për cilësimin e All’llahut që është Ushqyes dhe Furnizues i krijesave të Tij. Ka mundësi që kjo të tregojë se nevoja më e madhe e njeriut në jetën e tij materiale është ajo e “kafshatës së jetesës”, siç thuhet. Kjo kafshatë e shtyn njeriun që t’i përulet poseduesve të pasurisë dhe të pushtetit. Ka raste që kjo përulje arrin deri në kufirin e adhurimit. Në ajet, Kur’ani dëshmon se furnizimi i njerëzve është në dorën e All’llahut dhe jo në dorën e atyre të pasurve dhe as në dorën e idhujve, sepse vetë poseduesit e pasurisë e të fuqisë, kanë nevojë për ushqim dhe se vetëm All’llahu është Ai që i ushqen njerëzit dhe Ai nuk ka nevojë të ushqehet.

Në ajete të tjera shohim që Kur’ani e dëshmon dhe e përforcon sundimin e All’llahut dhe të qenit e Tij Furnizues me zbritjen e shirave dhe me mbirjen e bimëve. Këtë e bën që të zhduket nga mendjet e njerëzve mbështetja e tyre te krijesat e njëjta me ta.

Më pas, ajeti u përgjigjet politeistëve, të cilët e ftonin Profetin që të bashkohej me ta. Kur’ani e vërteton domosdoshmërinë e refuzimit të ftesës së tyre bazuar në urdhrin e All’llahut, në shtesë të ndalimit logjik. Ajeti thotë: **“Thuaj: ‘Unë jam urdhëruar që të jem i pari që t’i nënshtrohem Atij’ dhe kurrësi mos u bë idhujtar!”**

Në ajet, gjithashtu, tregohet për një çëshjte edukative të rëndësishme që është se çdo udhëheqës duhet të jetë shembull në zbatimin e mësimave të fesë së tij. Për këtë, ai duhet të jetë i pari besimtar i mesazhit të vet, i pari zbatues dhe praktikues i tij, më përpjekësi në rrugën e tij dhe më i shpejti në sakrificë për hir të atij mesazhi.

Ajeti pasardhës përmban dëshmi dhe përforsim më të fortë për ndalimin e All'llahut që të pasohen politeistët. Ajeti thotë: **“Thuaj: ‘Unë kurrë nuk e kundërshtoj Zotin tim, sepse i frikësohem dënimit të Ditës të Madhe’”**. Që do të thotë, se All'llahu e urdhëron të Dërguarin e Tij që të thotë se nuk është i përjashtuar nga ligjet e All'llahut dhe se ai i frikësohet dënimit të Ditës së Madhe.

Gjithashtu, nga ky ajet kuptojmë se ndjesia e Profetëve ndaj përgjegjësisë është më e lartë se ndjesia e të tjerëve.

Që të sqarohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk mund të bëjë asgjë pa mbështetjen tek mirësia dhe mëshira e All'llahut, dhe se çdo gjë është në dorën e Tij, deri edhe vetë i Dërguari e vështroi me syrin e shpresës mëshirën e Tij të gjerë dhe i kërkon Atij shpëtim, ajeti thotë: **“Atë që shpëtohet nga dënimi i kësaj Dite, vërtet Zoti e ka mëshiruar. Ky është shpëtimi i vërtetë.”**

Këto ajete sqarojnë shkallën e lartë të Njëtimin (teuhidit) dhe u përgjigjet atyre, të cilët mendonin se Profetët janë udhëheqës të pavarur nga dëshira e All'llahut, siç vepruan të krishterët kur e bënë shpëtues Hazreti Mesihun (Isanë) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ajeti u thotë atyre se edhe vetë të Dërguarit kanë nevojë për mëshirën e All'llahut njësoj si ata.

Ajetet 17 - 18

وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ ^ع وَإِنْ
يَمْسَسْكَ خَيْرٌ فَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٧﴾ وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ
عِبَادِهِ ^ج وَهُوَ الْحَكِيمُ الْخَبِيرُ ﴿١٨﴾

“Nëse nga All’llahu të godet ndonjë fatkeqësi, atëherë askush përveç Tij nuk mund të të shpëtojë. E, nëse të dhuron ndonjë mirësi, dije se vetëm Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”

“Ai është Sunduesi mbi robtë e Vet. Ai është i Urti dhe ka dijeni për gjithçka.”

Komentimi

Fuqia mposhtëse e All’llahut

Më parë thamë se qëllimi i kësaj sureje është shkulja e rrënjëve të politeizmit dhe e idhujtarisë. Këto dy ajete e vazhdojnë realizimin e këtij qëllimi.

Kur’ani pyet: Përse i drejtoheni tjetërkujt përveç All’llahut, e strehoheni tek idhujt që i prodhoni për të zgjidhur problemet tuaja dhe për të larguar dëmet prej vetave tuaja? Pse i kërkonit idhujve mirësi? Ndërkohë që kur ju godet një fatkeqësi, sado e

vogël, atë nuk ua largon veçse All'Ilahu i Madhëruar. Kur ju vijnë të mirat, begatitë, fitimi dhe lumturia, këto janë prej fuqisë së All'Ilahut, sepse Ai është i Fuqishmi, i Forti. Ajeti thotë: **“Nëse nga All'Ilahu të godet ndonjë fatkeqësi, atëherë askush përveç Tij nuk mund të të shpëtojë. E, nëse të dhuron ndonjë mirësi, dije se vetëm Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”**

Në realitet, shkakun e të drejtuarit kah diçka tjetër përveç All'Ilahut, ose është përfytyrimi i tyre se ato kah të cilat drejtohen janë burimi i mirësive, ose besimi në fuqinë e tyre se ato mund t'ua largojnë fatkeqësitë dhe ua zgjidhin problemet. Përulja ndaj poseduesve të pasurisë dhe pushtetit deri në shkallën e adhurimit të tyre buron nga këto dy shkaqe. Ky ajet sqaron se fuqia e All'Ilahut është sunduese mbi çdo gjë. Nëse dikujt ia ndalon mirësitë apo dikujt tjetër i jep mirësi, askush në botë nuk mund ta ndryshojë veprën e Tij. Vallë, përse i përulen të tjerëve përveç Atij?

Ajeti pasardhës e plotëson ajetin paraardhës. **“Ai është Sunduesi mbi robtë e Vet...”**

Fjalët “kāhirun” dhe “gālibun”, edhe pse kanë një kuptim (mposhtës), ato kanë rrënjë të ndryshme. Fjala “el kahr”, përdoret për atë triumf, i cili realizohet pa përpjekjen e palës tjetër për të bërë rezistencë. Ndërsa në fjalën “el galebetu” nuk gjendet ky kuptim, sepse triumfi realizohet pas rezistencës. Thënë ndryshe: “el kahiru” i thuhet atij që është sundues mbi palën tjetër dhe ajo nuk ka fare mundësi për të rezistuar, si p.sh.: hedhja e një kove me ujë mbi një vatër të vogël zjarri dhe ajo menjëherë fiket.

Disa komentues mendojnë se fjala “el kahr” përdoret kur i mposhturi apo i sunduari është krijesë logjike, kurse fjala “el galebetu” është më e gjerë se e para dhe përfshin triumfin edhe mbi krijesat që nuk mendojnë.¹

Përderisa ajeti i mëparshëm tregon se fuqia e All’llahut përfshin edhe adhuruesit e rremë, edhe posesuesit e fuqisë, kjo nuk ka kuptimin se Ai është i detyruar që të hyjë në konflikt për një periudhë kohe me ato fuqi, që t’i mposhtë ato. Por, kuptimi është se fuqia e Tij është sunduese dhe mposhtëse. Për ta vërtetuar dhe për ta përforcuar më shumë këtë, në ajet thuhet “**...Sunduesi mbi robtë e Vet...**”

Kur gjendja është e tillë, si ka mundësi që njeriu i mençur e arsyetues ta kundërshtojë Zotin e tij dhe t’i drejtohet krijesave dhe personave që nuk zotërojnë në vetvete asnjë fuqi? Edhe atë fuqi të pakët që kanë, e kanë prej All’llahut Fuqiplotë.

Për të hequr çdo dyshim dhe përfytyrim se All’llahu e keqpërdor fuqinë e Tij të pakufishme, siç ndodh tek disa njerëz të fuqishëm, Kur’ani thotë: “**...Ai është i Urti dhe ka dijeni për gjithçka.**” Kjo do të thotë se All’llahu ka urtësi dhe çdo vepër e Tij është e llogaritur, sepse Ai është i Mirinformuar, i Gjithëditur dhe nuk gabon kurrë në përdorimin e fuqisë së Tij.

Në historinë e Faraonit lexojmë se kur i kërcënoi bijtë e Izraelit për vrasje, tha: “**Meqenëse jemi sundues mbi ata...**”² Kjo do të thotë se ai (Faraoni) e përdori fuqinë e tij sunduese, edhe pse e dobët, si mjet për padrejtësi dhe shkeljen e të drejtave të të

¹ Tefsiri “Mijzan”, vëll. 7, f. 36.

² Sure “A’raf”, ajeti 127.

tjerëve. Kurse All'llahu është i Urtë dhe i Mirinformuar ndaj asaj fuqie mposhtëse dhe Ai nuk i bën padrejtësi, qoftë edhe krijesës më të vogël të Tij.

Fraza **“mbi robtë e Vet”** ka kuptimin e epërsisë në pozitë dhe jo në vend sepse, All'llahu nuk ka vend të caktuar.

Është shumë e habitshme se disa mendjetrashë e kanë marrë këtë ajet si argument të trupëzimit të All'llahut, edhe pse nuk ka asnjë dyshim se përdorimi i kësaj fraze është figurative dhe tregon epërsinë e fuqisë së All'llahut të Madhëruar mbi të gjithë robtë e Vet. Edhe Faraoni, megjithëse është njeri, e përdor po këtë fjalë për të shfaqur epërsinë e tij sunduese dhe jo epërsinë e tij vendore.

Ajetet 19 - 20

قُلْ أَيْ شَيْءٍ أَكْبَرُ شَهَادَةً ۖ قُلِ اللَّهُ ۖ شَهِيدٌ بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ ۚ
 وَأُوحِيَ إِلَيَّ هَذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرَكُمْ بِهِ ۖ وَمَنْ بَلَغَ ۚ أَتَيْنَكُمْ
 لَتَشْهَدُونَ أَنَّ مَعَ اللَّهِ إِلَهَةً أُخْرَى ۚ قُلْ لَا أَشْهَدُ ۚ قُلْ إِنَّمَا
 هُوَ إِلَهُ وَاحِدٌ وَإِنِّي بَرِيءٌ مِّمَّا تُشْرِكُونَ ﴿١٩﴾ الَّذِينَ ءَاتَيْنَاهُمْ
 الْكِتَابَ يَعْرِفُونَهُ كَمَا يَعْرِفُونَ أَبْنَاءَهُمْ ۚ الَّذِينَ خَسِرُوا
 أَنْفُسَهُمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٢٠﴾

“Thuaj: ‘Cila është dëshmia më e madhe?’- dhe përgjigju: ‘All’lahu është dëshmitar midis meje dhe jush. Ky Kur’an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij, t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujt do që i përcillet. A mos vallë ju dëshmoni se, përveç All’lauhut ka edhe zota tjerë?’ Thuaj: ‘Unë nuk dëshmoj.’ Thuaj: ‘Vërtet, Ai është vetëm Një Zot dhe unë jam larg nga ato që ju ia shoqëroni All’lauhut (në adhurim).”

“Atyre që ua kemi dhënë Librin, e njohin, ashtu si i njohin fëmijët e tyre. Por ata që kanë humbur shpirtat e tyre, nuk do të besojnë kurrë.”

Komentimi

Dëshmitarët më të mëdhenj

Një grup komentuesish përmendin se disa politeistë mekas shkuan te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thanë: *"Si mund të jesh profet dhe ne nuk shohim asnjë që të të përkrahë? Edhe jehudinjtë e të krishterët që i pyetëm nuk dëshmuan për saktësinë e fjalëve të tua, sipas asaj që kanë në Teurat (Torro) dhe në Inxhil (Ungjill). Na trego se kush dëshmon për profetësinë tënde?"* Dy ajetet e lartpëmendura tregojnë për këtë ndodhi.¹

Përballë këtyre kundërshtarëve kokëfortë, të cilët i mbyllnin sytë për të parë të gjitha argumentet rreth vërtetësisë së mesazhit dhe kërkojnë më shumë dëshmi për të, Profeti urdhërohet që të thotë: **"Thuaj: 'Cila është dëshmia më e madhe?' A ka dëshmi më të madhe se ajo e Sunduesit të botëve?" - dhe përgjigju: 'All'llahu është dëshmitar midis meje dhe jush...'"**

A ka argument më të madh se ky Kur'an? **"...Ky Kur'an më është shpallur..."**

Ky Kur'an, kurrë nuk mund të jetë krijimtari e mendjes së njeriut, veçanërisht në ato rrethana kohore dhe vendore. Ky Kur'an, që përmban dëshmi të ndryshme për mrekullinë e tij, se fjalët e tij janë mrekulli dhe kuptimet e tij janë mrekulli, a nuk

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 22. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 607.

është dëshmitar i madh dhe i mjaftueshëm që të vërtetojë se mesazhi është nga All'llahu?!

Nga kjo fjali e ajetit, gjithashtu, përfitohet se Kur'ani është mrekullia më e madhe dhe dëshmuesi më i madh për vërtetësinë e thirrjes së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Më pas, ajeti tregon qëllimin e zbritjes së Kur'anit dhe thotë: **"...në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujt do që i përcillet..."** Që do të thotë: Ky Kur'an më është shpallur mua që t'ju tërheq vërejtjen juve dhe të gjithë atyre që do t'u arrijë Kur'ani gjatë historisë së njerëzimit, në çdo kohë dhe në çdo vend deri në ditën e fundit të kësaj jete.

Këtu vërehet se bëhet fjalë vetëm për tërheqje vërejtjeje, ndërkohë që në të shumtën e rasteve Kur'ani bashkon tërheqjen e vëmendjes me përgëzimin. Shkaku këtu është se bëhet fjalë për njerëzit e pabindur që këmbëngulin në mendjemadhësi. Në këtë fjali mjaft domethënëse zhduken të gjitha pretendimet se Kur'ani është i posaçëm për arabët dhe se ai ka qenë për një kohë dhe për një vend të caktuar.

Disa dijetarë, me anë të kësaj thënieje, argumentojnë vulën e profetësisë së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kjo fjali ka kuptimin se Profeti Muhammed është dërguar për të gjithë ata, të cilëve u mbërrin shpallja dhe mesazhi i tij. E kjo përfshin të gjithë ata që jetojnë në këtë jetë, deri në fund të saj.

Transmetimet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja e All'lahut qoftë mbi ta!*) thonë se kuptimi i shpalljes të Kur'anit nuk është i kufizuar vetëm me mbërritjen e tekstit të tij tek popujt, por kuptimi i Shpalljes përfshin edhe mbërritjen e përkthimit të tij në gjuhë të ndryshme.

Është transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se kur e kanë pyetur për këtë ajet, ai ka thënë: “Në çdo gjuhë.”¹

Po ashtu, edhe prej bazave plotësisht të pranuarra të teologjisë është parimi “e shëmtuara e dënimit pa sqarim e argumentim”. Këtë e sqaron edhe ajeti i lartpërmendur.

Në bazat e jurisprudencës është konstatuar se përderisa një rregull nuk i ka arritur një personi, ai nuk mban përgjegjësi në zbatimin e këtij rregulli (me përjashtim nëse është i pamundur në kuptimin e atij rregulli). Ajeti thotë se atyre që u mbërrin mesazhi, janë përgjegjës ndaj tij. Ndërsa atyre që nuk u ka mbërritur mesazhi, nuk kanë përgjegjësi ndaj tij.

Në tefsirin “El Manar” gjendet një transmetim i Ubej ibn Ka'b i cili ka thënë: “Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i sollën robtë e luftës dhe u tha atyre: ‘A jeni thirrur për në Islam?’ Ata u përgjigjën: ‘Jo.’ Ai i liroi ata e pastaj lexoi: **“Ky Kur'an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet.”** Më pas tha: ‘Lirojini ata që të shkojnë në vendet e tyre sepse nuk janë thirrur.’”²

¹ Tefsiri “Burhan”, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 707.

² Tefsiri “El Manar”, vëll. 7, f. 341.

Më poshtë, All'Ilahu i Madhëruar e urdhëron të Dërguarin e Tij që t'i pyesë ata: **"...A mos vallë ju dëshmoni se, përveç All'Ilahut ka edhe zota tjerë? Thuaj: 'Unë nuk dëshmoj...'"** Pastaj e urdhëron duke i thënë: **"...Thuaj: 'Vërtet, Ai është vetëm Një Zot dhe unë jam larg nga ato që ju ia shoqëroni All'Ilahut (në adhurim).'"**

Fjalët e ajetit të fundit përmendin një qëllim të rëndësishëm psikik: Politeistët hamendësojnë se fjalët e tyre mund të shkaktojnë lëkundje te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kështu që ata largohen me shpresë që t'u thonë shokëve e tyre se Muhammedi mund të ndryshojë mendje për thirrjen e tij. Këto fjali të ajetit janë të qarta e të prera, që ua fshijnë shpresën politeistëve dhe ua përkeqësojnë gjendjen shpirtërore. Ato u sqarojnë atyre se çështja është më e madhe nga ç'mendojnë dhe se ata nuk mund të hedhin as dyshimin më të vogël tek Profeti për mesazhin e tij. Provat kanë treguar se përmendja e këtyre fjalëve të qarta e të prera në fund të çdo çështjeje, ka ndikim të thellë në realizimin e qëllimit final.

Kurse, ata që thanë se idhtarët e Librit nuk dëshmojnë për Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajeti i mëposhtëm u përgjigjet atyre dhe u thotë: **"Atyre që ua kemi dhënë Librin, e njohin, ashtu si i njohin fëmijët e tyre..."** Kjo ka kuptimin se njohja e Profetit nga ana e tyre nuk është e kufizuar vetëm me dukjen e tij dhe me thirrjen e tij, por ata njohin të veçantat dhe shenjat e tij të hollësishme. Për këtë, nëse një grup i banorëve të Mekës thonë se i kanë pyetur idhtarët e Librit dhe nuk gjetën dije dhe njohuri për Profetin, ata, ose gënjyen dhe nuk verifikuan, ose idhtarët e Librit ua fshehën

atyre argumentet dhe shenjat dhe nuk ua treguan. Për këtë fshehje të argumenteve dhe shenjave flasin ajete të tjera të Kur'anit.¹

Në fund, ajeti lajmëron rezultatin përfundimtar: “**...Por ata që kanë humbur shpirtrat e tyre, nuk do të besojnë kurrë.**” Kjo do të thotë se ata që nuk i besuan Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me gjithë argumentet dhe shenjat e qarta, do të humbasin çdo gjë në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër.

¹ Për më shumë sqarime, lexo komentimin e ajetit 146 të sures “Bekare”.

Ajetet 21 - 24

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَوْ كَذَّبَ بِآيَاتِهِ ۖ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿٢١﴾ وَيَوْمَ نَخْشُرُهُمْ جَمِيعًا ثُمَّ نَقُولُ لِلَّذِينَ أَشْرَكُوا آيِنَ شُرَكَائِكُمُ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ ﴿٢٢﴾ ثُمَّ لَمْ تَكُنْ فَتَنْتُهُمْ إِلَّا أَنْ قَالُوا وَاللَّهِ رَبِّنَا مَا كُنَّا مُشْرِكِينَ ﴿٢٣﴾ أَنْظِرْ كَيْفَ كَذَبُوا عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ ۚ وَضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٢٤﴾

“Kush është më keqbërës se ai që trillon gënjeshtër për All’llahun ose i përgënjeshtrojnë shpalljet e Tij? Vërtet, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.

“Atë ditë kur do t’i tubojmë të gjithë, Ne do t’u themi idhujtarëve: ‘Ku janë idhujt tuaj, për të cilët thoshit se ishin ortakë të All’llahut!’”

“Ata nuk do të mund të shfajësohen ndryshe, veçse duke thënë: ‘Betohemi në All’llahun, Zotin tonë, nuk kemi qenë idhujtarë!’”

“Shiko se si gënjejnë kundër vetes, por zotat që ata i trilluan, do t’i lënë në baltë.”

Komentimi

Padrejtësia më e madhe

Këto ajete vazhdojnë të paraqesin metodologjinë e Kur'anit në luftën kundër idhujtarisë dhe politeizmit. Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, në mënyrë pyetësore mohuese thotë: **“Kush është më keqbërës se ai që trillon gënjeshtër për All'llahun ose i përgënjeshton shpalljet e Tij?...”**

Në realitet, fjalia e parë tregon për mohimin e teuhidit dhe e dyta tregon për mohimin e profetësisë. Sigurisht, s'ka padrejtësi më të madhe që njeriu t'i vejë All'llahut shok një copë të ngurtë e të pavlerë, apo një njeri të dobët si vetja e tij. Vërtet, All'llahu i Madhëruar është Ekzistenca e domosdoshme absolute, është Sunduesi i gjithësisë. Kjo padrejtësi është e treanshme: padrejtësi ndaj All'llahut, kur thuhet se Ai ka shok; padrejtësi e njeriut ndaj vetes së vet, sepse ai humbet vlerat e tij kur i përulet dhe i bën sexhde një guri apo një druri; padrejtësi ndaj shoqërisë, sepse idhujtaria dhe politeizmi sjellin përçarje dhe largim nga shpirti i bashkimit dhe i unitetit të shoqërisë.

S'ka dyshim se çdo i padrejtë, veçanërisht ai që i bën padrejtësi vetes, nuk mund ta shohë lumturinë dhe shpëtimin, siç thotë edhe ajeti: **“...Vërtet, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.**

Fjala “shirk” (politeizëm, idhujtari) nuk përmendet në ajet. Mirëpo, duke parë ajetet paraardhëse dhe ato pasardhëse që flasin për politeizmin, sqarohet se kuptimi i fjalës “iftiraun” (shpifje) është për të vënit shok All'llahut të Madhëruar.

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'ani në pesëmbëdhjetë vende, në mënyrë pyetësore, i cilëson disa njerëz si më të padrejtët.¹ Shumica e atyre ajeteve flasin për shirkun, adhurimin e idhujve dhe mohimin e argumenteve të All'llahut. Kurse pjesa tjetër, flet për çështje të tjera, si për shembull: **"Kush është më i padrejtë se ai që pengon të përmendet nëpër xhamitë e All'llahut Emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre?!..."**² Dhe: **"...Kush është më i padrejtë se ai që fsheh të vërtetën e ardhur prej All'llahut?..."**³

Ajeti pasardhës flet për fundin e politeistëve në Ditën e Kiametit. Me mbështetjen e tyre tek krijesat e dobëta, si idhujt, ata nuk arritën të siguronin qetësinë as në këtë jetë dhe as në Jetën Tjetër. Ajeti thotë: **"Atë ditë kur do t'i tubojmë të gjithë, Ne do t'u themi idhujtarëve: 'Ku janë idhujt tuaj, për të cilët thoshit se ishin ortakë të All'llahut!'"** Ku janë ato? Përse nuk vijnë sot që t'ju shpëtojnë? Përse nuk shfaqin asnjë lloj fuqie? A nuk mendonit se ata do t'ju ndihmonin dhe do t'u zgjidhnin problemet? Atëherë, ku janë dhe përse nuk shohim asnjë ndikim dhe asnjë gjurmë të tyre? Më pas, ata do t'i mbulojë tmerri e frika dhe do të qëndrojnë të shtangur, të hutuar dhe nuk do të jenë në gjendje të përgjigjen, veçse do të betohen në All'llahun se ata nuk kanë qenë politeistë duke menduar se kështu mund të fshehin të vërtetën. Ajeti thotë: **"Ata nuk do të mund të shfajësohen ndryshe, veçse duke thënë:**

¹ Sure "Bekare", ajeti 114 dhe 140; sure "En'am", ajeti 21, 93, 144, 157; sure "A'raf", ajeti 37; sure "Junus", ajeti 17; sure "Hud", ajeti 15; sure "Kehf", ajeti 15 dhe 57; sure "Ankebut", ajeti 68; sure "Sexhde", ajeti 22; sure "Zumer", ajeti 32; sure "saf", ajeti 7.

² Sure "Bekare", ajeti 114.

³ Sure "Bekare", ajeti 140.

'Betohemi në All'llahun, Zotin tonë, që nuk kemi qenë idhujtarë!'"

Për kuptimin e fjalës “fitneh”, që përmendet në këtë ajet, komentuesit kanë thënie të ndryshme. Disa prej tyre kanë thënë se ka kuptimin e të kërkuarit ndjesë; disa të tjerë kanë thënë se ka kuptimin e përgjigjes; po ashtu, kanë thënë se ka kuptimin e shirkut.¹²

Ka një alternativë tjetër në komentimin e këtij ajeti, që është: Fjala “el fitnetu” vjen prej fjalës “el iftitan”, që do të thotë dashuri e zjarrtë për diçka. Në këtë mënyrë, kuptimi i ajetit është se kjo dashuri e tyre për idhujt dhe adhurimin e tyre ua mbulon mendjen dhe të menduarit. Në Ditën e Kiametit, kur të hiqen perdet, ata do t'i kuptojnë gabimet dhe gjynahet e tyre, do t'i shohin punët e këqija dhe do t'i mohojnë ato. Në librin e tij “El Mufredat” Ragibi thotë se origjinaliteti i fjalës “*el fiten*” është futja e floririt në zjarr për të parë cilësinë e tij prej papastërtisë. Ka mundësi që ky kuptim ta shpjegojë këtë ajet me kuptimin që kur ata t'i rrethojë ashpërsia e Ditës së Kiametit, do të zgjohen dhe do të shohin gabimet dhe gjynahet e tyre. Ata do t'i mohojnë punët që kanë bërë për të kërkuar shpëtim.

Me qëllim që njerëzit të nxjerrin mësim nga fundi i keq i idhujtarëve, ajeti i tretë, prej ajeteve në fjalë, thotë: **“Shiko se si gënjejnë kundër vetes...”** Ato mbështetës që ata i zgjodhën dhe i

¹ Nëse do ta marrim me kuptimin e të kërkuarit ndjesë dhe të përgjigjes, atëherë nuk është i nevojshëm aludimi për to. Kurse, po të jetë me kuptimin e shirkut, duhet që të aludohet fjala “rezultat”. Që do të thotë se rezultati i idhujtarisë së tyre ishte që ata të betoheshin se nuk kanë qenë idhujtarë.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 26.

quajtën ortakë të All'llahut, do të shkatërrohen dhe do të mbeten të zhgënjyer prej tyre “...por zotat që ata i trilluan, do t’i lënë në baltë.”

Hulumtime

1- S’ka dyshim se qëllimi i fjalës “undhur” (shiko), është për të parit me syrin e mendjes dhe jo të parit me shqisën e syrit, sepse nuk është e mundur të shihen skenat e Ditës së Kiametit në këtë jetë me shqisën e syrit me të cilin i shohim gjërat në këtë jetë.

2- Thënia e All'llahut: “**gënjejnë kundër vetes**”, ose ka kuptimin që ata mashtruan vetat e tyre në dynja dhe dolën nga rruga e drejtë, ose ka kuptimin e Ditës së Kiametit, në të cilën do të betohen se nuk kanë qenë idhujtarë. E vërteta është se ata, me këtë veprim, gënjejnë vetat e tyre, sepse ata, në realitet, ishin idhujtarë.

3- Nga ajeti përfitohet se në Ditën e Kiametit idhujtarët do ta mohojnë idhujtarinë e tyre, edhe pse në atë Ditë askush nuk mund t’i largohet së vërtetës, kur të shohë të vërtetat e prekshme. Kjo është njësoj sikur dikush të mbulojë diellin në mesin e ditës dhe të gënjejë duke thënë se është errësirë. Në Kur’an kemi ajete të tjera, nga të cilat përfitohet se në Ditën e Kiametit idhujtarët e pohojnë qartë idhujtarinë e tyre dhe nuk fshehin asgjë, siç thuhet në ajetin 42 të sures “Nisa”: “... **por All'llahut nuk mund t’i fshehin asnjë fjalë.**”

Për sqarim përmendim dy çështje:

E para: Dita e Kiametit ka faza. Në fazën e parë, idhujtarët mendojnë se me gënjeshtër mund t'i shpëtojnë dënimit të rëndë të All'llahut.

Për këtë ata rikthehen në zakonin e tyre të hershëm, duke u mbështetur tek gënjeshtria. Mirëpo në fazat e tjera, ata e kuptojnë fare mirë se për ta nuk ka asnjë rrugëdalje dhe i pohojnë veprat që kanë bërë.

Mesa duket, perdet në atë Ditë do të ngrihen në mënyrë të shkallëzuar nga sytë e njeriut. Në fillim, kur idhujtarët nuk e shohin ashtu siç duhet dosjen e punëve të tyre, strehohen tek gënjeshtria. Mirëpo, në fazat e mëpasme, kur perdet të ngrihen akoma më shumë, shohin se çdo gjë që kanë bërë është e shënuar dhe e pranishme në duart e tyre. Ata i pohojnë plotësisht ato që kanë bërë. Kjo është njësoj si kriminelët, të cilët, në fillim mohojnë çdo gjë deri edhe shokët e tyre. Por, kur atyre u tregohen argumentet prekëse dhe dëshmuese që sqarojnë krimin e tyre, ata e kuptojnë se çështja është shumë e qartë dhe nuk është nevoja të thuhet gënjeshtria. Atëherë ata e pohojnë krimin që kanë bërë. Këtë e gjejmë të theksuar edhe në një hadith të transmetuar nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

E dyta: Ajeti i larpërmendur flet për atë që nuk e quan veten e tij idhujtar, siç janë të krishterët që thonë për trininë dhe besojnë se janë monoteistë dhe jo politeistë. Ose si ata që pretendonin se ishin monoteistë, mirëpo veprat e tyre janë të përlyera me politeizëm, sepse ata i kundërshtonin mësimet e të

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 708.

Dërguarve dhe mbështeteshin tek krijesat e tjera dhe jo tek All'Ilahu i Madhëruar. Në Ditën e Kiametit këta do të betohen se kanë qenë monoteistë. Mirëpo, shumë shpejt, ata do ta kuptojnë se në brendi të tyre kanë qenë politeistë. Ky sqarim është përmendur edhe në hadithe të transmetuara nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

Të dyja çështjet janë të pranueshme.

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 708.

Ajetet 25 - 26

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ ۖ وَجَعَلْنَا عَلَى قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَنْ يَفْقَهُوهُ وَفِي
 آذَانِهِمْ وَقْرًا ۖ وَإِنْ يَرَوْا كَلَّآءَآيَةٍ لَا يُؤْمِنُوهَا ۖ حَتَّىٰ إِذَا جَاءُوكَ
 يُجَادِلُونَكَ يَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُوا إِنْ هَذَا إِلَّا أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿٢٥﴾ وَهُمْ
 يَنْهَوْنَ عَنْهُ وَيَنْعَوْنَ عَنْهُ ۚ وَإِنْ يُهْلِكُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿٢٦﴾

“Disa prej tyre duket sikur të dëgjojnë, por Ne kemi vënë perde në zemrat e tyre dhe ua kemi rënduar dëgjimin, në mënyrë që ata të mos kuptojnë. Edhe nëse do të shihnin ndonjë prej shenjave Tona, ata sërish nuk do të besonin. Kur vijnë tek ti për të kundërshtuar, jobesimtarët thonë: ‘Këto janë vetëm trillime të popujve të lashtë!’”

“Ata i ndalojnë të tjerët, edhe vetë largohen nga ai. Por vetëm veten e dëmtojnë, ndonëse nuk e vënë re.”

Komentimi

Perde që nuk pranojnë çarje

Në këto dy ajete tregohet për gjendjen shpirtërore të disa politeistëve. Ata nuk shfaqin asnjë gadishmëri për të dëgjuar të vërtetat. Jo vetëm kaq, por ata janë armiq të këtyre të vërtetave.

Ajeti thotë: **“Disa prej tyre duket sikur të dëgjojnë, por Ne kemi vënë perde në zemrat e tyre dhe ua kemi rënduar dëgjimin, në mënyrë që ata të mos kuptojnë...”**¹

Mendjet dhe të menduarit e tyre janë të zhytura në fanatizmin e verbër injorant, në interesat e tyre materiale dhe në dhënien pas egos, derisa mendja arriti të mbulohet me perde e me pengesë dhe ata as nuk dëgjojnë të vërtetat dhe as nuk i kuptojnë gjërat ashtu siç duhen kuptuar.

E kemi thënë vazhdimisht se atributet e All’llahut për këto gjëra, tregojnë për ligjin e shkakut dhe të pasojës dhe të specifikës së punës. Kjo do të thotë se gjurmët e vazhdimësisë në devijim dhe këmbungulja në mosbindje dhe pesimizëm shfaqin cilësimin e njeriut me këto cilësi dhe shndërrohen në pasqyrë të shtrembër, e cila i paraqet gjërat të shtrembra dhe të deformuara. Provat kanë konstatuar se të devijuarit dhe gjynahqarët, në fillim, e ndiejnë pakënaqësinë ndaj vetave të tyre, por dalëngadalë ata mësohen me këtë gjendje dhe arrijnë t’i konsiderojnë punët e këqija të domosdoshme. Me fjalë të tjera, ky është një lloj ndëshkimi që e marrin këmbëngulësit në gjynahe dhe ata që e urrejnë të vërtetën.

Ata kanë arritur deri në atë kufi sa që ajeti i cilëson: **“...Edhe nëse do të shihnin ndonjë prej shenjave Tona, ata sërish nuk do të besonin...”** Jo vetëm kaq, por ata nuk të afrohen ty dhe as nuk i hapin dritaret e zemrës për ato që thua. Por ata vijnë me shpirt dhe me mendim negativ. Qëllimi i vetëm i tyre është debati dhe kundërshtimi: **“...Kur vijnë tek ti për të të kundërshtuar...”** Kur dëgjojnë fjalët e tua, të cilat burojnë nga

¹ Fjala “*ekinnetun*” ka kuptimin e çdo perdeje apo pengese. Fjala “*uakrun*” ka kuptimin e dëgjimit të rëndë.

Shpallja, ata fillojnë të të akuzojnë se ato që thua nuk janë tjetër veçse legjenda që i shpikën njerëzit e shkuar. **“...jobesimtarët thonë: ‘Këto janë vetëm trillime të popujve të lashtë!’”**

Ajeti pasardhës thotë se ata nuk mjaftohen me kaq. Edhe pse janë të humbur, ata përpiqen të gjejnë rrugëzgjidhje pa bërë hulumtime për të vërtetën, ndaj së cilës hedhin gënjeshtra të ndryshme dhe ndalojnë të tjerët t’i afrohen të Dërguarit të All’llahut: **“Ata i ndalojnë të tjerët, edhe vetë largohen nga ai...”**. Por ata nuk e kuptojnë se kush ndeshet me të vërtetën, është i mposhtur dhe së fundi, sipas ligjit të Krijimit, do të duket pamja e së vërtetës pas reve dhe do të triumfojë me të gjitha fuqitë që ka. Kurse e pavërteta shpërndahet në sipërfaqen e ujit. Ata kokëfortë e kundërshtues dëmtojnë e shkatërrojnë vetëm vetat e tyre, mirëpo ata nuk e kuptojnë të vërtetën **“...Por vetëm veten e dëmtojnë, ndonëse nuk e vënë re.”**

Akuza e madhe ndaj Ebu Talibit, besimtarit të kurejshëve

Nga thëniet që janë përcjellur për komentimin e këtij ajeti sqarohet se ai flet për mushrikët kokëfortë, që ishin armiq të ashpër të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjn e tij!*). Përemri pronor “hum” që gjendet në këtë ajet, sipas rregullave të letërsisë e gramatikës gjuhësore, është për mushkrikët ekstremistë, të cilët i përdornin të gjitha mënyrat për t’i bërë keq të Dërguarit të All’llahut dhe vendosnin pengesa në rrugën e përhapjes së mesazhit të pastër e të drejtë islam.

Por, fatkeqësisht, shohim se disa komentues nga Ehli Syneti, i shkelin dhe i kundërshtojnë të gjitha rregullat e gjuhës

arabe. Ata e ndajnë ajetin e dytë prej ajeteve në fjalë, dhe thonë se ky ajet ka zbrtitur për Ebu Talibin, babain e prijësit të besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ata e komentojnë këtë ajet në këtë mënyrë: Kishte njerëz të cilët e mbronin Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por në të njëjtën kohë largoheshin prej tij: **“Ata i ndalojnë të tjerët, edhe vetë largohen nga ai...”**¹ Për të forcuar mendimin e tyre, sjellin për dëshmi disa ajete të tjera nga Kur’ani, siç është ajeti 114 i sures “Teube” dhe ajeti 56 i sures “Kasas”, për të cilët do të flasim kur të mbërrijmë në ato sure e ajete.

Mirëpo, të gjithë dijetarët shiitë dhe një grup dijetarësh nga Ehli Syneti, si ibn Ebi El Hadijd, shpjeguesi i Nehxhu Belagës; El Kastalanij në librin “Irshadu Es Sarij”; Zejn Dahlan në “Hashijetu Es Sijretul Halebijeh”, e konsiderojnë Ebu Talibin prej besimtarëve islamë. Në burimet origjinale islame ka shumë tregues për këtë.

Atë që i lexon këto argumente, e shtyn habia që të pyesë: Cili është shkaku që i ka shtyrë disa ta urrejnë Ebu Talibin dhe ta akuzojnë me këtë akuzë të madhe?!

Si mund të akuzohet një njeri, i cili me gjithë qënien e tij e mbronte të Dërguarin e All'llahut, ndërkohë që ai dhe djali i tij kanë rrezikuar jetën e tyre për të mbrojtur të Dërguarin e All'llahut nga çdo rrezik?!

¹ Tefsiri “Xhamiul Bejjan”, vëll. 7, f. 228 dhe 229. “Mustedrekul Hâkim”, vëll. 2, f. 315.

Nga këtu, studiuesit dhe hulumtuesit mendojnë se kundërshtuesit e çështjes së Ebu Talibit është çështje politike, dhe e ka pikënisjen tek armiqësia e “pemës së keqe të Beni Umejjes” ndaj pozitës së Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo sepse Ebu Talibi nuk është i vetmi që u përball me të tilla sulme për shkak të afërsisë së tij me prijësin e besimtarëve. Madje, ne shohim se përgjatë historisë islame, cilido që kishte ndonjë afërsi me prijësin e besimtarëve, Imam Aliun, nuk i ka shpëtuar sulmeve të ashpra. Vërtet, mëkati i vetëm i Ebu Talibit ishte se ai ishte babai i një personaliteti të lartë islam, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Këtu do të përmendim në mënyrë të përmblendhur tregues të ndryshëm që konstatojnë besimin e Ebu Talibit dhe detajet më të shumta ia lëmë literaturave të posaçme rreth kësaj tematike.

1- Ebu Talibi e dinte, para profetësisë, se djali i vëllait të tij do ta arrinte pozitën e profetësisë. Historianët kanë shkruar se në udhëtimin e tij me karvanin e kurejshëve për në Sham, mori me vete djalin e vëllait të tij, Muhammedin, i cili ishte 12 vjeç. Gjatë udhëtimit ai vuri re tek ai disa qeramete. Pastaj, kur karvani kaloi pranë karavanit të priftit Behira, i cili me vite të tëra shkote me karvanet tregtare, i bënë përshtypje shenjat në fytyrën e Muhammedit. Prifti filloi ta vështronte më hollësi fytyrën dhe pamjen e tij. Pastaj iu drejtua të gjithëve duke thënë: “Kush prej jush është kujdestari i këtij fëmije?” Ata u drejtuan kah Ebu Talibi, i cili tha: “Ky është djali i vëllait tim.” Behira tha: “Ky fëmijë do të ketë pozitë. Ky është Profeti për të cilin kanë lajmëruar. Për

mesazhin e tij kanë lajmëruar librat qiellorë. Unë i kam lexuar në to të gjitha detajet.”¹

Ebu Talibi, duke parë shenjat dhe argumentet e ndryshme tek djali i vëllait të tij, e kuptoi se ai do të ishte Profeti i këtij ymeti.

Shehj Ristani, autori i librit “El Milel uen Nihal”, si dhe dijetarë të tjerë të Ehli Syneetit, përmendin se për një vit në Mekë nuk kishte rënë asnjë pikë shi dhe njerëzit u përballën me një thatësi të ashpër. Ebu Talibi urdhëroi që t’i sillnin djalin e vëllait të tij, Muhammedin, i cili ishte akoma në gji dhe i mbështjellë. Ebu Talibi qëndroi përballë Qabes dhe në një gjendje frike e përgjërimit filloi ta hidhte fëmijën përpjetë tre herë duke e pritur. Gjatë kësaj thoshte: “O Zot! Për hak të këtij fëmije, na zbrit përherë shi!” Nuk kaloi shumë kohë derisa u duk reja në qiell, e cila mbuloi të gjithë qiellin e Mekës. Ra shi i rrëmbyeshëm, nga i cili desh u përmyt Meka. Pastaj, shehj Ristani thotë: “Kjo ngjarje që tregon për dijen e Ebu Talibit rreth profetësisë së djalit të vëllait që në fëmijërinë e tij, është argument që përforcon besimin e tij.”

Historinë e vajtjes së kurejshitëve të Ebu Talibit në kohën e thatësisë dhe ndërmjetësimi që bëri me fëmijën tek All’l-lahu, e përmendin një numër historianësh të tjerë përveç shehj Ristanit. Eruditi Emijni, autori i librit “El Gadijr” ka thënë se këtë histori e ka përcjellë nga “Sherhul Bukharij”, “El Meuahibul El Ledunijeh”, “El Khasaisul Kubra”, “Sherh Behxhetul Mehafil”, “Es Sijretul Halebije”, “Es Sijretun Nebeuiejeh” dhe “Talebetul Et Talib”.²

¹ Përmbledhje e asaj që përmendet në “Sijretu ibn Hisham”, vëll. 1, f. 116. “Sijretul Halebij”, vëll. 1, f. 131. E të tjerë libra.

² “El Gadijr”, vëll. 7, f. 345.

2- Në shtesë të librave të njohur të historisë, gjenden edhe poezi të Ebu Talibit të grumbulluara në “Divan Ebu Talib”. Prej këtyre poezive janë edhe vargjet e mëposhtme:

“Betohem në All’lahun, se kurrë nuk do të arrijnë tek ti me bashkimin e tyre

Derisa të vendosem në tokë i varrosur

Përgëzo dhe gëzoji sytë e tu

Ti më ftove mua dhe unë e kuptova se je këshilluesi im

Vërtet, fitove dhe ishe besniku

E mësova se feja e Muhammedit

Është feja më e mirë ndër të gjitha fetë.¹”

Ibn Ebi El Hadijd përmend një numër të madh poezish të Ebu Talibit, për të cilat ibn Shehr Ashub në librin “Muteshabihatul Kur’an”, thotë se ato arrijnë në tre mijë bejte. Pastaj thotë: “Këto poezi nuk lënë vend për të dyshuar se Ebu Talibi ka qenë besimtar në mesazhin e djalit të vëllait të tij.”

3- Ka hadithe të përcjella nga i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që e përforcojnë dëshminë e tij për besimin e xhaxhait të tij besnik, Ebu Talibit. Prej atyre haditheve janë ato që na ka përcjellë autori i librit “Ebu Talibi, besimtari i kurejshitëve”, në të cilin thuhet: “Kur vdiq Ebu Talibi, Profeti e varrosi atë. Ai qëndroi te varri i tij dhe tha: “Oh Babai im! Oh Abu Talib! Oh hidhërim për ty! Si të të harroj ty

¹ “El Gadijr”, vëll. 7, f. 334 dhe 351.

që më edukove që në vogëli dhe qëndrove gjithmonë pranë meje kur isha i madh. Unë isha tek ti si drita te syri dhe si shpirti te trupi.”¹

Shumë herë Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thoshte: “Kurejshitët nuk më kanë bërë asgjë që e urrej derisa vdiq Ebu Talibi.”²

4- I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka urdhëruar për ndërprerjen e të gjitha lidhjeve shoqërore dhe miqësore me mushrikët. Këtë e ka bërë disa vite para vdekjes së Ebu Talibit. Për këtë, dashuria që shfaqte Profeti për Ebu Talibin tregon se ai e shihte Ebu Talibin si pasuses të shkollës së njësimi. Vallë, si është e mundur që Profeti të urdhërojë shpëputjen e lidhjeve me mushrikët dhe vetë ai ta dojë aq shumë Ebu Talibin?!

5- Në hadithet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) ka argumente të mjaftueshme për besimin e Ebu Talibit dhe sinqeritetin e tij. Ato janë të shumta dhe nuk mund të përmenden këtu. Ato janë hadithe që bazohen në argumente logjike e arsyetuese, siç është hadithi i ardhur nga Imam Zejnul Abidijn (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilin, pasi e kanë pyetur për besimin e Ebu Talibit, ka thënë: “Këtu ka njerëz që thonë se ka qenë jobesimtar (*kafir*)... Habi e madhe! Ata akuzojnë Ebu Talibin apo të Dërguarin e All’llahut. All’llahu në shumë ajete të Kur’anit nuk i përmend pranë njëri-tjetrit besimtarin me jobesimtarin. Askush nuk dyshon se Fatime bintu Esed (*All’llahu qoftë e kënaqur me të!*) ka qenë prej besimtareve të

¹ “Shejkhul Abatih”. Marrë nga libri “Ebu Talibi, besimtari i kurejshitëve”.

² “El Gadijr”, vëll. 7, f. 367.

shkuara. Ajo ka qëndruar me Ebu Talibin derisa ai vdiq (All'llahu qoftë i kënaqur me të!)"¹

6- Nëse të gjitha këto i lëmë mënjanë, ne nuk dyshojmë në qënien e Ebu Talibit në krye të mbrojtësve të Islamit dhe të Profetit të Islamit. Mbrojtja e tij i tejkalonte kufijtë e njohur mes fiseve dhe fanatizmit fisnor. Prej shembujve jetikë rreth kësaj është ndodhia e Shu'ab Ebi Talib. Historianët janë të një mendimi dhe kanë përcjellë se kur kurejshitët vendosën ta shtrëngonin Profetin dhe myslimanët ekonomikisht dhe politikisht dhe shkëputën çdo lidhje me ta, Ebu Talibi qëndroi si mbrojtësi i vetëm i tyre për tre vjet me radhë. Ai i la të gjitha punët e tij dhe shkoi së bashku me fisin hashimit në luginën mes maleve të Mekës, e cila quhet Shu'ebetu Ebu Talib dhe jetuan aty. Sakrificat e tij arritën deri aty sa - përveç ndëritmit të kullave të posaçme që bëri për t'u ruajtur nga sulmet e kurejshitëve -, ai e zgjonte Profetin nga gjumi natën dhe e çonte në një vend tjetër dhe në vendin e Profetit, ai vendoste djalin e tij të dashur, Aliun. Kur Aliu i tha: *"O babai im! Kjo më çon në vdekje. Ai iu përgjigj: 'O biri im! Duro, sepse e gjithë lagjja është drejt vdekjes. Unë të kam bërë kurban për djalin e dashur të Abdullahut.'"* Aliu i thoshte: *"O babai im! Nuk ta thashë nga frika e vdekjes në rrugën e Muhammedit, por doja që ta dije se sa shumë të bindem ty dhe të të shfaqja gatishmërinë time në krah të Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)"².*

¹ "El Gadijr", vëll. 7, f. 389.

² "El Gadijr", vëll. 7, f. 357 dhe 363.

Ajetet 27 - 28

وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ وَقَفُوا عَلَى النَّارِ فَقَالُوا يَلَيْتَنَا نُرَدُّ وَلَا نُكَذِّبُ بِآيَاتِ
رَبِّنَا وَنَكُونُ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٢٧﴾ بَلْ بَدَأَ هُمْ مَّا كَانُوا تُخْفُونَ مِنْ قَبْلُ
وَلَوْ رُدُّوا لَعَادُوا لِمَا نُهُوا عَنْهُ وَإِنَّهُمْ لَكَاذِبُونَ ﴿٢٨﴾

“Sikur t’i shohësh ata kur të vihen para zjarrit, duke thënë: ‘Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t’i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!’

Po, atyre iu doli sheshit ajo që më parë e fshihnin, por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënë ato që u ishin ndaluar. Vërtet, ata janë gënjeshtarë.”

Komentimi

Zgjim i padobishëm

Në këto dy ajete tregohen disa qëndrime kundërshtuese të politeistëve. Në to trupëzohet një prej skenave të punëve të tyre, me qëllim që ta kuptojnë fundin e dhembshëm që i pret ata, prandaj duhet të zgjohen. Ose, të paktën gjendja e tyre të jetë mësim për të tjerët. Ajeti i parë thotë: **“Sikur t’i shohësh ata kur të vihen para zjarrit...”**

Ata ndodhen në atë gjendje të tmerrshme deri sa thërrasin me zë të lartë: Ah sikur të ktheheshim edhe një herë në dynja që të

ndryshojmë punët tona të këqija, të punojmë për të shpëtuar nga ky dënim i dhembshëm, t'i dëshmojmë shenjat e Zotit tonë dhe të qëndrojmë në krah të besimtarëve. **"....Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t'i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!"**

Ajeti pasardhës e përforcon këtë duke thënë se urimi i tyre nuk është veçse thënie prej thënive të gënjeshtarit. Ata do të thonë ashtu, sepse shohin në atë botë çdo gjë që kishin fshehur prej besimit, qëllimit dhe punëve të këqija. Të gjitha do të jenë të zbuluara. Për këtë ata do të zgjohen përkohësisht dhe kalimthi. **"Po, atyre iu doli sheshit ajo që më parë e fshihnin..."** Ky zgjim nuk është konstant, por ai ndodhi si pasojë e situatës alarmante. Prandaj, edhe sikur të supozojmë të pamundurën dhe ata të kthehen në këtë dynja, do të veprojnë ashtu siç vepruan edhe më parë. **"...por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënin ato që u ishin ndaluar..."** Ata nuk janë të vërtetë në urimet dhe në pretendimet e tyre. **"...Vërtet, ata janë gënjeshtarë."**

Hulumtime

1- Nga thënia **"atyre iu doli sheshit"** duket se ata jo vetëm që fshihnin shumë të vërteta ndaj njerëzve por, ata ua fshihnin edhe vetave të tyre, të cilat në Ditën e Kiametit do t'u shfaqen qartë. Për këtë, nuk mund të habitemi se pse njeriu në shumë raste fsheh shumë gjëra duke i mbuluar në ndërgjegjen dhe natyrën e tij me qëllim që të fitojë një qetësi mashtruese dhe gënjeshtare.

Çështja e mashtrimit të vetes dhe fshehja e të vërtetave është prej çështjeve të cilat shërohen nëpërmjet hulumtimeve të posaçme që

është aktivizimi i ndërgjegjes. Në shumë raste shohim se ata që pasojnë egon e tyre e kuptojnë dëmin, por për të vazhduar atë vepër ata përpiqen që me çdo lloj mënyre t'i fshehin të vërtetat.

2- Mund të thuhet që urimi nuk është prej çështjeve që përmban vërtetësi apo gënjeshtëri. Urimi është si “inshau” (dëshirë), në të cilën nuk mund të supozohet as gënjeshtria e as e vërteta. Mirëpo, kjo nuk është thënie e drejtë sepse “inshaun”, në të shumtën e rasteve, e shoqërojnë informacionet në të cilat supozohet e vërteta dhe gënjeshtria. Një njeri mund të thotë: “Sikur të më jepte All'llahu pasuri që të ndihmoja...” Edhe kjo pa dyshim është urim. Kjo thënie ka kuptimin e informacionit në të cilin mund të supozohet e vërteta dhe gënjeshtria. Nëse ti e di që ky njeri është koprac, pa dyshim e di që ky është gënjeshtar.

3- Shkaku i përmendjes së thënies në ajet ‘sikur të ktheheshin në këtë dynja do të përsërisnin punët e tyre të mëparshme’, është sepse shumica e njerëzve kur shohin me sytë e veta rezultatit e punëve të tyre, i mohojnë ato që vepruan dhe pendohen menjëherë duke uruar që t'u jepej mundësia e kompensimit. Mirëpo, ky është një urim i paparashikur, i cili vjen si pasojë e të parit drejtpërdrejt të asaj që u veprua dhe të asaj që i pret prej ndëshkimit dhe dënimit të rëndë. Sapo njeriu largohet nga ajo skenë, ai kthehet ashtu siç ishte më parë. Gjendja e tij është e njëjtë me atë të idhujtarëve, të cilët i sulmonte një furtunë e fuqishme dhe e shihnin se po zhdukeshin. Ata harruan çdo gjë, përveç All'llahut. Por, sa qetësohej situata dhe kalonin në bregun e sigurisë, çdo gjë kthehej si më parë. Siç thuhet në suren “Junus”, ajet 22: **“E kur All'llahu i shpëton ata, ata përnjëherë, pa kurrfarë të drejte, bëjnë turbullira në Tokë...”**

4- Duhet përmendur se kjo gjendje ishte për një grup idhujtarësh për të cilët flasin ajetet e mëparshme dhe jo për të gjithë idhujtarët. Prandaj, Profeti duhet ta vazhdonte këshillimin e të tjerëve me qëllim që të zgjoheshin e të udhëzoheshin.

Ajetet 29 - 32

وَقَالُوا إِن هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا وَمَا نَحْنُ بِمَبْعُوثِينَ ﴿٢٩﴾ وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الْوُقُوفُ عَلَىٰ رَبِّهِمْ ۚ قَالَ أَلَيْسَ هَذَا بِالْحَقِّ ۚ قَالُوا بَلَىٰ وَرَبِّنَا ۚ قَالَ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿٣٠﴾ قَدْ خَسِرَ الَّذِينَ كَذَبُوا بِلِقَاءِ اللَّهِ ۖ حَتَّىٰ إِذَا جَاءَتْهُمْ السَّاعَةُ بَغْتَةً قَالُوا يَحْسِرْتَنَّا عَلَىٰ مَا فَرَطْنَا فِيهَا وَهُمْ يَحْمِلُونَ أَوْزَارَهُمْ عَلَىٰ ظُهُورِهِمْ ۚ أَلَا سَاءَ مَا يَزُرُونَ ﴿٣١﴾ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا لَعِبٌ وَلَهُمْ ۖ وَلِلدَّارِ الْآخِرَةِ خَيْرٌ لِلَّذِينَ يَتَّقُونَ ۖ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿٣٢﴾

“Ata thonin: ‘S’ka tjetër, përveç jetës në këtë botë dhe ne nuk do të ringjallemi.”

“Ah, sikur t’i shohësh ata kur të dalin para Zotit! Ai do t’u thotë: ‘A nuk është e vërtetë kjo?’ Ata do të përgjigjen: ‘Po, është e vërtetë, për Zotin tonë!’ All’llahu do t’u thotë: ‘E pra, tani shijoni dënimin, sepse nuk besuat!’

“Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me All’llahun! Kur Ora (e Kiametit) t’u vijë papritur, ata do të

thërrasin: ‘Të mjerët ne, sa shumë që e kemi neglizhuar (Kiametin) në jetën e Tokës!’ dhe do të bartin gjynahet e veta mbi shpinat e tyre. Eh, sa e shëmtuar është ajo barrë!”

“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse Bota Tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen All’lilaut. Pra, a nuk po mendoni?”

Komentimi

Për komentin e ajetit të parë ka dy alternativa

Alternativa e parë: Ajeti është thënie e politeistëve kokëfortë e të pabindur, të cilët kur shohin tmerrin e Ditës së Kiametit, urojnë të kthehen në dynja që të veprojnë ato punë të mira që nuk kishin vepruar. Mirëpo, Kur’ani thotë se ata, edhe po të kthehen, nuk do t’i drejtohen punëve të mira, por do të vazhdojnë ashtu siç ishin ndoshta edhe më shumë, sepse ata do ta mohonin Ditën e Kiametit. **“Ata thonin: ‘S’ka tjetër, përveç jetës në këtë botë dhe ne nuk do të ringjallemi.”**

Alternativa e dytë: Ajeti fillon me fjalë të reja që i përkasin një grupi politeistësh, të cilët e mohuan plotësisht Ringjalljen. Në mesin e idhujtarëve arabë ishte një grup që nuk besonte në Ringjallje dhe një grup tjetër që besonte në një lloj Ringjalljeje.

Ajeti pasardhës tregon për fundin e tyre në Ditën e Kiametit, ditën kur do të dalin para All'llahut të Madhëruar. Ajeti thotë: **“Ah, sikur t’i shohësh ata kur të dalin para Zotit! Ai do t’u thotë: ‘A nuk është e vërtetë kjo...?’** Ata do të përgjigjen duke u betuar: **“...Ata do të përgjigjen: ‘Po, është e vërtetë, për Zotin tonë!’”** Pas kësaj: **“...All’llahu do t’u thotë: ‘E pra, tani shijoni dënimin, sepse nuk besuat.’”**

S’ka dyshim se qëndrimi para All’llahut nuk ka kuptimin se Ai ka vend, por kuptimi është për të qëndruarit në fushën e llogarisë, siç thonë disa komentues. Ose është thënie me kuptim figurativ, njësoj siç thuhet për një njeri që fal namazin, se ai është para All’llahut dhe në prani të Tij.

Ajeti vijues tregon për humbjen e atyre të cilët mohojnë Ringjalljen. Ai thotë: **“Sigurisht që janë të humbur ata që mohojnë takimin me All’llahun...”**

Pastaj ajeti sqaron se ky mohim do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit, kur papritur do t’i shohin vetat e tyre para pamjes tmerruese. Ata do ta shohin me sytë e tyre rezultatin e punëve të veta e më pas do të fillojnë britmat e pendimit për ato që nuk vepruan për këtë Ditë. **“...Kur Ora (e Kiametit) t’u vijë papritur, ata do të thërrasin: ‘Të mjerët ne, sa shumë që e kemi neglizhuar (Kiametin) në jetën e Tokës...’”**

Kuptimi i fjalës *“es saatu”* që përmendet në ajet, ka kuptimin e Ditës së Kiametit. Fjala *“bagtaten”* do të thotë *papritur*, sepse ndodhinë e Ditës së Kiametit nuk e di askush përveç All’llahut të Madhëruar. Shkaku i quajtjes së Ditës së Kiametit me emrin *“es saatu”* është ose për shkak të shpejtësisë së llogaritjes së

njerëzve në atë Ditë, ose për të treguar befasinë e ndodhisë së saj, ku njerëzit do të kalojnë me shpejtësi të madhe nga bota e Barzakhut në Botën e Ahiretit.

Fjala *“et jehassur”* ka kuptimin e keqardhjes së madhe e mjeruese për diçka. Kur arabët shqetësoheshin shumë, thonin: *“ja hasretah”* (Të mjerët ne!). Me këtë thënie duket sikur e kishin të trupëzuar mjerimin para tyre.

Më pas Kur'ani thotë: **“...dhe do të bartin gjynahet e veta mbi shpinat e tyre...”**

Fjala *“euzaar”* është shumësi i fjalës *“uizrun”* dhe ka kuptimin e barrës së rëndë. Këtu ka kuptimin e gjynaheve. Ky ajet mund të merret si argument për trupëzimin e veprave, sepse ai thotë që ata do të bartin gjynahet e tyre mbi shpinat e veta. Po ashtu, mund të jetë përdorim figurativ për mbajtjen e përgjegjësisë, sepse përgjegjësitë ngjasojnë me barrën e rëndë.

Në fund All'illahu thotë: **“...Eh, sa e shëmtuar është ajo barrë!”**

Ky ajet flet për humbjen e atyre që mohojnë Ringjalljen dhe arsyeja e humbjes është e qartë. Besimi në Ringjallje, përveç se e përgatit njeriun për jetën e lumtur e të përhershme, ai e inkurajon atë që të arrijë përsosurinë në dije e në praktikë. Ky besim ndikon shumë në mbrojtjen e njeriut prej gjynaheve.

Më poshtë, për të sqaruar raportin mes jetës së kësaj dynjaje dhe jetës në Botën Tjetër, All'illahu i Madhëruar thotë: **“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim...”** Ata të cilët u mjaftuan vetëm me këtë jetë dhe nuk kërkojnë asgjë tjetër, janë të ngjashëm

me fëmijët të cilët dëshirojnë ta kalojnë jetën e tyre me lojra dhe zbavitje dhe janë të pavëmendshëm për shumë gjëra.

Ngjasimi i jetës së kësaj dynjaje me lojën dhe argëtimin bazohet në të qëniet e lojës e të zbavitjes prej veprave sipërfaqësore, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me jetën e vërtetë, edhe pse fiton apo humbet lojtari. Kjo sepse, pas lojës dhe zbavitjes, njeriu kthehet në gjendjen e tij të zakonshme.

Në shumë raste i shohim fëmijët duke luajtur me simbole apo emra si: ti je 'prijësi', ti je 'ministri', ti je 'hajduti' etj. Mirëpo, pas një ore lojë, nuk gjendet as prijës, as ministër e as hajdut! Ose siç ndodh në kinema ku shfaqen filma me luftë, me dashuri etj. dhe pas një ore a më shumë, çdo gjë ikën.

Dynjaja i ngjason teatrit, që e luajnë një grup aktorësh. Ka raste që këto teatro tërheqin edhe mendimtarët dhe arsyetuesit tanë. Por, sapo ulen perdet e skenës, çdo gjë mbaron.

Fjala "*leibun*" vjen nga fjala "*el liaab*", e cila është pështyma që grumbullohet në gojë dhe del prej saj.

Në fund ajeti e krahason Jetën Tjetër me jetën e kësaj bote ku thotë: **"...kurse Bota Tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen All'llahut. Pra, a nuk po mendoni?"**

Ajo është bota e vërtetë dhe e përhershme e mbushur me mirësi. Mirëpo, dallimin mes mashtrimeve të kësaj bote dhe të vërtetave të Botës Tjetër nuk e kuptojnë vetëm mendimtarët, të cilët logjikojnë, arsyetojnë dhe mendojnë thellë.

Hisham ibn Hakem ka transmetuar nga Imam Musa ibn Xha'fer, se ka thënë: *"O Hisham! Vërtet All'llahu i porosit mendimtarët dhe i ka bërë ta dëshirojnë Ahiretin. Pastaj lexoi ajetin: 'Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse Bota Tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen All'llahut. Pra, a nuk po mendoni?'"*¹

Qëllimi i këtyre ajeteve është luftimi i dhënies pas botës materiale dhe harresa e qëllimit të fundit. Ata, të cilët e marrin dynjanë si mjeti për të arritur lumturinë, pa dyshim që kërkojnë Ahiretin dhe jo dynjanë.

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 711. Usulul Kafij, vëll. 1, f. 14.

Ajetet 33 - 34

قَدْ نَعْلَمُ إِنَّهُ لَيَحْزُنُكَ الَّذِي يَقُولُونَ ۖ فَإِنَّهُمْ لَا يُكَذِّبُونَكَ
وَلَكِنَّ الظَّالِمِينَ بَيَّاتِ اللَّهُ تَجْحَدُونَ ﴿٣٣﴾ وَلَقَدْ كَذَّبَتْ رُسُلٌ مِّنْ
قَبْلِكَ فَصَبَرُوا عَلَىٰ مَا كُذِّبُوا وَأُوذُوا حَتَّىٰ أَتَاهُمْ نَصْرُنَا ۚ وَلَا
مُبَدِّلَ لِكَلِمَاتِ اللَّهِ ۚ وَلَقَدْ جَاءَكَ مِنْ نَّبَائِ الْمُرْسَلِينَ ﴿٣٤﴾

“Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e All’llahut.”

“Edhe para teje (o Muhammed), shumë të dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin (që kanë pësuar), derisa u ka ardhur ndihma Jonë, sepse askush nuk mund t’i ndryshojë vendimet e All’llahut. Ti tashmë ke dëgjuar për ata të dërguar.”

Komentimi

Reformatorët gjithmonë përballen me vështirësitë

S’ka dyshim se gjatë diskutimeve logjike dhe dialogjeve ideologjike të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me politeistët kokëfortë e të pabindur, ai përballej me kokëfortësinë dhe ashpërsinë e tyre, madje ata e akuzonin atë.

Për këtë Profeti ndiente zemërim dhe shqetësim. Në shumë vende në Kur'an All'Ilahu e ngushëllon Profetin dhe e urdhëron për durim ndaj këtyre veprimeve të politeistëve dhe jobesimtarëve kokëfortë e të pabindur me qëllim që të vazhdojë rrugëtimin e tij me zemër, me shpirt të fortë dhe me vendosmëri më të madhe. Ajeti i parë thotë: **“Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata...”** Dije se ata nuk të mohojnë ty, por mohojnë argumentet dhe shenjat e All'Ilahut; nuk të përgënjeshtrojnë ty, por përgënjeshtrojnë All'Ilahun, siç thotë edhe vazhdimi i ajetit: **“...Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e All'Ilahut.”**

E njëjta thënie është e përhapur edhe në mesin tonë. Ka raste kur thuhet: “Ajo që të thanë ty, ishte për mua. Nëse ndodh ndonjë problem, unë jam qëllimi e tij e jo ti.” Me këtë përpiket ta ngushëllojë shokun e tij dhe t'i përcjellë lehtësim.

Disa komentues mendojnë për një komentim tjetër të ajetit, por e jashtëmja e tij është ai që ne përmendëm. Nuk është problem që thjesht për njohje ta përmendim mendimin e tyre që thotë se kuptimi i ajetit është ky: Ata që të kundërshtuan ty, në të vërtetë, ata janë besimtarë në sinjeritetin tënd dhe nuk dyshojnë në thirrjen tënde. Mirëpo, frika se interesat e tyre mund të kanosen me rrezik, i pengon ata që të përqafojnë të vërtetën. Ose mund të jetë fanatizmi verbues dhe kokëfortësia ajo që i pengon ata që të dorëzohen para së vërtetës.

Nga librat e historisë sqarohet se injorantët - në mesin e tyre edhe kundërshtarët më të ashpër të mesazhit - në brendinë e tyre e besonin të vërtetën e thirrjes. Në ato libra përmendet se një ditë, Profeti u takua me Ebu Xhehlin. Ebu Xhelhi i dha dorën. Atë

e pyetën përse e bëri këtë. Ai u tha: *“Betohem në All’llahun! Unë e di që ai është i singertë dhe i vërtetë në thënie, por ne nuk kemi qenë ndjekës të Ebu Menafit.”* (Që do të thotë se pranimi i thirrjes së tij nga ana jonë do të na detyrojë të ndjekim fisin e tij.)¹

Në librat e historisë është përcjellë se Ebu Xhehli shkante natën fshehurazi për të dëgjuar leximin e Kur’anit nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në të njëjtën kohë, shkojnë Ebu Sufjani dhe Ekhnes ibn Shurejk. Askush nuk e dinte praninë e njëri-tjetrit. Ata e dëgjuan leximin e Kur’anit deri në sabah. Kur zbardhi mëngjesi, u larguan dhe i bashkoi e njëjta rrugë. Ata i treguan njëri-tjetrit se pse kishin ardhur. Pastaj u betuan se nuk do të ktheheshin më për të dëgjuar, sepse kishin frikë nga të rinjtë e kurejshitëve, se po ta merrnin vesh, do të ndodhte konflikt. Kur erdhi nata e dytë, secili nga ata shkoi për të dëgjuar, duke menduar se të tjerët nuk do të shkonin për shkak të betimit. Kur zbardhi mëngjesi, ata i bashkoi rruga dhe kur u takuan, qortuan njëri-tjetrin. Kur erdhi nata e tretë, ata shkuan përsëri. Kur zbardhi mëngjesi, u betuan që të mos shkonin dhe u ndanë. Kur u zgjua në mëngjes Ekhnes ibn Shurejk, mori shkopin e tij, doli nga shtëpia dhe shkoi te Ebu Sufjani. Ai i tha: *“Më thuaj, o babai i Handhales: Çfarë mendimi ke për atë që dëgjove tek Muhammedi?”* Ebu Sufjani i tha: *“O babai i Tha’lebetu! Betohem në All’llahun se unë dëgjova gjëra dhe i njoh ato dhe ia di kuptimin. Dëgjova edhe gjëra të tjera që as nuk i njoh dhe as nuk ia di kuptimin.”*

Ekhnesi tha: *“Edhe unë betohem në atë që u betove, gjithashtu!”*

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 42.

Pastaj doli nga Ebu Sufjani dhe shkoi tek shtëpia e Ebu Xhehlit dhe i tha: *"O babai i Hakemit: Çfarë mendimi ke për atë që dëgjove tek Muhammedi?"*

Ai iu përgjigj: *"Çfarë dëgjova? Ne dhe fisi Abdul Menaf jemi konfliktuar për nderin. Ata ushqyen edhe ne ushqyem. Ata i dhanë njerëzve kafshë edhe ne u dhamë. Ata dhanë edhe ne dhamë." Ata thanë: "Prej nesh do të vijë i dërguar dhe do t'i vijë shpallje nga qielli. Kur do ta kuptojmë ne këtë? Betohem, se kurrë nuk do t'i besojmë atij dhe as nuk do ta pohojmë!" Atëherë El Ekhnes u ngrit dhe u largua.¹*

Është transmetuar se Ekhnes ibn Shurejk një ditë u takua me Ebu Xhehlin dhe i tha: *"O babai i Hakemit! Më fol për Muhammedin, a është i vërtetë apo është gënjeshtar? Këtu nuk ndodhet dikush tjetër përveç meje dhe teje dhe nuk na dëgjon askush." Ebu Xheli i tha: "I mjeri ti! S'ka dyshim se Muhammedi është i vërtetë dhe kurrë nuk ka gënjyer. Mirëpo nëse Beni Kusij merr flamurin, detyrën e shërbetorit, dhënien ujë haxhilerëve, këshillimin dhe profetësinë, atëherë çfarë i mbeten kurejshitëve të tjerë?!"²*

Nga këto thënie, e me të ngjashme me to, sqarohet se shumë prej kundërshtarëve më të ashpër të Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në brendinë e tyre e pohonin të vërtetën e thënieve të tij. Por gara fisnore, e të tjera çështje, nuk i lejonte që ta shfaqnin atë që besonin. Ose mund të thuhet se nuk kishin guximin ta bënin.

¹ Tefsiri "El Mijzan"; vëll. 13, f. 125.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 42.

Ne e dimë se ky besim i brendshëm, nëse nuk është i shoqëruar me nënshtrim dhe zbatim, nuk ka asnjë ndikim dhe nuk e fut njeriun në rreshtin e besimtarëve të vërtetë.

Ajeti i dytë vazhdon me ngushëllimin e Profetit, duke i sqaruar gjendjen e Profetëve të mëparshëm dhe i përforcon atij se nuk është i vetëm, sepse edhe Profetët paraardhës janë ofenduar, janë kundërshtuar, janë mohuar dhe janë akuzuar nga populli i tyre. Ajeti thotë: **“Edhe para teje, shumë të Dërguar janë mohuar...”** Mirëpo, ata duruan dhe i përballuan të gjitha këto dhe dolën fitimtarë me ndihmën e All’llahut: **“...por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin (që kanë pësuar), derisa u ka ardhur ndihma Jonë...”** Ky është vendim i All’llahut: **“...sepse askush nuk mund t’i ndryshojë vendimet e All’llahut...”** Prandaj, mos u zemëro dhe mos u frikëso kur populli yt të përgënjeshtrohet dhe të bën keq, por duro përballë kokëfortësisë dhe të keqes së kundërshtarëve! Dije se bazuar në këtë vendim të All’llahut, mirësitë e vazhdueshme të Tij do të jenë me ty dhe në fund ti do të triumfosh mbi të gjithë ata. Ato lajme që të kanë ardhur prej të Dërguarve të mëparshëm së bashku me përballjet e tyre, me vështirësitë dhe ashpërsitë, për durimin, për qëndrueshmërinë dhe për triumfin e tyre, ato janë dëshmi të qarta për ty. **“...Ti tashmë ke dëgjuar për ata të Dërguar.”**

Ky ajet tregon për një parim të përgjithshëm që është: Udhëheqësit punëdrejtë të shoqërisë, të cilët përpiqen për udhëzimin e njerëzve nëpërmjet thirrjes në vlera dhe mësim të dobishme dhe që luftojnë mendimet e këqija e të devijuara, ata përballen me kundërshtime të ashpra nga grupe provokuese, të cilët mendojnë se përhapja e atyre mësimëve dhe e vlerave të larta

janë të rrezikshme dhe kërcënojnë interesat e tyre. Këta përdorin të gjitha mjetet për përhapjen e qëllimeve të tyre shkatërruese si: akuzat, gënjeshttrat, lëndimet, torturat, vjedhjet, grabitjet e deri edhe vrasjet. Pra, përdorin çdo armë për t'i luftuar punëdrejtët dhe reformatorët.

Mirëpo, e vërteta, me gjithë fuqinë tërheqëse që ka, bazuar në ligjin e krijimit, ajo bën punën e saj dhe e pastron rrugën prej atyre gjembave. Kusht për këtë triumf është durimi dhe palëkundshmëria.

Ky ajet i përshkruan ligjet me fjalën “*kelimetull'llahu*”, sepse të folurit dhe fjala ndikojnë ndjeshëm në të dy shqisat: të dëgjuarit dhe të shikuarit, sepse folësi dhe të folurit ndikojnë thellë në shqisën e të dëgjuarit dhe të shikuarit. Të folurit perceptohet nga të dëgjuarit dhe ai që flet perceptohet me anë të shikuarit. *Kelemtuhu* do të thotë: e plagosa me një plagë, ku u duk ndikimi i saj. Më pas termi “*fjalë*” është zgjeruar në përdorimin shprehimor dhe kuptues e deri edhe në besim, sjellje, traditë dhe mësim.

Ajetet 35 - 36

وَإِنْ كَانَ كَبُرَ عَلَيْكَ إِعْرَاضُهُمْ فَإِنْ أُسْتَطِعْتَ أَنْ تَبْتَغِيَ نَفَقًا فِي
الْأَرْضِ أَوْ سُلَّمًا فِي السَّمَاءِ فَتَأْتِيَهُمْ بِآيَةٍ ۚ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَمَعَهُمْ
عَلَى الْهُدَى ۚ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْجَاهِلِينَ ﴿٣٥﴾ إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ
الَّذِينَ يَسْمَعُونَ وَالْمَوْتَى يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ ثُمَّ إِلَيْهِ يُرْجَعُونَ ﴿٣٦﴾

“Nëse ty të duket e rëndë për t’u mbajtur përbuzja e tyre, atëherë kërk - nëse mundesh - një zgavër në tokë ose shkallë në qiell, që t’u sjellësh atyre një mrekulli! Sikur All’Ilahu të donte, do t’i kishte mbledhur ata në rrugë të mbarë, prandaj mos u bëj nga ata që nuk e dinë këtë!’ Do të të përgjigjen vetëm ata që dëgjojnë. Sa për të vdekurit, All’Ilahu do t’i ngjallë ata, pastaj të gjithë do të kthehen tek Ai.”

Komentimi

Këto dy ajete vazhdojnë ngushëllimin e të Dërguarit të All’Ilahut, që nis që në ajetet e mëparshme. I Dërguari i All’Ilahut ndihej shumë i mërzhitur nga humbja e politeistëve dhe dëshironte t’i udhëzonte të gjithë ata në rrugën e besimit me çdo lloj mënyre të mundshme. All’Ilahu i Madhëruar thotë: “Nëse ty

të duket e rëndë për t'u mbajtur përbuzja e tyre, atëherë kërko - nëse mundesh - një zgavër në tokë ose shkallë në qiell, që t'u sjellësh atyre një mrekulli!"¹ Kjo do të thotë: kundërshtimi i politeistëve të mundon dhe është i vështirë për ty; atëherë, nëse mundesh, çaje tokën në thellësi të saj ose vendos shkallë që të të çojnë në qiell për të kërkuar një mrekulli, por dije se edhe nëse e bën, ata nuk do të të besojnë ty.

Fjala "*en nefek*" do të thotë "*eth thakab*", që ka kuptimin e rrugës depërtuese nën tokë. Prej saj rrjedh edhe fjala "*en nifak*" (hipokrizi), që do të thotë: hyrje në fe nga një portë dhe dalje nga një portë tjetër. Edhe hipokriti ka dy sjellje: një të dukshme dhe një të padukshme.

Në këtë ajet, All'llahu e lajmëron të Dërguarin e Tij: Në mësimet e tua, në thirrjen tënde dhe në përpjekjet e tua nuk ka asnjë mangësi e asnjë të metë; përkundrazi, mangësia dhe e meta gjendet tek ata, sepse nuk e pranojnë të vërtetën. Çfarëdolloj përpjekjeje nga ana jote, kurrë nuk do të ndikojë tek ata, prandaj mos u shqetëso.

Mirëpo, me qëllim që askush të mos mendojë se All'llahu është i pafuqishëm në bërjen e tyre që të dorëzohen e të nënshtrohen, ajeti thotë: **"Sikur All'llahu të donte, do t'i kishte mbledhur ata në rrugë të mbarë..."** Pra, sikur të donte All'llahu do t'i kishte bërë ata të dorëzoheshin para thirrjes tënde dhe para besimit në All'llahun. Porse, besimi i imponuar është i refuzuar,

¹ Fjalja "*in isteta'te...*" (nëse mundesh) është fjali kushtore dhe përgjigjja e saj është aluduese. Aludimi i saj është: nëse mundesh, bëje, por ata nuk do të të besojnë.

sepse krijimi i njeriut për t'u përsosur bazohet në liri, zgjedhje me dëshirë. Dallimi i besimtarit nga jobesimtari, i punëmiri nga punëkeqi, i të sinqertit nga tradhtari, i të vërtetit nga gënjeshtari, arrihet vetëm në gjendjen e zgjedhjes së lirë. Kurse në gjendjen e besimit të imponuar, kurrë nuk gjendet ndryshim mes të mirit dhe të keqit. Kur ka imponim, të gjitha njohuritë e mira e humbasin plotësisht kuptimin e tyre.

Më pas, All'llahu i Madhëruar thotë: **"...prandaj mos u bëj nga ata që nuk e dinë këtë."** Pra, mos e humb durimin tënd, mos u brengos dhe mos u shqetëso për shkak të mosbesimit dhe politeizmit të tyre! Nuk ka dyshim se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dinte këto të vërteta, por All'llahu ia përmend atij këto për qetësim, njësoj siç i themi atij që humbet fëmijën e tij: Mos u mërzit se dynjaja është e zhdukshme dhe të gjithë ne do të vdesim! Ti je akoma i ri dhe do të begatohesh me një fëmijë tjetër, prandaj mos u hidhëro shumë! S'ka dyshim se paqëndrueshmëria e kësaj dynjaje apo të qenit e atij që ka humbur fëmijën i ri, nuk janë të panjohura tek ai, por i thuhet për përmendje e kujtesë.

Edhe pse ky ajet është prej ajeteve që mohojnë detyrimin dhe imponimin, disa komentues, si Raziu, e konsiderojnë si argument për detyrimin dhe imponimin, duke u bazuar te thënia **"Sikur të donte..."** Raziu thotë: "Nga ky ajet sqarohet se All'llahu nuk do që jobesimtarët të besojnë!" Mirëpo, ai është i pavëmendshëm se dëshira dhe vullneti në këtë ajet janë të detyrueshme, që do të thotë se All'llahu nuk do që njerëzit të besojnë me detyrim e me imponim, por do që ata të besojnë me zgjedhje të lirë dhe me dëshirën e vullnetin e tyre. Kështu që, ky

ajet është argument i prerë që hedh poshtë thënien e atyre që besojnë në detyrim e në imponim.

Ajeti pasardhës është plotësues i ajetit paraardhës dhe i thënieve të tij. Në të ka akoma më shumë ngushëllim për Profetin (*Pajja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajeti thotë: **“Do të të përgjigjen vetëm ata që dëgjojnë...”**

Në të vërtetë, ata janë të ngjashëm me të vdekurit, sepse nuk do të besojnë derisa t'i ringjallë All'Ilahu në Ditën e Kiametit: **“...Sa për të vdekurit, All'Ilahu do t'i ngjallë ata, pastaj të gjithë do të kthehen tek Ai.”¹**

Atë ditë, kur të shohin skenat e Ditës së Kiametit, do të besojnë, mirëpo ai besim i tyre nuk i sjell asnjë dobi, sepse ai është një besimi i detyruar për shkak të pamjeve trishtuese të asaj dite.

Prej thënieve të pëlqyeshme është se fjala “*el meutaa*” (të vdekurit), që gjendet në këtë ajet, nuk tregon për vdekjen trupore të njerëzve, por tregon për vdekjen shpirtërore sepse jeta dhe vdekja janë dy llojesh: jetë dhe vdekje organike (materiale) dhe jetë dhe vdekje shpirtërore. Po ashtu, edhe të dëgjuarit dhe të shikuarit, ato janë organikë (materiale) dhe shpirtërorë. Të shumta janë rastet, në të cilat, i cilësojmë ata që dëgjojnë dhe që shikojnë si të verbër, por që nuk i kuptojnë të vërtetat, se ata janë

¹ Nga ana sintaksore (e gjuhës arabe), fjala “*el meutaa*” (të vdekurit) është kryefjala, kurse fraza “*jeb'athhumullah*” (All'Ilahu do t'i ngjallë ata) është kallzuesi. Kuptimi është: gjendja e tyre nuk ndryshon derisa t'i ringjallë All'Ilahu në Ditën e Kiametit dhe të shohin të vërtetat.

të verbër, të shurdhët, deri edhe të vdekur. Reagimet që ndodhin tek njerëzit që i shohin dhe i dëgjojnë të vërtetat, nuk ndodhin tek ata të tjerët.

Të tilla shprehje në Kur'an janë të shumta. Ato janë të këndshme dhe kanë një terheqje të posaçëm. Madje, Kur'ani nuk interesohet shumë për jetën materiale e biologjike që përfaqësohet me të ngrënit, të fjeturit dhe të frymëmarrjes. Ai interesohet më shumë për jetën shpirtërore të njerëzve, e cila përfaqësohet me mbajtjen e përgjegjësisë dhe me kryerjen e detyrave, me ndjeshmërinë dhe vëmendshmërinë.

Gjithashtu, duhet thënë se verbëria, shurdhëria dhe vdekshmëria burojnë tek vetja e njeriut, sepse për shkak të vazhdimësisë së tij në gjynahe dhe këmbëgjuljes së tij në to, ai arrin në atë gjendje.

Ai që i mbyll sytë për një kohë të gjatë, arrin deri në atë gjendje, sa të humbasë fuqinë e të shikuarit dhe mund të arrijë në verbëri të plotë. Po ashtu, edhe ai që e mbyll syrin e shpirtit nga të parët e të vërtetave për një kohë të gjatë, e humbet, pak e nga pak, shikimin me sytë e shpirtit.

Ajeti 37

وَقَالُوا لَوْلَا نُزِّلَ عَلَيْهِ آيَةٌ مِّن رَّبِّهِ ۚ قُلْ إِنِّ اللَّهَ قَادِرٌ عَلَىٰ
 أَن يُنْزِلَ آيَةً وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٧﴾

“Ata thonë: ‘Ah! Pse nuk ia zbret atij ndonjë mrekulli Zoti i tij?’ Thuaj: ‘All’llahu është i Fuqishëm të dërgojë mrekulli, por shumica e tyre nuk e dinë.’”

Komentimi

Ky ajet tregon për një prej justifikimeve, me të cilin justifikohen politeistët. Në disa hadithe thuhet se kur disa kryetarë kurejshitë ishin të paafte të përballeshin me Kur'anin dhe nuk mund ta kundërshtonin, i thanë të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “E gjitha kjo që thua nuk ka asnjë dobi. Nëse je i vërtetë për ato që thua, na sill mrekullira si shkopi i Musait, deveja e Salihut.”¹ Për këtë, Kur’ani thotë: “**Ata thonë: ‘Ah! Pse nuk ia zbret atij ndonjë mrekulli Zoti i tij?’**”

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 46.

Është e qartë se ata nuk ishin seriozë në kërkimet që bënin për të vërtetën, sepse i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u solli atyre mrekulli të mjaftueshme. Madje, nëse nuk do t'u sillte mrekulli të tjera veçse Kur'anit, i cili i sfidoi ata në disa ajete dhe i ftoi ata shumë qartë që të sjellin të ngjashëm me të (Kur'anin) e ata nuk arritën ta bënin, ai do të mjaftonte për vërtetimin e profetësisë së tij. Mirëpo ata falsifikatorë kërkonin justifikim që nga njëra anë, të ofendonin Kur'anin dhe nga ana tjetër, të largoheshin nga pranimit i thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Prandaj, ata nuk ndalonin së kërkuari mrekulli. Edhe sikur i Dërguari i All'llahut t'i përgjigjej kërkesave të tyre, ata do të mohonin gjithçka duke thënë: **“Kjo është magji e qartë.”**¹ Për këtë, All'llahu e urdhëron të Dërguarin e Tij (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“...Thuaj: ‘All'llahu është i Fuqishëm të dërgojë mrekulli...’”**, mirëpo në këtë gjendet një çështje ndaj së cilës ju jeni të pavëmendshëm, se nëse All'llahu do t'i realizonte kërkesat tuaja që burojnë nga kokëfortësia juaj, e pastaj përsëri do të mbeten kokëfortë e nuk do të besoni pasi t'i shihni mrekullitë, atëherë dënimi i All'llahut do të bjerë mbi ju të gjithë dhe do të zhdukeni, sepse ai do të jetë fundi i talljes dhe i përçmimit tuaj që i bënit All'llahut, të Dërguarit të Tij, shenjave,

¹ Sure “Neml”, ajeti 13; sure “Ahkaf”, ajeti 7; sure “Saf”, ajeti 6.

argumenteve dhe mrekullive të Tij. Për këtë, ajeti përfundon me thënien: **“...por shumica e tyre nuk e dinë.”**

Paqartësi: Në komentimin “Mexhaul Bejjan” thuhet se disa kundërshtues të Islamit, para disa shekujsh, e kanë marrë këtë ajet si argument, në të cilin bazojnë thënien se Profeti nuk ka patur asnjë mrekulli, sepse sa herë që ata kërkonin prej tij një mrekulli, ai mjaftohej me thënien: *“All’llahu është i Potfuqishëm për këtë, por shumica juaj nuk e dinë.”*¹ Këtë metodologji kanë përdorur edhe sot disa shkrimtarë, të cilët e kanë ringjallur këtë ide të vjetëruar e të pavlerë.

Përgjigjja:

Së pari: Dihet se ata nuk e kanë thelluar mendimin në ajetet paraardhëse dhe pasardhëse të këtij ajeti, përndryshe do të kuptonin se fjalët kanë të bëjnë me kokëfortët, të cilët asnjëherë nuk dorëzohen para së vërtetës e së drejtës. Është qëndrimi i tyre që e pengoi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t’i përgjigjet kërkesës së tyre. A thuhet në Kur’an se kërkuessit e së vërtetës i kanë kërkuar Profetit që t’u realizojë atyre një mrekulli dhe ai ka refuzuar? Ajeti 111 i kësaj sureje flet për këta kokëfortë e të pabindur ku thotë: **“Edhe sikur t’u dërgonim atyre melekët, t’i bënim të vdekurit t’u flisnin atyre dhe t’i tubonin të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin...”**

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, 47.

Së dyti: Nga transmetimet e ardhura përfitohet se kjo kërkesë ishte nga ana e kryetarëve kurejshitë dhe qëllimi i tyre me atë kërkesë ishte ofendimi i Kur'anit dhe kundërshtimi i tij. Është e natyrshme që i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të mos i përgjigjej kërkesës me këtë qëllim.

Së treti: Vërtet, autorët e këtij keqkuptimi janë të pavëmendshëm ndaj ajeteve të tjera, të cilat flasin qartë se vetë Kur'ani është mrekulli e përjetshme. Ato ajete shumë herë i kanë ftuar kundërshtarët për ballafaqim dhe kanë konstatuar dobësinë dhe paaftësinë e tyre për ballafaqim. Ata kanë harruar ajetin e parë në suren "Isra", i cili thotë qartë: **"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhammedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona!"** dhe ky udhëtim u krye brenda një nate të vetme.

Së katërti: Është jashtë logjike që Kur'ani të jetë i mbushur me përmendjen e mrekullive të Profetëve të mëparshëm dhe me thënie se Profeti Muhammed është vula e Profetëve, më i larti i tyre në pozitë; feja e tij është më e plota e feve dhe më e përkryera, pastaj sprapsja nga shfaqja e mrekullisë si përgjigje për kërkuesit e së vërtetës e të së drejtës. A nuk është kjo një paqartësi në thirrjen e tij sipas pikëpamjes së kërkuesve të së vërtetës?

Nëse ai nuk ka patur asnjë mrekulli, atëherë nuk duhet të përmendte mrekullitë e të DDërguarve të tjerë me qëllim që të vazhdonte planet e tij dhe të mbyllte rrugët e kundërshtimit e të kritikës. Mirëpo, ai nuk jetoi të fliste për mrekullitë e të tjerëve, si të Musait, Isait (birit të Merjemes), Ibrahimit, Salihut dhe Nuhut (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ky është tregues i qartë në besimin e tij te mrekullitë e veta. Vërtet, librat e historisë islame, hadithet e konsiderueshme e të sakta dhe libri “Nehxhul Belaga” përmendin mjaft mrekulli të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ajeti 38

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا طَيْرٍ يَطِيرُ بِجَنَاحَيْهِ إِلَّا أُمَمٌ أَمْثَالُكُمْ ۚ مَا
فَرَّطْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ ۚ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ يُحْشَرُونَ ﴿٣٨﴾

“Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju. Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë. Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.”

Komentimi

Për shkak të hulumtimit të gjerë rreth këtij ajeti, do të fillojmë me sqarimin e frazave të tij, pastaj do t'i komentojmë në formë të përgjithshme.

Fjala “*ed dabetu*” vjen nga fjala “*debbe*” (ecje e lehtë). Kjo përdoret më shumë për kafshët dhe insektet.¹ Kjo fjalë përdoret edhe për thashethemexhiun. Në një hadith thuhet: “Nuk hyn në Xhennet thashethemexhiu (dejjubun)”.²

Fjala “*et tairu*” përdoret për çdo shpend me dy krahë që fluturon në hapësirë. Me këtë fjalë mund të përshkruhen disa

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 47.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 47.

çështje shpirtërore, të cilat zhvillohen shpejt dhe me hov. Ajeti ka për qëllim shpendët që fluturojnë me dy krahë.

Fjala “umemun” është shumësi i fjalës “ummetun”, që është një grup që i bashkon diçka, si feja e përbashkët, koha e përbashkët apo vendi i përbashkët.

Fjala “juhsherune” vjen nga fjala “hashrun” me kuptimin e grumbullimit, të tubimit. Në Kur'an ka kuptimin e Ditës së Kiametit, sepse Kur'ani thotë: “...tek Zoti i tyre”.

Ky ajet, ashtu si ajetet e mëparshme, fillon me fjalë për politeistët dhe me paralajmërimin e tyre për fundin që do të kenë në Ditën e Kiametit. Ai flet për tubimin dhe Ringjalljen e përgjithshme, e cila përfshin të gjitha qëniet e gjalla. Në fillim, ajeti thotë: **“Të gjitha kafshët në Tokë e të gjithë shpendët që fluturojnë me krahët e veta, janë në bashkësi të ngjashme me ju...”** Nga kjo sqarohet se llojet e kafshëve dhe të shpendëve janë bashkësi njësoj si njerëzit. Mirëpo, komentuesit kanë thënie të ndryshme rreth ngjashmërisë në këtë shembull. Disa thonë se ngjashmëria është e veçantë me sekretet e krijimit të tyre të habitshëm, i cili tregon madhështinë e Krijuesit të Madhëruar.

Disa të tjerë thonë se ngjashmëria është në nevojat e tyre të ndryshme jetike dhe në mënyrat e përmbushjes së atyre nevojave. Ka prej atyre që mendojnë se ngjashmëria qëndron në ngjashmërinë perceptuese, në kuptim dhe në ndjenja. Kjo do të thotë se kafshët dhe shpendët, gjithashtu, kanë perceptim dhe ndjenja të posaçme në botën e tyre. Bota e tyre e njeh All'Ilahun,

e lartëson atë, e shenjtëron sipas aftësisë dhe mundësisë, edhe pse fuqia perceptuese e tyre është më e dobët se fuqia që gjendet tek njeriu. Fundi i ajetit, siç do të shihet, e miraton këtë mendim të fundit.

Pastaj ajeti thotë: **“Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë...”** Ka mundësi që fjala *libër* të ketë për qëllim Kur’anin, që përmban gjithçka nga ato që kanë lidhje me edukimin e njeriut, me udhëzimin dhe përsosjen e tij dhe i sqaron këto herë në formë të përgjithshme, siç është nxitja për kërkimin e dijes, e herë tjetër i sqaron me detaje, siç janë shumë rregulla islame dhe çështje morale.

Ka edhe një mundësi tjetër që thotë se qëllimi i fjalës *libër* është për botën ekzistuese, sepse bota e krijuar është si një libër gjigand që përmban çdo gjë dhe asgjë nuk e harron. Nuk gjendet asnjë pengesë që ajeti t’i përfshijë të dy komentimet, sepse Kur’ani nuk ka lënë asnjë çështje edukative pa përmendur.

Ajeti përfundon me thënien: **“...Pastaj të gjithë do të tubohen para Zotit të tyre.”**

Me sa duket, përemri “hum” (ata) është për kafshët dhe shpendët, megjithë ndryshimin e llojeve të tyre. Kjo do të thotë se edhe ata do të ringjallen dhe do të tubohen. Për ta ka shpërblim dhe ndëshkim. Këtë e thonë shumica e komentuesve. Mirëpo disa prej tyre e mohojnë këtë dhe e komentojnë këtë ajet dhe ajetet e

ngjashme me komentim tjetër, siç është thënia e tyre se tubimi para All'Ilahut është vdekja dhe kthimi në jetë.¹

Nga këtu, ajeti i qorton politeistët dhe u thotë atyre se All'Ilahu, i Cili i krijoi kafshët, u ka siguruar atyre ato që kanë nevojë, i mbikëqyr veprat e tyre dhe ka vendosur për ta ringjallje dhe tubim. Ai ka caktuar edhe për ju Ringjalljen dhe tubimin. Çështja nuk është ashtu siç thonë një grup politeistësh se gjendet vetëm kjo jetë dhe vdekja.

Hulumtime

1- A ka ringjallje për kafshët?

S'ka dyshim se kusht i parë i llogaridhënies, i shpërblimit apo i dënimit është për njeriun arsyetimi, të cilin e pason përgjegjësia e kryerjes së detyrimeve të caktuara nga All'Ilahu.

Mbartësit e këtij mendimi thonë: Ata kanë argument që konstaton se kafshët kuptojnë aq sa është e mundur. Prej tyre është se jeta e shumë kafshëve ecën sipas një sistemi të hollësishëm dhe të habitshëm që tregon nivelin e lartë të të kuptuarit. Kush është ai që nuk ka dëgjuar për milingonën dhe bletën - për përparimin e tyre të habitshëm, për sistemin e tyre mahnitës në ndërtimin e vendbanimeve dhe të hojeve të tyre dhe nuk e ka pëlqyer kuptimin dhe perceptimin e tyre? Edhe pse disa e quajnë gjithë këtë një lloj *inspirimi instiktor*, nuk ka asnjë fakt se këto veprime kryhen instiktivisht dhe jo me logjikë.

¹ Këtë mendim e përcjell autori i komentimit "El Manar" nga ibn Abasi.

Cili është argumenti se këto vepra, sipas paraqitjes së tyre, nuk burojnë nga logjika dhe të kuptuarit? Shpesh ndodh, sipas situatave, kafsha bën diçka të cilën nuk e ka bërë më parë dhe as nuk e ka provuar. Dashi që sheh për herë të parë në jetë ujkun, frikësohet sapo e sheh dhe e kupton rrezikun e tij dhe përpiket që të shmangë nga vetja rrezikun e tij.

Marrëdhëniet që formohen mes kafshës dhe të zotit të saj gradualisht, janë argument tjetër për këtë çështje. P.sh: Qentë janë besnikë me të zotët e tyre.

Shumë flitet edhe për besnikërinë e kafshëve dhe për shërbimet e tyre ndaj njeriut. S'ka dyshim se këto gjëra nuk është e lehtë të konsiderohen se burojnë nga instikti, sepse nga instikti burojnë vepra të njëjta e të vazhdueshme. Kurse veprat që kryhen në situata të veçanta, siç janë reagimet ndaj ndodhjeve të papritura, janë më afër logjikës dhe kuptimit, se sa instiktit. Sot shohim se kafshë të ndryshme stërviten për qëllime të ndryshme. Qentë e policisë stërviten për të kapur kriminelët, pëllumbi postier (zagjil) për dërgimin e letrave, disa kafshë përdoren për gjueti etj. Këta e kryejnë misionin e tyre me hollësi dhe korrektësi. Sot janë hapur shkolla të posaçme për mësimin dhe stërvitjen e kafshëve.

Përveç gjithë kësaj, ka disa ajete në Kur'an që tregojnë qartë se kafshët zotërojnë aftësinë e të kuptuarit. Prej tyre është ikja e milingonave nga rruga e ushtrisë së Sulejmanit, tregimi i shkuarjes së pupzës në zonën e Sebes në Jemen dhe kthimi i saj me lajme të habitshme për Sulejmanin etj. Ka shumë transmetime islame rreth ringjalljes së kafshëve. Prej tyre është hadithi i transmetuar nga Ebu Dherri, i cili ka thënë: *"Kur një ditë ishim me të Dërguarin e All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dy dhi goditën njëra-tjetrën. I Dërguari i*

*All'llahut tha: 'A e dini përse goditën njëra-tjetrën?' Ata thanë: 'Jo, nuk e dimë.' Ai u tha: 'All'llahu e di dhe Ai do të gjykojë mes tyre.'"*¹

Në një hadith të Profetit i ardhur nga Ehli Syneti për komentimin e këtij ajeti, transmetohet se ai ka thënë: *"Vërtet, këto bashkësi do të tubohen në Ditën e Kiametit dhe do të marrin hakun e njëra-tjetrës."*²

2- Tubimi dhe detyrimi (teklifi)

Këtu parashtrohet një çështje, tek e cila qëndron kuptimi i ajetit. Ajo është: A është e logjikshme thënia për teklifin e kafshëve, ku prej kushteve të teklifit është mendja dhe se fëmija dhe i çmenduri nuk kanë teklif? A e kanë kafshët atë mendje që i bën të meritueshme për teklif? A mund ta konsiderojmë kafshën më me mend, sesa një fëmijë që nuk ka arritur në moshën e pjekurisë dhe se i çmenduri? Nëse nuk e ka këtë mendje, atëherë si mund të detyrohet dhe me çfarë detyrimi?

Për përgjigjen e kësaj pyetjeje, themi: Vërtet, për teklifin ka shkallë dhe faza. Çdo fazë është në përshtatje me një shkallë të caktuar të mendjes e të kuptuarit. Ka shumë teklife të detyrueshme në Sheriatin Islam, që kërkojnë nivel të lartë të mendjes e të të kuptuarit që të realizohen. Sigurisht, këto teklife nuk mund t'u detyrohen kafshëve, sepse kushti i realizimit të tyre nuk gjendet te kafshët. Madje është e vështirë të refuzojmë të gjithë teklifin e fëmijëve dhe të të çmendurve të aftë për të kuptuar disa çështje. Sepse, djali që nuk e ka mbushur moshën e

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 50. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 715.

² Tefsiri "El Manar", fundi i ajetit në fjalë.

teklifit, sikur të jetë 14 vjeç, nëse kryen ndonjë vrasje dhe ai është i njohur për pasojat e kësaj vepre, ai nuk mund të konsiderohet i pafajshëm. Edhe ligjet ndëshkuese në botë kanë vendosur dënime për disa krime që bëjnë fëmijët që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, sigurisht që janë më të lehta.

Prandaj, mosha e pjekurisë dhe plotësimi i mendjes janë prej kushteve të teklifit.

3- A tregon ky ajet për rimishërimin?

Është e habitshme se disa mbështetës të idesë së kotë të “klonimit” e marrin këtë ajet argument për rregullsinë e mendimit të tyre, duke thënë se nga ky ajet kuptohet se kafshët janë bashkësi njësoj si ju, edhe pse ne e dimë që janë ndryshe nga ne. Prandaj, mund të thuhet që shpirti i njerëzve që del prej tyre hyn tek kafshët. Në këtë mënyrë, shpirtrat mëkatarë marrin dënimin.

Mirëpo, ligji i rimishërimit është në kundërshtim me ligjin e plotësimit dhe nuk përputhet me logjikën dhe mendjen e shëndoshë. Ai çon në mohimin e Ringjalljes. Ky ajet nuk tregon absolutisht për rimishërimin, sepse bota e kafshëve, siç e thamë, ngjason me botën njerëzore dhe kjo ngjashmëri është me vepër dhe jo me dhunë, sepse kafshët kanë pjesën e tyre të të kuptuarit dhe të perceptimit. Gjithashtu, kafshët kanë pjesë në ringjallje dhe llogaridhënie. Pra, ata ngjasojnë në këtë gjendje me njerëzit.

Duhet të dimë se detyrimet dhe përgjegjësitë e kashëve nuk nënkuptojnë se ata kanë prijës dhe Imamë, në sheriat e fe, siç thonë disa sufistë. Ata i udhëheq një kuptim batin (i brendshëm).

Pra, ata i kuptojnë disa çështje dhe janë përgjegjës për aq sa kuptojnë.

Ajeti 39

وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا صُمُّ وَبُكْمٌ فِي الظُّلُمَاتِ ۚ مَنْ يَشِإِ اللَّهُ يُضْلِلْهُ
وَمَنْ يَشَأْ تَجْعَلْهُ عَلَىٰ صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٣٩﴾

“Ata që i mohojnë shpalljet Tona janë shurdhë e memecë, janë në errësirë. All’llahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë.”

Komentimi

I shurdhri dhe memeci

Përsëri Kur’ani kthehet dhe flet për mohuesit kokëfortë dhe u thotë: **“Ata që i mohojnë shpalljet Tona janë shurdhë e memecë, janë në errësirë...”** Ata nuk kanë veshë që të dëgjojnë të vërtetat. As gjuhë që të flasin të vërtetën dhe t’ua shpjegojnë të tjerëve ato të vërteta që i kupton njeriu. Përderisa errësirat e vetëpëlqimit dhe të mburrjes, adhurimi i vetvetes, kokëfortësia dhe padituria i rrethojnë ata nga të gjitha anët, ata nuk mund ta shohin fytyrën e së vërtetës. Për këtë ata janë të ndaluar (privuar) prej tri mirësive që e lidhin njeriun me botën e jashtme. Këto janë: të dëgjuarit, të shikuarit dhe të folurit.

Disa komentues kanë mendimin se qëllimi i fjalës *shurdhë* është për ata që imitojnë udhëheqësit e tyre të humbur dhe nuk i kundërshtojnë në asnjë mënyrë. Ata i shurdhojnë veshët e tyre për të dëgjuar thirrjen e thirrësve në rrugën e All’llahut të Madhëruar.

Kurse qëllimi i fjalës *memecë* është për ata drejtues të humbur, të cilët i kuptojnë shumë mirë të vërtetat, mirëpo për hir të mbrojtjes së interesave të tyre dhe të posteve në këtë jetë, ata i mbyllin gojët dhe nuk e thonë të vërtetën. Që të dy këto grupe janë të zhytur në errësirat e paditursisë dhe të adhurimit të vetvetes.¹

Më pas, Kur'ani Fisnik thotë: **"...All'llahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë."**

Më parë kemi thënë se atributi i udhëzimit e atributi i humbjes nga All'llahu e sqarojnë ajetet e tjera në Kur'anin fisnik. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...kurse keqbërësit i shpie në humbje..."**² dhe: **"Ai i lë në humbje vetëm gjynahqarët e mëdhenj..."**³ Në një vend tjetër, All'llahu thotë: **"Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona..."**⁴

Nga këto ajete dhe ajete të tjera të ngjashme me to, sqarohet se udhëzimi dhe humbja që i atribuohen dëshirës dhe vullnetit të All'llahut, në të vërtetë ato janë shpërblimi dhe ndëshkimi i robve të Tij sipas punëve që ata kanë bërë, të mira apo të këqija. Thënë ndryshe: Ka raste që njeriu bën një gjynah të madh, i cili bën që shpirti i tij të rrethohet nga një errësirë e frikshme. Sytë e tij e humbasin fuqinë e të parit të së vërtetës; veshët e tij e humbasin vetinë e dëgjimit të zërit të së vërtetës dhe gjuha e tij e humbet fuqinë e të folurit e të thënies të së vërtetës.

¹ Tefsiri "El Mijzan", vëll. 7, f. 84.

² Sure "Ibrahim", ajeti 27.

³ Sure "Bekare", ajeti 26.

⁴ Sure "Ankebut", ajeti 69.

Por ka mundësi që çështja të jetë e kundërt. Kjo do të thotë se njeriu bën shumë punë të mira, derisa arrin një botë të ndritur që ia ndriçon shpirtin. Në këtë mënyrë, të parit dhe të kuptuarit e tij zgjerohen më shumë. Mendimet e shtojnë ndriçimin dhe gjuha e tij është më elokuente në paraqitjen e të vërtetave. Ky është edhe kuptimi i udhëzimit e i humbjes, të cilat i atribuohen dëshirës dhe vullnetit të All'lahut.

Ajetet 40 - 41

قُلْ أَرَأَيْتَكُمْ إِنْ أَتَتْكُمْ عَذَابُ اللَّهِ أَوْ أَتَتْكُمُ السَّاعَةُ أَغَيْرَ اللَّهِ

تَدْعُونَ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿٤٠﴾ بَلْ إِيَّاهُ تَدْعُونَ فَيَكْشِفُ مَا

تَدْعُونَ إِلَيْهِ إِنْ شَاءَ وَتَنْسَوْنَ مَا تُشْرِكُونَ ﴿٤١﴾

“Thuaj: ‘Mendoni: nëse ju godet dënimi i All’llahut apo ju vjen Ora e Kiametit, a do të thërrisnit për ndihmë dikë tjetër, përveç All’llahut?! Më tregoni, nëse thoni të vërtetën!”

“Përkundrazi! Ju do të thërrisnit vetëm Atë! Nëse do të dojë, Ai do t’ju shpëtojë nga ajo për të cilën e thërrisnit dhe ju do t’i harronit idhujt që ia shoqëronit Atij (në adhurim).”

Komentimi

Njësimi (*Teuhidi*) i natyrshëm (*fitrij*)

Edhe një herë bëhet fjalë për politeistët. Këtë radhë flitet për argumentimin e njësimi të All’llahut dhe të adhurimit të Tij, të Vetëm e të Pashoq. Kjo nëpërmjet përmendjes së atyre çasteve të vështira e të dhimbshme që kalojnë në jetë. Këtu dëshmojnë ndërgjegjet e tyre. Në këto situata të vështira, ata harrojnë çdo gjë dhe nuk gjejnë strehim, përveçse tek All’llahu i Madhëruar.

All’llahu e urdhëron të Dërguarin e Tij: **“Thuaj: ‘Mendoni: nëse ju godet dënimi i All’llahut apo ju vjen Ora e Kiametit, a**

do të thërrisnit për ndihmë dikë tjetër, përveç All'Ilahut?! Më tregoni, nëse thoni të vërtetën!"

Gjendjen psikologjike që e paraqet ky ajet nuk është e kufizuar vetëm tek politeistët. Por, kjo gjendet tek të gjithë njerëzit kur përballen me vështirësi dhe me rrezik. Kur goditet nga ndonjë rrezik të vogël, njeriu mund të strehohet tek All'Ilahu. Mirëpo kur përballlet me një situatë të tmerrshme, ai harron çdo gjë, edhe pse në thellësi të vetes së tij e ndien shpresën e shpëtimit, e cila buron tek besimi që ndodhet në natyrën e tij krijuese. Ky është të drejtuarit kah All'Ilahu dhe kah e vërteta e Njësimit të Tij.

Në këto situata shumë të vështira, deri edhe idhujtarët nuk e mendojnë që të strehohen tek idhujt e tyre për shpëtim, por: **"Përkundrazi! Ju do të thërrisnit vetëm Atë! Nëse do të dojë, Ai do t'ju shpëtojë nga ajo për të cilën e thërrisnit dhe ju do t'i harronit idhujt që ia shoqëronit Atij (në adhurim)."**

Hulumtime

Është mirë që këtu të përmenden disa pika:

1- Argumenti i paraqitur në këto dy ajete është ai i Njësimit të natyrës krijuese, me të cilën konstatohet ekzistenca e All'Ilahut dhe njësimi i Tij. Transmetimet islame dhe dijetarët islamë janë bazuar te këto dy ajete për t'iu përgjigjur mohuesve së ekzistencës së All'Ilahut.

2- Duhet përmendur se argumentimi i përmendur cek edhe Orën e Kiametit. Dikush mund të thotë: Atyre, të cilëve u drejtohet ajeti, e që nuk besojnë në Kiametin, si mund t'u paraqitet ky argumentim?

Për këtë themi:

Së pari: Ata nuk kanë qenë të gjithë mohues së Ditës së Kiametit, sepse një grup prej tyre besonin në një lloj ringjalljeje.

Së dyti: Ka mundësi që kuptimi i orës “*es sa’atu*”, të jetë për kohën e vdekjes, apo për kohën e tmerrshme kur njeriut i vjen ndonjë fatkeqësi e rëndë që e çon buzë greminës shkatërruese.

Së treti: Ka mundësi që kjo të jetë thënie figurative për ndodhitë e tmerrshme, sepse Kur’ani e përsërit thënien që Dita e Kiametit është e shoqëruar me disa ndodhi të frikshme, si: tërmete, stuhi, vetëtimat etj.

3- Ne e dimë se Dita e Kiametit dhe ndodhitë që e shoqërojnë atë janë të patjetërsueshme dhe nuk mund të ndryshohen. Atëherë përse ajeti thotë: **“Përkundrazi! Ju do të thërrisnit vetëm Atë! Nëse do të dojë...”**? Vallë, a ka si qëllim dukjen e fuqisë së All’llahut, apo ka ndonjë qëllim tjetër?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje themi: Kjo nuk do të thotë se me anë të lutjes, Ringjallja dhe Kiameti nuk do të ndodhin. Por, qëllimi i ajetit është për politeistët, madje edhe për jopoliteistët, se kur të shohin ndodhitë e tmerrshme në Ditën e Kiametit, si dhe vështirësitë dhe dënimin që i pret, ata do t’i mbulojë frika dhe tmerri dhe do t’i luten All’llahut që t’ua lehtësojë atyre ato vështirësi dhe t’i shpëtojë prej atij rreziku. Kjo lutje e tyre është për të shpëtuar prej tmerrit të Ditës së Kiametit dhe jo për mospërjetimin e asaj Dite.

Ajetet 42 - 45

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا إِلَىٰ أُمَمٍ مِّن قَبْلِكَ فَأَخَذْنَاهُم بِالْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ
لَعَلَّهُمْ يَتَضَرَّعُونَ ﴿٤٢﴾ فَلَوْلَا إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا تَضَرَّعُوا وَلَكِن
قَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٤٣﴾
فَلَمَّا نَسُوا مَا ذُكِّرُوا بِهِ فَتَحْنَا عَلَيْهِم أَبْوَابَ كُلِّ شَيْءٍ
حَتَّىٰ إِذَا فَرِحُوا بِمَا أُوتُوا أَخَذْنَاهُم بَغْتَةً فَإِذَا هُمْ مُبْلِسُونَ ﴿٤٤﴾
فَقُطِعَ دَابِرُ الْقَوْمِ الَّذِينَ ظَلَمُوا ۖ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٤٥﴾

“Ne u kemi dërguar shumë popujve Profetë para teje dhe i kemi dënuar ata me skamje dhe fatkeqësi, për t’u bërë të dëgjueshëm.”

“Vetëm sikur të përuleshin kur u erdhi ndëshkimi Ynë! Por zemrat e tyre u bënë gur, ndërsa shejtani ua paraqiste si të bukura veprat e tyre të këqija.”

“Kur ata i harruan paralajmërimet Tona, Ne ua hapëm dyert e çdo mirësie. Por, sapo po gëzoheshin me atë që u dhamë, Ne i dënuam befasisht dhe atëherë ata u zhytën në dëshpërim.”

“Kështu humbi gjurma e atij populli keqbërës. Lavdërimi qoftë i All’llahut, Zotit të gjithësisë!”

Komentimi

Fundi i atyre që nuk nxjerrin (marrin) mësim

Këto ajete vazhdojnë t'u drejtohen të humburve dhe idhujtarëve. Këtu Kur'ani përdor metotë tjetër për t'i zgjuar ata duke u përmendur atyre kohët e mëparshme dhe sqaron gjendjen e popujve të humbur, të padrejtë e idhujtarë. Ai u sqaron se atyre u janë dhënë të gjitha mundësitë e edukimit, të pastrimit e perceptimit, mirëpo një pjesë e tyre nuk u interesuan për asnjë prej atyre elementëve dhe nuk nxorën mësim prej fundit të keq të tyre. **“Ne iu kemi dërguar shumë popujve Profetë para teje dhe i kemi dënuar ata me skamje dhe fatkeqësi, për t'u bërë të dëgjueshëm.”**

A nuk duhej të zgjoheshin ata kur i godiste skamja dhe vështirësitë?! **“Vetëm sikur të përulleshin kur u erdhi ndëshkimi Ynë!** Mirëpo ata nuk u zgjuan dhe kjo, për dy shkaqe:

I pari: Për shkak të gjynaheve të shumta dhe kokëfortësisë së tyre në idhujtari. Kështu, mëshira dhe butësia ikën nga zemrat dhe shpirtrat e tyre. **“...Por zemrat e tyre u bënë gur...”**

I dyti: Shejtani i mallkuar e shfrytëzoi adhurimin që i bënin ata vetes së tyre dhe ua zbukuroi punët. Të këqijat që vepronin, shejtani ia paraqiste si të mira dhe çdo gabim që bënin, ua shfaqte në sytë e tyre si shpërblim. **“...ndërsa shejtani ua paraqiste si të bukura veprat e tyre të këqija.”**

Më pas, Kur'ani thotë se kur nuk u sollën dobi vështirësitë, problemet dhe presionet, All'illahu u soll me ta me butësi e mëshirë, duke u hapur atyre portat e mirësive të ndryshme me

qëllim që të zgjoheshin dhe të kujtonin Krijuesin e tyre, i Cili u dhuroi atyre të gjitha ato mirësi dhe të dallonin rrugën e drejtë: **“Kur ata i harruan paralajmërimet Tona, Ne ua hapëm dyert e çdo mirësie...”**

Mirëpo, ato mirësi ishin me natyrë të dyanshme. Nga jashtë ishin dukuri e shfaqjes së dashurisë, që kishte si qëllim zgjimin e fjetësve, gjithashtu, ato ishin edhe parahyrje e zbritjes së dënimit të rëndë nëse vazhdonte pavëmendshmëria. Kjo, sepse ai që është i zhytur në mirësi e komoditet, pikëllohet shumë kur këto mirësi i zhduken befasisht. Ndërsa kur i zhduken dalngadalë, nuk pikëllohet shumë. Për këtë, ajeti thotë se Ne u dhamë atyre shumë prej mirësive: **“Por, sapo po gëzoheshin me atë që u dhamë, Ne i dënuam befasisht dhe atëherë ata u zhytën në dëshpërim.”**

Kështu u shkulën rrënjët e të padrejtëve dhe u ndërpre gjeneza e tyre: **“Kështu humbi gjurma e atij populli keqbërës...”**

Përderisa All’llahu ua siguroi atyre të gjitha mjetet e edukimit dhe nuk ishte koprac ndaj tyre për asgjë, atëherë falënderimi është i vetëm për All’llahun, i Cili është Edukuesi i mbarë njerëzimit: **“...Lavdërimi qoftë i All’llahut, Zotit të gjithësisë!”**

Hulumtime

Këtu duhen përmendur disa pika:

1- Disave mund t'u duket se këto ajete janë në kundërshtim me ajetet e mëparshme, të cilat sqaruan se kur vështirësitë dhe fatkeqësitë i sulmonin idhujtarët, ata drejtoheshin kah All'llahu duke harruar çdo gjë tjetër përveç Atij. Mirëpo këto ajete thonë se ata politesistë nuk u zgjuan, edhe pse u përballën me fatkeqësi të forta.

Ky ndryshim i dukshëm largohet nëse përqendrohemi në këtë pike, që është zgjimi i përkohshëm dhe i menjëhershëm që ndodh kur shfaqet ndonjë fatkeqësi e fortë, e që nuk konsiderohet zgjim i vërtetë, sepse shumë shpejt ata kthehen në pavëmendshmërinë e tyre të mëparshme.

Në ajetet e mëparshme bëhej fjalë për njësimin e natyrës së krijuar (*teuhidin fitrij*). Zgjimi i menjëhershëm, drejtimi kah All'llahu dhe të harruarit e çdo gjëje përveç All'llahut në ato çaste delikate mjaftonin për konstatimin e zgjimit. Ndërsa, në ajetet në fjalë bëhet fjalë për udhëzimin dhe kthimin nga humbja në rrugën e drejtë. Për këtë, zgjimi i përkohshëm dhe kalimtar nuk sjell asnjë dobi.

Mund të përfytyrohet se ndryshimi mes ajeteve është se ajetet e mëparshme tregojnë për idhujtarët në kohën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kurse ajetet në fjalë tregojnë për kombet e

mëparshme. Për këtë nuk ka kundërshtim mes tyre.¹ Mirëpo është shumë larg që idhujtarët kokëfortë të kohës së Profetit të jenë më të mirë se kombet e mëparshme. Prandaj, çështa zgjidhet vetëm ashtu siç thamë.

2- Në këto ajete lexojmë se kur sprovimi me vështirësi nuk ndikoi në zgjimin e tyre, atëherë All'llahu hapi dyert e mirësive për ata gjynahqarë. Vallë, a është ky inkurajim pas ndëshkimit apo parapërgatitje për në dënimin e rëndë? Thënë ndryshe: A janë këto mirësi të shkallëzuara ku kokëforti mbulohet me to në mënyrë të shkallëzuar e gëzohet duke arritur që ta mbulojë një lloj pavëmendshmërie e pastaj menjëherë t'i hiqen atij të gjitha ato mirësi?

Ka fakte në ajet që e pranojnë supozimin e dytë, por nuk ka asnjë pengesë për pranimin e të dy supozimeve. Kjo do të thotë se inkurajimi dhe nxitja për zgjim nëse nuk ndikojnë, atëherë ato janë hyrje për heqjen e mirësive dhe të zbritjes së dënimit të dhimbshëm.

Në një hadith të Profetit Muhammed thuhet: *"Nëse sheh se All'llahu i jep një rob mēkatar prej dynjasë, dije së është provë për atë."* Pastaj lexoi ajetin: **"Kur ata i harruan..."**²

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në një hadith ka thënë: *"O biri i Ademit! Nëse sheh se Zoti yt vazhdon të të mirësojë ty dhe ti i bën gjynah Atij, atëherë ki kujdes prej Tij!"*¹

¹ Këtë ndryshim e përmend edhe Fakhri Razi në Tefsirin "el Kebir", vëll. 12, f. 224.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejjan"; vëll. 4, f. 55. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 718.

3- Nga këto ajete sqarohet se qëllimi i shumë ndodhive të dhimbshme është zgjimi i njeriut dhe bërja e tij të vëmendshëm. Kjo është një nga llojet e filozofisë që njeriu me anë të vështirësive dhe fatkeqësive, të drejtohet kah njësimi i All'llahut (teuhidi).

Fjala '*tedaru*' në origjinalitet do të thotë zbritja e qumështit prej gjirit dhe kalimi i tij tek foshnja. Më pas është përdorur për dorëzimin me frikë dhe thjeshtësi. Kjo do të thotë se ato ndodhi të ashpra kanë si qëllim zbritjen e tyre prej shkallëve të mendjemadhësisë e kokëfortësisë dhe dorëzimin tek All'llahut të Madhëruar.

4- Ajo që tërheq vëmendjen është fundi i ajetit me thënien: **"...Lavdërimi qoftë i All'llahut, Zotit të gjithësisë!"** Ky është argument se shkulja e rrënjëve të padrejtësisë e të shkatërrimit është aq e rëndësishme, saqë e meriton falënderimin e All'llahut të Madhëruar.

Në një hadith të transmetuar nga Fudehjl ibn Ajjadh nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: *"Kushdo që dëshiron qëndrimin e të padrejtëve, ai dëshiron t'i bëjë gjynah All'llahut. Vërtet, All'llahu i Lartësuar e ka falënderuar veten e Tij kur zhduken të padrejtët duke thënë: "...Lavdërimi qoftë i All'llahut, Zotit të gjithësisë!"*²

¹ "Nehxhul Belaga", *Fjalët e urta*, fjala 25.

² "Usulul Kafij", vëll. 5, f. 108. Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 56.

Ajetet 46 - 49

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَخَذَ اللَّهُ سَمْعَكُمْ وَأَبْصَارَكُمْ وَخَتَمَ عَلَى قُلُوبِكُمْ
 مَنْ إِلَهٌ غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُمْ بِهِ ۚ أَنْظِرْ كَيْفَ نُصَرِّفُ الْآيَاتِ ثُمَّ
 هُمْ يَصْدِفُونَ ﴿٤٦﴾ قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ أَتَيْتُمْ عَذَابَ اللَّهِ بَغْتَةً أَوْ
 جَهْرَةً هَلْ يُهْلِكُ إِلَّا الْقَوْمَ الظَّالِمُونَ ﴿٤٧﴾ وَمَا نُرْسِلُ
 الْمُرْسَلِينَ إِلَّا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ ۚ فَمَنْ ءَامَنَ وَأَصْلَحَ فَلَا خَوْفٌ
 عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٤٨﴾ وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا يَمَسُّهُمْ
 الْعَذَابُ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴿٤٩﴾

“Thuaj: ‘Më thoni: Sikur All’lahu t’jua merrte dëgjimin dhe shikimin e t’ua vuloste zemrat, cili zot, përveç All’llahut, do t’jua kthente ato?!’ Shih si ua shpjegojmë shpalljet Tona, por ata përsëri largohen nga e vërteta.”

“Thuaj: ‘Më thoni, nëse ju vjen dënimi i All’llahut papritmas ose sheshazi, a do të zhdukej kush përveç popullit keqbërës?’”

“Ne i çojmë të Dërguarit vetëm si sjellës të lajmeve të mira dhe qortues. Pra kushdo që i beson ata dhe bën mirë, nuk do të frikësohet e as nuk do të pikëllohet.”

“Kurse ata që përgënjeshtrojnë shpalljet tona, do t’i godasë dënimi për shkak të mohimit.”

Komentimi

Njiheni Dhuruesin e mirësive!

Fjalët vazhdojnë t’u drejtohen akoma politeistëve.

Në këto ajete ka inkurajim argumentues për zgjimin e tyre, duke përdorur një sqarim tjetër që mbështetet tek instikti i largimit të dëmit. Ajetet fillojnë me thënien se nëse All’llahu ua merr një të mirë të çmuar që ua pati dhënë, siç është dëgjimi a shikimi, apo ua ka mbyllur portat e zemrës për të dalluar të mirën nga e keqja, të vërtetën nga e pavërteta, atëherë kush është ai që mund t’ua kthejë juve ato mirësi? **“Thuaj: ‘Më thoni: Sikur All’llahu t’jua merrte dëgjimin dhe shikimin e t’ua vuloste zemrat, cili zot, përveç All’llahut, do t’jua kthente ato?!’”**

Vetë politeistët e besonin se Krijuesi dhe Dhuruesi është All’llahu. Ata i adhuronin idhujt që të bënin *shefaat* për ta tek All’llahu. Mirëpo, Kur’ani i nxit ata që t’i drejtohen All’llahut drejtpërsëdrejti, sepse Ai është burimi i të gjitha të mirave. Kur’ani i nxit të heqin dorë nga idhujt që nuk kanë asnjë vlerë. Kur’ani u thërret mendjeve të tyre me qëllim që ta kuptojnë të vërtetën e idhujve, të cilët nuk zotërojnë as sy, as veshë, as zemër e as ndjenja. Përderisa janë të tillë, a mundet që këto idhuj t’u dhurojnë të tjerëve këto mirësi?!

Më pas, ajeti thotë: Shikoji ata që ne ua sqarojmë shenjat dhe argumentet me mënyra të ndryshme, e ata, përsëri i kundërshtojnë dhe ua kthejnë shpinën këtyre argumenteve: **"...Shih si ua shpjegojmë shpalljet Tona, por ata përsëri largohen nga e vërteta."**

Fjala "*nesrifu*" vjen nga "*et tesrif*", që do të thotë "*tag'jir*" (ndryshim). Këtu fjala "*nesrifu*" tregon për argumente të ndryshme në forma të ndryshme.

Fjala "*jesdifune*" vjen nga folja "*sadefe*", që do të thotë "*el xhanibu*" ose "*en nahijetu*" (anë). Kuptimi i saj është se kundërshtuesi i diçkaje e kthen fytyrën në një anë a drejtim tjetër kur nuk i pëlqen ajo. Kjo fjalë përdoret edhe për kundërshtim të rreptë, siç thotë Ragib Asfahani në librin e tij "*El Mufredat*".

Pas përmendjes së mirësive të syrit, të veshit dhe të zemrës tek ajeti i parë prej ajeteve në fjalë, dhe pas përmendjes se këto mirësi janë burimi i të gjitha të mirave të kësaj jete dhe të Jetës Tjetër, ajeti pasardhës tregon për mundësinë e zhdukjes së këtyre mirësive përnjëherë. Ajeti thotë: **"Thuaj: 'Më thoni, nëse ju vjen dënimi i All'lahut papritmas ose sheshazi, a do të zhdukej kush përveç popullit keqbërës?'"**

Fjala "*bagtaten*" do të thotë papritur, kurse fjala "*xhehreten*" do të thotë haptazi, dukshëm. Gjithmonë, në gjuhën arabe, fjala "*siren*" (fshehtas) shoqërohet me fjalën "*xhehreten*" dhe jo me fjalën "*bagtaten*". Por, fjala "*bagtaten*" përmban edhe kuptimin e fshehjes.

Kuptimi i ajetit është se Ai që ka mundësi t'i zbrësë ndëshkimet e ndryshme dhe t'i zhdukë të gjitha mirësitë, është vetëm All'lahu dhe se idhujt nuk ndikojnë kurrë në këtë gjë.

Prandaj, nuk ka arsye e as shkak strehimi tek ato idhuj. Me urtësinë e Tij dhe me mëshirën e Tij, All'llahu dënon vetëm të padrejtët. Nga kjo kuptohet se padrejtësia ka kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha llojet e politeizmit (shirkut) dhe të gjynaheve. Kur'ani Fisnik e konsideron "*shirkun*" (politeizmin, idhujtarinë) padrejtësi të madhe, siç i thotë Lukmani djalit të vet: **"O djali im, mos i shoqëro All'llahut asgjë! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe."**¹

Ajeti i tretë, prej ajeteve në fjalë, tregon për postin e të Dërguarve dhe se qëllimi i të gjithë atyre ka qenë përcjellja e mesazheve, paralajmërimi dhe përgëzimi. Ata u përmendin dhe u kujtojnë njerëzve se të gjitha të mirat që kanë, janë prej All'llahut dhe se idhujt nuk sjellin asnjë të mirë. Ajeti thotë: **"Ne i çojmë të Dërguarit vetëm si sjellës të lajmeve të mira dhe qortues..."**

E përbashkëta e këtij ajeti me ajetet e mëparshme është se ajetet e mëparshme tregonin për përgëzim dhe paralajmërim, ndërsa ajeti në fjalë flet për qëllimin e dërgimit të Profetëve dhe se ata janë përgëzues dhe qortues.

Më pas ajeti thotë se rruga e shpëtimit është e kufizuar në dy çështje:

E para: Ata që besojnë, që i ndreqin vetat e tyre dhe që bëjnë punë të mira, nuk janë as të frikësuar e as të dëshpëruar nga dënimi i All'llahut. **"...Pra kushdo që i beson ata dhe bën mirë, nuk do të frikësohet e as nuk do të pikëllohet."**

¹ Sure "Lukman", ajeti 13.

Kurse ata që i kundështuan argumentet e All'llahut dhe i përgënjeshtruan ato, atëherë për ata do të ketë dënim nga All'llahu, për shkak të kokëfortësisë dhe mohimit. **“Kurse ata që përgënjeshtrojnë shpalljet tona, do t'i godasë dënimi për shkak të mohimit.”**

Ajo që duhet përmendur është se ky ajet e ka treguar dënimin e atyre që përgënjeshtrojnë shenjat dhe argumentet e All'llahut duke thënë: **“...do t'i godasë dënimi”**. Kjo do të thotë se dënimi i ndjek në çdo vend, derisa t'i përfshijë dënimi më i rëndë.

Po ashtu duhet thënë se fjala *“fiskun”* ka kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha llojet e gjynaheve, të mosbindjes ndaj All'llahut dhe të mosadhurimit të Tij. Në disa raste përfshin edhe kufrin (mohimin). Ky është edhe kuptimi i këtij ajeti. Për këtë, nuk është e nevojshme që të bëhen hulumtime, siç ka vepruar Fakhri Raziu dhe komentuesit e tjerë rreth fjalës *“fusuk”*.

Ajeti 50

قُلْ لَا أَقُولُ لَكُمْ عِنْدِي خَزَائِنُ اللَّهِ وَلَا أَعْلَمُ الْغَيْبَ وَلَا
 أَقُولُ لَكُمْ إِنِّي مَلَكٌ ۖ إِنِ اتَّبَعُوا إِلَّا مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ ۚ قُلْ هَلْ
 يَسْتَوِي الْأَعْمَىٰ وَالْبَصِيرُ ۚ أَفَلَا تَتَفَكَّرُونَ ﴿٥٠﴾

“Thuaj: ‘Unë nuk ju them se zotëroj depozitat e All’llahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam melek. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet’. Thuaj: ‘A barazohet i verbri me atë që sheh? A s’po mendoni?’”

Komentimi

Njohja e Gajbit

Ky ajet është vazhdim i përgjigjes ndaj kundërshtimeve të ndryshme të politeistëve dhe mohuesve. Përgjigjja përfshin tre lloje kundërshtimesh:

Së pari: Ata i kërquan të Dërguarit të All’llahut që t’u sillte mrekulli të habitshme e të mahnitshme. Çdokush propozonte atë që dëshironte. Ata nuk bindeshin me mrekullitë që kërkonin të tjerët. Herë kërkonin shtëpi prej floriri, herë kërkonin zbritjen e melekëve; herë tjetër kërkonin që toka e thatë dhe e nxehtë e Mekës të shndërrohej në kopësht të mbushur me ujë, fruta e

gjelbërim. Kishte edhe kërkesa të tjera që i kërkonin Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sqarimi i të cilave do të jetë tek komentimi i ajetit 90, i sures "Isra".

Ka mundësi që nëpërmjet kërkesave të tyre të habitshme, ata mendonin që Profeti dinte të fshehtat dhe kishte në dorë tokën e qiejt. Si përgjigje e kërkesës së tyre vjen urdhri i All'llahut: **"Thuaj: 'Unë nuk ju them se zotëroj depozitat e All'llahut...'"**

Fjala "*el khazinu*" është shumësi i fjalës "*el khazinetu*", që ka kuptimin e vendit në të cilin vendosen gjërat për t'i ruajtur dhe për t'i fshehur nga sytë e të tjerëve. Duke u mbështetur në ajetin 21 të sures "Hixhr", që thotë: **"Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne depozitat e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar"**, sqarohet se depozitat e All'llahut janë burimi i të gjitha gjërave.

Së dyti: Më pas, ajeti u përgjigjet atyre që donin prej Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) t'u zbulonte të fshehtat e së ardhmes dhe t'i lajmëronte se çfarë ngjarjesh i prisnin, me qëllim që të largonin të keqen dhe të sillnin të dobishmet. Ajeti thotë: **"...apo se e di të padukshmen..."**

E kemi thënë edhe më parë se askush nuk mund të jetë i ditur për çdo gjë, vetëm nëse është i pranishëm dhe dëshmues në çdo vend dhe në çdo kohë, dhe ky është vetëm All'llahu i Madhëruar. Kurse ajo krijesë, prania e së cilës është e kufizuar me vend dhe me kohë, natyrisht që nuk mund të jetë e ditur për çdo gjë. Por, askush nuk e pengon All'llahun, që të Dërguarit e Tij, t'i

pajisë me një lloj dijeje për të padukshmen me qëllim që të plotësojnë misionin e tyre. Natyrisht që kjo dije është e fituar, pra All'Ilahu ua mësoi dhe nuk është rastësore tek të Dërguarit. Në ajetet 26 dhe 27 të sures "Xhin" thuhet: **"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur..."**

Së treti: Në fjalinë e tretë ka përgjigje për ata të cilët mendonin se Profeti ishte melek ose i shoqëruar nga melekët dhe se ai nuk ishte i cilësuar siç cilësohen njerëzit me ngrënien e ushqimit, të ecurit në rrugë etj. Fjalja e ajetit thotë: **"...dhe as nuk them se jam melek..."**

Në këtë ajet duket mjaft qartë se dija që kishte Profeti dhe veprimet që bënte ai ishin sipas shpallje të shpallur dhe ai nuk vepronte sipas mendimit të tij, por ai ndiqte Shpalljen në çdo çështje prej çështjeve të fesë.

Në fund, Profeti urdhërohet që t'u thotë atyre: A është e mundur që ata të cilët mbyllin sytë dhe bllokojnë mendjet ndaj të menduarit të jenë të barabartë me ata që i shohin të vërtetat shumë mirë dhe i kuptojnë ato? **"...Thuaj: 'A barazohet i verbri me atë që sheh? A s'po mendoni?'"**

Përmendja e kësaj fjalie pas tri fjalive të mëparshme mund të jetë me qëllimin se më parë, Profeti u tha atyre: **"Thuaj: 'Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e All'Ilahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam melek. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet.'" Megjithatë, kjo nuk do të thotë se unë jam si ju, o politeistë. Unë jam njeri që i njoh të vërtetat, kurse ju jeni njësoj si të verbrit. A janë të barabartë i verbri dhe jo i verbri?!**

Ka supozim tjetër për lidhjen mes këtyre fjalive të ajetit që thotë se argumentet dhe faktet rreth Njësimit (Teuhidit) dhe vërtetësisë së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë të qarta, por ato kanë nevojë që të shihen me syrin e zemrës. Nëse nuk i pranoni apo nuk bindeni me to, kjo nuk do të thotë se ato argumente janë të paqarta, por syri i zemrës suaj është i verbër. Vallë, a është i njëjtë i verbri dhe jo i verbri?!

Ajeti 51

وَأَنْذِرْ بِهِ الَّذِينَ يَخَافُونَ أَنْ يُحْشَرُوا إِلَىٰ رَبِّهِمْ ۚ لَيْسَ لَهُمْ مِنْ
دُونِهِ وَلِيٌّ وَلَا شَفِيعٌ لَّعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٥١﴾

“Paralajmëroji ata që i frikësohen daljes para Zotit të tyre, se atëherë nuk do të kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër përveç Tij, me qëllim që të ruhen nga gjynahet!”

Komentimi

Në fund të ajetit të mëparshëm, All’llahu i Madhëruar përmendi se nuk janë të barabartë i verbri me atë që shikon.

Në këtë ajet All’llahu e urdhëron të Dërguarin e Tij që t’i paralajmërojë ata që i frikësohen Ditës së Kiametit, duke thënë: **“Paralajmëroji ata që i frikësohen daljes para Zotit të tyre...”**, që do të thotë se këta kanë këtë masë perceptimi, se shpërblimi e dënimi janë të pranishëm. Në dritën e këtij mendimi e të frikës ndaj përgjegjësisë, tek ata lind aftësia e kuptimit dhe e pranimit.

Më parë thamë se prania e udhëheqësit dhe e programit të plotë edukativ nuk mjaftojnë për udhëzimin e njerëzve, sepse vetë

njerëzit duhet të kenë aftësi për pranimin e thirrjes, njësoj si rrezet e diellit, të cilat nuk mjaftojnë në vetvete për ndriçimin e rrugës, por nevojitet edhe syri për të shikuar. Ose, si fara e shëndetshme, e cila nuk mund të mbijë e të rritet normalisht, veçse në tokën pjellore e të përshtatshme për të mbjella.

Nga kjo kuptohet se përemri në frazën “*bihi*” (me të) aludon Kur’anin, edhe pse fjala *Kur’an* nuk përmendet në ajet.

Po ashtu, fjala “*jekhafune*” ka kuptimin *supozohet* (mendohet) prania e dëmit. Cilido mendar që e dëgjon thirrjen e të Dërguarve, e kupton se kjo thirrje është e vërtetë dhe se kundërshtimi i saj sjell humbje dhe dëmtim. Nga kjo, ai konkludon se është mirë që ta studiojë thirrjen e të Dërguarve dhe argumentet që ata kanë sjellë.

Ky studim i thirrjes së të Dërguarve është një prej kritereve të udhëzimit. Dijetarët e besimit e quajnë “domosdoshmëria e largimit të dëmit supozues”. Ata e konsiderojnë atë argument të domosdoshëm studimi për atë që pretendon profetësinë.

Më pas, ajeti thotë se të njëjtë me ata që kanë zemra të vetëdijshme i frikësohen asaj Dite në të cilën nuk gjendet strehim vetëm se tek All’llahu e nuk gjendet as ndihmues tjetër përveç Tij: **“...se atëherë nuk do të kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër përveç Tij...”**

Pra, paralajmëroji ata njerëz dhe ftoji për tek All’llahu, sepse shpresa për udhëzimin e tyre është e pranishme. **“...me qëllim që të ruhen nga gjynahet.”**

Është e natyrshme se mohimi i ndërmjetësimit dhe i vilajetit (udhëheqjes) të të tjerëve, përveç All'llahut, që përmendet në këtë ajet, nuk e mohon shefaatin e të dashurve të All'llahut. Më parë e kemi thënë se nuk ka shefaat e as vilajet tek njerëzit, sepse të dyja këto janë të posaçme për All'llahun. Nëse dikush përveç Tij, bën shefaat, atëherë kjo ndodh me lejen e All'llahut dhe me urdhrin e Tij, siç e thotë edhe Kur'ani në suren "Bekare", ajeti 255: **"...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?..."**

Ajetet 52 - 53

وَلَا تَطْرُدِ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْغَدَاةِ وَالْعَشِيِّ يُرِيدُونَ وَجْهَهُ
 مَا عَلَيْكَ مِنْ حِسَابِهِمْ مِنْ شَيْءٍ وَمَا مِنْ حِسَابِكَ عَلَيْهِمْ مِنْ
 شَيْءٍ فَتَطْرُدَهُمْ فَتَكُونَ مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿٥٢﴾ وَكَذَلِكَ فَتَنَّا
 بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لِيَقُولُوا أَهَؤُلَاءِ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنْ بَيْنِنَا أَلَيْسَ
 اللَّهُ بِأَعْلَمَ بِالشَّاكِرِينَ ﴿٥٣﴾

“Mos i dëbo ata që i luten Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Fytyrën (mirësinë) e Tij! Ti nuk je aspak përgjegjës për ata e as ata nuk janë përgjegjës për ty. Nëse ti i dëbon ata, atëherë do të jesh i padrejtë.”

“Kështu, Ne i kemi bërë disa prej tyre si sprovë për të tjerët, që të thonë: ‘Vallë, këta janë ata prej nesh, që All’lillahu u ka dhuruar mirësi?!’ - A mos vallë, All’lillahu nuk i njeh më mirë ata që i janë mirënjohës?”

Shkaku i zbritjes

Përmenden shumë transmetime për shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve që janë të ngjashme me njëri-tjetrin. Ndër to, është edhe ai që përmendet në tefsirin “Ed Dur’rul Menthur”, në të cilin thuhet: “Një herë një grup kurejshitësh kaluan pranë

Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili po qëndronte me Khababin, Suhejbën, Amarin, Bilalin e me të tjerë të varfër e punëtorë që ishin të pranishëm tek ai. Kurejshitët u habitën nga kjo pamje, sepse ata e llogarisnin personalitetin e një njeriu mbi bazën e pasurisë, postit, pushtetit, familjes dhe nuk arrinin ta kuptonin pozitën shpirtërore të atyre personave. Po ashtu, nuk e imagjinonin se ata persona që ishin me Profetin do të luanin rol në ndërtimin e shoqërisë së madhe islame. Ata thanë: 'O Muhammed! A je i kënaqur me ta prej popullit tënd? A do që ne t'i ndjekim ata? Vallë, a i ka mirësuar All'llahu ata?! Dëboji ata prej teje, se po t'i dëbosh, ndoshta ne do të të ndjekim ty. Atëherë All'llahu zbriti ajetin në fjalë.¹

Autori i komentimit "El Manar" përmend një hadith rreth kësaj përmbajtjeje. Më pas thotë se ndër të pranishmit ishte edhe Omer ibn Khatabi, i cili i propozoi Profetit ta pranonte propozimin e kurejshitëve me qëllim që të kuptonte nëse ishin të vërtetë në thënie apo jo. Atëherë zbritën këto dy ajete që e refuzojnë propozimin e tij.²

Duhet thënë se përmendja e shkakut të zbritjes të disa ajeteve të kësaj sureje nuk bien ndesh me zbritjen e të gjithë sures në një vend të vetëm. Më parë e kemi thënë se mund të ndodhin ngjarje të ndryshme në kohë të ndryshme para zbritjes së sures, e pastaj zbret surja që i përmend ato ndodhi.

¹ Tefsiri "El Mijzan"; vëll. 7, f. 109.

² Tefsiri "El Mijzan"; vëll. 7, f. 109.

Ndalimi i të menduarit për ndarje shtresore

Në këtë ajet tregohet për një prej diskutimeve të politeistëve, të cilët donin prej Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të miratonte disa dallime për shtresën e pasur dhe t'i quante më të mirë sesa shtresa e varfër. Kjo, sepse ata mendonin se po të uleshin me të varfërit prej shokëve të Profetit, e quanin fyerje. Mirëpo, Islami erdhi për t'i zhdukur këto dallime të pavlefshme. Ata gjithmonë këmbëngulnin në dëbimin e atyre të varfërve. Por Kur'an iu përgjigj kësaj kërkesë duke thënë: **“Mos i dëbo ata që i luten Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Fytyrën (mirësinë) e Tij...”**

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'an i nuk përmend për ata persona shenja të veçanta, por mjaftohet me cilësinë e tyre të dukshme: se ata e përmendin All'llahun në mëngjes dhe në darkë, pra gjithmonë në çdo kohë. Këtë, ata nuk e bëjnë për t'u dukur, por sepse e dinë mirë që Ai është i Vetëm e i Pashoq; Ai e meriton të falënderohet, sepse prej Atij kërkohet plotësimi i nevojave.

Nga ajete të ndryshme të Kur'anit sqarohet se kjo nuk ka qenë kërkesa e parë e atyre politeistëve të pasur kurejshitë drejtuar Profetit Muhammed. Ata e përsëritën disa herë kundërshtimin e tyre që Profeti të mos i mbledhte të varfërit rreth tij dhe t'i dëbonte ata. Në të vërtetë, me këtë kërkesë të tyre, ata mbështeteshin tek tradita e vjetër dhe e gabuar sipas së cilës njeriu vlerësohej në bazë të pasurisë së tij. Ata besonin se parimi dhe kriteri i dallimit shtresor bazuar në pasuri duhet të ruhet. Kështu, ata kundërshtonin çdo thirrje për anulimin e këtij parimi.

Në jetëshkrimin e Profetit Nuh (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) lexojmë se paria e kohës së tij i thonin Nuhut: **"...Ne shohim se ti je thjesht njeri si ne dhe, shohim, që ty të shkojnë pas vetëm më të pavlerët nga ne, pa menduar fare..."** Këtë e konsideronin si argument i mosnjohjes së profetësisë së tij.

Prej argumenteve të madhështisë së Islamit, Kur'anit dhe e shkollës së Profetëve në përgjithësi, është se gjithmonë kanë qëndruar vigjilentë e të pakëlundur ndaj këtyre kërkesave dhe i kanë luftuar vazhdimisht këto dallime injoruese në çdo shoqëri, e cila e konsideron dallimin shtresor prej çështjeve të palëkundura. Luftimin e kësaj tradite e bëjnë me qëllim që të njoftojnë se varfëria nuk është e metë tek njerëzit, (siç ishin Selman Farisiu, Ebu Dherri, Khabbabi e Bilali). Po ashtu, pasuria nuk është dalluese shoqërore apo shpirtërore për të pasurit e zbrazët, kokëfortë e mendjemëdhenj.

Më pas, ajeti thotë se nuk gjendet asnjë shkak për largimin e besimtarëve prej teje, sepse llogaria e tyre nuk është në dorën tënde dhe as llogaria jote nuk është në dorën e tyre. **"...Ti nuk je aspak përgjegjës për ata e as ata nuk janë përgjegjës për ty..."** Mirëpo, nëse e bën këtë, je bërë i padrejtë: **"...Nëse ti i dëbon ata, atëherë do të jesh i padrejtë."**

Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të fjalës *"el hisab"*, që përmendet në ajet. Ka prej tyre që thonë se ka qëllimin e furnizimit të tyre që do të thotë se edhe pse janë të varfër ata nuk janë rëndesë për ty, sepse llogaria e furnizimit të tyre është tek All'Ilahu. Gjithashtu, edhe ti nuk e ke vendosur jetesën tënde në kurrizin e tyre, sepse llogaria e furnizimit tënd nuk është në dorën e tyre.

Mirëpo, ky mendim më duket i largët, sepse mesa duket qëllimi i fjalës “hisab” është për llogarinë e punëve, siç thonë shumica e komentuesve. Përsa i përket pyetjes se përse All’llahu thotë se llogaria e punëve të tyre, nuk është detyrë e jotja, ndonëse prej tyre nuk u duk ndonjë punë e keqe që ta meritojnë këtë thënie, përgjigja është se politeistët i akuzonin shokët e varfër të Profetit se ishin larg All’llahut për shkak të varfërisë. Ata thoshin se punët e pranura tek All’llahu janë të lidhura me pasurinë dhe bollëkun. Ata i akuzonin shokët se kishin besuar vetëm që të siguronin jetesën e tyre dhe për të fituar kafshatën e gojës. Mirëpo, Kur’ani u përgjigjet duke u thënë se edhe po të jenë të tillë, llogaria e tyre është në dorën e All’llahut. Përderia ata kanë besuar dhe ndodhen në rreshtat e myslimanëve, nuk lejohet kurrë dëbimi i tyre.

Dëshmitar i këtij komentimi është tregimi i Profetit Nuh (Paqja qoftë mbi të!), i cili i ngjan tregimit të kurejshitëve. Ata i thoni Nuhut: **“Ata thanë: ‘Vallë, a të të besojmë ne ty, ndërkohë që ty po të pasojnë më të ulëtit?’ Ai tha: ‘Unë nuk di ç’kanë bërë ata! Llogaria e tyre është vetëm te Zoti im, a nuk kuptoni? Unë nuk do t’i dëboj besimtarët.’”**¹

Nga këtu, themi se është detyrë e çdo Profeti që ta pranojë çdo njeri që shfaq besimin e tij pa bërë dallim shtrese. Përderisa çështja është e tillë për njerëzit në përgjithësi, atëherë, si do të jetë për ata besimtarë të pastër, të cilët nuk kërkojnë, veçse afrimin tek All’llahu? Gjynahu i tyre është se ata janë duarbosh dhe nuk janë të njollosur me këtë jetë si shtresa e pasur!

¹ Sure “Shuara”, ajetet 111-114.

Dallimi i madh i Islamit

Ne e dimë se kompetencat e dijetarëve të fesë së krishterë janë zgjeruar në mënyrë qesharake, sepse ata i kanë dhënë vetes së tyre të drejtën e faljes së gjynaheve. Mirëpo, një prej ajeteve në fjalë, po ashtu edhe në ajete të tjera, mohohet qartë e drejta e dëbimit të njeriut. Edhe Profeti nuk e ka këtë të drejtë, përderisa ana tjetër ka shfaqur besimin dhe nuk ka vepruar asgjë që e nxjerr nga Islami, sepse falja e gjynaheve dhe llogaria janë në dorën e All'llahut të Vetëm e të Pashoq. Absolutisht, askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në këtë çështje.

Fjala këtu është për “dëbim fetar” dhe jo “dëbim juridik”. Sepse, po të ishte një shkollë e bazuar vetëm tek studentët e një shtrese të posaçme dhe në të të pranohej dikush që i plotëson kushtet e pranimit, e pastaj ai t'i shkelte disa nga ato kritere, atëherë dëbimi i tij nga shkolla nuk do të përbënte problem. Po ashtu, nëse drejtorit të shkollës i janë dhënë kompetenca të caktuara për administrimin e çështjeve të saj, atëherë ai ka të drejtë t'i përdorë ato kompetenca për mbrojtjen e shkollës.

Hadithi që përmend autori i tefsirit “*El Manar*” në komentimin e këtij ajeti, i cili është në kundërshtim me këtë kuptim, e ka burimin te paqartësia mes “dëbimit fetar” dhe “dëbimit juridik”.

Në ajetin e dytë, prej ajeteve në fjalë, Kur'ani i paralajmëron të pasurit se pasuria është një provim për ta. Nëse nuk dalin me sukses në provim, atëherë ata duhet të përballen me një përfundim të dhimbshëm, sepse All'llahu i sprovon disa njerëz

me disa të tjerë. **“Kështu, Ne i kemi bërë disa prej tyre si sprovë për të tjerët...”**

Fjala *“el fitnetu”*, në këtë ajet ka kuptimin e provimit. A ka provim më të vështirë sesa ai që kaluan të pasurit, të cilët për një kohë të gjatë ishin mësuar të ishin më lart se shtresat e tjera? Ata nuk merrnin pjesë as në gëzimet e as në hidhërimet e tyre. Jo vetëm kaq, por ata edhe varret i veçonin nga varret e tyre. Kurse tani atyre u kërkohet që të zhvishen prej pasurisë, të shkatërrojnë zakonet dhe traditat dhe t'i bashkohen fesë në ballë të së cilës qëndrojnë të varfërit dhe ata që i quajnë si shtresa e ulët.

Më pas, ajeti shton se çështja e tyre arrin deri aty, sa ata i shohin besimtarët e vërtetë me përbuzje: **“...që të thonë: ‘Vallë, këta janë ata prej nesh, që All’lhu u ka dhuruar mirësi?!’”**.

Pastaj ajeti u përgjigjet kundërshtarëve se me siguri që ata njerëz janë falënderues të mirësive dhe njohës së punës së mirë. Po ashtu, ata falënderuan edhe thirrjen e Profetit dhe e pranuan atë. Cila është mirësia më e madhe? Cili është falënderimi më i lartë? Për këtë, All’lhu ua forcoi besimin në zemrat e tyre: **“...A mos vallë, All’lhu nuk i njeh më mirë ata që i janë mirënjohës?”**

Ajetet 54 - 55

وَإِذَا جَاءَكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِآيَاتِنَا فَقُلْ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ ۖ كَتَبَ
 رَبُّكُمْ عَلَىٰ نَفْسِهِ الرَّحْمَةَ ۖ أَنَّهُ مَن عَمِلَ مِنكُمْ سُوءًا مَّجْهَلًا
 ثُمَّ تَابَ مِن بَعْدِهِ وَأَصْلَحَ فَإِنَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٥٤﴾
 نَفْصِلُ الْآيَاتِ وَلِتَسْتَبِينَ سَبِيلُ الْمُجْرِمِينَ ﴿٥٥﴾

“Kur të vijnë te ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaj: ‘Paqja qoftë mbi ju!’. Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën. Nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë All’llahun Falës dhe Mëshirues.”

“Ne kështu i shpjegojmë hollësisht shpalljet, në mënyrë që të qartësohet rruga e njerëzve të këqij.”

Komentimi

Disa komentues thonë se ajeti ka zbritur për ata, për të cilët ajeti i mëparshëm ndaloi dëbimin e tyre. Disa të tjerë thonë se ka zbritur për një grup gjynahqarësh, të cilët shkuan tek Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thanë se kishin bërë shumë gjynahe. Profeti heshti derisa zbriti ajeti.

Sido që të jetë shkaku i zbritjes së ajetit, ajo për të cilën nuk ka dyshim është se kuptimi i ajetit është i gjerë dhe gjithëpërfshirës, sepse ai fillon me kërkesën për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të mos i largojë gjynahqarët, sado të mëdha t'i kenë gjynahet e tyre. Jo vetëm kaq, por edhe që ai t'i presë e t'i pranojë ata. Ajeti thotë: **“Kur të vijnë te ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaj: ‘Paqja qoftë mbi ju!...’”**.

Ka mundësi se “*selami*” i përmendur në ajet është prej All'llahut me ndërmjetësimin e Profetit. Ose mund të jetë nga Profeti drejtpërdrejt. Në të dyja alternativat ka argument për pranimin, mirëseardhjen, mirëkuptimin dhe dashurinë.

Pastaj ajeti thotë: **“...Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën...”** Fjala “*ketebe*” në shumë raste vjen si metaforë për domosdoshmërinë dhe për premtimin. Në pjesën e fundit të ajetit, në të cilën sqarohet dhe shtjellohet mëshira e All'llahut, Ai flet me gjuhën e dashurisë e të butësisë: **“...Nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë All'llahun Falës dhe Mëshirues.”**

Në komentimin e ajetit 71 të sures “Nisa” thamë se fjala “*el xhehaletu*”, në të tilla tematika, ka kuptimin e tiranisë së epsheve dhe të studimit të tyre. Për shkak të këtyre epsheve dhe jo për shkak të urrejtjes së tij për All'llahun dhe të vërtetën, njeriu humbet fuqinë logjike për t'i sunduar epshet. Një njeri i tillë, edhe pse është në dijeni për gjynahun dhe ndalimin, quhet “*xhahil*”, që domethënë “*i paditur*”, sepse dija e tij është e fshehur pas perdeve të epsheve dhe dëshirave të këqija. Ky njeri është përgjegjës i

gjynaheve të veta dhe përpiket që ta ndreqë veten dhe t'i shlyejë gabimet.

Ajeti e urdhëron Profetin që të mos largojë asnjë njeri besimtar i cilësdo shtresë që të jetë dhe sido që të jenë rrethanat e tij. Të gjithë t'i shohë me syrin e barazisë, t'i afrojë dhe të punojë për përmirësimin e tyre, derisa të pastrohen prej gjynaheve.

Ajeti pasardhës, për ta forcuar më shumë këtë temë, tregon se All'llahu i Madhëruar i sqaron qartë shenjat dhe urdhrat e Tij, me qëllim që rruga e hulumtuesit dhe e kërkuesit të Tij të jetë e qartë. Po ashtu, sqaron rrugën e gjynahqarëve kokëfortë prej armiqve të All'llahut. **“Ne kështu i shpjegojmë hollësisht shpalljet, në mënyrë që të qartësohet rruga e njerëzve të këqij.”**

Në këtë ajet është e qartë se fjala *“el muxhrim”* (kriminel, gjynahqar) nuk ka kuptimin e të gjithë gjynahqarëve, sepse i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë ajet është i ngarkuar që t'i pranojë gjynahqarët që shkojnë tek ai, sado i madh të jetë gjynahu i tyre, të cilin e kanë bërë nga padituria. Prandaj, gjynahqarët këtu janë ata gjynahqarë kokëfortë, të cilët nuk i nënshtrohen së vërtetës. Kjo do të thotë se pas ftesës së përgjithshme për tek All'llahu, e cila përfshin edhe gjynahqarët e penduar, sqarohet plotësisht rruga e kokëfortëve që nuk heqin dorë nga kokëfortësia e tyre.

Ajeti 56 - 58

قُلْ إِنِّي نُهِيتُ أَنْ أَعْبُدَ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ ۚ قُلْ لَا
 أَتَّبِعُ أَهْوَاءَكُمْ ۖ قَدْ ضَلَلْتُ إِذَا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُهْتَدِينَ ﴿٥٦﴾
 قُلْ إِنِّي عَلَىٰ بَيِّنَةٍ مِّن رَّبِّي وَكَذَّبْتُمْ بِهِ ۚ مَا عِندِي مَا
 تَسْتَعْجِلُونَ بِهِ ۚ إِنِ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ ۚ يَقْصُ الْحَقُّ ۖ وَهُوَ خَيْرُ
 الْفَاصِلِينَ ﴿٥٧﴾ قُلْ لَوْ أَنَّ عِندِي مَا تَسْتَعْجِلُونَ بِهِ لَقَضِيَ
 الْأَمْرُ بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ ۖ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِالظَّالِمِينَ ﴿٥٨﴾

“Thuaj: ‘Mua më është ndaluar t’i adhuroj ata, të cilëve ju u luteni në vend të All’llahut’. Thuaj: ‘Unë nuk i ndjek dëshirat tuaja të kota, sepse atëherë do të isha i humbur dhe nuk do të isha nga ata që janë në rrugë të drejtë.’”

“Thuaj: ‘Unë kam provë të qartë nga Zoti Im, por ju e përgënjeshtroini atë. Ajo që ju kërkon me nxitim, nuk është në pushtetin tim. Vendimi i takon vetëm All’llahut. Ai e shpall të vërtetën dhe Ai është Gjykatësi më i mirë.’”

“Thuaj: ‘Sikur ta kisha në dorë atë që kërkon ju, shpejt e shpejt do të sqarohej puna midis meje dhe jush. All’llahu i njeh më së miri të padrejtët.’”

Komentimi

Këmbëngulja e kotë

Në këto ajete fjala është përsëri për politeistët dhe idhujtarët kokëfortë. Si shumë ajete të tjera të kësaj sureje, sipas kontekstit të këtyre ajeteve, politeistët e ftuan Profetin që të përqafonte fenë e tyre. Për këtë zbriti ajeti: **“Thuaj: ‘Mua më është ndaluar t’i adhuroj ata, të cilëve ju u luteni në vend të All’lauhut...’”**.

Fraza *“nuhijtu”* (jam ndaluar), që përmendet në kohën e shkuar dhe është në formë të panjohur, tregon se ndalimi i adhurimit të idhujve nuk është çështje e re, por ka qenë e përhershme dhe e vazhdueshme, dhe e tillë do të qëndrojë. Pastaj me fjalinë: **“...Thuaj: ‘Unë nuk i ndjek dëshirat tua të kota...’”**, Kur’ani u përgjigjet qartë kokëfortësisë së tyre, sepse adhurimi i idhujve nuk përkethehet as me arsyen, dhe as me argumentet logjike. A ka mundësi që njeriu t’i nënshtrohet krijesave të tjera që janë më të ulëta se ai? Si është e mundur që ata idhuj, të cilët vetë njeriu i ka prodhuar, të jenë objekt adhurimi dhe njeriu të strehohet tek ato për zgjidhjen e problemeve? Bazuar në këtë, zanafilla e adhurimit të idhujve nuk është veçse imitim verbues dhe pasim i epsheve e uni-t. Në fund të ajetit, Kur’ani përforcon edhe njëherë se nëse e vepron atë, **“...atëherë do të isha i humbur dhe nuk do të isha nga ata që janë në rrugë të drejtë.”**

Ajeti pasardhës përmban përgjigje tjetër: **“Thuaj: ‘Unë kam provë të qartë nga Zoti Im, por ju e përgënjeshtroni atë...’”** Fjala *“el bejjinetu”*, në origjinë ka kuptimin e ndarjes mes dy gjërave, ku mes tyre nuk ka as përzierje, e as lidhje. Pastaj është përdorur për

argumentin dhe faktin e qartë, sepse ajo ndan të vërtetën nga e pavërteta.

Në terminologjinë e jurisprudencës përdoret për dy dëshmitarë të drejtë. Mirëpo, kuptimi i fjalës në gjuhësi është shumë i gjerë dhe dëshmia e drejtë është një prej atyre kuptimeve. Po ashtu, mrekullia është argument i qartë, sepse ajo ndan mes të së drejtës dhe të së padrejtës, të së vërtetës dhe të së pavërtetës. Nëse u thuhet ajeteve dhe rregullave të All'Ilahut se janë "bejjinate", kjo ndodh për faktin se janë prej të vërtetave të shumta të kësaj fjale.

Për këtë, Profeti është urdhëruar në këtë ajet që të thotë se argumentimi në çështjen e adhurimit të All'Ilahut dhe në luftimin e idhujve është i qartë dhe "bejji". Përgënjeshtrimi dhe mohimi juaj nuk e pakësojnë të vërtetën e argumentit.

Pastaj ajeti tregon një fakt imagjinar prej fakteve të tyre. Ai është se ata thoshin: "Nëse je i vërtetë, atëherë shpejtoje dënimin që po na thua." Profeti u thotë atyre: "**...Ajo që ju kërkoni me nxitim, nuk është në pushtetin tim...**", sepse këto punë dhe urdhra janë të gjitha në dorën e All'Ilahut "**...Vendimi i takon vetëm All'Ilahut...**". Pas kësaj, ajeti thotë se "**...Ai e shpall të vërtetën dhe Ai është Gjykatësi më i mirë.**"

Natyrisht, i fuqishmi që ndan të vërtetën nga e pavërteta dhe në mënyrën më të mirë, ai duhet të jetë më i dituri i të gjithëve. Është e lehtë për atë që të dallojë mes të vërtetës dhe të së pavërtetës. Cilësia e dijes dhe e fuqisë janë prej cilësive të Vetvetishme e të pakufizuara të All'Ilahut. Prandaj, Ai është më i Miri në ndarjen e së vërtetës nga e pavërteta.

Ajeti pasardhës e urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i thotë atij grupi kokëfortë e injorantë se ajo që kërkoni nga unë për përsheptim,

po të ishte e mundur, do t'i përgjigjesha, do të sqarohej çështja dhe asgjë nuk do të gjendej mes meje dhe jush: **"Thuaj: 'Sikur ta kisha në dorë atë që kërkoni ju, shpejt e shpejt do të sqarohej puna midis meje dhe jush...'"**.

Me qëllim që të mos mendojnë se dënimin e tyre e ka palosur harresa, në fund, ajeti thotë: **"...All'llahu i njeh më së miri të padrejtët."** dhe ata do t'i ndëshkojë në kohën e caktuar.

Hulumtime

Këtu duhen përmendur disa pika:

1- Nga ajetet e Kur'anit mësohet se shumë prej popujve të shkuar i bënë të njëjtën kërkesë Profetit të kohës së tyre, duke i thënë se nëse je i vërtetë për ato që thua, atëherë përse nuk na e sjell dënimin të cilin po na e premton.

Populli Nuhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) i thanë atij: **"Ata thanë: 'O Nuh, ti na kundërshtove ne, madje e zgjate kundërshtimin. Le të na godasë ajo me çfarë na kërcënon, nëse thua të vërtetën!'"**.¹

Në suren "Isra" lexojmë se e njëjta kërkesë i është përsëritur të Dërguarit të All'llahut, Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), derisa i thanë: **"...ose, derisa ta bësh qiellin të bjerë copa-copa mbi ne, siç ke thënë..."**² Shkaku për këto kërkesa ka qenë jologjik, tallës dhe ofendues. Ose ka qenë dëshirë për të parë mrekullinë. Në të dy rastet ka

¹ Surja "Hud", ajeti 32.

² Surja "Isra", ajeti 92.

qenë kërkesë prej budallallëkut. Si është e mundur që një njeri të kërkojë zhdukjen e vetes së vet?

S'ka dyshim se fanatizmi verbues dhe kokëfortësia janë fatkeqësi të mëdha, që qëndrojnë përballë mendjes dhe logjikës.

2- Vërtet, kuptimi i fjalisë së ajetit: "...Vendimi i takon vetëm All'Ilahut..." është i qartë. Që do të thotë se çdo çështje në botën e Krijimit dhe në atë të zbatimit të ligjeve janë në dorën e All'Ilahut. Prandaj, edhe i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur kryente një mision, ai e bënte me urdhër prej All'Ilahut.

Kur Isai (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*) e ngjallte të vdekurin, këtë e bënte me lejen e All'Ilahut. Po ashtu, çdo pozitë, përfshirë dhe udhëheqjen dhe gjykimin sipas urdhrave të All'Ilahut, nëse i jepet dikujt, është me lejen e All'Ilahut.

Është për të ardhur keq se kjo frazë është shfrytëzuar gjatë historisë, siç bënë khavarixhët në luftën e Sifinit, ku qëllimi ishte: Fjala e vërtetë, me anë të së cilës synohej e pavërteta, siç thotë Imam Aliu, derisa u bë parrullë e tyre se gjykimi i takon vetëm All'Ilahut. Nga padituria ata thonin se kush gjykon me lejen e All'Ilahut, ai e ka kundërshtuar thënien: **"...Vendimi i takon vetëm All'Ilahut..."**, ndërkohë që e lexonin shumë Kur'anin, por pak e kuptonin. Vetë Kur'ani flet qartë për çështjen e mosmarrëveshjes mes bashkëshorteve dhe thotë që të zgjidhet një ndërmjetës nga ana e bashkëshortit dhe një nga ana e bashkëshortes, siç thuhet në ajetin e 35 të sures "Nisa": **"...atëherë caktoni një ndërmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas..."**.

Disa të tjerë e konsiderojnë këtë ajet (siç thotë Fakhri Raziu në komentimin e tij) si argument të detyrimit *"al xhebrije"*. Ata thonë: Nëse themi se çështjet në këtë botë janë në dorën e

All'llahut, atëherë nuk ka vend për zgjedhje. Mirëpo, ne e dimë se liria e dëshirave të robit të All'llahut dhe liria e zgjedhjes së tyre janë me lejen e All'llahut, i cili deshi që njerëzit të jenë të lirë në zgjedhje me veprat që bëjnë, me qëllim që ata të jenë vetë përgjegjës për punët e tyre.

3- Folja *"jekussu"*, në gjuhësi ka kuptimin e prerjes *"el kat'un"*. Në fjalor thuhet: Prerja e flokëve dhe e thonjve, pra prerja e një pjese të tyre me gërshërë. Sipas kësaj, kuptimi *"ju kasulahu"* është se All'llahu e ndan të vërtetën nga e pavërteta. Prandaj, këtë folje e pason fraza: **"Ai është ndarësi më i mirë"**, e cila është përforcuese. Folja *"jekusu"*, që përmendet këtu, nuk ka kuptimin e vazhdimësisë së tregimit, siç e menduan disa komentues.

Ajetet 59 - 62

وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ ۚ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ ۚ
وَمَا تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظِلْمَتٍ أَلْأَرْضِ وَلَا رَطْبٍ
وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ ﴿٥٩﴾ وَهُوَ الَّذِي يَتَوَفَّاكُم بِاللَّيْلِ وَيَعْلَمُ
مَا جَرَحْتُم بِالنَّهَارِ ثُمَّ يَبْعَثُكُمْ فِيهِ لِيُقْضَىٰ أَجَلٌ مُّسَمًّى ۖ ثُمَّ إِلَيْهِ
مَرْجِعُكُمْ ثُمَّ يُنَبِّئُكُم بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٦٠﴾ وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ عِبَادِهِ ۖ
وَيُرْسِلُ عَلَيْكُمْ حَفَظَةً حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَحَدَكُمْ الْمَوْتُ تَوَفَّتْهُ رُسُلُنَا وَهُمْ
لَا يُفْرِطُونَ ﴿٦١﴾ ثُمَّ رُدُّوْا إِلَى اللَّهِ مَوْلَاهُمُ الْحَقِّ ۚ أَلَا لَهُ الْحُكْمُ وَهُوَ أَسْرَعُ
الْحَسِبِينَ ﴿٦٢﴾

“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i di ato. Ai e di ç’ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).”

“Ai jua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t’ju tregojë gjithçka që keni bërë.”

“Ai është Sunduesi mbi robërit e Vet. Ai ju dërgon rojtarë (melekë) të cilët, kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, ia marrin shpirtin, duke mos bërë kurrfarë lëshimi.”

“Pastaj të gjithë do të kthehen tek All’llahu, Zoti tyre i vërtetë. Vetëm Atij i takon të gjykojë dhe Ai është më i shpejtë në llogari.”

Komentimi

Sekretet e të padukshmes (Gajb)

Në këto ajete flitet rreth dijes së All’llahut, fuqisë së Tij, urtësisë dhe urdhrit të Tij. Ato sqarojnë atë ç’ka përmendën në mënyrë të përmbledhur ajetet e mëparshme. Ajeti sqaron dijen e All’llahut dhe thotë: **“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i di ato...”**

“*Mefatih*” është shumësi i fjalës “*el miftah*” (çelësi). Kurse fjala “*meftah*” ka kuptimin e arkës, në të cilën depozitohen gjëra.

Sipas fjalës së parë, kuptimi është se të gjithë çelësat e së padukshmes janë në dorën e All’llahut.

Sipas të dytës, kuptimi është se të gjitha depozitat e së padukshmes janë në dorën e All’llahut.

Ka mundësi që të dy kuptimet janë të bashkuar në një frazë të vetme, siç është e njohur në shkencën e Usulit (parimet e jurisprudencës).

Përdorimi i një fjale për disa kuptime nuk përbën ndonjë problem. Për këtë, të dy fjalët e lartpërmendura janë të pandashme, sepse, kur është arka, është edhe çelësi.

Më e njohura është se fjala “*mefatih*” ka kuptimin e çelësave e jo të depozitës, sepse qëllimi është sqarimi i dijes së All’llahut dhe çelësat janë prej mjeteve të njohjes së thesareve të ndryshme. Ky kuptim është më i përshtatur në këtë ajet. Kjo fjalë, “*mefatih*”, përmendet edhe në dy vende të tjera në Kur’an: në suren “Kasas”, ajeti 76 dhe në suren “Nur”, ajeti 61. Për ta forcuar më shumë këtë kuptim, ajeti vazhdon e thotë: “**...Ai e di ç’ka në tokë dhe në det...**”.

Fjala “*el berr’rru*” ka kuptimin e vendit të gjerë. Me këtë emër quhet edhe toka.

“*El bahru*” është vendi i gjerë, në të cilin grumbullohet uji. Kjo fjalë përdoret edhe për detërat, oqeanet dhe ndonjëherë edhe për lumenjtë e mëdhenj.

Thënia se All’llahu di se çfarë ndodhet në tokë e në det është aludim i gjithëpërfshirjes së Tij për çfarë ndodhet në tokë e në det. Kjo gjithëpërfshirje e Tij në tokë e në det, në të vërtetë, simbolizon dijen e Tij të gjerë. Ai është i Ditur për lëvizjet e miliona gjallesave, të mëdha e të vogla, në thellësi të detrave. Ai është i Gjithëditur për dridhjet e gjetheve të pemëve në çdo pyll e në çdo mal. Ai është i Gjithëditur për çdo gonxhe dhe për çeljen e tyre. Ai është i Gjithëditur për fryrjen e flladit në lugina, në kodra e male. Ai është i Gjithëditur për numrin e qelizave në trupin tonë dhe për numrin e rruazave të gjakut. Ai është i Gjithëditur për lëvizjet e padukshme të elektroneve në zemrën e elektronit. Ai është i Gjithëditur për të gjitha vendimet që kalojnë në qelizat e mendjeve tona, deri edhe ato që ndodhen në thellësinë e trupave tanë. Po, Ai dhe vetëm Ai është i Gjithëditur për gjithçka. Këtë e forcon edhe më shumë duke thënë: “**...asnjë gjethe nuk bie, pa e ditur Ai...**”. Që do të thotë, se Ai është i Gjithëditur për numrin e gjetheve, për momentin e shkëputjes së tyre nga degët dhe për

rënien e tyre në tokë. E gjithë kjo është e ditur dhe e qartë përballë dijes së All'llahut. Prandaj, asnjë kokërr nuk mund të fshihet në palët e tokës, pa patur dije All'llahu për të me të gjitha detajet: **“...dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës...”**.

Vallë kush mund ta dijë se sa kokrra apo fara mbart era që fryn në skajet e ndryshme të tokës ditën dhe natën dhe në cilën tokë e lëshon ajo atë derisa përgatitet për mbirje? Kush është ai që e di se sa fara mbarten në çdo orë nëpërmjet njeriut apo insekteve nga një vend në tjetrin? Cila është ajo mendje elektronike që arrin të numërojë numrin e gjetheve të pemëve që bien çdo ditë? Shikoje një pyll prej pyjeve në stinën e vjeshtës, sidomos pas një shiu të furishëm apo të një ere të fuqishme, vështro pamjen e rënies së gjetheve në mënyrë të vazhdueshme e të mrekullueshme, e atëherë do të të zbulohet e vërteta se një dije e tillë nuk do të jetë asnjëherë në dorën e njeriut.

Në realitet, rënia e gjetheve është koha e tharjes së saj, kurse rënia e farës në një pjesë të tokës është fillimi i jetës së saj. Askush përveç All'llahut nuk e di sistemin e kësaj tharjeje dhe të kësaj jete të bimëve. Madje çdo fazë që kalon fara deri në plotësimin e saj, e di vetëm All'llahu.

Kjo temë ka ndikim filozofik edhe edukativ. Ndikimi filozofik mohon mendimin e tyre që e kufizojnë dijen e All'llahut tek të përgjithshmet dhe besojnë se Ai nuk është i Ditur për të pjesshmet. Në këtë ajet dëshmohet se All'llahu është i Ditur për të përgjithshmet e për të pjesshmet. Kurse ndikimi edukativ është i qartë, sepse besimi në këtë dije të gjerë të All'llahut i thotë njeriut se të gjitha sekretet e eksiztencës tënde, të punëve të tua, të thënieve e qëllimeve të tua dhe të mendimeve të tua, ato i di All'llahu i Madhëruar. Nëse njeriu beson realisht në këtë, atëherë si mund të mos jetë mbikëqyrës i vetes së tij dhe të drejtojë

mendimet, thëniet dhe veprimet e tij? Në fund, ajeti thotë: “...as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë...”

Këto fraza të shkurtra sqarojnë dijen e pakufizuar të All’llahut dhe se Ai është i Mirinformuar për të gjitha krijesat, sepse përdorimi i fjalës “*er rutbu*” dhe “*jabis*” nuk është me kuptim gjuhësor, por me kuptim figurativ për përfshirjen dhe përgjithësinë.

Komentuesit kanë mendime të shumta për kuptimin e frazës “*kitabun mubijn.*” Por, më i forti është se ai aludon për dijen e All’llahut. Që do të thotë se të gjitha krijesat janë të regjistruara në dijen e All’llahut. Thuhet se kjo frazë ka kuptim tjetër, që është: All’llahu është i Ditur për krijesat dhe për hallkat e shkaqeve në të cilat është shkruar çdo gjë.

Është transmetuar nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) se fjala “*el uerekatu*”, ka kuptimin e foshnjes së abortuar, “*el habetu*” ka kuptimin e djalit, “*dhulumatul erdi*” ka kuptimin e mitrës së nënës, “*er rutbu*” ka kuptimin e asaj që mbetet e gjallë prej spermës dhe “*jabisun*”, ajo që zhduket prej spermës.¹

S’ka dyshim se ky komentim nuk përputhet me sendet (jo frymorët), sipas kuptimit gjuhësor të ajetit, sepse kuptimi i gjethes, i farës, i errësirave të tokës, i të njomtit, i të thatit, janë të njohura. Mirëpo Imamët e Ehli Bejtit, me anë të këtij komentimi, duan që t’ia zgjerojnë horizontin e të menduarit myslimanëve për Kur’anin, me qëllim që të mos jenë të kufizuar në kornizën e fjalëve, por kur gjenden arsye dhe argumente, ato ta zgjerojnë horizontin e të menduarit. Hadithi i lartpërmendur tregon se kuptimi i fjalës “*el habbetu*” nuk është e kufizuar vetëm me farën e bimëve, por ai kuptim përfshin edhe spermën e njeriut.

¹ Tefsiri “Burhan”, vëll. 1, f. 528.

Në ajetin e dytë thuhet se punët e njeriut janë të rrethuara nga dija e All'llahut. Ky është qëllimi kryesor për sqarimin e fuqisë absolute të All'llahut, me qëllim që njerëzit të nxjerrin mësimë edukative nga ky hulumtim. Ajeti fillon me thënien se All'llahu është Ai që i merr shpirtat tuaj në darkë dhe e di se çfarë bëni gjatë ditës. **“Ai jua merr shpirtat (ju vë në gjumë) natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën...”**

Fjala *“teuaffa”* do të thotë rikthim. Thuhet se gjumi është rikthim i shpirtit, do të thotë se gjumi është vëllai i vdekjes. Vdekje do të thotë të ndaluarit plotësisht të funksionimit të mendjes dhe shkëputja e plotë e lidhjes mes shpirtit dhe trupit. Kurse gjumi është ndalimi i funksionimit të një pjese të aparatit mendor dhe dobësimi i lidhjes së shpirtit me trupin. Për këtë, gjumi është një fazë e vogël (e shkurtër), e cila është një prej fazave të vdekjes.

Fjala *“xherahtum”* vjen nga fjala *“xherhun”* që ka kuptimin e fitimit, që do të thotë se ju, natën dhe ditën, jetoni nën hijen e fuqisë së All'llahut dhe të dijes së Tij. Ai që është i ditur për çarjen e farës dhe rritjen e saj në barkun e tokës dhe që e di rënien e gjetheve të pemëve dhe tharjen e tyre në cilin vend dhe në cilën kohë, gjithashtu, është i ditur edhe për punët tuaja.

Pastaj thotë se sistemi i gjumit dhe i zgjimit është i përsëritur, sepse ju fleni natën: **“...pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar...”**, që do të thotë se zgjohemi kur vjen dita. Ky proces vazhdon deri në fund të jetës tuaj. Kur'ani sqaron rezultatin e fundit të këtij kërkimi: **“...Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t’ju tregojë gjithçka që keni bërë.”**

Ajeti i tretë, prej ajeteve në fjalë, e sqaron më shumë përfshirjen e punëve të njeriut me dijen e All'llahut dhe ruajtjen e tyre me hollësi për Ditën e Gjykimit, pasi ato punë i regjistrojnë

mbikëqyrësit e caktuar. Ajeti thotë: **“Ai është Sunduesi mbi robtë e Vet...”**.

Fjala *“el kahiru”* ka kuptimin e mposhtjes, sunduesit para të cilit nuk qëndron asnjë fuqi. Fjala *“el galibu”* (triumfues), nuk e ka këtë veçori, sepse ajo është e përgjithshme dhe me kuptim të gjerë. Fjala *“hafedhetun”* është shumësi i fjalës *“hafidhun”* (ruajtës, mbrojtës), të cilët janë melekët e caktuar për ruajtjen e punëve të njerëzve, siç thuhet në suren *“Infitar”*, ajetet 10-12: **“...ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.”**

Disa komentues mendojnë se ata nuk ruajnë punët e njeriut, sepse janë urdhëruar për mbrojtjen e njeriut prej ndodhive e fatkeqësive deri në fundin e jetës së tij. Thënie **“...kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja...”**, e konsiderojnë argument të kësaj thënieje. Po ashtu edhe ajeti 11 i sures *“Rad”* mund të konsiderohet argument për këtë.¹

Mirëpo, po të mendojnë thellë për ajetin në fjalë, do të sqarohet se qëllimi është për mbrojtjen e njeriut, kurse çështjen e melekëve të caktuar për mbrojtjen e njeriut do ta sqarojmë me dëshirën e All’llahut në komentimin e sures *“Rad”*.

Më poshtë Kur’ani sqaron se ruajtja e veprave vazhdon deri në fund të jetës dhe në momentet e ardhjes së vdekjes. **“...Ai ju dërgon rojtarë (melekë), të cilët, kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, ia marrin shpirtin...”**

Në fund, ajeti sqaron se ato melekë as nuk neglizhojnë, e as nuk tejkalojnë në misionin e tyre. Ata as nuk vonohen, e as nuk shpejtohen: **“...duke mos bërë kurrfarë lëshimi.”**

¹ Tefsiri *“Mijzan”*, vëll. 7, f. 131.

Në ajetin e fundit, prej ajeteve në fjalë, Kur'ani tregon për fazën e fundit të punëve të njeriut. Ajeti thotë: **“Pastaj të gjithë do të kthehen tek All’llahu, Zoti tyre i vërtetë...”**, që do të thotë se ata do të kthehen tek All’llahu pasi i palosën fazat e jetës së tyre dhe u mbyll regjistri i punëve të veta. Në atë gjykatë çdo gjë është në dorën e All’llahut: **“...Vetëm Atij i takon të gjykojë...”**.

Edhe pse punët e njerëzve gjatë gjithë historisë janë të shumta, All’llahu është shumë i shpejtë në shikimin e tyre: **“...dhe Ai është më i shpejtë në llogari.”**.

Në disa transmetime thuhet se All’llahu do t’i llogarisë të gjithë njerëzit me një kohë sa është mjelja e deleve.¹

Siç e kemi thënë edhe në komentimin e ajetit 202 të sures “Bekare”, llogaridhënia është aq e shpejtë, saqë kryhet në sekondë. Mirëpo, përmendja e mjeljes së deles në transmetimin e lartpërmenduar sqaron kohën e shkurtër që duhet për llogarinë. Në një transmetim tjetër thuhet se All’llahu i llogarit njerëzit sa hap e mbyll sytë.² Argument për këtë është ajo që përmendëm në komentimin e këtij ajeti, që punët e njerëzve ndikojnë në ekzistencën e tij dhe në ekzistencën e krijesave të tjera që e rrethojnë, njëlloj si makineria që regjistron sasinë e lëvizjeve të saj me anë të numeratorit të lidhur me të.

Me fjalë më të qarta: Sikur të gjendej një aparat shumë précis, do të arrinte të regjistronte shikimet gjynahqare të syrit të njeriut, gënjeshttrat, shpifjet, akuzat, sharjet që dalin nga gjuhët.

Çdo organ i trupit të njeriut, në shtesë edhe të shpirtit të tij, kanë aparatin që e shfaq llogarinë shumë shpejt. Nëse në disa transmetime thuhet se llogaria e përgjegjësve (sipërmarrësve) dhe

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 313.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 3, f. 313.

e të pasurve zgjat në Ditë e Kiametit, kjo nuk ka kuptimin e zgjatjes së kohës së llogarisë, por është koha e llogaritjes së tyre, sepse ata do të japin përgjigje për shumë pyetje që do t'u drejtohen në lidhje me punët e tyre që kanë bërë në këtë jetë. Kjo do të thotë se rëndesa e përgjegjësisë së tyre dhe domosdoshmëria e përgjigjes së pyetjeve për plotësimin e argumenteve ndaj tyre, çojnë në zgjatjen e kohës së llogarisë së tyre.

Ky grup ajetesh përbën një mësim edukativ të plotë për robtë e All'llahut rreth dijes së Tij dhe se çdo gjë në këtë jetë, qoftë më e vogla apo më e madhja, All'llahu është i ditur për të dhe ajo është e rrethuar nga sundimi i mbikëqyrjes së Tij. Ai është i Gjithëditur për ruajtësit besnikë të punëve të njeriut dhe për marrjen e shpirttrave të tyre në kohën e caktuar. Ai është i Gjithëditur dhe i Plotfuqishëm t'i ringjallë ata në Ditën e Kiametit, si dhe, të bëjë llogaritjen e tyre në mënyrë të hollësishme e të shpejtë.

Vallë, si është e mundur që një njeri t'i besojë të gjitha këtyre gjërave e të mos mbikëqyrë punët e veta, duke bërë padrejtësi, duke gënjyer e shpifur për të tjerët? A bashkohen të gjitha këto me besimin?

Ajetet 63 - 64

قُلْ مَنْ يُنَجِّيكُمْ مِّنْ ظُلُمَاتِ الْبَرِّ وَالْبَحْرِ تَدْعُونَهُ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً لَّيِّنٌ
أَنجِنَا مِنْ هَذِهِ لَنَكُونَنَّ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿٦٣﴾ قُلِ اللَّهُ يُنَجِّيكُمْ مِّنْهَا وَمِنْ
كُلِّ كَرْبٍ ثُمَّ أَنْتُمْ تُشْرِكُونَ ﴿٦٤﴾

“Thuaju: ‘Kush ju shpëton nga errësira e tokës dhe e detit, kur i luteni Atij haptazi dhe fshehurazi (duke thënë): Nëse Ai na shpëton prej këtyre (rreziqeve), vërtet do të bëhemi mirënjohës.”

“Thuaj: ‘All’llahu ju shpëton nga ato dhe nga çdo e keqe tjetër, por prapëseprapë ju adhuronit të tjerë veç Tij.”

Komentimi

Drita që ndriçon në errësirë

Edhe një herë Kur’ani i merr përdore politeistët dhe i drejton që të hyjnë në thellësinë e natyrës së tyre të krijuar (el fitratu), e cila është e mbushur me sekrete, që t’u tregojë atyre dritën e monoteizmit dhe të adhurimit të All’llahut të Vetëm e të Pashoq.

Kur'ani i thotë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'u thotë atyre: **"Thua ju: 'Kush ju shpëton nga errësira e tokës dhe e detit...'"**.

Errësira, nganjëherë mund të jetë e prekshme, e herë tjetër mund të jetë shpirtërore. Ajo e prekshmja është kur shkëputet drita ose dobësohet deri në atë masë, sa nuk shihet asgjë ose shikon me përpjekje të mëdha. Errësitat shpirtërore janë problemet dhe vështirësitë që përfundojnë të errëta dhe të pazgjidhura. Ato janë padituria, çrregullimi shoqëror, ekonomik dhe mendor, devijimet dhe degjenerimi moral, që të çojnë në farkeqësi etj. Të gjitha këto janë errësira.

Dihet se errësira si errësirë në vetvete është e frikshme dhe ndikon në të fantazuarit dhe iluzionet. Shumica e sulmeve të kafshëve të egra apo edhe vjedhjet e grabitjet kryhen në errësirë. Kur vjen errësira, aktivizohen iluzionet e përfytyrimet, duke sjellë hije të frikshme dhe frika e tmerrit pushtojnë brendinë e njerëzve.

Errësira është prej hiçit "el adem" dhe njeriu me natyrën e tij i largohet kësaj dhe i frikësohet. Për këtë, ai i frikësohet errësirës. Nëse në këtë errësirë ndodhin gjëra të frikshme: sikur njeriu të jetë duke udhëtuar në det dhe e rrethojnë dallgët e tmerrshme në natën e errët, frika e tij do të jetë më e madhe. Kurse, po të ndodhte ditën, do të ishte më e vogël. Kjo ndodh sepse njeriu në të tilla rrethana i sheh rrugët e shpëtimit të bllokuara para syve të vet.

E njëjta gjë ndodh sikur të udhëtojnë në errësirë nëpër shkretëtirë dhe dëgjon ulërimat e egërsirave që kërkojnë gjahun. Në këtë gjendje, njeriu harron gjithçka dhe mendon vetëm për veten e vet dhe për dritën që ndodhet në thellësi të tij, që e orienton drejt Krijuesit Fuqiplotë, i cili i largon vështirësitë dhe mundimet. Në këtë gjendje hapen dritaret për në botën e

monoteizmit dhe të besimit në një Zot të vetëm e Fuqiplotë. All'Ilahu thotë: **"...kur i luteni Atij haptazi dhe fshehurazi..."**.

Në këtë gjendje, njeriu bën marrëveshje me veten e tij dhe i premteton vetes se: **"...Nëse Ai na shpëton prej këtyre (rreziqeve), vërtet do të bëhemi mirënjohës."**

Pastaj ajeti e urdhëron Profetin që t'u thotë atyre se All'Ilahu do t'i shpëtojë ata nga kjo situatë dhe nga situatat e tjera të rrezikshme e të frikshme. Këtë e ka bërë shumë herë edhe më përpara. Mirëpo, kur rreziku langohej prej tyre, ata ktheheshin në rrugën e politeizmit e të mosbesimit. Ajeti thotë: **"Thuaj: 'All'Ilahu ju shpëton nga ato dhe nga çdo e keqe tjetër, por prapëseprapë ju adhuronin të tjerë veç Tij.'"**

Hulumtime

Këtu duhen përmendur disa pika:

1- Ka mundësi që përmendja e fjalës *"tederr'rruan"*, që është lutja e dukshme dhe e fjalës *"khifjetun"*, që është lutja në fshehtësi, tregon se vështirësitë dhe fatkeqësitë janë të ndryshme. Ajo vështirësi që nuk ka arritur në fazën më të ashpër, mund të kërkojë lutje në fshehtësi. Dhe kur arrin në fazën shumë të ashpër, e bën njeriun që të ngrejë duart e të lutet me zë dhe mund të jetë e shoqëruar edhe me të qara. Pa dyshim, që All'Ilahu i zgjidh problemet, qofshin të lehta apo të vështira.

2- Disa komentues mendojnë se ajeti tregon për katër gjendje psikike të njeriut. Secila prej tyre është reagim i caktuar për

shfaqjen e problemeve. Ato gjendje janë: gjendja e lutjes, e të frikësuarit, e çiltërsisë dhe gjendja e falënderimit në kohën e shpëtimit prej rreziqeve.

Fatkeqësisht, tek disa njerëz, këto situata kalojnë sipërfaqësisht, sikur të jenë të pavlera në përballjen me rreziqet dhe problemet. Përderisa këto gjendje nuk janë të shoqëruara me kuptim e arsyetim, ato zhduken dhe fiken sapo të kalojë situata. Bazuar në këtë, këto situata, edhe pse janë kalimtare, mund të jenë argument për njohjen e All'llahut për ata që nuk i përceptojnë argumentet e tjera.

3- Fjala “el kerbu” në origjinalitet ka kuptimin e gërmimit të tokës dhe të përmbysjes së saj. Gjithashtu, ka kuptimin e lidhjes së nyjes në litarin e kovës. Më pas është përdorur për vështirësitë, shqetësimin dhe hidhërimin, të cilat e shndërrojnë zemrën e njeriut duke e bërë të rëndë si nyja e kovës.

Gjithashtu, përmendja e fjalës “el kerbu”, e cila ka kuptim të gjerë dhe përfshin llojet e problemeve dhe të vështirësive, pas fjalisë: **“...nga errësira e tokës dhe e detit...”**, që përfshin një anë të problemeve, kjo konsiderohet si përmendja e kuptimit të përgjithshëm pas sqarimit të kuptimit të përveçëm.

Këtu duhet të përmendim një hadith që e përcjellin disa komentime të këtij ajeti. Është transmetuar nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Më e mira dua është ajo që bëhet në fshehtësi dhe më i miri risk (furnizim) është ai që mjafton.”*¹

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë, tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll.1, f. 724.

Po ashtu transmetohet se një ditë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kaloi pranë disa njerëzve që luteshin me zë të lartë. Ai u tha atyre: *"Ju nuk i luteni shurdhit, as të papranishmit. Ju i luteni Dëgjuesit dhe të Afërtit."*¹

Nga kjo thënie përfitohet se lutja më e mirë është ajo që bëhet e fshehtë, me zë të ulët dhe e shoqëruar me çiltërsi.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", fundi i ajetit në fjalë, tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll.1, f. 724.

Ajeti 65

قُلْ هُوَ الْقَادِرُ عَلَىٰ أَنْ يَبْعَثَ عَلَيْكُمْ عَذَابًا مِّنْ فَوْقِكُمْ أَوْ مِنْ
تَحْتِ أَرْجُلِكُمْ أَوْ يَلْبِسَكُمْ شِيْعًا وَيُذِيقَ بَعْضَكُمْ بَأْسَ بَعْضٍ ۚ أَنْظُرْ
كَيْفَ نُصَرِّفُ الْآيَاتِ لَعَلَّهُمْ يَفْقَهُونَ ﴿٦٥﴾

“Thuaj: ‘Ai ka fuqi t’ju ndëshkojë prej së larti ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njëri-tjetrit. Shih si ua shpjegojmë shpalljet, që ata të mund të kuptojnë.”

Komentimi

Ngjyrat e dënimit

Në ajetet e mëparshme, të cilët përmbanin sqarimin e monoteizmit të natyrshëm, dukej qartë dashuria e All’llahut për robtë e Tij, përkrahja e Tij për ata në situata të vështira dhe përgjigjia e lutjes së tyre nga ana e All’llahut.

Në këtë ajet gjendet përqendrim në kërcënimin me dënimin e All’llahut e me ndëshkimin e Tij, me qëllim që të plotësohet rruga e edukimit dhe e disiplinimit. Kjo do të thotë se All’llahu është Mëshiruesi i mëshiruesve dhe Strehuesi i atyre që kërkojnë strehim, Mposhtës dhe Hakmarrës ndaj tiranëve e zullumqarëve gjynahqarë. Në këtë ajet, Profeti urdhërohet që t’i paralajmërojë kriminelët dhe keqëbërësit me tre lloje dënimesh: dënim nga lart,

dënim nga poshtë dhe dënim që përfaqësohet (simbolizohet) nga mosmarrëveshje fjalësh, nga lufta dhe gjakderdhja. Ajeti thotë: **“Thuaj: ‘Ai ka fuqi t’ju ndëshkojë prej së larti ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njëri-tjetrit...’”**.

Në fund ajeti thotë: **“...Shih si ua shpjegojmë shpalljet, që ata të mund të kuptojnë.”**.

Hulumtime

Po përmendim disa pika:

1- Ka mendime të ndryshme mes komentuesve rreth qëllimit të llojeve të dënimit nga lart dhe nga poshtë. Duket se këto dy fjalë kanë kuptime të gjera. Ato përfshijnë dy anët materiale të tokës dhe të qiellit si: rrufeja, shirat e furishëm, furtunat shkatërruese (sot njihen si cunamet), që vijnë nga lart; tërmetet, çarjet e tokës dhe përmytjet e lumejve e liqeneve, që vijnë nga poshtë.

Po ashtu, përfshijnë dhimbjen dhe fatkeqësitë që sjellin disa udhëheqës dhe shtresa sunduese e shfytëzuese në shoqërinë njerëzore. Gjithashtu, përfshijnë edhe lëndimet dhe ndëshkimet që shkaktojnë disa përgjegjës që nuk i njohin detyrat e tyre karshi njerëzve, të cilat nuk mund të jenë më të pakta, sesa dhimbja dhe torturat e udhëheqësve dhe e shtresave të larta në shoqëri.

Gjithashtu, supozohet se përfshijnë edhe armët e frikshme luftarake të kohës së sotme, të cilat marrin jetë njerëzish në mënyra barbare, qoftë nga toka apo edhe nga qielli, si dhe, brenda

një kohe të shkurtër i shndërrojnë qytetet e fshatrat në gërmadha, nëpërmjet bombardimeve ajrore e tokësore, nëpërmjet minave dhe nëndetëseve në detëra e oqeanë.

2- Fjala “*jelbeskum*” vjen nga fjala “*el lebse*” dhe ka kuptimin e përzierjes, bashkimit dhe nuk ka kuptimin e veshjes, sepse fjala veshje “*libsun*” është kur gërma *lam* ka zanoren *kesre* (i). Prandaj, kuptimi i ajetit është: Ai (All’llahu) është i fuqishëm që t’ju bëjë juve grupe të ndryshme të përziheni e të bashkoheni me njëri-tjetrin.

Nga kjo fjalë, konkludohet se çështja e konfliktit me fjalë dhe përçarja në shoqëri, nuk është më pak e rrezikshme se sa rrufetë, tërmetet dhe erërat shkatërruese. Edhe përçarja sjell dënim të rrezikshëm. Kjo është e vërtetë, sepse ka mundësi që shkatërrimi që vjen prej grindjeve me fjalë, mund të jetë më i madh, sesa shkatërrimi i bombardimeve, i tërmeteve, i cunameve etj. Po ashtu, shohim se shtete të përparuara i godet shkatërrimi për shkak të mosmarrëveshjeve dhe të përçarjeve. Për këtë, të gjithë myslimanët e botës duhet të jenë të kujdesshëm.

Ka edhe një mendim tjetër rreth komentimit të këtij ajeti: All’llahu i Madhëruar, përveç dënimit qiellor dhe tokësor, përmend edhe dy lloje të tjera dënimesh: njëri është ndryshimimi në ideologji dhe tjetri ndryshimi në praktikë dhe në sjelljet shoqërore, të cilat çojnë në luftë dhe në gjakderdhje. Për këtë, ajeti tregon katër lloje dënimesh natyrore dhe dy lloje dënimesh shoqërore.

3- Duhet patur kujdes se thënia e All’llahut: “...ose t’ju përçajë në grupe...” nuk ka kuptimin se All’llahu i sprovon njerëzit pa arsye, me hipokrizi dhe me mosmarrëveshje. Por, ajo sprovë vjen si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, prej

mendjemadhësisë, vetëpëlqimit, si dhe, prej zhytjes së tyre në interesat individuale.

4- Edhe pse ky ajet i drejtohet politeistëve dhe idhujtarëve, ne konkludojmë se shoqëria idhujtare dhe e devijuar nga rruga e drejtë e monoteizmit dhe e adhurimit të All'llahut, është e sprovuar prej padrejtësisë. Shoqëritë e sotme që adhurojnë teknologjinë dhe pasurinë, janë peng i fatkeqësive dhe nuk u shpëtojnë kthetrave të tyre (fatkeqësive). Disa myslimanë flasin vetëm me fjalë për monoteizmin dhe adhurimin e All'llahut, por në praktikë janë poloteistë dhe idhujtarë. Vërtet, fundi i popujve të tillë nuk ndryshon nga fundi i politeistëve. Edhe thënia e Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): “E gjitha kjo, te pasuesit e Kibles...”, tregon për ndryshimin dhe mospajtimin mes myslimanëve. Kur myslimanët devijojnë nga rruga e monoteizmit, atëherë mendjemadhësia e vetëpëlqimi zënë vendin e vëllazërisë islame, interesi personal triumfon mbi interesin e përgjithshëm, secili mendon vetëm për veten e tij dhe njerëzit i harrojnë urdhëresat dhe ndalesat e All'llahut. Atëherë ata ndëshkohen njësoj si politeistët.

Ajetet 66 - 67

وَكَذَّبَ بِهِ قَوْمُكَ وَهُوَ الْحَقُّ ۚ قُلْ لَّسْتُ عَلَيْكُمْ بِوَكِيلٍ ﴿٦٦﴾ لِّكُلِّ
نَبِيٍّ مُّسْتَقَرٌّ ۚ وَسَوْفَ تَعْلَمُونَ ﴿٦٧﴾

“Por populli yt e quan të gënjeshtërt atë (Kur’anin), ndonëse ai është i vërtetë. Thuaj: ‘Unë nuk jam rojtari juaj.’”

“Do të vijë koha, kur çdo profeci do të përmbushet dhe ju do ta merrni vesh.”

Komentimi

Këto dy ajete plotësojnë hulumtimin në ajetet e mëparshme rreth thirrjes për besimin në All’llahun, në Botën Tjetër, në të vërtetat e Islamit dhe në frikën prej dënimit të All’llahut.

Ajeti i parë e lajmëron Profetin se populli i Tij, kurejshitët dhe banorët e Mekës, nuk e besojnë atë që u thotë, megjithëse është e vërtetë. Këtë mosbesim të tyre e forcojnë argumentet e ndryshme logjike. Ajeti thotë: **“Por populli yt e quan të gënjeshtërt atë (Kur’anin), ndonëse ai është i vërtetë...”**¹ Më pas, Profeti urdhërohet: **“...Thuaj: ‘Unë nuk jam rojtari juaj.’”** Që do

¹ Për përemrin në frazën “*bihî*”, disa thonë se është për “Kur’anin”; të tjerë thonë se është për dënimin që u përmend në ajetet e mëparshme. Mirëpo, në pamje, duket se është tek të gjitha këto dhe tek mësimet e Profetit, të cilat i përgënjeshtrojnë ato. Këtë e forcon ajeti pasardhës.

të thotë: Unë jam vetëm i Dërguar dhe nuk e garantoj pranimin tuaj.

Në ajete të shumta të ngjashme me këtë ajet, siç janë: ajeti 107 i sures "En' am," ajeti 108 i sures "Junus", ajeti 41 sures "Zumer" dhe ajeti 6 i sures "Shuara", sqarohet se qëllimi i fjalës "uekijl" në këto sure është me kuptimin e përgjegjësit të udhëzimit praktik të njerëzve dhe të garantuesit të udhëzimit për ta. Prandaj, Profeti u thotë atyre në këtë ajet se çështja u kthehet atyre. Pra, ju jeni ata që duhet të vendosni për pranimin e së vërtetës apo për refuzimin e saj. Unë jam vetëm i Dërguar dhe përcjellës i mesazhit të All'llahut.

Në ajetin e shkurtër pasardhës, që përmban kuptim të thellë, gjendet paralajmërim për ta dhe ftesë që të zgjedhin rrugën e drejtë. Ai thotë: **"Do të vijë koha, kur çdo profeci do të përmbushet dhe ju do ta merrni vesh."** Kjo do të thotë se çdo lajm që u thotë juve Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për këtë jetë apo për Jetën Tjetër është konstant dhe ai lajm do të vërtetohet në kohën e premtuar dhe në atë ditë do ta njihni.

Ajetet 68 - 69

وَإِذَا رَأَيْتَ الَّذِينَ تَخُوضُونَ فِي آيَاتِنَا فَأَعْرِضْ عَنْهُمْ حَتَّى تَخُوضُوا
 فِي حَدِيثٍ غَيْرِهِ ۚ وَإِمَّا يُنْسِيَنَّكَ الشَّيْطَانُ فَلَا تَقْعُدْ بَعْدَ
 الذِّكْرِى مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٦٨﴾ وَمَا عَلَى الَّذِينَ يَتَّقُونَ
 مِنْ حِسَابِهِمْ مِنْ شَيْءٍ وَلَكِنْ ذِكْرِى لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٦٩﴾

“Kur t’i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër. E, nëse djalli të bën të harrosh, sapo të përmendesh, mos rri me të padrejtët.”

“Të devotshmit s’kanë kurrfarë përgjegjësie për gjynahet e mohuesve, por ua kujtojmë vetëm që të ruhen nga e keqja.”

Shkaku i zbritjes

Në komentimin e tefsirit “Mexhmaul Bejjan” transmetohet nga Imam Bakri (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Kur zbriti ajeti i parë prej këtyre dy ajeteve dhe i ndaloi myslimanët prej uljes me jobesimtarët, të cilët talleshin me argumentet e All’llahut, një grup myslimanësh thanë se nëse ata duhet ta zbatonin këtë ndalim, ai do t’i pengonte që të shkonin në Qabe e të bënin tauaf.”

Atëherë zbriti ajeti i dytë në fjalë që i urdhëron myslimanët se në të tilla raste, duhet t'i këshillojnë dhe t'i udhëzojnë ata me sa të kenë mundësi.¹

Përmendja e shkakut të zbritjes së këtij ajeti nuk bie ndesh me atë që thamë më parë, se kjo sure ka zbritur e tëra bashkë, sepse ka mundësi që të kenë ndodhur ngjarje të ndryshme në jetën e myslimanëve. Dhe, atëherë zbret një sure ku secili ajet apo grup ajetesh të asaj sureje të jenë të posaçëm për atë ndodhi.

Komentimi

Braktisja e qëndrimit me të devijuarit

Meqenëse temat që cek kjo sure flasin për gjendjen e politeistëve dhe të idhujtarëve, këto dy ajete hulumtojnë një temë tjetër prej temave që kanë lidhje me ta. Në fillim, ajeti i thotë të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Kur t'i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër...”**²

Edhe pse fjalët këtu i drejtohen të Dërguarit, ato nuk janë të kufizuara vetëm për të, por u drejtohen myslimanëve në përgjithësi. Filozofia e këtij rregulli është e qartë, se nëse myslimanët qëndrojnë me politeistët dhe idhujtarët, këto të fundit do të vazhdojnë t'i hedhin poshtë argumentet e All'Ilahut, sikur

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë. “Biharul Enuar”, vëll. 9, f. 89.

² Fjala “el khaud”, siç thotë Ragib Asfahani në librin “El Mufredat”, ka kuptimin e hyrjes në ujë dhe ecja në të. Pastaj është huazuar për hyrje në çështje të tjera. Në Kur'an, më shumë përdoret për hyrjen në një çështje të kotë e të pabazë.

ato janë të pavlera, duke u tallur me fjalët e All'llahut. Në qoftë myslimanët kalojnë pranë tyre dhe nuk ua vënë veshin fjalëve që thonë, ata nuk do të flasin për fjalën (shpalljen) e All'llahut, por do të flasin për diçka tjetër. Kjo ndodh sepse ata dëshirojnë ta ofendojnë Profetin dhe myslimanët. Pastaj ajeti i flet Profetit duke ia forcuar rëndësinë e këtij subjekti: “...E, nëse djalli të bën të harrosh, sapo të përmendesh, mos rri¹ me të padrejtët.” Kjo do të thotë se nëse djalli ta harron këtë gjë dhe ulesh me atë popull, kur ta kujtosh, të çohesh menjëherë dhe ta braktisësh uljen e qëndrimin me të padrejtët.

Dy pyetje:

Pyetja e parë: A mundet shejtani ta sundojë të Dërguarin e t'i shkaktojë atij harresë? Me fjalë të tjera themi se, si është e mundur për Profetin, i cili është i pagjynah dhe i mbrojtur nga gabimet që ai të gaboje e të harrojë?

Përgjigja: Në përgjigje të kësaj pyetjeje, mund të thuhet se fjalët në këtë ajet, edhe pse i drejtohen Profetit, janë për pasuesit e Tij, të cilët mund të harrojnë dhe të ulen me politeistët gjynahqarë. Prandaj, kur ata ta kujtojnë porosinë, duhet ta braktisin vendin. Një metodë e tillë përdoret edhe sot në jetën tonë të përditshme. Ka raste që ti i drejtohesh dikujt, por qëllimi yt është që të dëgjojnë të tjerët, siç thotë proverbi: “Ty të flas, dëgjo ti, o fqinj!”²

Pyetja e dytë: Disa dijetarë të Ehli Syneetit e konsiderojnë këtë ajet argument për moszbatimin e maskimit “takijes” fetar nga

¹ Togfjalëshi “Mos rri”, “la tek’adu” nuk ka vetëm kuptimin e ndalimit të të ndenjurit me ta, por ka kuptimin e ndalimit të shoqërimit me ta në të gjitha situatat: në të ulur, në të qëndruarit në këmbë ose në rrugëtim.

² “Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 631.

ana e udhëheqësit të fesë. Kjo, sepse ajeti e thotë qartë ndalimin e strehimit tek maskimi përballë armiqve dhe urdhëron për mosqëndrim me ta.

Përgjigjja për këtë kundërshtim është e qartë, sepse jo gjithmonë, shiat thonë se maskimi është i domosdoshëm. Por, në disa raste, ai është haram (i ndaluar). Domosdoshmëria e tij është e kufizuar me rrethanat, në të cilat përdorimi i maskimit ka dobi më shumë ose është shkak i largimit të dëmit dhe të rrezikut.

Ajeti pasardhës ka një përveçim, që është: nëse disa të devotshëm marrin pjesë në tubimet e atyre politeistëve me qëllim që t'i ndalojnë ata nga e keqja me shpresën se do të heqin dorë nga gjynahet, kjo nuk përbën problem dhe të këqijat e atyre politeistëve nuk u regjistrohen këtyre besimtarëve, sepse qëllimi i tyre është kryerja e detyrës që t'i udhëzojnë në rrugën e drejtë. Ajeti thotë: **“Të devotshmit s’kanë kurrfarë përgjegjësie për gjynahet e mohuesve, por ua kujtojmë vetëm që të ruhen nga e keqja.”**

Ka komentim tjetër për këtë ajet, por ai që përmendëm përputhet më shumë me të dukshmen e ajetit dhe me shkakun e zbritjes.

Në të njëjtën kohë, duhet të dimë se ata që duhet të përfitojnë nga kjo veçanti, janë ata që kriteret e ajetit janë në përputhje me ta. Për këtë, ata janë të dalluar me devotshmërinë, me mosndikimin dhe me forcën e ndikimit tek politeistët.

Në komentimin e ajetit 140 të sures “Nisa” e kemi përmendur këtë temë.

Ajeti 70

وَذَرِ الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَهُمْ لَعِبًا وَلَهْوًا وَغَرَّتَهُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا
وَذَكَرَ بِهِ أَنْ تَبْسَلَ نَفْسٌ بِمَا كَسَبَتْ لَيْسَ لَهَا مِنْ دُونِ اللَّهِ
وَلِيٌّ وَلَا شَفِيعٌ وَإِنْ تَعَدَلَ كُلَّ عَدَلٍ لَا يُؤْخَذَ مِنْهَا أَُولَئِكَ
الَّذِينَ أُبْسِلُوا بِمَا كَسَبُوا ۖ لَهُمْ شَرَابٌ مِّنْ حَمِيمٍ وَعَذَابٌ أَلِيمٌ بِمَا
كَانُوا يَكْفُرُونَ ﴿٧٠﴾

“Largohuni nga ata që fenë e tyre e marrin si lojë dhe dëfrim e që janë mashtruar nga jeta e kësaj bote. Këshilloji ata me Kur’anin, me qëllim që të mos i humbasin shpirtrat e tyre për shkak të veprave të veta. Përveç All’Ilahut, ata nuk do të kenë as ndihmës, as ndërmjetës. Edhe sikur të ofrojnë çdo lloj shpagimi, nuk do t’u pranohet. Këta janë ata që do të lihen në humbje për shkak të veprave që kanë bërë. Ata do të pinë ujë të valuar dhe do të kenë dënim të dhembshëm për shkak të mosbesimit të tyre.”

Komentimi

Ata që e kanë marrë fenë si lojë

Ky ajet vazhdon hulumtimin e ajetit të mëparshëm. Ai e urdhëron Profetin (Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) t’i braktisë ata që tallen me fenë, që e marrin atë si lojë

e dëfrim të tyre dhe mashtrohen me këtë dynja dhe me kënaqësitë e saj materiale. Ajeti thotë: **“Largohuni nga ata që fenë e tyre e marrin si lojë dhe dëfrim e që janë mashtruar nga jeta e kësaj bote...”**.

Natyrisht, urdhri i braktisjes së tyre nuk bie ndesh me xhihadin, sepse për xhihadin ka disa kritere dhe për braktisjen e jobesimtarëve ka kritere të tjera. Secila prej këtyre të dyjave duhet të realizohen në rrethana të posaçme. Ka raste që çështja mund të çojë në mosinteresimin ndaj tyre. Herë tjetër mund të çojë në xhihadin me armë. Përsa i përket thënies se ajetet e xhihadit u anuluan me këtë ajet, ajo nuk është e saktë.

Ky ajet tregon se jeta e tyre është e zbrazët. Ata i emërtojnë disa punë, të cilat janë të ngjashme me lojrat e fëmijëve, me emrin e fesë. Ata nuk janë të aftë as të diskutojnë e as të hulumtojnë. Prandaj, Profeti urdhërohet që t'u shmanget atyre dhe të mos interesohet për fenë e tyre të zbrazët.

Nga kjo që thamë, sqarohet se “feja e tyre” është “feja e politeizmit dhe e idhujtarisë”, të cilën e pasonin.

Ka mendim tjetër për komentimin e këtij ajeti. Ai thotë se Kur'ani tregon se një grup jobesimtarësh, që e konsideronin fenë e tyre si lojë e zbavitje, asnjëherë nuk e shihnin fenë si realitet dhe se e meriton arsyetimin e të menduarit. Që do të thotë se ata nuk besojnë në parimet e tyre politeiste dhe nuk e vlerësojnë fenë e tyre, e cila nuk ka asnjë bazë.

Sido që të jetë, ajeti nuk është i veçantë vetëm për politeistët, por ai përfshin të gjithë ata që i marrin rregullat e All'llahut dhe të *Shenjtat* mjete loje e dëfrimi për të plotësuar boshllëqet e tyre dhe për të arritur synimet e tyre materiale e individuale. Janë ata që fenë e bëjnë mjet fitimi në këtë jetë dhe rregullat e All'llahut, lojë të synimeve personale. Më pas, Profeti

(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) urdhërohet që t'i informojë ata për këtë punë të tyre dhe se do të vijë koha, kur do të dorëzohen para rezultateve të punëve të tyre dhe nuk do të gjejnë vend ku të shkojnë: **"...Këshilloji ata me Kur'anin, me qëllim që të mos i humbasin shpirtrat e tyre për shkak të veprave të veta..."**

Atë Ditë as ndërmjetësi e as i dashuri nuk sjell dobi, përveç All'llahut: **"...Përveç All'llahut, ata nuk do të kenë as ndihmës, as ndërmjetës..."**

Atë Ditë ata do të jenë në gjendje të vështirë e të dhimbshme. Do të lidhen me prangat e punëve të tyre. Ata do të dëshirojnë të paguajnë çdo gjë, nëse do të kenë ç'të japin, por asgjë nuk do të pranohet prej tyre: **"...Edhe sikur të ofrojnë çdo lloj shpagimi, nuk do t'u pranohet..."** Kjo ndodh sepse ata janë të mbërthyer me kthetrat e punëve të tyre. As shpagimi e as pendimi nuk u sjell atyre dobi pasi ka marë fund çdo gjë: **"...Këta janë ata që do të lihen në humbje për shkak të veprave që kanë bërë..."**.

Më poshtë tregohet për dënimin e dhimbshëm që do t'i godasë ata për shkak të kundërshtimit që i bënë së vërtetës e së drejtës: **"...Ata do të pinë ujë të valuar dhe do të kenë dënim të dhembshëm për shkak të mosbesimit të tyre."** Ata do të dënohen me ujin e valuar e përvëlues dhe do të rrethohen nga zjarri i Xhehennemit.

Këtu duhet thënë se fjalia **"...Këta janë ata që do të lihen në humbje për shkak të veprave që kanë bërë..."**, është si shkak i ndalimit të pranimi të shpagimit, apo mospranimi i çdo lloji ndërmjetësimi. Kjo do të thotë se dënimi i tyre nuk është prej shkaqeve të jashtme ku mund të paguhet e të hiqet shkak. Ai buron nga brendia e tij dhe nga sjelljet dhe veprat. Ata janë pengje të punëve të tyre të këqija. Prandaj, ata nuk mund të ikin e të

fshihen, sepse ikja dhe fshehja e njeriut prej punëve të tij do të thotë të ikë nga vetja e vet dhe kjo është pamundur.

Mirëpo, duhet të dimë se kjo gjendje e vështirë e fatkeqe, mosgjetja e rrugës së kthimit dhe mospranimi i ndërmjetësimit, janë për ata që këmbëngulën në mosbesimin e tyre dhe qëndruan në këtë gjendje, siç sqarohet në frazën “**...për shkak të mosbesimit të tyre.**” (Folja në ajet është në kohën e tashme dhe nga e tashmja, sipas gramatikës arabe përfitohet e nënkuptohet vazhdimësia.)

Ajeti 71 - 72

قُلْ أَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُنَا وَلَا يَضُرُّنَا وَنُرَدُّ عَلَىٰ
 أَعْقَابِنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْنَا اللَّهَ كَالَّذِي اسْتَهْوَتْهُ الشَّيَاطِينُ فِي الْأَرْضِ
 حَيْرَانَ لَهُ أَصْحَابٌ يَدْعُونَهُ إِلَى الْهُدَىٰ أُنْتَنَا^{٦١} قُلْ إِنِّ هُدَىٰ
 اللَّهُ هُوَ الْهُدَىٰ^{٦٢} وَأَمْرَنَا لِنُسَلِّمَ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦١﴾ وَأَنْ أَقِيمُوا
 الصَّلَاةَ وَآتَوْهُ^{٦٣} وَهُوَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٦٢﴾

“Thuaj: ‘A të adhurojmë në vend të All’lilaut çfarë nuk na sjell as dobi, as dëm?! A të kthehemi mbrapsht, pasi All’lilahu na udhëzoi, duke u bërë si i magjepsuri nga djajtë, që sillet i çoroditur nëpër tokë, ndonëse shokët e thërrasin në rrugë të drejtë: Eja tek ne!’ Thuaj: ‘Udhëzimi i All’lilaut është i vetmi udhëzim i drejtë! Ne jemi të urdhëruar t’i nënshtrohemi Zotit të botëve.’”

“Të falim namazin dhe të jemi të devotshëm ndaj Tij. Dhe është Ai, para të Cilit do të tuboheni.”

Komentimi

Politeistët këmbëngulnin në thirrjen e myslimanëve që të ktheheshin në politeizëm e në idhujtari. Atëherë, zbriti ky ajet që e urdhëron Profetin (Paqja dhe bekimet e All’lilaut qofshin mbi të dhe mbi

familjen e tij!) që t'u përgjigjet me një përgjigje, që ta zhdukë mendimin dhe thirrjen e tyre. Kjo përgjigje është në formë pyetësoi mohues ku pyetet: A kërkon prej nesh që t'i vëmë shok All'llahut ato që nuk sjellin asnjë dobi dhe t'i adhurojë? A të marrim për Zot e të adhurojmë ato që nuk mund të na dëmtojnë e t'u frikësohemi atyre? **"Thuaj: 'A të adhurojmë në vend të All'llahut çfarë nuk na sjell as dobi, as dëm?!...'"**

Ky ajet tregon se ka raste që veprat e njeriut lindin prej dy shkaqeve: ose për të sjellë dobi materiale apo shpirtërore, ose për të larguar dëmin. Si është e mundur që njeriu të bëjë diçka, në të cilën nuk ka as dobi e as dëm?

Më pas vjen argumenti tjetër që e hedh poshtë vijën e politeizmit. Argumenti thotë: Nëse kthehemi në adhurimin e idhujve pas udhëzimit të All'llahut, do të thotë që jemi kthyer në humbje. Kjo është në kundërshtim me ligjin e përsosurisë, i cili është ligj i përgjithshëm jetësor: **"...A të kthehemi mbrapsht, pasi All'llahu na udhëzoi..."** Pastaj ajeti sjell shembull për sqarimin e çështjes. Ai thotë se kthimi nga monoteizmi në politeizëm është njësoj me atë që e mashtrojnë shejtanët (ose si "Gijlanul bevadij", për të cilën arabët besonin se ndodhet në kryqëzimet e rrugëve dhe i mashtronte e ua humbiste rrugën kalimtarëve): **"...duke u bërë si i magjepsuri nga shejtanët, që sillet i çoroditur nëpër tokë..."**. Ndërkohë, njeriu ka shokë që e udhëzojnë në rrugën e drejtë dhe i thonë atij: *"Eja tek ne!"*. Por, ai qëndron i heshtur, i hutuar dhe nuk e dëgjon thirrjen. Ose nuk është në gjendje të vendosë: **"...ndonëse shokët e thërrasin në rrugë të drejtë: 'Eja tek ne!'..."**

Në fund, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhërohet që t'u thotë se udhëzimi është nga All'llahu dhe për ne s'ka gjë tjetër veçse t'i dorëzohemi urdhrit të

All'Ilahut, Sunduesit të botëve: **"...Thuaj: 'Udhëzimi i All'Ilahut është i vetmi udhëzim i drejtë! Ne jemi të urdhëruar t'i nënshtrohemi Zotit të botëve.'"**

Ky është një argument tjetër për refuzimin e fesë së politeistëve, sepse dorëzimi dhe nënshtrimi i bëhen vetëm Krijuesit të gjithësisë, Sunduesit të mbarë botës ekzistuese dhe jo idhujve që nuk kanë asnjë rol në këtë ekzistencë e as në administrimin e saj.

Ajeti pasardhës vazhdon shpjegimin e thirrjes së All'Ilahu dhe thotë: Ne, përveç besimit në Zotin Një të Vetëm e të Pashoq, jemi urdhëruar që të falim namazin dhe për devotshmëri ndaj All'Ilahut: **"Të falim namazin dhe të jemi të devotshëm ndaj Tij."**

Në mbyllje, ajeti tregon për Ringjalljen dhe se njerëzit do të kthehen të gjithë tek All'Ilahu: **"...Dhe është Ai, para të Cilit do të tuboheni."**

Këto ajete të shkurtra zbulojnë programin në të cilin fton i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe që përbëhet nga katër parime. Fillon me Njësimin dhe përfundon me Ringjalljen. Mes këtyre dyve janë forcimi i lidhjeve me All'Ilahun dhe ruajtja nga çdo gjynah.

Ajetet 73

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ ۖ وَيَوْمَ يَقُولُ
 كُنْ فَيَكُونُ ۚ قَوْلُهُ الْحَقُّ ۚ وَلَهُ الْمُلْكُ يَوْمَ يُنفَخُ فِي الصُّورِ ۚ
 عِلْمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ ۚ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْخَبِيرُ ﴿٧٣﴾

“Është Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën për një qëllim. Ditën kur Ai thotë ‘Bëhu!’, ajo bëhet. Fjala e Tij është e Vërteta dhe Atij i përket pushteti Ditën kur fryhet në Sur. Ai e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai është i Urti dhe i Gjithëdituri.”

Komentimi

Ky ajet është argument për atë që ka ardhur në ajetin e mëparshëm, për domosdoshmërinë e dorëzimit e të nënshtrimit para All’llahut dhe për ndjekjen e pasimin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Për këtë, ajeti thotë: “Është Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën për një qëllim...”

Krijuesi i kësaj gjithësie është i vetmi që e meriton të adhurohet. Duhet që vetëm për Të të jetë nënshtrimi dhe dorëzimi, sepse Ai i ka krijuar krijesat me qëllime të vërteta.

Qëllimi i fjalës “*el hakku*”, në këtë ajet, është për rezultatet, qëllimet, dobite dhe urtësitë. Që do të thotë, se çdo krijesë është krijuar për një qëllim, për një rezultat dhe për një dobi. Ky ajet i përngjan tematikës për të cilën foli ajeti 27 i sures “Sad”, në të cilin thuhet: **“Ne nuk e kemi krijuar kot qiellin, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre...”**

Më pas ajeti thotë se përveç të qenit të Tij Krijuesi i gjithçkaje, gjithashtu, Dita e Kiametit është me urdhrin e Tij. Kur të urdhërojë për ardhjen e asaj Dite, ajo do të bëhet menjëherë. Ajeti thotë: **“...Ditën kur Ai thotë ‘Bëhu!’, ajo bëhet...”**¹

Disa supozojnë se kjo frazë tregon për krijimin e gjithësisë e të botës ekzistuese, ku gjithçka është krijuar me urdhrin e All’llahut. Mirëpo, duke parë se folja “jekulu” (thotë) është në kohën e tashme dhe para këtij ajeti tregohet për zanafillën e krijimit, e gjithashtu, duke parë ajetet pasuese, mund të thuhet se kjo frazë është e posaçme për Ringjalljen dhe Ditën e Kiametit.

Në komentimin e ajetit 177 të sures “Bekare”, thamë se fraza: **“...‘Bëhu!’, ajo bëhet.”** nuk ka kuptimin e urdhrit shprehimor të diçkaje, por ka kuptimin se kur Ai do të krijojë diçka, vullneti i Tij realizohet pa nevojën e ndonjë faktori a shkakut tjetër. Nëse Ai do që diçka të realizohet menjëherë, ajo realizohet. Nëse do të realizohet gradualisht, realizohet.

Pastaj, ajeti thotë se ajo që thotë All’llahu është e vërtetë. Ashtu si është fillimi i krijimit me qëllim e dobi, po ashtu edhe Dita e Kiametit: **“...Fjala e Tij është e Vërteta...”**.

¹ Komentuesit kanë mendime të ndryshme se me kë lidhet fjala “*jeumun*”, “*dite*”. Disa thonë se është e lidhur me fjalën “*khaleka*”, “*krijoi*”. Disa të tjerë thonë se është e lidhur me thënien e aluduar “*udhkuru*”, “*kujtoni*”, por nuk është e largët që të jetë e lidhur me frazën “*jekunu*”, “*bëhet*”. Atëherë kuptimi është: Dita e Kiametit është dita që i thotë asaj: “*Bëhu!*”.

Në atë Ditë, në të cilën i fryhet Surit, rigjallen njerëzit dhe dalin para All'llahut të Madhëruar, sundimi, gjykimi i takojnë vetëm All'llahut, siç thotë ajeti: **"...dhe Atij i përket pushteti Ditën kur fryhet në Sur..."**.

Sundimi i All'llahut dhe posedimi i gjithësisë kanë qenë që nga fillimi i krijimit e deri në fund të tij, dhe në Ditën e Kiametit. Këto nuk janë vetëm për Ditën e Kiametit. Ka shkaqe dhe faktorë që ndikojnë në vazhdimësinë e kësaj jete dhe e drejtojnë drejt qëllimeve të saj. Por njeriu është i pavëmendshëm se pas këtyre faktorëve dhe shkaqeve është All'llahu. Kurse në atë Ditë, në të cilën shkëputen të gjitha shkaqet dhe faktorët, sundimi dhe gjykimi i All'llahut duket shumë qartë. Në ajetin 16 të sures "Gafir" thuhet: **"...Kujt i përket pushteti i asaj Dite? All'llahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!"**.

Përsa i përket natyrës së "Surit", sesi i fryn Israfili, sesi prej zërit të tij vdesin njerëzit, sesi i fryn përsëri që të ringjallen të gjithë dhe të fillojë Dita e Kiametit, këtë do ta sqarojmë inshall'lah në komentimin e ajetit 68 të sures "Zumer".

Në fund ajeti tregon tri cilësi të All'llahut: **"...Ai e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai është i Urti dhe i Gjithëdituri."**

Zakonisht këto cilësi përmenden në ajetet që janë të posaçme për Ditën e Kiametit. Pra, bazuar te cilësia e dijes absolute të All'llahut dhe se Ai është i Gjithëditur për punët e robve të Tij dhe bazuar në fuqinë dhe urtësinë e Tij, Ai do t'i japë gjithkujt atë që meriton.

Ajeti 74

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ ءَازَرَ اتَّخِذْ أَصْنَامًا ءَالِهَةً ۖ إِنِّي أَخْلَصْتُكَ
وَقَوْمَكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٧٤﴾

“Trego për Ibrahimin, kur ai i tha të atit, Azerit: ‘A do t’i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe.”

Komentimi

Megenëse kjo sure lufton politeizmin dhe idhujtarinë dhe më shumë flet për politeistët dhe idhujtarët, në të janë përdorur metoda të ndryshme për zgjimin e tyre. Këtu përdoret historia e Ibrahimit, heroit të monoteizmit. Në disa ajete tregon për logjikën dhe arsyetimin e tij të fortë në thyerjen e idhujve.

Duhet përmendur se në shumë hulumtime rreth Njësimit dhe luftimit të idhujtarisë, Kur’ani bazohet tek kjo e vërtetë, sepse Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) gëzonte respekt dhe pozitë tek të gjithë popujt, veçanërisht tek politeistët arabë.

Kur’ani thotë se Ibrahimit e qortoi babanë (xhaxhain) e tij duke thënë: “A po zgjedh për zot dhe për adhurim këto idhuj të poshtër që nuk zotërojnë jetë?” “Trego për Ibrahimin, kur ai i tha

të atit, Azerit: 'A do t'i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe.'"

A ka humbje më të madhe e më të qartë se kur njeriu quan për zot atë që e prodhon vetë me duart e veta? A ka humbje më të madhe se të strehohesh tek diçka e pashpirt dhe pa ndjenja, për të zgjidhur problemet?!

Ai ishte Azeri babai i Ibrahimit?

Në gjuhën arabe fjala "ebun" në të shumtën e rasteve përdoret për babanë. Mirëpo, ajo përdoret edhe për gjyshin nga ana e nënës dhe për xhaxhain. Po ashtu, përdoret për edukatorin dhe mësuesin që ndihmojnë në një farë mënyrë në edukimin e njeriut. Kur vjen e pakufizuar, ajo ka kuptimin e babait, nëse nuk ka argument që tregon diçka tjetër përveç këtij kuptimi.

A është burri (Azer) që përmend ajeti, babai i Ibrahimit? A mund të jetë prodhuesi i idhujve dhe adhuruesi i tyre babai i një prej Profetëve të vedosmërisë së lartë (ulul azmi)? A nuk gjendet nga trashëgimia e këtij babai ndikim negativ tek fëmijë të tij?

Disa komentues të Ehli Synetit i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetjeje, duke thënë se Azeri ka qenë babai i vërtetë i Ibrahimit. Ndërsa komentuesit shi'itë janë të një mendimi se Azer nuk është babai i Ibrahimit. Disa thonë se është gjyshi i tij nga nëna dhe shumica e tyre thonë se është xhaxhai i tij. Për këtë, ata mbështeten në argumentet e mëposhtme:

1- Në librat e historisë nuk përmendet se babai i Ibrahimit është Azeri. Por në to thuhet se emri i babait të tij ka qenë Tarkh. Kjo përmendet, gjithashtu, edhe në "Dhiatën e Vjetër" dhe në

“Dhiatën e Re”. Ata që e konsiderojnë Azerin si babanë e Ibrahimit, mbështeten në shkaqe (ta’lilate) të papranueshme, si psh: Emri i vërtetë i babait të Ibrahimit është Tarkh dhe nofka e tij është Azer. Këtë thënie nuk e mbështesin as dokumentet historike. Ose thonë: Azer është emri i idhullit që adhuronte babai i Ibrahimit. Kjo thënie nuk përputhet me këtë ajet që thotë se babai i tij ishte Azeri. E kundërta ndodh nëse me këtë ajet aludohet fjalia ose fjala, dhe ky aludim është në kundërshtim me të dukshmen e ajetit.

2- Kur’ani i Shenjtë thotë: “Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre....”¹ Më pas, me qëllim që askush të mos e marrë si argument kërkimin e faljes së Ibrahimit për Azerin, Kur’ani thotë: **“Ndërsa lutja e Ibrahimit për faljen e babait të tij, ka qenë vetëm për shkak të një premtimi, që i kishte bërë. Por, kur iu bë e qartë se i ati ishte armik i All’lilahun, ai u nda prej tij...”²** Kjo sepse Ibrahim i premtoi Azerit se do të kërkonte falje për të, siç thotë Kur’ani: **“...Do t’i lutem Zotit tim që të të falë...”³**, me shpresën se do të heqë dorë nga adhurimi i idhujve. Por kur e pa atë këmbëngulës dhe kokëfortë në idhujtari, nuk kërkoj falje për të.

Të gjitha argumentet tregojnë se këto ndodhi kanë ndodhur kur Ibrahim ishte i ri, e që jetonte në Babilioni dhe luftonte idhujtarinë.

¹ Sure “Teube”, ajeti 113.

² Sure “Teube”, ajeti 114.

³ Sure “Merjem”, ajeti 47.

Ka ajete të tjera që tregojnë se në fund të jetës së tij dhe pas ndërtimit të Qabes, Ibrahim i kërkoj faljen për babanë e tij. Në këto ajete të sures "Ibrahim", Ibrahim ka përdorur fjalën e qartë "*uvalid*", që në arabisht ka kuptimin e babait të vërtetë dhe jo fjalën "*ebun*": **"Qoftë lavdëruar All'Ilahu, i cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is'hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet! O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet! O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!"**¹

Nëse e bashkojmë këtë ajet me ajetin e sures "Teube", i cili i ndalonte myslimanët që të kërkonin falje për politeistët dhe e mohonte ta kishte bërë Ibrahim, vetëm në raste të veçanta e për qëllim të shenjtë, na bëhet e qartë se qëllimi i fjalës "*ebun*", në ajetin e lartpërmendur, nuk është për babanë, por për xhaxhanë apo gjyshin nga ana e nënës. Thënë ndryshe: Fjala "*uvalidun*" ka kuptim të drejtpërdrejtë të babait, kurse fjala "*ebun*" nuk e ka këtë kuptim.

Fjala "*ebun*" në Kur'an ka ardhur me kuptimin e xhaxhait dhe kjo në ajetin 133 të sures "Bekare" që thotë: **"Ata u përgjigjën: 'Ne do të adhurojmë Zotin tënd, që është edhe Zoti i baballarëve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is'hakut, një Zot të vetëm...'"** Përemri në frazën "*ata thanë*", është për djemtë e Jakubit, dhe Ismaili ka qenë xhaxhai i Jakubit dhe jo babai i tij.

3- Ka transmetime të ndryshme islame, të cilat e përforcojnë këtë çështje.

¹ Sure "Ibrahim", ajetet 39-41.

Tabari, dijetar i shquar e i njohur i Ehli Synetit, në komentimin e tij “*Xhamiul Bejjan*”, përcjell nga komentuesi i njohur Muxhahid, se ka thënë: “*Azeri nuk ka qenë babai i Ibrahimit.*”¹

Alusij, në tefsirin “*Ruhul Meanij*”, në komentimin e këtij ajeti thotë se jo vetëm shi’iat besojnë se Azeri nuk ka qenë babai i Ibrahimit, sepse ka shumë prej dijetarëve të medh’hebeve të tjera që besojnë se Azer ka qenë emri i xhaxhit të Ibrahimit.²

Es Sujuti, dijetar i njohur i Ehli Synetit, në librin e tij “*Mesalikul Hunefa*” përcjell nga libri “*Esraru Nuzul*” i Fakhri Raziut se gjyshërit e të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe stërgjyshërit e tij, kurrë nuk kanë qenë politeistë. Këtë e argumenton me hadithin që përmendëm më lart. Pastaj, vetë Sujuti mbështetet në dy grupe transmetimesh:

Grupi i parë thotë se stërgjyshërit e të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe gjyshërit e tij deri tek Ademi kanë qenë njerëzit më të mirë të kohës së tyre. (Për këtë, ai përcjell hadithe nga “*Sahihu Buhari*” dhe nga “*Delailu Nubuueti*” i Bajhakij, e nga të tjera burime.)

Grupi i dytë thotë se në çdo kohë ka patur njerëz monoteistë, të cilët e adhuronin All’llahun. Më pas, Sujuti i bashkon këto dy grupe transetimesh dhe konkludon se gjyshërit dhe stërgjyshërit të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimet e*

¹ Tefsiri “*Xhamiul Bejjan*”, vëll. 7, f. 158.

² Tefsiri “*Ruhul Meanij*”, vëll. 7, f. 169.

All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), në mesin e të cilëve edhe babai i Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!), kanë qenë monoteistë.¹

Nga kjo sqarohet se komentimi i këtij ajeti bazohet në praninë e argumenteve dhe fakteve të qarta nga vetë Kur'ani dhe në transmetimet e ndryshme islame dhe nuk është kurrë komentim sipas mendimit personal, siç thonë disa komentues të Ehli Syneetit, si autori i tefsirit “*El Manar*”.

¹ “Mesaliul Hunefa”, f. 17. Po ashtu, në futnotë tek “Biharul Enuar”, vëll. 15, f. 118 e më pas. Botimi i ri.

Ajetet 75 - 79

وَكَذَلِكَ نُرِي إِبْرَاهِيمَ مَلَكُوتَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلِيَكُونَ مِنَ
 الْمُوقِنِينَ ﴿٧٥﴾ فَلَمَّا جَنَّ عَلَيْهِ اللَّيْلُ رَأَى كَوْكَبًا ۖ قَالَ هَذَا رَبِّي
 فَلَمَّا أَفَلَ قَالَ لَا أَحِبُّ الْآفِلِينَ ﴿٧٦﴾ فَلَمَّا رَأَى الْقَمَرَ بَازِغًا
 قَالَ هَذَا رَبِّي ۖ فَلَمَّا أَفَلَ قَالَ لَئِنْ لَّمْ يَهْدِنِي رَبِّي لَأَكُونَنَّ مِنَ
 الْقَوْمِ الضَّالِّينَ ﴿٧٧﴾ فَلَمَّا رَأَى الشَّمْسَ بَازِغَةً قَالَ هَذَا رَبِّي
 هَذَا أَكْبَرُ ۖ فَلَمَّا أَفَلَتْ قَالَ يَنْقُومِ إِنِّي بَرِيءٌ مِمَّا تُشْرِكُونَ ﴿٧٨﴾
 إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا ۖ
 وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٧٩﴾

“Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të Tokës, që ai të bëhej nga të devotshmit.”

“Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: ‘Ky është zoti im!’ Por, kur perëndoi ylli, ai tha: ‘Nuk i dua ata që perëndojnë.’”

“Kur pa Hënën duke lindur, tha: ‘Ky është zoti im!’ Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: ‘Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit.’”

“Kur vërejti Diellin duke lindur, ai thërriti: ‘Ky është zoti im, ky është më i madhi!’ Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: ‘O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni All’llahut në adhurim!’”

“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët.”

Komentimi

Argumentet e Njësimit (*Teuhidit*) në qiej

Ajeti i mëparshëm tregonte për përbuzjen që mbarte Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) ndaj idhujve dhe kërkesën e tij drejtuar Azerit, që të hiqte dorë nga adhurimi i idhujve. Ajetet në fjalë tregojnë për heroizmin logjik të Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) ndaj adhuruesve të idhujve. Ato sqarojnë metodën e arritjes në thelbin e Njësimit nëpërmjet argumenteve të qartë logjike.

Së pari, sqarojnë se All’llahu, ashtu siç ia bëri të njohur Ibrahimit dëmet e adhurimit të idhujve, po ashtu e njohu atë me sundimin dhe pushtetin absolut të All’llahut në qiej e në tokë, duke thënë: **“Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të Tokës...”**¹

¹ Në ajet ka aludim që tregon për atë që gjendej në ajetet e mëparshme. Kështu që përmbajtja e ajetit është: Ashtu siç i treguam Ibrahimit të shëmtuarën e adhurimit të idhujve që bënte populli i tij, po ashtu i treguam atij mbretërinë e qiejve e të Tokës.

Fjala “*melekut*” rrjedh nga fjala “*mulkun*” me kuptimin e pronësisë e të sundimit. Kuptimi i saj është për mbretërinë absolute të All’liahut në ekzistencë në përgjigjësi.

Ndoshta ky ajet është përmbledhje për detajin e përmendur në ajetin pasardhës rreth yjeve, hënës, diellit dhe perceptimit se ato janë prej krijesave, kur Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) pa largimin e tyre. Që do të thotë, se Kur’ani filloi me përmendjen përmbledhëse të atyre situatave, pastaj me sqarimin e tyre. Këtu sqarohet qëllimi pse iu bë e njohur mbretëria e qiejve dhe e tokës Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!).

Po ashtu, në mbyllje thotë se qëllimi me këtë është që Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) të bëhet prej të devotshmëve: “**...që ai të bëhej nga të devotshmit.**”

S’ka dyshim se Ibrahim ka qenë prej të devotshmëve dhe monoteist në natyrën e tij. Por, me studimin e sekreteve të krijimit, bindja e tij arriti në kufirin e përsosurisë. Gjithashtu, ai ka qenë besimtar që besonte në Ringjalljen e në Ditën e Kiametit. Mirëpo me shikimin e shpendëve të therur që u ringjallën, besimi i tij arriti në fazën e “*ajnul jekin*” - bindjes së plotë.

Ajeti pasardhës e sqaron këtë kuptim dhe qartëson argumentimin e Ibrahim nëpërmjet largimit (perëndimit) të yjeve dhe të diellit, se ato nuk janë Zoti. Kur mbulesa e errët e natës mbuloi mbarë botën, para syve të tij u shfaq një yll i ndritshëm. Ibrahim thirri e tha: “Ky është zoti im!” Por kur e pa se perëndoi, tha: “Nuk i dua ato që perëndojnë”. Për këtë Kur’ani na thotë: “**Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: ‘Ky është zoti im!’ Por, kur perëndoi ylli, ai tha: ‘Nuk i dua ata që perëndojnë.’**”

Përsëri ai ngriti sytë nga qielli e atij iu shfaq sfera e argjendtë e hënës e ndritur, e shkëlqyeshme dhe tërheqëse. Ai tha me zë të lartë për të dytën herë: “Ky është zoti im.” Mirëpo, fundi

i hënës nuk ishte më i mirë se ai i yllit që pa më parë. Ajo e fshehu fytyrën e saj pas palosjeve të horizontit.

Këtu Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Nëse nuk më udhëzon All’llahu në rrugën që të çon tek Ai, do të jem prej të humburve.” Ajeti thotë: **“Kur pa Hënën duke lindur, tha: ‘Ky është zoti im!’ Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: ‘Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit.’”**

Kështu që nata filloi të largohej. Ajo filloi ta mbledhte mbulesën e saj nga sipërfaqja e qiellit. Ndërkohë, filloi të lindte dielli nga ana e Lindjes, duke hedhur rrezet e tij të bukura si thurje e artë mbi male, lëndina e shkretëtira. Sapo sytë e Ibrahimit panë diellin e lindur, bërtiti: “Ky është zoti im.” Ky është më i madh dhe me dritë më të fortë. Por, kur e pa që edhe ai perëndoi dhe filloi të fshihej në errësirën e natës, Ibrahim deklaroi vendimin e tij përfundimtar duke thënë: “O populli im! U lodha nga këto idhuj të krijuar që ju ia shoqëroni All’llahut”: **“Kur vërejti Diellin duke lindur, ai thërriti: ‘Ky është zoti im, ky është më i madhi!’ Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: ‘O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni All’llahut në adhurim!’”**

Pasi e mësova se pas të gjitha këtyre krijesave të ndryshueshme, të kufizuara e të nënshtruara ndaj ligjeve të natyrës qëndron një Zot i Plotfuqishëm dhe Ngadhënjyes mbi të gjitha krijesat, atëherë unë i drejtohem Atij që krijoi qiejtë dhe tokën. Në këtë besim që kam, unë nuk i shoqëroj Atij asgjë sepse unë jam monoteist dhe jo politeist: **“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët.”**

Komentuesit kanë thënie të shumta në komentimin e këtyre ajeteve dhe të ajeteve pasardhës rreth çështjes se çfarë e shtyu

Ibrahimin monoteist, adhures të All'Ilahut të Vetëm që të shohë planetet në qiell e të thotë: 'Ky është Zoti im?' Në mesin e mendimeve të komentuesve do të qëndrojmë në dy komentime, ku njërin prej tyre e kanë zgjedhur shumica e komentuesve. Gjithashtu, ato të dy mbështeten me dëshmi prej burimeve të haditheve.

Komentimi i parë thotë: Sigurisht, vetë Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) donte që të meditonte në njohjen e All'Ilahut dhe të gjente të Adhuruarin, që e njihte nëpërmjet natyrës së tij të pastër (*el fitratu*) në brendinë e tij. Ai e njihte All'Ilahun e Madhëruar me anën e dritës së natyrës së tij të krijuar dhe me anë të argumenteve të përgjithshëm logjikë. Sepse, të gjitha thëniet e tij tregojnë se ai kurrë nuk dyshonte në ekzistencën e All'Ilahut. Mirëpo, ai kërkonte të arrinte nëpërmjet argumentimit logjik në bindjen e plotë.

Këto ndodhi kanë ndodhur para profetësisë së tij. Supozohet që të kenë ndodhur me fillimin e moshës së pjekurisë së tij.

Në disa libra të historisë dhe në disa transmetime thuhet se kjo ishte hera e parë që Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) shikonte qiellin dhe planetet e tij ndriçuese, sepse nëna e tij e kishte fshehur në shpellë nga frika se mos e vriste Nemrudi mizor me xhelatët e tij të pamëshirshëm.¹

Mirëpo ky supozim duket i largët, sepse është e vështirë të përfytyrohet një njeri që të jetojë me vite në brendësi të shpellës, duke mos dalë asnjëherë prej saj dhe në errësi të plotë.

¹ "Biharul Enuar", vëll. 11, f. 78 dhe 79.

Ajetet 80 - 83

وَحَاجَّهُ قَوْمُهُ^ج قَالَ أَتُحْجُونَنِي فِي اللَّهِ وَقَدْ هَدَانِ^ج وَلَا أَخَافُ مَا
تُشْرِكُونَ بِهِ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ رَبِّي شَيْئًا^{هـ} وَسِعَ رَبِّي كُلَّ شَيْءٍ
عِلْمًا^{هـ} أَفَلَا تَتَذَكَّرُونَ ﴿٨٠﴾ وَكَيْفَ أَخَافُ مَا أَشْرَكْتُمْ وَلَا
تَخَافُونَ أَنْكُمْ أَشْرَكْتُمْ بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنَزَّلْ بِهِ عَلَيْكُمْ سُلْطَانًا^ج
فَأَيُّ الْفَرِيقَيْنِ أَحَقُّ بِالْأَمْنِ^ط إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٨١﴾ الَّذِينَ
ءَامَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ أُولَئِكَ لَهُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ
مُهْتَدُونَ ﴿٨٢﴾ وَتِلْكَ حُجَّتُنَا آتَيْنَاهَا إِبْرَاهِيمَ عَلَى قَوْمِهِ^ج نَرْفَعُ
دَرَجَاتٍ مِّنْ نَّشَاءٍ^{هـ} إِنَّ رَبَّكَ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿٨٣﴾

“Dhe, kur populli i tij polemizoi me të, ai tha: ‘Doni të polemizoni me mua për All’llahun, ndërkohë që Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë?! Unë nuk i kam frikë idhujt tuaj, sepse vetëm po të dojë Zoti im, ato mund të më lëndojnë. Zoti im, me dijeninë e vet ka përfshirë çdo gjë. A nuk po mendoni?’”
“E si të frikësohem nga zotat tuaj të rremë, ndërkohë që ju nuk keni frikë t’i shoqëroni All’llahut idhuj, për të cilët Ai nuk ju ka zbritur kurrfarë argumenti?! Cili nga ne e meriton të jetë i sigurt? Më thoni, nëse njihni të vërtetën!”

“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi, pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.”

“Ky është argumenti Ynë, të cilin Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë kë të duam në shkallë të lartë. Vërtet, Zoti yt është i Urtë e i Gjithëditur.”

Komentimi

Pas kërimit në ajetet e mëparshme rreth argumenteve të Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) për Njëtimin (teuhidin), ajetet në fjalë tregojnë për debatin që ndodhi mes Ibrahimit dhe politeistëve, të cilët e filluan me polemizimin. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **“Dhe, kur populli i tij polemizoi me të...”**. Profeti Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) u përgjigjet atyre duke u thënë: *“Përse debaton me mua rreth All'llahut të Vetëm e të Pashoq dhe më kundërshtoni rreth Tij, i Cili më ka dhuruar argumente të ndritshëm logjik, me atë të të cilëve më udhëzoi në rrugën e Njëtimit?”* Për këtë ajet thotë: **“...ai tha: ‘Doni të polemizoni me mua për All'llahun, ndërkohë që Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë?!...’”**

Në këto ajete sqarohet fare mirë se populli idhujtar i Ibrahimit u përpoqën shumë për ta larguar atë nga besimi i tij dhe ta kthenin në adhurimin e idhujve. Mirëpo, Ibrahim (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me plot guxim e trimëri iu përgjigj atyre me argumente të qarta logjike.

Këto ajete nuk tregojnë për argumentet që përdori populli i Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ndaj tij, që ai të hiqte dorë nga besimi i tij. Por, nga përgjigja e Ibrahimit duket se ata e

kërcënuan atë me zemërimin e zotave të tyre dhe me ndëshkimin e tyre, për ta frikësuar e për ta tmerruar atë.

Gjatë bisedës së tij duket se Ibrahim i tallej me kërcënimin e tyre. Ajo bisedë përforcon se ai nuk u frikësohet idhujve të tyre, të cilët nuk kanë as forcë e as fuqi që t'i bëjnë dëm atij. Ajeti thotë: **"...Unë nuk i kam frikë idhujt tuaj..."**. Askush e asgjë nuk ka mundësi të më bëjë keq mua pa lejen e All'llahut: **"...sepse vetëm po të dojë Zoti im, ato mund të më lëndojnë..."**

Nga ky ajet duket se Ibrahim u përpoq të merrte masa mbrojtëse ndaj gjithçkaje të mundshme që mund të ndodhte. Ai dëshmonte dhe përforconte se nëse të godet ndonjë e keqe, atëherë kjo e keqe nuk ka lidhje fare me idhujt, por është me lejen e dëshirën e All'llahut, sepse idhulli, i cili nuk ka as shpirt, as fuqi që t'i sjellë dobi vetes së tij e s'ka as fuqi ta dëmtojë atë, nuk ka fuqi as t'u sjellë dobi e as t'u bëjë keq të tjerëve. Përveç kësaj, ai sqaron qartazi se Zoti i tij ka dituri të gjerë, e cila përfshin gjithçka. Për këtë, ajeti thotë: **"...Zoti im, me dijeninë e Vet ka përfshirë çdo gjë..."**.

Kjo frazë është argument i frazës së mëparshme, që thotë se idhujt nuk kanë fuqi as për dëm e as për dobi, sepse ata nuk zotërojnë dituri e as njohje, të cilat janë të domosdoshme për atë që do të sjellë dobi apo të dëmtojë. Vërtet, All'llahu, i Cili me diturinë e Tij ka përfshirë gjithçka, është i Vetmi dhe i Plotfuqishëm për sjellje dobie e për dëmtim. A nuk është më mirë që t'i frikësohemi zemërimit të Allahut?!

Më pas ajeti u vë në lëvizje atyre shpirtin e kërkimit e të të menduarit, duke u thënë atyre: **"...A nuk po mendoni?"**.

Në ajetin vijues, Ibrahim i (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ndjek një logjikë tjetër argumentuese. Ai u thotë idhujtarëve: Si mund t'u frikësohem idhujve e të më kaplojë frika prej

kërcënimeve tuaja, ndërkohë që unë nuk shoh tek idhujt tuaj asnjë shenjë mendjeje, kuptimi, ndjenje, fuqie e diturie? Kurse ju, megjithëse besoni në praninë e All'llahut, dëshmoni e pranoni se Ai ka dituri e fuqi, ju e dini se Ai nuk ju ka urdhëruar t'i adhuronit idhujt. Megjithkëtë, ju nuk i frikësoheni zemërimit të Tij. Ajeti thotë: **“E si të frikësohem nga zotat tuaj të rremë, ndërkohë që ju nuk keni frikë t'i shoqëroni All'llahut idhuj, për të cilët Ai nuk ju ka zbritur kurrfarë argumenti?!...”**¹ Ne e dimë se idhujtarët nuk e mohojnë All'llahun, Krijuesin e qiejve e të Tokës, por ata i shoqëronin Atij idhuj në adhurim dhe i konsideronin ata ndërmjetës të tyre tek Ai. Jini të drejtë e thoni: **“...Cili nga ne e meriton të jetë i sigurt? Më thoni, nëse njihni të vërtetën!”**.

Këtu logjika e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) bazohet në arsyen e vërtetë. Ai u thotë atyre se ata po e kërcënonin me zemërimin e idhujve, por ndikimi i tyre ishte veç iluzion e fantazi. Edhe ju, duke mos iu frikësuar All'llahut të Madhëruar, të cilin e besojmë të gjithë dhe besojmë në ndjekjen dhe zbatimin e urdhrave, i jeni larguar realitetit dhe jeni kapur pas iluzionit e fantazisë. Kurrë nuk na ka urdhëruar All'llahu që t'i adhurojmë idhujt.

Në ajetin pasardhës gjendet përgjigjja për pyetjen që gjendej në ajetin parardhës dhe thotë se besimtarët, të cilët besuan dhe që nuk e kanë përzier besimin e tyre me padrejtësi, ata janë të sigurtë e të udhëzuar: **“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin**

¹ Fjala “sultan” ka kuptimin “epërsi, triumf”. Përderisa argumenti dhe fakti ishin prej shkaqeve të triumfit, ato cilësohen edhe me fjalën “sultan”, siç është gjendja këtu që nuk ka asnjë argument për lejimin e adhurimit të idhujve dhe këtë nuk e mohon idhujtari, sepse diçka e tillë duhet të vijë nëpërmjet rrugës së arsyes dhe të logjikës ose nëpërmjet Shpalljes profetike. Adhurimi i idhujve nuk ka asnjë argument prej tyre.

besimin e tyre me padrejtësi, pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar."

Gjendet një transmetim nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), që e pohon se ky ajet është plotësues i dialogut të Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me idhujtarët.¹ Disa komentues kanë mendimin se ky ajet mund të jetë sqarim i All'llahut dhe nuk është thënie e Ibrahimit. Mirëpo, ajo që përmendëm, në shtesë të pohimit e të mbështetjes së transmetimit të këtij ajeti, është në përputhje më shumë me renditjen e ajeteve.

Përsa i përket thënies se ky ajet është thënie e idhujtarëve dhe se ata e thanë këtë pas zgjimit të tyre, sapo dëgjuan argumentet e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), por ajo thënie është shumë e largët.

Çfarë kuptimi ka këtu fjala "dhulmun"?

Shumica e komentuesve kanë mendimin se kuptimi i fjalës "dhulmun", këtu është për "shirkun" (politeizmin). Ajeti 13 i sures "Lukman" thotë: **"...Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe"**, është argument për këtë.

Në një transmetim të përcjellë nga ibn Abbasi thuhet se kur zbriti ajeti, njerëzit thanë: *"O i Dërguari i All'llahut! Cili prej nesh nuk i ka bërë padrejtësi vetes? (Pra, ajeti i përfshin të gjithë)."* I Dërguari i All'llahut tha: *"Nuk është ashtu siç mendoni ju. A nuk e keni dëgjuar thënen e robit punëmirë: 'O djali im, mos i shoqëro All'llahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.'"*²

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 100.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 100.

Mirëpo, ajetet e Kur'anit kanë kuptime të ndryshme në shumë prej gjendjeve, ku njëra prej tyre mund të jetë më e gjerë dhe më gjithpërfshirëse. Kjo mund të jetë e mundshme edhe në këtë ajet.

Fjala “*el emn*” është e përgjithshme dhe përfshin sigurinë nga dënimi i All'llahut, sigurinë prej ndodhjeve të dhimbshme në shoqëri, sigurinë prej luftimeve dhe shkatërimeve të krimeve. Madje, edhe sigurinë shpirtërore, e cila arrihet vetëm me realizimin e dy parimeve: besimi dhe drejtësia shoqërore. Nëse lëkundën bazat e besimit në All'llahun dhe në vend të drejtësisë sundon padrejtësia, atëherë në atë shoqëri nuk ka siguri. Megjithatë shumë dijetarë përpiqen ta ndreqin shoqërinë, pasiguria sërish zgjerohet ditaditës. Shkaku i kësaj është lëkundja e bazave të besimit dhe prania e padrejtësisë në vend të drejtësisë.

Vërtet, ndikimi i besimit në qetësinë shpirtërore nuk mund të mohohet. Po ashtu, nuk mund të mohohet se shqetësimi shpirtëror dhe mosfunksionimi i ndërjegjes janë shkak për kryerjen e padrejtësive.

Transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se për thënien e All'llahut: **“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi...”** ka thënë: *“Për atë që solli Muhammedi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) prej vilajetit dhe nuk e ka përzier atë me vilajetin e filanit e të filanit...”*¹

Ky komentim ka për qëllim sqarimin e shpirtit të çështjes në këtë ajet të begatë, sepse fjala është për vilajetin e All'llahut dhe për mospërzierjen e tij me vilajet tjetër. Përderisa vilajeti i prijësit të besimtarëve, Imam Aliut, bazuar në thënien: **“Miq të dhe**

¹ Tefsiri “Nuruth Thakalejn”, vëll. 1, f. 740.

mbrojtësit tuaj janë vetëm All'llahu, i Dërguari i Tij...¹ është përfitim nga vilajeti i All'llahut dhe i të Dërguarit të Tij dhe vilajetet e paemëruara nga ana e All'llahut nuk janë të tilla, për këtë ky ajet nga këndvështrimi i përgjithshëm i përfshin të gjithë. Qëllimi me këtë bisedë nuk është se kuptimi i ajetit është i kufizuar vetëm me këtë, por ky kuptim është përfitim prej kuptimit të vërtetë të ajetit.

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë tregon në formë të përmbledhur hulumtimin rreth Njëtimin (teuhidit) dhe luftimit të politeizmit, siç u përmend me gjuhën e Ibrahimit. Ajeti thotë: **“Ky është argumenti Ynë, të cilin Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij...”**.

Vërtet, ato argumente ishin logjike, e të cilat, Ibrahim i arriti me anë të fuqisë së arsyes e të frymëzimit të natyrës së krijuar (*el fitratu*). Të gjitha këto janë prej All'llahut. Për këtë All'llahu ia atribuon vetes së Tij këto argumente dhe ia hedh Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në zemrën e tij.

Pastaj ajeti thotë: **“...Ne ngremë kë të duam në shkallë të lartë...”**² Me qëllim që askush të mos dyshojë se All'llahu favorizon në ngritjen e shkallëve atë që do, ajeti thotë se All'llahu është i Urtë dhe i Gjithëditur dhe nuk mund ta ngrejë në shkallë të lartë atë që nuk e meriton. Për këtë, ajeti përfundon me thënien: **“...Vërtet, Zoti yt është i Urtë e i Gjithëditur.”**.

¹ Sure “Maide”, ajeti 55.

² Shih komentimi e ajetit 145 të sures “Nisa” për të njohur dallimin mes fjalës “ed derexhetu” dhe “ed derku”.

Ajetet 84 - 87

وَوَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ ۚ كُلًّا هَدَيْنَا ۚ وَنُوحًا هَدَيْنَا مِنْ
 قَبْلُ ۚ وَمِنْ ذُرِّيَّتِهِ دَاوُدَ وَسُلَيْمَانَ وَأَيُّوبَ وَيُوسُفَ وَمُوسَى
 وَهَارُونَ ۚ وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿٨٤﴾ وَزَكَرِيَّا وَيَحْيَىٰ وَعِيسَىٰ
 وَإِيلَاسَ ۖ كُلًّا مِّنَ الصَّالِحِينَ ﴿٨٥﴾ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيُوسُفَ
 وَلُوطًا ۚ وَكُلًّا فَضَّلْنَا عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٨٦﴾ وَمِنْ آبَائِهِمْ وَذُرِّيَّاتِهِمْ
 وَإِخْوَانِهِمْ ۖ وَاجْتَبَيْنَاهُمْ وَهَدَيْنَاهُمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٨٧﴾

“Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin. Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët.”

“Edhe Zekerija, Jahjai, Isai, Iljazi - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë.”

“Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit.”

“Ne zgjodhëm dhe udhëzuam në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre.”

Komentimi

Në këto ajete përmenden mirësitë me të cilat All'llahu e begatoi Ibrahimin (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila simbolizohet (përfaqësohet) me fëmijë të mirë tek gjeneza dhe punëdrejtë. Vërtet, kjo është prej mrësive më të mëdha nga ana e All'llahut të Madhëruar. All'llahu Fuqiplotë thotë: **“Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin....”** Ajeti nuk e përmend djalin tjetër të Ibrahimit, Ismailin. Por, emri i tij përmendet në ajetin tjetër. Ka mundësi që shkaku të jetë se lindja e Is’hakut prej Sarës së moshuar, e cila ishte sterile para lindjes së tij, është prej mirësive të habitshme dhe e papritur.

Më pas, ajeti sqaron se pozita e lartë e këtyre të dyve nuk ishte se ishin fëmijë të Profetit Ibrahim, sepse drita e udhëzimit gjendej në zemrat e tyre si rezultat i të menduarit të thellë dhe i punëve të mira që ata kryenin: **“...Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë...”**.

Me qëllim që askush të mos mendojë se nuk ka patur asnjë njeri mbartës të flamurit të monoteizmit para Ibrahimit, apo të thotë se monoteizmi filloi me Ibrahimin (*Paqja qoftë mbi të!*), ajeti thotë: **“...ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun...”**

Ne e dimë se Nuhu është i pari prej Profetëve të vendosmërisë së lartë (*ulil azmi*), të cilëve u erdhi Sheriati. Nuhu është prej stërgjyshërve të Ibrahimit. Të flasësh për të dhe për një grup Profetësh prej bijëve dhe fisit të tij, është dëshmi e qartë për pozitën e veçantë të Hazreti Ibrahimit në lidhje me trashëgiminë, origjinën dhe gjenezën e tij. Për këtë, në ajet përmenden emrat e disa të Dërguarve prej familjes së Ibrahimit: **“...Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin,**

Musain dhe Harunin...” Më poshtë ajeti sqaron se pozita e tyre e ka burimin tek punët e mira. Duke bërë punë të mira, ata morën shpërblimin e tyre: **“...Kështu i shpërblejmë punëmirët.”**

Komentuesit kanë thënie të shumta rreth përemrit pronor “e tij” që përmendet tek fjala “*dhurijeti-hi*” (gjeneza e tij). A është ky përemër për Ibrahimin apo është për Nuhun? Shumica e komentuesve janë të mendimit se bëhet fjalë për Ibrahimin. Nga pamja e jashtme duket se nuk ka dyshim që përemri flet për Ibrahimin, sepse në ajet flitet për mirësitë që All’l-lahu i dha Ibrahimit e jo Nuhut (*Paqja qoftë mbi të dy ata!*). Edhe transmetimet që do t’i përmendim më poshtë e forcojnë këtë mendim.

Ajo që i bëri disa komentues të thonë se përmemri është për Nuhun, është përmendja e Junusit dhe e Lutit në ajetin pasardhës. Sepse, siç është e njohur në histori, Junusi nuk është prej bijve të Ibrahimit. Po ashtu edhe Luti, i cili ka qenë djali i vëllait të Ibrahimit ose djali i motrës.

Përsa i përket prejardhjes së Junusit, historianët kanë mendime të ndryshme. Disa thonë se ka qenë prej familjes së Ibrahimit¹. Kurse disa të tjerë kanë mendimin se ka qenë prej të Dërguarve të bijve të Izraelit.²

Tek historianët është e njohur se ata përmendin prejardhjen nga ana e babait. Pse duhet të duket e habitshme edhe nëse Junusi mund ta ketë prejardhjen prej gjenezës së Ibrahimit nga ana e nënës së tij, siç është Isai, emrin e të cilit e lexojmë tek ajetet? Përsa i përket Lutit, edhe pse nuk është prej bijve të Ibrahimit, ai ka qenë prej familjes së tij, sepse arabët e përdorin fjalën “*ebun*” (baba) edhe për xhaxhanë. Gjithashtu, fëmija e djalit apo e vajzës

¹ Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 7, f. 184.

² “Dairetul Mearif” i Ferijd Uxhdij, vëll. 10, f. 1055, tek fjala “Junus”.

janë prej gjenezës së një personi. Prandaj, nuk duhet neglizhuar e jashtëmja e ajetit e të themi se përemri flet për Nuhun.

Në ajetin e dytë përmendet Zekerija, Jahjai, Isai dhe Iljasi dhe të gjithë kanë qenë punëmirë e të drejtë. **“Ne udhëzuam edhe Zekerijan, Jahjain, Isain, Iljazin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë.”**

Ndërsa në ajetin e tretë përmenden katër të Dërguar të All'llahut të Madhëruar: **“Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit.”** Komentuesit nuk kanë mendim të përbashkët për emrin Eljesa. Disa thonë se është emër hebraik dhe origjina e tij është 'Jusha'u'. Më pas janë shtuar 'lami' dhe 'elifi' dhe është ndërruar gërma 'shiin' në gërmën 'siin'.

Disa të tjerë thonë se është emër arab që vjen prej foljes 'jese'a'. Sido që të jetë, ai është emri i një prej të Dërguarve të All'llahut dhe prej gjenezës së Ibrahimit.

Në ajetin e fundit flitet përgjithësisht për baballarët e të Dërguarve të përmendur, për bijtë e tyre dhe për vëllezërit e tyre, emrat e të cilëve nuk janë përmendur me detaje. Të gjithë kanë qenë punëmirë dhe të udhëzuar. Ajeti thotë: **“Ne zgjodhëm dhe udhëzuam në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre.”**

Hulumtime

1- Fëmijët e Profetit Ibrahim

Në këto ajete Isai është konsideruar prej bijve të Ibrahimit (supozohet edhe prej bijëve të Nuhut). Ne e dimë se lidhja e Hazreti Isait me të dy ata është nga ana e nënës. Ky është argument se zinxhiri i gjenezës, qoftë nga babai, ashtu edhe nga nëna, është i barabartë. Kjo do të thotë se nipërit dhe mbesat prej djalit dhe vajzës janë gjeneza e një njeriu dhe fëmijë të tij.

Bazuar në këtë, edhe Imamët e Ehli Bejt, të cilët janë nipërit e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për nga vajza e tij, ata njihen edhe si djemtë e tij. Në kohën para Islamit, gruaja nuk kishte pozitë.

Gjeneza, sipas tyre, ishte vetëm kur ka lidhje me babanë. Por Islami e anuloi këtë traditë të xhahilijetit. Është për të ardhur keq se disa kalemxhinj, të cilët mbartin në vetat e tyre diçka jo të mirë për Ehli Bejt, janë përpjekur që ta mohojnë këtë temë duke u kthyer tek tradita xhahilijite dhe duke mohuar prejardhjen e fëmijëve të Fatimesë, të qenit prej gjenezës së Profetit. Ata e kundërshtuan përdorimin e frazës thirrëse 'ibn Resulil'lah', i biri i Dërguarit të All'llahut, duke ringjallur në këtë mënyrë traditën para Islamit. Po e njëjta temë diskutohej edhe në kohën e Imamëve, të cilët përgjigjeshin me këtë ajet, duke e konsideruar argument të fortë e të prerë për të gjitha shpifjet.

Në librin "el Kafij" dhe në tefsirin "El Ajjashij" transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: "Betohem në All'llahun. Vërtet, All'llahu e ka quajtur Isanë prej

gjenezës së Ibrahimit nga ana e nënës. Pastaj lexoi ajetin e lartpërmendur."¹

Në tefsirin "Ajjashij", transmetohet nga Ebi el Esued se ka thënë: "Haxhaxhaxhi i dërgoi një shkresë Jahja ibn Muamer dhe i tha: Më kanë lajmëruar se ti pretendon që Hasani dhe Hysejmi janë prej gjenezës së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për këtë pretendim ju thoni se e gjeni në Librin e All'llahut. Unë e kam lexuar Kur'anin nga fillimi e deri në fund dhe nuk e kam parë këtë." Jahjai tha: A nuk e ke lexuar suren "En'am": **"...e prej pasardhësve të tij Daudi dhe Sulejmani"**, derisa sa arriti të **"Jahjai dhe Isai"**. A nuk është Isai prej pasardhësve të Ibrahimit nga ana e nënës e ai nuk ka baba? Haxhaxhaxhi i tha: 'Ke të drejtë.'"²

Në librin "Ujun Akhbar Rida" gjendet një bisedë e gjatë mes Musa ibn Xhaferit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe mes Harun Rashidit dhe Musa ibn Mehdi. Haruni i tha Ebu Xhaferit: "Si thoni ju që jeni pasardhësit e të Dërguarit të All'llahut dhe i Dërguari nuk ka lënë pasardhës dhe se pasardhësit janë për nga meshkujt dhe jo nga femrat. Ju jeni bijtë e vajzës së tij. Musa ibn Xhaferi (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: A më lejon të të përgjigjem? I tha: "Bëje." I thashë: "I kërkoj mbrojtje All'llahut prej djallit të mallkuar. Me emrin e All'llahut, të Gjithmëshirshmit Mëshirplotit: **"...Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët."** "Edhe Zekerijan, Jahjain, Isain..." Kush është babai i Isait, o prijës i besimtarëve? Tha: "Isai nuk ka baba." I thashë: "Ai është prej

¹ Tesiri "Ajjashij", vëll. 1, f. 367. "Biharul Enuar", vëll. 65, f. 91 (Shih edhe komentimin e Hafiz Ibrahim Dalliut në faqen 698. Shënim i përkthyesit)

² Tefsiri "Ajjashij", vëll. 1, f. 367. "Biharul Enuar", vëll. 65, f. 91.

pasardhësve të Profetëve nëpërmjet Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe ne jemi prej pasardhësve të Profetit nëpërmjet nënës tonë, Fatimesë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Këtë e përmend edhe Fakhri Rraziu në komentimin e këtij, i cili argumenton se Hasani dhe Hysejini janë prej gjenezës së Profetit Muhammed, sepse All'Ilahu ka përmendur që Isai është prej gjenezës së Ibrahimit edhe pse me lidhje nga nëna.¹

Autori i tefsirit “El Manar”, pasi përcjell thënien e Raziut, thotë: “Për këtë temë ka hadith që e transmeton Buhariu në “Sahihun” e tij, i përcjellë nga Ebu Bekri se Profeti ka thënë për Hasanin të birin e Aliut: “Ky djali im është zotëri.” Ndërkohë që fjala “ibn” (djale), në kohën para Islamit, nuk përdorej për djemtë e vajzës.²

S’ka dyshim se bijtë e djalit dhe ato të vajzës janë të njëjtë dhe nuk ka dallim mes tyre dhe kjo nuk është çështje e posaçme vetëm për Profetin. Shkaku i kundërshtimit të kësaj është veçse fanatizmi verbues dhe kapja pas mendimeve të kohës para Islamit. Për këtë shohim se në *Sheriatin* Islam nuk ka dallime mes tyre në martesë e në trashëgimi. Dallimi i vetëm është për tematikën e khumsit (një e pesta) që është e sqaruar në librat e jurisprudencës.

2- Përse përmenden emrat e Profetëve në tre grupe në tre ajete?

Disa komentues kanë mendimin se **grupi i parë**: Daudi, Sulejmani, Ejububi, Jusufi, Musai dhe Haruni, në shtesë të qëniet të tyre Profetë kanë patur në duart e tyre drejtimin dhe gjykimin.

¹ Tefsiri “Kebir”, vëll. 13, f. 66.

² “Sahihu” Buhari, vëll.3., f. 169 dhe 170.

Ka mundësi që edhe përmendja e thënies: **“Kështu i shpërblejmë punëmirët”** tregon për punët e mira që ata kanë bërë kur udhëhiqnin.

Grupi i dytë: Zekerija, Jahai, Isai, dhe Iljasi, përveçse ishin të Dërguar, njiheshin edhe për mistikën e tyre si dhe duke mos u dhënë pas dynjasë. Pas përmendjes së emrave të tyre thuhet se të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë.

Grupi i tretë: Ismaili, Eljesai, Junusi dhe Luti, kanë udhëtuar në rrugën e përhapjes së thirrjes së All'Ilahut. Frazja **“...secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit”**, tregon se këta udhëtuan në vende të ndryshme të tokës në mesin e popujve të ndryshëm.¹

3- Rëndësia e fëmijëve punëmirë në njojhjen e personalitetit të njeriut

Kjo është një temë tjetër që konkludohet nga ky ajet. Duke përmendur personalitetin e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) heroit të thyerjes së idhujve, All'Ilahu tregon se në kohë të ndryshme ka patur personalitete të larta prej gjenezës së këtij njeriu të madh. Edhe ata kanë patur cilësi dhe virtyte të larta. Ndër njëzet e pesë të dërguar që përmenden në Kur'an, gjashtëmbëdhjetë prej tyre janë prej gjenezës së Ibrahimit. Në realitet, ky është një mësim i përkryer për myslimanët që ta dinë se ata dhe fëmijët e tyre janë pjesë e personalitetit të atyre njerëzve të mëdhenj dhe se edukimi i fëmijëve të tyre është prej çështjeve shumë të rëndësishme.

¹ Tesiri “Mijzan”, vëll. 7, f. 244.

4- Përgjigje kundërshtimit

Ndoshta ata që lexojnë ajetin: **“Ne zgjodhëm dhe udhëzuam në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre.”** konkludojnë se jo të gjithë baballarët e Profetëve kanë qenë besimtarë. Ka patur prej tyre që nuk kanë qenë monoteistë, siç thonë disa komentues të Ehli Synetit në kometimin e këtij ajeti. Mirëpo, ne duhet të vështrojmë se fraza **“Ne zgjodhëm dhe udhëzuam...”** me argumentet e pranishme në ajet, ka kuptimin e pozitës së profetësisë e të mbartjes së mesazhit. Me këtë sqarohet edhe kundërshtimi. Që do të thotë, se kuptimi i ajetit është: Ne i kemi zgjedhur disa prej tyre për postin e profetësisë dhe kjo nuk do të thotë se të tjerët nuk kanë qenë monoteistë. Në ajetin 90 të kësaj sureje, fjala *“hidajetun”* ka ardhur me kutpimin *“nubuuwetun”* “të Dërguar”.

Ajetet 88 - 90

ذَٰلِكَ هُدَىٰ ٱللَّهُ يَهْدِي بِهِ ٱلْمَن يَشَآءُ ٱلَّذِينَ عِبَادِهِ ۚ وَلَوْ
 أَشْرَكُوا لَحَبِطَ عَنْهُمْ مَآ كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٨٨﴾ أُوْلَٰئِكَ ٱلَّذِينَ
 ءَاتَيْنَهُمُ ٱلْكِتَآبَ وَٱلْحُكْمَ وَٱلنُّبُوَّةَ ۚ فَاِنْ يَكْفُرْ بِهَا هَٰؤُلَاءِ فَقَدْ
 وَكَّلْنَا بِهَا قَوْمًا لَّيْسُوا بِهَا بِكَافِرِينَ ﴿٨٩﴾ أُوْلَٰئِكَ ٱلَّذِينَ هَدَى
 ٱللَّهُ ۖ فَبِهَدْيِهِمْ أَقْتَدِهِ ۚ قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا ۖ إِنْ هُوَ إِلَّا
 ذِكْرَىٰ لِّلْعَالَمِينَ ﴿٩٠﴾

“Ky është udhëzimi i All’Ilahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë nga robtë e Vet. Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t’u humbë çdo gjë nga ajo që kanë bërë.”

“Këta janë ata që u kemi dhënë Librin, Urtësinë dhe Profetësinë. E, nëse ata (banorët e Mekës) i mohojnë këto, Ne do t’ia besojmë një populli tjetër që nuk do t’i mohojë.”

“Këta janë ata, të cilët All’Ilahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhammed) ndiq rrugën e tyre. Thuaj: ‘Unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi për atë. Ai është vetëm këshillë për të gjithë botët (njerëzit dhe xhindet)’”.

Komentimi

Tri veçanti të rëndësishme

Pas përmendjes së disa Profetëve në ajetet e mëparshme, këto ajete flasin për vijat e përgjithshme të jetës së tyre. Ato fillojnë me thënien: **“Ky është udhëzimi i All’llahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë nga robtë e Vet...”**, domethënë, se ata edhe pse janë punëmirë dhe të udhëzuar me forcën e mendjes e të logjikës në rrugën e udhëzimit, ata i ka përfshirë përkujdesja e All’llahut.

Më qëllim që askush të mos mendojë se ata janë të detyruar në këtë rrugë, ose të mos mendojë se All’llahu i shikon me shikim të veçantë, Kur’ani thotë: **“...Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t’u humbë çdo gjë nga ajo që kanë bërë.”** Pra, ata janë të përfshirë në këtë ligj të All’llahut, që i përfshin të gjithë.

Ajeti pasardhës flet për tri veçanti të rëndësishme që janë baza e dallimit të Profetëve. Ai thotë: **“Këta janë ata që u kemi dhënë Librin, Urtësinë dhe Profetësinë...”** Kjo nuk do të thotë se të gjithë kanë patur Libër qiellor, por fjalët janë për të gjithë. Atribuimi i librit për të gjithë është sikur të themi se filan libër e përmendin dijetarët në librat e tyre, që do të thotë se ka shkruar ai që është autor prej tyre.

Përsa i përket kuptimit të fjalës *“el hukm”*, ka tri alternativa:

1- Ka kuptimin e “logjikës dhe perceptimit”. Që do të thotë, se përveç Librit qiellor që u kemi zbritur atyre, Ne u kemi dhuruar fuqinë e të logjikuarit e të të perceptuarit. Kjo për faktin se prania e librit, pa qenë prania e fuqisë së të kuptuarit të tij të thellë, nuk ka kuptim.

2- Ka kuptimin e ‘el kadau’. Që do të thotë, se me nxjerrjen e ligjeve të All’llahut prej atyre librave qiellorë, kanë qenë të aftë

të gjykojnë në mesin e njerëzve, sepse zotërojnë të gjitha kriteret e duhura për të qenë gjykatës të drejtë.

3- Ka kuptimin e **“el hukumetu”**, udhëheqje qeverisje, në shtesë të postit të profetësisë. Argumenti për kuptimet e mësipërme - në shtesë të kuptimit gjuhësor që përshtatet me fjalën - është se fjala **“el hukmu”** gjendet po me këtë kuptim edhe në ajete të tjera të Kur'anit.¹

Nuk gjendet asnjë pengesë që fjala në këtë ajet të përdoret me të tre kuptimet së bashku, sepse fjala **“el hukmu”** në origjinalitet, siç thotë Ragibi në librin e tij **“El Mufredatu”**, do të thotë **“el Men’u”** (ndalim, pengim). Prej atyre është edhe intelekti që pengon kryerjen e gabimeve e kundërshtimeve. Gjithashtu, edhe gjykimi i drejtë e ndalon padrejtësinë. Qeveria e drejtë qëndron përballë qeverive të padrejta. Pra, fjala **“el hukm”**, është përdorur për të tre kuptimet.

Më pas ajeti thotë se nëse ky grup (politeistët dhe banorët e Mekës) i kundërshtojnë ato të vërteta kur ti i fton ata, dije se thirrja jote nuk do të mbetet pa përgjigje, sepse Ne kemi urdhëruar disa të tjerë që jo vetëm të besojnë, por ta ruajnë mesazhin tënd, sepse ata kurrë nuk ndjekin rrugën e mosbesimit, por ndjekin vetëm të vërtetën: **“...E, nëse ata (banorët e Mekës) i mohojnë këto, Ne do t’ia besojmë një populli tjetër që nuk do t’i mohojë.”**.

Në tefsirin **“El Manar”** dhe në tesirin **“Ruhul Meanij”** transmetohet nga disa komentues se kuptimi i fjalës **“kaumun”**, **“popull”** është për persët² të cilët e pranuan me shpejtësi Islamin

¹ Në ajetin 12 të sures **“Lukman”** ka ardhur me kuptimin e dijes e të kuptimit. Në ajetin 22 të sures **“Sad”** ka kuptimin e të gjykuarit. Në ajetin 26 të sures **“Kehf”** ka kuptimin e udhëheqjes.

² Tefsiri **“El Manar”** dhe tefsiri **“Ruhul Meanij”** fundi i ajetit në fjalë.

dhe janë përpjekur në rrugën e përhapjes së tij. Në mesin e tyre janë dukur dijetarë në fusha të ndryshme të dijes, shkencës e të artit islam dhe kanë shkruar shumë libra.¹

Ajeti i fundit e bën rrugën e atyre Profetëve të mëdhenj shembull të lartë të udhëzimit dhe ia paraqet të Dërguarit të Islamit e i thotë: **“Këta janë ata, të cilët All’llahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, prandaj edhe ti (o Muhammed) ndiq rrugën e tyre!”** Ky ajet dëshmon edhe njëherë se baza e thirrjes së Profetëve është e njëjtë dhe e përbashkët megjithë praninë e disa ndryshimeve të veçanta dhe veçorive të domosdoshme për çdo kohë dhe çdo vend. Çdo fe pasardhëse është më e plotë se ajo paraardhëse. Pa dyshim që Islami është më i ploti dhe vula e të gjitha feve.

Ku është qëllimi me urdhërimin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të ndjekur udhëzimin e atyre Profetëve?

Disa komentues thonë: Ka mundësi që kuptimi të jetë durimi dhe fuqia e vendosmërisë përballë problemeve. Disa të tjerë thonë se ka kuptimin e unifikimit të predikimit të mesazhit. Mirëpo, fjala “*el hidajetu*” (*udhëzimi*), ka kuptim të gjerë dhe përfshin Njësimin dhe parimet e tjera të besimit, ashtu siç përfshin durimi dhe vendosmëria parimet e tjera morale dhe edukative.

Nga ajo që u tha më parë sqarohet se ky ajet nuk bie ndesh me thënien se Islami është anulues i feve dhe i sheriateve të mëparshme, sepse anulimi përfshin një anë prej rregullave dhe ligjeve të atyre sheriateve dhe jo parimet e përgjithshme të thirrjes.

¹ Ka mundësi që të jenë vetë të Dërguarit, nëse supozojmë të pamundurën e të themi se ata Profetë të mëdhenj e lanë predikimin e mesazhit të All’llahut, e kështu mesazhi do ta vazhdonte rrugën e tij nëpërmjet duarve të tjera. E njëjtë si kjo thënie përmendet edhe në suren “Zumer”, ajeti 65.

Pastaj All'llahu e urdhëron të Dërguarin që t'u thotë njerëzve se ai është si Profetët e tjerë që nuk merr shpërblim në këtë jetë për përhapjen e mesazhit: **"...Thuaj: 'Unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi për atë...'"**.

Kjo fe e pastër që u solla juve është amanet i All'llahut, të cilin e vendosa në duart tuaja dhe kërkimi i shpërblimit për këtë nuk ka kuptim.

Sigurisht, mirësitë e përgjithshme si: drita e diellit, ajri, shirat, janë për të gjithë. Ato as nuk shiten e as nuk blihen dhe as shpërblim nuk jepet për ato. Ky udhëzim dhe ky mesazh nuk janë të posaçëm vetëm për disa njerëz.

Nga ajeti i fundit sqarohet se feja islame nuk është fe kombëtare e as rajonale. Ajo është fe mbarëbotërore dhe e përgjithshme.

Ajeti 91

وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ إِذْ قَالُوا مَا أَنزَلَ اللَّهُ عَلَىٰ بَشَرٍ مِّن شَيْءٍ ۚ قُلْ مَنْ أَنزَلَ الْكِتَابَ الَّذِي جَاءَ بِهِ مُوسَىٰ نُورًا وَهُدًى لِّلنَّاسِ ۚ تَجْعَلُونَهُ قَرَاطِيسَ تُبْدُونَهَا وَتُخْفُونَ كَثِيرًا ۚ وَعَلَّمْتُمْ مَا لَمْ تَعْلَمُوا أَنَّكُمْ وَلَا آبَاؤُكُمْ ۚ قُلِ اللَّهُ ۚ ثُمَّ ذَرْهُمْ فِي خَوْضِهِمْ يَلْعَبُونَ ﴿٩١﴾

“Ata nuk e vlerësojnë siç duhet All’llahun, kur thonë: ‘All’llahu nuk i ka zbritur asgjë njeriut’. Thuaj: ‘Atëherë, kush e shpalli Librin që solli Musai si dritë dhe udhërrëfyes për njerëzit?! Librin që ju e keni shpërndarë në fletë, ca prej të cilave i tregoni, ndërsa shumicën e fshihni, ndonëse tani keni mësuar diçka që as ju, as etërit tuaj nuk e keni ditur më parë?!’ Thuaj: ‘All’llahu e ka shpallur (atë Libër)!’ Pastaj lëri ata që të argëtohen me gënjeshtat e tyre.”

Shkaku i zbritjes

Transmetohet nga ibn Abbasi se një grup jehudinësh i thanë Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “O Muhammed! A është e vërtetë që All’llahu të ka

*zbritur ty libër?" Ai iu përgjigj: "Po." Ata i thanë: "Betohemi në All'llahun se ty nuk të ka zbritur libër nga qielli."*¹

Ka edhe thënie të tjera për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, por ne do ta sqarojmë më poshtë se kjo që përmendëm për shkakun e zbritjes është më e përshtatshme.

Komentimi

Të pavëmendshmit ndaj All'llahut

Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth zbritjes së këtij ajeti se a ka zbritur për jehudinjtë apo për mushrikët (politeistët). Përderisa Profeti nuk ka patur diskutime me jehudinjtë në Mekë, sepse ato filluan në Medine, edhe kjo sure është mekase. Disa komentues mendojnë se ky ajet ka zbritur në Medine. Ata thonë se ky ajet është vendosur në këtë sure (mekase) me urdhër të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Për sqarimin e së vërtetës duhet së pari të njihemi me komentimin përgjithësues të ajetit, pastaj të hulumtojmë rreth asaj që flet ajeti dhe qëllimit të tij.

Në fillim, ajeti thotë se ata nuk e njihnin All'llahun ashtu siç duhet njohur dhe e mohuan zbritjen e librit nga qielli (nga All'llahu): **"Ata nuk e vlerësojnë siç duhet All'llahun, kur thonë: 'All'llahu nuk i ka zbritur asgjë njeriut...'"**.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 17. Tefsiri "Mijzan", vëll. 7, f. 304.

All'Ilahu e urdhëron të Dërguarin e Tij: **"...Thuaj: 'Atëherë, kush e shpalli Librin që solli Musai si dritë dhe udhërrëfyes për njerëzit?!...'"** Atë Libër të cilin ju e bëtë fletë të shpërndara? Merrni prej tij ato që ju interesojnë juve dhe fshihni ato që mendoni se ju sjellin dëm: **"...Librin që ju e keni shpërndarë në fletë, ca prej të cilave i tregoni, ndërsa shumicën e fshihni..."** Vërtet, nga ky Libër qiellor ju mësoni shumë gjëra, të cilat as ju e as babllarët tuaj nuk i dinin: **"...ndonëse tani keni mësuar diçka që as ju, as etërit tuaj nuk e keni ditur më parë?!"**

Në fund të ajetit, Profeti urdhërohet që ta përmendë All'Ilahun dhe t'i lërë ata në kotësinë, kokëfortësinë dhe në zbavitjen e tyre: **"...Thuaj: 'All'Ilahu e ka shpallur (atë Libër)! Pastaj lëri ata që të argëtohen me gënjeshttrat e tyre."**

Nëse ky ajet ka zbritur në Medine dhe flet për jehudinjtë, atëherë kuptimi i tij është se një grup jehudinjsht nuk besonin se Profetëve u janë zbritur libra. Vallë, a mundet që jehudinjtë, idhtarët e Teuratit, të mohojnë zbritjen e Librit nga qielli? Po. Habia yte do të sqarohet kur të dish çështjen që vijon: Sikur të vështrojmë me vëmendje Inxhilin dhe Teuratin, do të shohim se ato nuk janë fjalët e All'Ilahut drejtuar njerëzve, por janë thënie të ardhura nga nxënësit e Musait dhe Isait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi ata të dy!*) në formën e një ndodhie apo tregimi. Pra, në ato libra nuk ka ngjyra qiellore. Sepse ne to janë shtuar dhe janë hequr gjëra të cilat i ndryshuan pasuesit e tyre.

Mesa duket, sot as jehudinjtë e as të krishterët nuk e mohojnë këtë gjë, sepse shumë ndodhi që kanë ndodhur pas vdekjes së Musait dhe të Isait (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi ta!*) janë të shkruajtura në Teurat dhe në Inxhil. Vallë a është e mundur që këto dy lloj librash të tillë u janë zbritur Musait dhe Isait?!

Të krishterët dhe jehudinjtë besojnë se këto libra janë shkruar me duart e njerëzve të tyre dhe i konsiderojnë libra të shenjtë, të zbrazët nga gabimet dhe mund të mbështetesh tek ato. Bazuar në këtë, na sqarohet se përse habiteshin kur dëgjonin metodën e Kur'anit, ku All'llahu i drejtohet të Dërguarit të Tij dhe robve të Tij.

Siç thamë edhe në shkakun e zbritjes se kur u habitën, e pyetën të Dërguarin e All'llahut, Profetin Muhammed duke i thënë: *"E vërtetë është se All'llahu të ka zbritur libër?"* Pastaj e mohuan plotësisht se asnjë të Dërguari nuk i është zbritur Libër, deri as edhe Musait.

Mirëpo, All'llahu u përgjigjet duke u thënë atyre se ata vetë besonin se Musait i kishin ardhur broshura dhe se ai libër që ndodhej në duart e tyre, edhe nëse nuk ishte qiellor, ju besoni se diçka e pakët si kjo është zbritur nga All'llahu dhe ju e shfaqni një pjesë dhe fshihni një pjesë tjetër prej tij. Sipas kësaj nuk mbetet vend për të dyshuar për mundësinë e mohimit të zbritjes së Librit qiellor nga ana e jehudinjtë.

Por, nëse ky ajet është si ajetet e tjera të kësaj sureje që është e posaçme për politeistët, atëherë kuptimi i tij është se ata e mohuan zbritjen e librave për të mohur thirrjen e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Mirëpo, All'llahu u sqaron atyre logjikisht se ata nuk mund ta mohojnë plotësisht zbritjen e Kur'anit, sepse politeistët, edhe pse nuk ndiqnin fenë jehudite, ata i konsideronin të Dërguarit e mëparshëm, Ibrahimin dhe Musain, si Profetët e kohës së tyre.

Dhe, kur erdhi Profeti Islam ata u strehuan tek ithtarët e Librit, duke kërkuar tek librat e tyre për shenjat që tregojnë

ardhjen e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nëse nuk do të besonin se ato libra janë të zbritur nga qielli, përse të kërkonin në to shenjat e ardhjes së Profetit Muhammed? Pasi pyetën jehudinjtë, e shfaqën atë që kishin interes dhe e fshehën atë që u sillte dëm, siç ishin shenjat treguese për ardhjen e Profetit Islam që përmendeshin në ato libra. Bazuar në këtë, ky ajet, gjithashtu, mund të përputhet me thëniet e politeistëve mekas. Mirëpo, komenti i parë është më afër me kontekstin e ajetit dhe me shkakun e zbritjes, duke parë edhe përemrat pronorë që ka ky ajet.

Hulumtime

1- Fjala “*karatijsun*” është shumësi i fjalës “*kirtasun*” me origjinë nga greqishtja, siç thonë disa. Ajo ka kuptimin e asaj që shkruhet në të (fletës), siç thotë Ragibi në librin “*El Mufredat*”. Bazuar në këtë, letrat e zakonshme, lëkurat e kafshëve, të pemëve e të ngjashme me to, të cilat përdoreshin për shkrim në të kaluarën, përfshihen nën këtë fjalë.

2- Dikush mund të pyesë: Përse ajeti i qorton jehudinjtë dhe shkrimet e tyre në letra? A është i domosdoshëm qortimi sepse ata shkruanin? Përgjigja është: Qortimi nuk ka qenë për shkak të shkrimit, por për shkak se ata e shkruan në letra të ndryshme me anë të të cilave ata mund të shfaqnin çfarë të donin dhe të fshihnin çfarë të donin, në varësi të dobisë dhe të dëmit të tyre.

3- Tek fraza **“Ata nuk e vlerësojnë siç duhet All’llahun...”**, kuptohet se ai që e njeh All’llahun ashtu siç duhet, nuk mund ta mohojë faktin se Ai nuk ka dërguar udhëzues e udhërrëfyes dhe së bashku me ta edhe libra për njerëzit, sepse urtësia e All’llahut çon në:

Së pari: Njeriu është ai që e cakton rrugën e vet për të arritur qëllimin e përsosurisë së vet për të cilën është krijuar. Ky qëllim nuk mund të realizohet pa praninë e të Dërguarve dhe të Librave qiellorë që përmbajnë mësimet më të larta për edukim dhe përparim dhe që janë të zbrazët nga gabimet e dyshimet.

Së dyti: Si është e mundur që All’lahu i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë ta lërë njeriun në vetmi në rrugën e lumturisë së tij, kur dihet që kjo rrugë është e mbushur me pengesa të ndryshme e të shumta? A është e mundur që Ai të mos dërgojë udhëzues që mbart mësimet e udhëzime për drejtimin e njerëzve? Atëherë, urtësia dhe mëshira e Tij e bëjnë të domosdoshëm dërgimin e Profetëve dhe zbritjen e Librave qiellorë.

S’ka dyshim se njohja e vërtetë e Vetës së Shenjtë dhe pastrimi i saj prej cilësive të krijesave është pjesë e besimit. Mirëpo, ky ajet nuk ka për qëllim këtë kufi njohjeje, por thotë: Sikur të arrijë njeriu ta njohë sadopak All’llahun, atëherë ai nuk do të dyshojë aspak se ky Krijues do ta lërë njeriun pa udhëzues, pa tregues dhe pa libër sqarues.

Ajeti 92

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ مُصَدِّقُ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَلِتُنْذِرَ أُمَّ
الْقُرَى وَمَنْ حَوْلَهَا ۚ وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۖ وَهُمْ
عَلَى صَلَاتِهِمْ تُحَافِظُونَ ﴿٩٢﴾

“Ky Libër që e kemi zbritur, është i bekuar, vërtetues të atij që gjendet para tij dhe që të paralajmërosh popullin e nënës së qyteteve (Mekës) dhe ata që banojnë rreth saj. Ata që besojnë në Jetën e Ardhshme, besojnë edhe në të (Kur’anin) dhe kujdesen për kryerjen e namazit të tyre.”

Komentimi

Në vazhdim të hulumtimit të ajeteve të mëparshme rreth Librit qiellor të jehudinjeve, ky ajet flet për Kur’anin. Në realitet, përmendja e Teuratit para Kur’anit është për t’u hequr atyre habinë dhe frikën e zbritjes së librit qiellor (Kur’anin) një njeriu prej njerëzve. Ajeti fillon me thënien: “**Ky Libër që e kemi zbritur, është i bekuar...**”, sepse është burimi i të mirave dhe i begative, i ndreqjes dhe i përparimit e qytetërimit. Ai e dëshmon Librin që zbreti para tij: “**...vërtetues të atij që gjendet para tij...**”

Kuptimi është se Kur’ani i dëshmon librat që kanë zbritur para tij dhe të gjitha shenjat që përmenden në ato libra janë në përputhje me të. Më pas Kur’ani sqaron qëllimin e zbritjes, që

është paralajmërimi për banorët e Mekës dhe për ata që jetojnë përreth saj, duke i paralajmëruar për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre: **“...dhe që të paralajmërosh popullin e nënës së qyteteve (Mekës) dhe ata që banojnë rreth saj...”**

Fjala *“el indharu”* do të thotë lajmërim, e cila përmban frikë kur lihen detyrat dhe përgjegjësitë. Ky është një prej qëllimeve të Kur'anit, veçanërisht për tiranët dhe kokëfortët. Në fund, ajeti dëshmon se ata që besojnë në Ditën e Kiametit, në Ditën e Llogarisë e të Shpërblimit, ata e besojnë edhe këtë Libër. Ata e kryejnë namazin dhe nuk ekzagjerojnë në kryerjen e tij. Ajeti thotë: **“...Ata që besojnë në Jetën e Ardhshme, besojnë edhe në të (Kur'anin) dhe kujdesen për kryerjen e namazit të tyre.”**

Hulumtime

Islami - fe mbarëbotërore

Në ajete të ndryshme të Kur'anit sqarohet më së miri, duke hequr çdo mëdyshje, se Islami është fe mbarëbotërore. Prej këtyre ajeteve është: **“...në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujt do që i përcillet...”**¹ Dhe: **“Ai është vetëm këshillë për të gjithë botët.”**² Dhe: **“Thuaj (o Muhammed): ‘O njerëz, unë jam i Dërguari i All'llahut për të gjithë ju...’”**³ e të tjera ajete kur'anore, të cilat e dëshmojnë dhe e përforcojnë këtë të vërtetë. Ajo që tërheq vëmendjen është se shumica e këtyre ajeteve kanë

¹ Sure “En'am”, ajeti 19.

² Sure “En'am”, ajeti 90.

³ Sure “A'raf”, ajeti 158.

zbritur në Mekë në kohën që Islami nuk i kishte kaluar kufijtë e atij qyteti.

Duke parë ajetin në fjalë lind pyetja: Ky ajet i drejtohet me *“umul kurra”* dhe atyre që gjenden rreth saj. Si ka mundësi që kjo të përputhet me thënien se Islami është fe mbarëbotërore?

Në të vërtetë, ky kundërshtim ka ardhur edhe nga gjuhët e jehudinjeve dhe prej pasuesve të feve të tjera, duke menduar se e goditën njëherë e mirë të qenit e Islamit fe mbarëbotërore, sepse ajeti e kufizon vendin e tij me një zonë të veçantë që është Meka dhe rrethinat e saj.¹

Përgjigje: Përgjigja e këtij kundërshtimi sqarohet duke u përqëndruar në dy pika që të kuptojmë se ky ajet, jo vetëm nuk bie ndesh me të qenit e Islamit mbarëbotëror, por ai është një prej argumenteve që e forcojnë këtë çështje.

Fjala *“el karjetu”*, në gjuhën e Kur’anit është emër që tregon për një vend në të cilin grumbullohen njerëzit, qoftë qytet i madh apo fshat i vogël. Në suren Jusuf, për shembull, thuhet nëpërmjet gjuhës së vëllezërve të Jusufit kur i flasin babait të tyre: **“Pyet banorët e qytetit në të cilin kemi qenë...”**² Ne e dimë se ata u kthyen të hutuar për shkak se Azizi i Egjiptit e mbajti vëllanë e tyre Benjaminin. Gjithashtu lexojmë: **“Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.”**³ Natyrisht që qëllimi këtu nuk është për fshatin apo rrethinë të qytetit, por për një zonë të banuar në tokë. Nga ana tjetër, ka transmetime të shumta që thonë se

¹ Disa kundërshtime në lidhje me këtë temë kanë përmendur edhe orientalistët që i përmend autori i tefsirit *“El Manar”*, vëll. 7, f. 621 dhe në tefsirin *“Fi Dhilalil Kur’an”*, vëll. 3, f. 305.

² Sure *“Jusuf”*, ajeti 82.

³ Sure *“A’raf”*, ajeti 96.

thatësira është përhapur nën Qabe. Kjo është ajo që i thuhet "*dehul erdi*".¹

Gjithashtu, e dimë se në fillim zbritën shira të shumtë, të cilët e mbuluan rruzullin tokësor. Pastaj uji filloi të thahej pjesë-pjesë, derisa u përqëndrua në vende të ulëta dhe u duk toka. Pika e parë në të cilën u shfaq toka pas mbulimit me ujë, sipas transmetimeve islame, ka qenë Meka.² Të qëniet e Mekës jo në vendin më të lartë të rruzullit tokësor nuk bie ndesh me thënien se kanë kaluar me qindra miliona vjet nga koha e ndodhisë së "*dehul erdi*". Dhe që nga koha e saj kanë ndodhur ndryshime të shumta gjeografike të cilat e kanë ndryshuar plotësisht tokën. Disa male janë shndërruar në detëra të thellë dhe disa vende ku kishte detëra janë bërë male. Kjo është konsatnte në shkencën e gjeologjisë dhe gjeografisë natyrore.

Fjala "*ummun*", siç e kemi përmendur edhe më parë, ka kuptimin e origjinës, themelit dhe fillimit të çdo gjëje. Nga e gjitha kjo sqarohet se nëse Meka është quajtur "*Ummul kurra*", kjo është për shkak ajo ka qenë epiqendra e shfaqjes së tokës pas mbulimit nga uji. Frazja "*ue min hauliha*", dhe ata që banojnë rreth saj, ka kuptimin e njerëzve që banojnë në të gjitha tokat e saj (Mekës). Këtë e dëshmojnë edhe ajete të tjera që forcojnë qënien e Islamit fe mbarëbotërore. Gjithashtu edhe letrat e shumta që u dërgoi Profeti Muhammed udhëheqësve të asaj kohë siç ishin perandorët romake dhe ata pers, të cilat i pëmendëm në xhuzin e dytë të këtij komentimi.

¹ Tefsiri "Mijzan", vëll. 3, f. 356. "Biharul Enuar"; vëll. 63, f. 454.

² "Uesailu Shia"; vëll. 10, f. 449 (kreu 16, pëlqyeshmëria e zgjerimit në ditën e dukjes së tokës).

Lidhja mes besimit në Kur'an dhe në Jetën Tjetër

Ky ajet sqaron se ata që besojnë në Jetën Tjetër (Ahiretin), gjithashtu, i besojnë edhe Kur'anit. Që do të thotë, se ata e dinë që kjo jetë nuk është tjetër veçse hyrje për në Jetën Tjetër. Ajo i ngjan bujqësisë, shkollës apo tregut. Arritja e synimit të lartë dhe përgatitja për atë Jetë nuk mund të arrihen vetëm me dërgimin e Profetëve dhe zbatimin e ligjeve dhe rregullave të All'Ilahut që i ka sjellë nëpërmjet Librave qiellorë.

Me fjalë të tjera: Vërtet, All'Ilahu e ka krijuar njeriun në këtë jetë që të vazhdojë rrugën e plotësimit e të përsosurisë, me qëllim që të arrijë në vendbanimin e vërtetë të tij në Jetën Tjetër. Ky qëllim nuk arrihet nëse nuk vijnë të Dërguar dhe nuk zbresin Libra qiellorë. Nga këtu mund të konkludojmë besimin në All'Ilahun, në Ringjalljen, në profetësinë e Profetëve dhe në Librat e zbritur.

Rëndësia e namazit

Në këtë ajet vëmë re se ai flet vetëm për namazin ndër të gjitha adhurimet e tjera. Ne e dimë se namazi është dukja e lidhjes me All'Ilahun, prandaj ka pozitën më të lartë se adhurimet e tjera. Disa komentues mendojnë se kur ka zbritur ky ajet, namazi ka qenë adhurimi i vetëm i detyruar në atë kohë.¹

¹ Tefsiri "El Manar", vëll. 7, f. 622.

Ajeti 93

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَوْ قَالَ أُوحِيَ إِلَيَّ وَلَمْ
يُوحَ إِلَيْهِ شَيْءٌ وَمَنْ قَالَ سَأُنْزِلُ مِثْلَ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَوْ تَرَىٰ
إِذِ الظَّالِمُونَ فِي غَمَرَاتِ الْمَوْتِ وَالْمَلَائِكَةُ بَاسِطُوا أَيْدِيهِمْ
أَخْرِجُوا أَنْفُسَكُمُ ۗ الْيَوْمَ تُجْزَوْنَ عَذَابَ الْهُونِ بِمَا كُنْتُمْ
تَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ غَيْرَ الْحَقِّ وَكُنْتُمْ عَنْ آيَاتِهِ تَسْتَكْبِرُونَ ﴿٩٣﴾

“Kush është i padrejti më i madh se ai që trillon gënjeshtër për All’llahun ose që thotë: ‘Kjo më është shpallur mua’, ndërkohë që asgjë nuk i është shpallur atij? Ose që thotë: ‘Unë mund të shpall diçka si ajo që ka shpallur All’llahu.’ Ah sikur t’i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur melekët zgjasin duart (duke thënë): ‘Dorëzoni shpirtrat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për All’llahun dhe që keni shpërfillur Shpalljet e Tij.’”

Shkaku i zbritjes

Ka transmetime të shumta për shkakun e zbritjes së këtij ajeti të cilat janë përcjellë në librat e hadithit dhe të komentimit (tefsirit). Ndër to është një hadith se ky ajet ka zbritur për një person të quajtur “Abdullah ibn Sa’d” prej shkruajtësve të

Revelatës. Ai e tradhtoi Profetin dhe Profeti e përzuri. Ai filloi të thoshte se mund të fliste ashtu siç thotë Kur'ani.¹

Një grup tjetër komentuesish thonë se ky ajet, apo një pjesë e tij, ka zbritur për Musejlemetul Kedhab (Musejlemi gënjeshtar), i cili pretendonte se ishte profet.² Por duke patur parasysh se Musejlemi gënjeshtar u shfaq nga fundi i jetës së Profetit dhe se kjo sure është mekase, atëherë mbështetësit e këtij komentimi thonë se ky ajet ka zbritur në Medine. Më pas ky ajet është vendosur në këtë sure me urdhër nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Sido që të jetë, ky ajet është njësoj si ajetet e tjera të Kur'anit që kanë zbritur në rrethana të posaçme. Ai ka kuptim të përgjithshëm dhe përfshin cilindo që pretendon profetësinë e të ngjashëm me të.

Komentimi

Në ajetet e mëparshme u fol për pretendimet e jehudinëve, të cilët thonin se askujt nuk i kishte zbritur libër qiellor. Në këtë ajet flitet për persona të tjerë që qëndrojnë në anë të kundërt të atyre mohuesve dhe thonë se Profetëve u zbret Shpallja. Ajeti përmend tre grupe prej tyre:

Grupi i parë: **“Kush është i padrejti më i madh se ai që trillon gënjeshtria për All'Ilahun...”**

Grupi i dytë janë ata që pretendojnë profetësinë apo zbritjen e shpalljes, e cila nuk u ka zbritur: **“...ose që thotë: ‘Kjo**

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 111. Tefsiri “Et Tibjan”, vëll. 4, f. 202.

² I njëjti burim

më është shpallur mua', ndërkohë që asgjë nuk i është shpallur atij..."

Grupi i tretë janë ata që mohojnë profetësinë e Profetit Islam ose pretendojnë se mund të sjellin të njëjtë si Kur'ani. Për të gjitha këto ata janë gënjeshtarë: **"...Ose që thotë: 'Unë mund të shpall diçka si ajo që ka shpallur All'Ilahu...'"**

Vërtet, të gjithë ata janë të padrejtë, madje më të padrejtët e të padrejtëve, sepse ata mbyllin dyert e së vërtetës para syve të njerëzve të tjerë dhe i lënë në hutinë e humbjes. Ata i luftojnë udhëheqësit e së vërtetës e të së drejtës. Pra, ata janë të humbur. A ka më të padrejtë se ai që pretendon se ka udhëheqje nga ana e All'Ilahut, ndërkohë që nuk ka asnjë aftësi për këtë kompetencë? Ajeti flet për ata që pretendojnë profetësinë, por përmbajtja e tij përfshin çdokënd që gënjen për veten e vet duke i dhënë vetvetes vendin që nuk i takon.

Më pas, ajeti sqaron dënimin e dhimbshëm që i pret këta persona duke thënë: **"...Ah sikur t'i shihje keqbërësit gjatë agonisë¹ së vdekjes, kur melekët zgjasin duart** (duke thënë): **'Dorëzoni shpirtat tuaj!...',** që do të thotë: "O Profet, sikur t'i shohësh ata të padrejtë se si e kalojnë vështirësinë e vdekjes dhe daljen e shpirtit dhe melekët u marrin atyre shpirtin me duar të zgjatura dhe u thonë atyre të dorëzohen, do ta kuptosh dënimin që do t'i godasë ata."

Në atë kohë, melekët e dënimit i lajmërojnë ata se sot do të marrin dënimin poshtërues për shkak të dy gjërave: e para, që gënjen dhe trilluan për All'Ilahun; e dyta, që nuk ia vunë veshin

¹ Fjala "el gameratu" është shumësi i fjalës "el gamretu", që në origjinalitet do të thotë heqja e shenjës së diçkaje. Pastaj është përdorur për ujin që mbulon plotësisht sipërfaqen e diçkaje. Gjithashtu përdoret për vështirësitë dhe fatkeqësitë që e mbulojnë njeriun.

fjalëve të Tij: “...Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për All’llahun dhe që keni shpërfillur Shpalljet e Tij.”.

Hulumtime

Këtu duhen përmendur disa pika:

1- Ajeti i konsideron pretenduesit e profetësisë prej të padrejtëve më të këqinj. Nuk ka padrejtësi më të madhe se kjo e tyre, sepse ata vjedhin mendimet e njerëzve, shkatërrojnë besimet e tyre dhe ua mbyllin dyert e lumturisë duke i shfrytëzuar ata me forma të ndryshme.

2- Fraza “**zgjasin duart**” mund të ketë kuptimin që melekët që marrin shpirtërat zgjasin duart e tyre për marrjen e shpirtit ose ka kuptimin e fillimit të dënimit.

3- Fraza “**Dorëzoini vetat tuaja**” ka kuptimin e poshtërimit që e shfaqin melekët karshi atyre të padrejtëve dhe se marrja e shpirtit nuk është në dorë të tyre, por është detyrë e melekëve. Kjo është njësoj siç i thuhet kriminelit kur dënohet me vdekje: “Vdis!”. Ka mundësi që ky poshtërim është për poshtërimitin që ata i bënë shenjave të All’llahut, Profetëve të Tij dhe robve të drejtë të Tij.

Në të njëjtën kohë, ky ajet konsiderohet argument tjetër për pavarësinë e shpirtit dhe ndarjes së tij nga trupi. Nga ajeti, gjithashtu, përfitohet se dënimi i atyre fillon që në kohën e marrjes së shpirtit të tyre.

Ajeti 94

وَلَقَدْ جِئْتُمُونَا فُرَادَىٰ كَمَا خَلَقْنَاكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَتَرَكْتُمْ مَا خَوَّلْنَاكُمْ
وَرَاءَ ظُهُورِكُمْ ۖ وَمَا نَرَىٰ مَعَكُمْ شُفَعَاءَكُمُ الَّذِينَ زَعَمْتُمْ أَنَّهُمْ فِيكُمْ
شُرَكَاءُ ۚ لَقَدْ تَقَطَّعَ بَيْنَكُمْ وَضَلَّ عَنْكُمْ مَا كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ ﴿٩٤﴾

“(All’Ilahu do t’u thotë): ‘Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë, duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar. Ne nuk po i shohim me ju ndërmjetësuesit tuaj, për të cilët pretendonit se ishin ortakët e All’Ilahut. Midis jush janë shkëputur të gjitha lidhjet dhe ajo tek e cila shpresonit, ju ka lënë në baltë.’”

Shkaqet e zbritjes

Në tefsirin “Mexhmaul Bejjan”, në tefsirin e “Tabariut” dhe në tefsirin e “Alusiut” thuhet se një mushrik (politeist) i quajtur Nedr ibn Harith ka thënë: “Lati dhe Uzza (dy idhuj të njohur tek arabët) do të më shpëtojnë mua në Ditën e Kiametit. Atëherë zbriti ajeti në fjalë si përgjigje për të dhe për të tjerë si ai.¹

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 115. Tefsiri “Xhamiul Bejjan”, vëll. 7, f. 363.

Komentimi

Të humburit

Ajetet e mëparshme folën për gjendjen e të padrejtëve kur janë pranë vdekjes. Ky ajet flet për thënien që All'llahu u thotë atyre në momentin e vdekjes dhe për Ditën kur do të japin llogari para All'llahut. Ajeti fillon me thënien se ata do të vijnë të vetëm në Ditën e Kiametit, ashtu siç u krijuan të vetëm: **“Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë...”** Pasuritë që Ne ua dhuruam dhe ju mështeteshit tek ato në jetën tuaj, do t'i lini prapa dhe do të vini duarbosh: **“...duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar...”**¹

Sot nuk i shohim me ju ato idhuj që thonit se do t'ju mbronin dhe mendonit se ato ishin partnerët e përcaktimit të jetës suaj: **“...Ne nuk po i shohim me ju ndërmjetësuesit tuaj, për të cilët pretendonit se ishin ortakët e All'llahut...”** Në realitet, bashkimi juaj është shpërndarë dhe janë shkëputur të gjitha lidhjet mes jush. **“...Midis jush janë shkëputur të gjitha lidhjet...”** Çdo gjë që mendonit dhe mbështeteshit në të është zhdukur dhe ju kanë lënë: **“...dhe ajo tek e cila shpresonit, ju ka lënë në baltë.”**

Politeistët arabë mbështeteshin në tri gjëra në jetën e tyre: Te fisi nga i cili vinin, te pasuria që grumbullonin për vetat e tyre dhe te idhujt që i konsideronin ortakë të All'llahut në përcaktimin e jetës së tyre dhe në ndërmjetësimin tek All'llahu.

¹ Fraza arabe “*khaualnakum*”, që përmendet në këtë ajet, vjen nga fjala “*el khau*” dhe ka kuptimin e dhënies që nevojitet për premtim dhe administrim. Dhe janë mirësi që All'llahu ia jep robve të Tij.

Ajeti në fjalë, në të tre fjalitë e tij, tregon për njëren prej atyre që përmendëm (fisi, pasuria dhe idhujt).

Dy hulumtime

1- Duke parë që ky ajet vjen pas ajetit të mëparshëm që flet për marrjen e shpirtit nga melekët në momentin e vdekjes, gjithashtu, duke parë frazën: “**...duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar...**”, kuptojmë se kjo u thuhet atyre, gjithashtu, edhe pranë vdekjes, por nga ana e All'llahut. Mirëpo, disa transmetime thonë se këto fjalë u drejtohen atyre në Ditën e Kiametit.¹

2- Edhe pse ky ajet ka zbritur për politeistët arabë, ai nuk është i kufizuar vetëm tek ata. Në atë Ditë çdo gjë do të shkëputet dhe do të ndahet nga njerëzit si: pasuria, adhurimet fantazuese, etj. dhe nuk mbetet tjetër, veçse njeriu dhe puna e tij.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 115.

Ajetet 95 - 96

﴿ إِنَّ اللَّهَ فَالِقُ الْحَبِّ وَالنَّوَى ^ط تُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَمُخْرِجُ الْمَيِّتِ مِنَ الْحَيِّ ^ج ذَٰلِكُمْ اللَّهُ ^ط فَأَنَّى تُؤْفَكُونَ ﴿٩٥﴾ فَالِقُ الْإِصْبَاحِ وَجَعَلَ اللَّيْلَ سَكَنًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ حُسْبَانًا ^ج ذَٰلِكَ تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ﴿٩٦﴾

“Me të vërtetë, All’llahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë. Ai e nxjerr të gjallën prej të vdekurës dhe të vdekurën prej të gjallës. Ky është All’llahu. Atëherë, përse i largoheni Atij?”

“Ai bën të feksë drita e agimit. Ai e ka bërë natën për pushim, ndërsa Diellin dhe Hënën për të njehsuar kohën. Kjo është urdhëresa e All’llahut, të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshtit.”

Komentimi

Çarësi i dritës së mëngjesit

Edhe njëherë tjetër, Kur’ani u drejtohet politeistëve me anë të një mesazhi, duke u shpjeguar atyre, me fraza tërheqëse e metoda të gjalla, argumentet e njësimi, sekretet e universit, sistemin krijues e mrekullitë e tij.

Ajeti 95 tregon për tre lloje të mrekullive të tokës, ndërsa ajeti 96 tregon për tri dukuri qiellore.

Në Kur'an, së pari, thuhet: **"...Me të vërtetë, All'illahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë..."**

Fjala *"el felku"* tregon ndarjen e diçkaje dhe shfaqjen e një pjese nga tjetra.¹

Fjala *"el habu"* dhe *"el habetu"* përdoret për lloje të ndryshme të farërave ushqyese, si: gruri, elbi e bimë të tjera ushqyese që korren. E njëjta fjalë përdoret edhe për çeljen e borzilokut.²

Fjala *"en neuaa"*, ka kuptimin e bërthamës, thelbit. Thuhet se ajo është e veçantë për bërthamën e hurmës. Ndoshta kjo për arsye të ekzistencës së shumë të hurmave në vendet arabe. Kur një arab dëgjonte këtë fjalë, i shkante mendja te bërthama e hurmës.

Le të vërejmë tani se çfarë fshihet në këtë shprehje:

Duhet të dimë se momenti më i rëndësishëm i jetës së farës e të bërthamës është çasti i çarjes, i cili është i ngjashëm me çastin e lindjes së fëmijës dhe kalimin e tij nga një botë në një tjetër, ku gjatë këtij çasti ndodh transformimi më i rëndësishëm në jetën e tij.

Ajo që të tërheq vëmendjen, është se fara dhe bërthama shpeshherë janë të ashpra.

Duke parë bërthamën e hurmës, të kumbullës, e të ngjashme me to, si dhe disa farëra të forta, na zbulohet se ajo pikë e vogël, plot jetë, është e fortifikuar si një kala e fortë, e rrethuar nga çdo anë. Dora e Krijuesit i ka dhënë kësaj "kështjelle" të vogël veçorinë e dorëzimit, të butësisë përpara depërtimit të embrionit

¹ Er Ragib El Asfahani, "El Mufredat", f. 385.

² Burimi i mëparshëm, f. 105.

së bimës, ashtu siç i ka dhënë embrionit forcën shtytëse, e cila i mundëson asaj çarjen e mureve të kështjellës së saj, duke çelur bimën me shtatin e saj të gjatë.

Kjo është një ndodhi e mrekullueshme në botën e bimëve. Kjo është edhe arsyeja se pse Kur'an i flet për një gjë të tillë, sepse është nga argumentet e njësimi.

Më pas thotë: **“...Ai e nxjerr të gjallën prej të vdekurës dhe të vdekurën prej të gjallës...”**

Kjo shprehje përsëritet shpesh në Kur'an, duke na treguar rregullin e jetës e të vdekjes dhe ndryshimin midis tyre. Kështu që, njëherë e shikon jetën të lindë nga lëndë të forta e pa shpirt, në thellësi të oqeanëve, në vendet e humbura të xhunglave e të shkretëtirave, duke krijuar nga kombinimi i lëndëve të secilës prej tyre helm vdekjeprurës e lëndë energjike dhe nganjëherë sheh të kundërtën.

Me anë të procedurës së një ndryshimi të thjeshtë te qeniet e gjalla e të forta, të mbushura plot jetë, e shikon atë të shndërrohet në një qenie që s'ka jetë në të.

Tematika e jetës dhe e vdekjes, përsa i përket qenieve të gjalla, është ndër çështjet më të besuara, të cilat shkencat njerëzore nuk mund t'i përkufizojnë, të ngrenë perden e sekreteve e të depërtojnë në thellësitë e të panjohurave të tyre. Për më tepër, të njohin se si është e mundur që elementet e natyrës dhe lëndët e tyre të ngurta të kalojnë në një mutacion madhështor e të shndërrohen në qenie të gjalla.

Mund të vijë një ditë që njeriu të ndërtojë një qenie të gjallë, duke përdorur përbërës natyrorë të ndryshëm, në kushte të ndërlikuara e të veçanta, me anë të metodës së montimit të pjesëve të prodhuara, ashtu siç bëjnë me makinat dhe aparataturat, pavarësisht se aftësitë njerëzore, me hamendje, në të ardhmen nuk

mund ta ulin rëndësinë e çështjes së jetës e komplikacionet e saj, të cilat fillojnë nga Shpikësi i Aftë.

Për këtë arsye, në Kur'an gjejmë vërtetimin e ekzistencës së All'lahut, duke e përsëritur shpesh këtë tematikë. Këtë fakt, pra ekzistencën e një pikënisjeje të aftë e të mençur, në lidhje me çështjen e jetës dhe të vdekjes, e kanë argumentuar edhe Profetët e mëdhenj, si Ibrahim i e Musai për t'i bindur tiranët despotë, si Nemrudi e Faraoni.

Ibrahimi i thotë Nemrudit: **“Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje.”**¹ Musai i thotë Faraonit: **“Është Ai që Tokën e ka bërë shtrat për ju, që ju ka shtruar rrugët nëpër të dhe që lëshon ujë nga qielli, me qëllim që, nëpërmjet tij, të rriten shumë lloje bimësh të ndryshme.”**²

Është e domosdoshme të mos harrojmë se shfaqja e të gjallit nga i vdekuri nuk karakterizohet vetëm me fillimin e shfaqjes së jetës në tokë. Por, kjo ndodh në çdo kohë.

Për shpjegimin e kësaj çështjeje mund të bazohemi edhe te transmetimet e Imamëve të Ehli Bejt (Paqja qoftë mbi ta!). Kjo përfshin jetën dhe vdekjen materiale, ashtu siç përfshin³ jetën dhe vdekjen jo materiale. Kështu, nga baballarë jobesimtarë lindën besimtarë dhe nga baballarë të devotshëm e të zgjedhur të tjerë lindën shkatërrimtarë keqbërës, në kontradiktë me ligjin e trashëgimisë, me dëshirën e zgjedhjen e tyre.

Pra, ky është një argument tjetër për madhështinë e Krijuesit, i Cili i dhuroi njeriut këtë aftësi e dëshirë.

Pika tjetër, për të cilën duhet të tregohemi të vëmendshëm, është se fjala *nxjerr* është folje në kohën e tashme dhe fjala *nxjerrës*

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 258.

² Sure “Ta Ha”, ajeti 53.

³ “Usulul Kafij”, vëll. 2, kap. 5; “El Burhan”, vëll. 1, f. 543.

është emër. Të dyja fjalët tregojnë vazhdimësi. Pra, sistemi i shfaqjes së të gjallit nga i vdekuri dhe i shfaqjes së të vdekurit nga i gjalli është i përhershëm dhe i përgjithshëm në botën krijuese.

Në mbyllje të ajetit ka një përforsim të tematikës: **“...Ky është All’l-lahu. Atëherë, përse i largoheni Atij?”** Pra, ky është Zoti juaj. Kjo është aftësia e Tij, dituria e Tij e pafund. E si pra, pas gjithë kësaj, largoheni nga e vërteta dhe anoni nga e pavërteta? Në ajetin 96, i cili është objekt studimi Kur’ani na tregon për tre begati qiellore.

Begatia e parë: **“...Ai bën të feksë drita e agimit...”**.

Përmendëm më parë se fjala *“el felku”* tregon çarjen e diçkaje dhe shfaqjen e një pjese nga tjetra dhe se fjala *“el isbahu”* dhe *“es subhu”*, kanë të njëjtin kuptim - *mëngjesi*.

Vërtet, ky është një përshkrim mahnitës, sepse errësira e natës është e ngjashme me një mbulesë të trashë, të cilën e çan drita e mëngjesit. Kjo gjendje është në përputhje me mëngjesin “e vërtetë” e me mëngjesin “e rremë”, sepse mëngjesi “i rremë” është drita e pakët, e cila shfaqet në fund të natës drejt lindjes në formë kolone. Ai është i ndarë e i çarë, duke filluar nga lindja drejt perëndimit në kupën e qiellit të errësuar. Mëngjesi “i vërtetë” është ai që pason në formën e një shiriti të bardhë, të ndritur e të bukur, që shfaqet në shtrirjen e horizontit lindor. Ai e ndan dhe e çan përroin e natës së zezë nga poshtë, duke u zgjeruar nga jugu nga veriu e duke paraprirë në çdo cep, deri sa e mbulon të tërë qiellin dalëngadalë.

Shpeshherë Kur’ani na tregon për dy begati, dritën dhe errësirën, natën dhe ditën. Por këtu ka përmendur “lindjen e mëngjesit” si begati nga begatitë madhështore të All’l-lahut. Ne e dimë se kjo dukuri ndodh si rezultat i ekzistencës së atmosferës së tokës, mbulesës gjigante të ajrit, që rrethon Tokën.

Sikur Toka të ishte, si p.sh. Hëna, pa atmosferë, nuk do të kishim “dy lindje”, as agim, as mëngjes, as muzg, as mugëtirë. Madje, Dielli do të lindte në mënyrë të papritur e pa paralajmërim. Drita e tij do të lindte në sytë e atyre që janë mësuar me errësirën e natës e që nuk u shmanget atyre, e në perëndim fshihet papritmas, ku kaplon një errësirë e zyrtë në një çast të vetëm.

Është pikërisht atmosfera ekzistuese rreth Tokës, që çon në arritjen e një periudhe ndarëse ndërmjet errësirës së natës dhe dritës së ditës gjatë lindjes së Diellit dhe perëndimit të tij, që njeriu të mësohet gradualisht me këto ndryshime të kundërta e transferimin e tij nga errësira në dritë e nga drita në errësirë pak nga pak, në mënyrë që ai të mund të mbartë gjithsecilën prej tyre.

Ne ndihemi të shqetësuar nëse ndodhemi në një dhomë me dritë, kur dritat fiken papritur atë e kaplon errësira. Nëse pas një ore qëndrimi në errësirë vijnë papritur dritat, kthehet gjendja shqetësuese për shkak të rënies së dritës në mënyrë të papritur.

Ne ndiejmë dhimbje në sy, duke e bërë të vështirë shikimin e gjërave. Nëse përsëritet kjo gjë disa herë, s’ka dyshim se do të na i dëmtonte sytë, pavarësisht se “Krijuesi i dritës së mëngjesit” ia ka shmangur njeriut këtë dëmtim në mënyrë të mahnitshme.¹

Në mënyrë që të mos dyshojë asnjëri, që krijimi i dritës së mëngjesit është argument se errësira e natës është një çështje jo e kërkuar, por përfitim i begatisë, Kur’ani na jep thënien e All’llahut: **“...Ai e ka bërë natën për pushim...”**.

Nga çështjet e padiskutueshme është se njeriu, gjatë përhapjes së dritës së ditës, anon në punë e përpjekje. Gjaku në

¹ Astronautët thonë se lindja e diellit fillon kur ai arrin në 18 gradë para horizontit të lindjes dhe bëhet errësirë kur arrin 18 gradë në perëndim.

trupin e tij shkon drejt sipërfaqes, muskujt e tij janë të gatshëm për aktivitet e veprimtari. Për këtë arsye, gjumi në dritë nuk është i rehatshëm, përkundrazi është më i thellë e më i rehatshëm sa herë që errësira është e fortë, pasi gjaku i trupit shkon drejt brendësisë, qelizat në përgjithësi futen në një lloj qetësie e rehatie.

Ne shohim në natyrë se gjumi gjatë natës nuk kufizohet vetëm te kafshët, por edhe te bimët, pasi edhe ato flenë gjatë natës. Në momentin e lindjes së mëngjesit të parë, “zgjohet” aktiviteti dhe veprimtaria e tyre. E kundërta ndodh me njeriun e kësaj epoke, i cili rri zgjuar deri në gjysmë të natës e më pas fle deri në disa orë pas lindjes së diellit, duke humbur kështu veprimtarinë dhe shëndetin e tij.

Në hadithet e transmetuara nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) gjejmë sigurinë që trupëzohet e mishërohet me këtë sistem. Te libri “Nehxhul Balagah” i Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë këshillën që i ka dhënë një prej komandantëve të tij: “...Mos u end në fillim të natës, sepse All’llahu e ka bërë atë për qetësi e pushim. E ka ngritur atë në një pozitë të lartë e jo të urryer, kështu që qetëso trupin tënd dhe rehato kurrrizin tënd...”¹

Në një hadith të Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Çiftëzohu gjatë natës, sepse Ai e ka bërë natën për qetësi.”²

Ndërsa në librin “El Kafij”, transmetohet nga Imam Zejnul Abidijn, Ali ibn Hysejn (*Paqja qoftë mbi të!*) se ai urdhëronte që të mos thereshin bagëtitë gjatë natës dhe para lindjes së agimit. Ai thoshte: “... Me të vërtetë, All’llahu e ka bërë natën qetësi për çdo gjë...”³

¹ “Nehxhul Belaga”, mesazhi 12.

² “Usulul Kafij”, vëll. 5, f. 367; “Uesailu Shia”, vëll. 20, f. 91.

³ “Usulul Kafij”, vëll. 6, f. 236; “Et Tehdhijb”, vëll. 9, f. 60.

Më pas, All'illahu i Lartësuar na tregon për begatinë e tretë të argumenteve më madhështore të Tij, që e bën Diellin dhe Hënën mjet llogaritjeje: **"...ndërsa Diellin dhe Hënën për të njehsuar kohën..."**.

Fjala "*husban*" ka kuptimin e "*el hisab*" (llogari, njehsim). Ndoshta me këtë fjalë synohet rrethrotullimi i këtyre dy trupave qiellorë dhe ecuria e tyre. (Këtu kemi si qëllim lëvizjen e tyre që e shohim, e cila vjen nga lëvizja e Tokës). Kjo është ndihmë për ne, që të bëjmë programimet e ndryshme të jetës, sipas orareve të llogaritura, siç e kemi përmendur edhe në komentim.

Disa komentues e shohin këtë ajet me kuptimin se këto dy trupa qiellorë lëvizin në qiell sipas një llogarie, programi e sistemi. E kështu, në rastin e parë, tregon një nga begatitë e All'illahut për njeriun; në rastin e dytë, tregon një nga argumentet e njësimiut dhe të qëndrueshmërisë së ekzistencës së Krijuesit, e ndoshta mund t'i tregojë që të dyja.

Gjithsesi, kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Toka, që para miliona vitesh sillet rreth Diellit dhe Hëna sillet rreth Tokës. Në këtë mënyrë, Dielli transferohet, në këndvështrimin tonë, nga një zodiak në tjetrin ndërmjet dymbëdhjetë zodiakëve orbitalë.

Gjithashtu, edhe Hëna rrotullohet me lëvizjen e saj të rregullt nga Hëna e re deri në shuarjen e saj, pra, ditën e fundit të muajit. Llogarisë së këtij rrethrotullimi, për nga saktësia, nuk i paraprin dhe as nuk i prapavjen qoftë edhe një çast i vetëm. Nëse vëmë re me kujdes, Toka rrotullohet rreth Diellit në një orbitë vezore, me një mesatare të rrezes së tij 150 milionë kilometër, përfshi edhe gravitetin madhështor të Diellit. Hëna rrotullohet rreth Tokës çdo muaj në një orbitë të ngjashme me rrethoren, me një rreze rreth 374 mijë kilometër, e cila nuk del jashtë gravitetit

madhështor të Tokës, i cili është përherë tërheqës rreth saj. Kështu që mund të perceptojmë ekuilibrin e saktë të forcës tërheqëse ndërmjet këtyre trupave qiellore nga njëra anë dhe forcën shtytëse nga epiqendra e tyre nga ana tjetër, ku nuk mund të ndalojnë për një çast të vetëm, apo të ndryshojnë qoftë edhe një fije floku.

Kjo nuk mund të ndodhë ndryshe veçse nën hijen e diturisë e të aftësisë së pafundme, me një planifikim të saktë. Kjo është arsyeja që ajeti përfundon me thënien e All'llahut të Lartësuar: **"...Kjo është urdhëresa e All'llahut, të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshtit."**

Ajeti 97

وَهُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ النُّجُومَ لِتَهْتَدُوا بِهَا فِي ظُلُمَاتِ اللَّيْلِ وَالْبَحْرِ

قَدْ فَصَّلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ

“Është Ai që i ka krijuar yjet, për t’ju rrëfyer rrugën në errësitat e tokës dhe të detit. Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që dinë.”

Komentimi

Pas shpjegimit të rrethrotullimit të Diellit e të Hënës në ajetin e mëparshëm, ky ajet na tregon për një begati tjetër nga begatitë e All’llahut për njerëzit. Ai i krijoi yjet në mënyrë që njerëzit të udhëzohen gjatë netëve në tokë e në det: **“Është Ai që i ka krijuar yjet, për t’ju rrëfyer rrugën në errësitat e tokës dhe të detit...”**

Ajeti mbyllet: **“...Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që dinë.”** All’llahu i sqaron argumentet e Tij për ata që mendojnë, kuptojnë e perceptojnë.

Pavarësisht se njerëzimi ka bërë përparime të mëdha në fushën e astronomisë, njohja me yjet dhe sistemin e tyre është bërë mijëra vjet më parë. Yjet kanë qenë mjete më i mirë për njohjen e drejtimit gjatë udhëtimit të tyre në tokë e në det, sidomos në oqeanet e gjera, të cilat kanë qenë të zhveshura nga pikat e orientimit, përpara shpikjes së busullës.

Yjet kanë orientuar miliona njerëz, i kanë shpëtuar nga mbytja, duke i nxjerrë shëndoshë e mirë në tokë. Sikur të

vështrojmë në qiell disa net me radhë, do të zbulojmë vendosjen sistematike të yjeve.

Yjet në qiell janë të ngjashme me perlat e qëndisura në kumash të zi. Kjo pëlhurë tërhiqet vazhdimisht nga lindja drejt perëndimit dhe e gjitha rrotullohet rreth boshtit të Tokës, pa ndryshuar ndarjet ndërmjet tyre.

Përjashtimi i vetëm në këtë sistem tështë numri i disa planeteve, që njihen si Planete udhëtuese, që bëjnë lëvizje të pavarura e të veçanta. Numri i tyre është tetë, e pesë prej tyre shikohen me sy të lirë. Ata janë: Mërkuri, Afërdita, Saturni, Marsi dhe Jupiteri. Tre prej tyre shihen vetëm me teleskop. Ata janë: Urani, Neptuni dhe Plutoni, duke shtuar këtu edhe Tokën, që e bën shumën e tyre nëntë.

Ndoshta njeriu prehistorik ka ditur diçka në lidhje me “të qëndrueshmit” dhe “udhëtuesit”, sepse nuk ka pasur mundësi të mos i kenë tërhequr vëmendjen më shumë sesa qielli i zbukuruar me yje në një natë të errët, kështu që nuk është çudi që edhe ai të ketë përdorur yjet për t’u udhëzuar e për të njohur drejtimin.

Nga disa transmetime të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) përftohet se për këtë ajet ka një komentim tjetër: “Me yjet identifikohen udhëheqësit hyjnorë e udhëzuesit drejt rrugës së lumturisë, pra, Imamët e Ehli Bejtit, me anë të të cilëve udhëzohen njerëzit në errësirën e jetës e shpëtojnë nga humbja.”¹

Ashtu siç thamë edhe më parë, këto komentime shpirtërore nuk bien në kundërshtim me komentimet e qarta. Është e mundur që me këtë ajet të synohen të dy komentimet.

¹ Tesfsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 750.

Ajetet 98 - 99

وَهُوَ الَّذِي أَنشَأَكُمْ مِّن نَّفْسٍ وَاحِدَةٍ فَمُسْتَقَرٌّ وَمُسْتَوْدَعٌ ۖ قَدْ
 فَصَّلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَفْقَهُونَ ﴿٩٨﴾ وَهُوَ الَّذِي أَنزَلَ مِنَ السَّمَاءِ
 مَاءً فَأَخْرَجْنَا بِهِ نَبَاتَ كُلِّ شَيْءٍ فَأَخْرَجْنَا مِنْهُ خَضِرًا نُّخْرِجُ مِنْهُ
 حَبًّا مُتَرَاكِبًا وَمِنَ النَّخْلِ مِنَ طَلْعِهَا قِنْوَانٌ دَانِيَةٌ وَجَنَّتٍ مِّنْ
 أَعْنَابٍ وَالزَّيْتُونَ وَالرُّمَّانَ مُشْتَبِهًا وَغَيْرَ مُتَشَبِهٍ ۚ انظُرُوا إِلَى ثَمَرِهِ
 إِذَا أَثْمَرَ وَيَنْعِهِ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكُمْ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٩٩﴾

“Është Ai që ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm, që të jetoni dhe të preheni në tokë. Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që kuptojnë.”

“Është Ai që lëshon nga qielli ujë, nëpërmjet të cilit Ai nxjerr sythat e çdo bime. Prej kësaj Ne nxjerrim gjelbërim, kokrra gruri në kallinj, palma hurme të ngarkuara me kalaveshë të ulët, kopshte rrushi, ulliri dhe shege, që ngjajnë, por që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Vështroni frytet e tyre kur formohen dhe piquen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë.”

Komentimi

Këto dy ajete pasohen nga argumentet e Njësimit e të njohjes së All'llahut. Për të arritur te ky qëllim, Kur'ani e "merr përdore" njeriun dhe e çon drejt horizonteve të largëta të botës brenda vetes së tij, duke i bërë të qartë atij gjurmët e All'llahut në trupin dhe në shpirtin e tij, duke i dhënë rastin që ta shohë All'llahun në çdo vend.

Ajeti 98 fillon: **"Është Ai që ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm ..."**

Pra, ju keni ndryshime vizionesh, shijesh, idesh dhe ndryshueshmëri të madhe në aspekte të ndryshme të jetës suaj, u krijuat nga një individ i vetëm. Ky është argument për madhështinë e aftësinë e pafund të Krijuesit, i cili bëri të ekzistojnë gjithë këto fytyra të ndryshme nga shembulli i parë.

Vlen të përmendim këtu së ky ajet përshkruan krijimin e njeriut në zhvillim të vazhdueshëm. Fjala *krijim*, nga ana gjuhësore, nënkupton ekzistencën dhe shpikjen të shoqëruar me edukim. Pra, All'llahu ju krijoi juve dhe premtoi edukimin tuaj. Është e qartë se një krijues që krijon diçka e më pas e neglizhon atë, nuk ka treguar aftësitë më të larta të tij. Por, nëse ai ndihmon krijesat e tij, duke i mbrojtur ato, duke mos harruar për asnjë çast edukimin e tyre, ka shfaqur madhështinë dhe gjerësinë e mëshirës së tij.

Duhet të sqarojmë këtu, në këtë ajet, që nëna jonë e parë, Havaja, nuk është krijuar nga Ademi (siç transmetohet në kapitullin e dytë të "Genesis në Torra" -Teurat). Ademi dhe Havaja janë krijuar nga e njëjta baltë e vetme dhe që të dy janë nga një gen e nga një lloj.

Kjo është arsyeja se ata janë krijuar nga një lëndë e vetme. Ne kemi bërë kërkime për këtë tematikë, në fillimet e komentimit të sures “En Nisa”.

Më pas ajeti thotë: **“...që të jetoni dhe të preheni në tokë...”** Origjina e fjalës “*mustekarrun*” në gjuhën arabe është “*kurrun*”, që do të thotë *ftohtë*. Ajo përfshin qëndrimin dhe moslëvizjen. Pra, kuptimi i fjalës “*mustekarrun*” është *i qëndrueshëm, i palëvizshëm*.

Fjala “*musteudi'un*” vjen nga fjala “*ued'un*”, që ka kuptimin *lënë*. Gjithashtu, përdoret me kuptimin *i paqëndrueshëm*. “*El uediatu*”, është diçka që lihet tek një person dhe të kthehet përsëri te i zoti i saj.

Del e qartë nga këto fjalë se ajeti nënkupton se disa njerëz janë të qëndrueshëm dhe disa të paqëndrueshëm. Por çfarë synohet nga këto dy përshkrime? Ka shumë mendime të komentuesve. Disa komentime janë më afër të vërtetës së ajetit e në të njëjtën kohë nuk bien në kundërshtim me të tjerët.

Nga këto komentime del se thënia “*mustekarrun*”, *i qëndrueshëm*, është cilësi e atyre që u është plotësuar krijimi dhe që janë të qëndrueshëm mbi sipërfaqen e tokës. Ndërsa fjala “*musteudi'un*”, *i paqëndrueshëm*, është cilësi e atyre që nuk u është plotësuar krijimi e vazhdojnë të jenë ende një pikë në kraharorët e prindërve të tyre.

Një komentim tjetër thotë: “*Mustekarrun*” (*i qëndrueshëm*), tregon për shpirtin e njeriut që është *i qëndrueshëm*, ndërsa “*musteudi'un*” (*i paqëndrueshëm*), nënkupton trupin e njeriut që është *i shkatërrueshëm* e *i paqëndrueshëm*.

Ndërsa në disa transmetime të komentimit shpirtëror të këtyre dy shprehjeve është se “*mustekarrun*” (*i qëndrueshëm*), nënkupton ata që kanë besim të qëndrueshëm dhe “*musteudi'un*” (*i*

paqëndrueshëm), nënkupton ata që nuk kanë besim të qëndrueshëm.¹

Mundësia është që këto dy shprehje të na tregojnë dy pjesët e para të ngjizjes së pikës së njeriut. Me të vërtetë, pika, siç e dimë, formësohet nga dy pjesë: e para, është veza te femra dhe e dyta sperma te mashkulli. Kështu që veza e femrës është e qëndrueshme, ndërsa sperma te mashkulli është e gjallë, lëviz me shpejtësi në drejtim të saj. Kur spermatozoidi i parë mbërrin në vezore, e bashkohet bashkë me të, e fekondon atë dhe përjashton spermatozoidet e tjerë. Nga këto dy pjesë formohet fara e njeriut.

Në mbyllje, ajeti thotë: **“...Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që kuptojnë.”**

Kur i kthehemi librave të gjuhës, bëhet e qartë se fjala *“fikhun”*, nuk është çdo njohuri apo kuptim; madje, ajo është një arritje drejt diturisë së fshehtë me anë të diturisë së qartë.² Duke u bazuar mbi këtë, del se qëllimi i vëzhgimit të krijimit të njeriut e ndryshimi i formave e ngjyrave të tij është që njeriu i mprehtë të arrijë nga njohja e krijesës te njohja e Krijuesit.

Ajeti 99 është ajeti i fundit i këtij grupimi, që zbulon mrekullitë e botës së krijesës dhe na udhëzon drejt njohjes së All’llahut përmes njohjes së krijesave të Tij.

Në fillim ajeti na tregon për njërën nga begatitë më të rëndësishme të All’llahut, e cila mund të quhet “begatia nënë” dhe origjina e begative të tjera, që është shfaqja e bimëve, zhvillimi dhe rritja e tyre, me mirësinë e begatisë që zbret nga qielli: **“Është Ai që lëshon nga qielli ujë....”**

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 750.

² “Mufredat” Er Ragib, f. 384.

Ka thënë *nga qielli*, sepse fjala *qiell* kupton gjithçka që është në lartësi. Gjithçka që është në tokë, si: burime, puse, lumenj, kanale, etj. ushqehen nga shirat që bien nga qielli. Pakësimi i shirave ndikon te sasia e ujërave të gjitha këto burime. Nëse vazhdon thatësira, thahen edhe këto puse.

Më pas na tregon qartë për ndikimin e zbritjes së shirave: **“...nëpërmjet të cilit Ai nxjerr sythat e çdo bime.”** Komentuesit shohin dy mundësi të përdorimit të togfjalëshit: **“sythat e çdo bime.”**

E para: Nga kjo synohen të gjitha llojet e bimëve e kategoritë e tyre, të cilat ujiten me një ujë të vetëm e që mbijnë në një tokë të vetme, që ushqehen nga i njëjti dhë. Kjo është një nga mrekullitë e krijimit. Si dalin të gjitha këto kategori bimësh me format, ngjyrat, e frytet e tyre të ndryshme, nga një tokë e vetme dhe nga një ujë i vetëm?!

E dyta: Është se të gjitha krijesat e tjera, insektet, shpendët e kafshët, në det e në tokë kanë, nevojë për bimët. Është e çuditshme dhe mrekulli se All'llahu i Lartësuar nxjerr nga një tokë e vetme dhe nga një ujë i vetëm një ushqim, për të cilin kanë nevojë të gjitha këto krijesa. Kjo është nga veprat më mahnitëse të mrekullisë. Është njësoj sikur dikush të mundë të gatujë, nga një lëndë e vetme në kuzhinë, mijëra lloje ushqimesh për mijëra shije.

Gjëja më e çuditshme nga të gjitha këto është se bimët e shkretëtirës, të thata, nuk janë të vetmet që mbijnë nga bereqeti i ujit të shiut. Madje edhe bimët e vogla të ujit, të cilat pluskojnë mbi sipërfaqen e ujit të detit e që janë ushqim për peshqit, rriten e zhvillohen nga rrezet e diellit e pikat e shiut.

Nuk e harroj se çfarë më tha një nga banorët e bregdetit, i cili ankohej për peshkimin e pakët në det dhe kujton se shkak për këtë është thatësira, rënia e pakët e shiut. Për më tepër, ishte i

bindur se pikat e shiut kanë një ndikim më të madh në det se në shkretëtirë.

Më pas ajeti e shpjegon një gjë të tillë, duke marrë si shembull disa bimë që mbijnë si rezultat i ujit të shiut. Përmendet se All'Ilahu nxjerr me ujë trungun e bimëve të gjelbra nga toka. E nga kjo farë e ngurtë dhe e njëjtësuar krijon trungun jeshil, të njomë e të butë, të bukur e që i çudit shikuesit: **“...Prej kësaj Ne nxjerrim gjelbërim...”**¹

Dhe nga ky trung jeshil nxorëm farën, kokrrat e sistemuara **“...kokrra gruri në kallinj...”**²

Gjithashtu, me ujë nxjerrim nga palma lulen e mbyllur, që më pas çahet e nxjerr vilëzat me fijet e saj të ngritura e të bukura, të cilat mbartin kokrrat e hurmave, që varen poshtë nga rëndesa e tyre: **“...palma hurme të ngarkuara me kalaveshë të ulët...”**.

“Et-Tal'u” është një vilë hurme, para se të hapë mbulesën e saj të gjelbër. Kur lulja çel, dalin prej saj degët e ngritura të vilës. Ajo është një vilë në formë buqetash, që quhet Kinvane dhe njëjësi i saj është *kinv*.

Dhe *“daniyeh”* do të thotë *afër*, d.m.th. e afërt. Ndoshta me këtë fjalë do të thotë për afërsinë e degëve të vilës me njëra-tjetrën, ose ngaqë ajo anohet drejt tokës si rezultat i peshës së saj.

Gjithashtu, edhe kopshte ku në të ka lloje të ndryshme frytësh e frutash: **“...kopshte rrushi, ulliri dhe shege...”**

Ajeti tregon një mrekulli tjetër të krijimit të këtyre pemëve e frutave: **“...që ngjajnë, por që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri.”**

¹ Fjala “ekhadaru” përfshin të gjitha bimët, por, përderisa ajo është e ndjekur nga fara, synimi i ajetit është mbjellja e farës.

² Të mbivendosura nga vendosja njëra mbi tjetrën dhe shumica e farërave janë kështu.

Shiko komentimin e ajetit 141 të kësaj sureje, për shpjegimin e të ngjashmes dhe jo të ngjashmes, për ullirin e shegën.¹

Pema e ullirit është e ngjashme me pemën e shegës për nga forma e jashtme, përbërja e degëve e forma e gjetheve. Gjithsesi, të dyja këto, përsa i përket frytit, shijes e vlerës janë të ndryshme. Kështu që te ulliri ka një lëndë vajore me ndikim të fortë, ndërsa te shega ka një lëndë acetike e sheqerore. Në këtë rast, janë të ndryshme. Pavarësisht kësaj, të dy pemët mbillen në një tokë të vetme, “pinë” nga i njëjti ujë dhe janë sa të ngjashme, aq edhe të ndryshme në të njëjtën kohë.

Ekziston mundësia e sinjalizimit të llojeve të ndryshme të pemëve frutore, që kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën në pemë e në fruta, por që ndryshojnë nga njëra-tjetra në këtë drejtim (Pra, secila nga këto dy cilësi përcaktohet me një grup pemësh e frutash. Ndërsa sipas komentimit të parë të dy cilësitë janë e njëjta gjë).

Më pas ajeti përqendrohet te grupimi i pjesëve të pemës, te fryti i pemës, përbërja e frytit kur formësohet, te pjekja e frytit. Pra, në të ka argument të qartë për aftësinë dhe mençurinë e All'Ilahut, për besimtarët e për njerëzit: **“...Vështroni frytet e tyre kur formohen dhe piquen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë.”**

Ajo që lexohet sot në shkencën e botanikës, për mënyrën e çeljes së frytit dhe pjekjen e tij, zbulon rëndësinë e veçantë që i jep Kur'ani frutave, ku shfaqja e frutave te bota e bimëve është e ngjashme me lindjen e fëmijëve, këlyshëve te bota e kafshëve.

¹ Ragibi te “Mufredat” thotë se “mushtebihen” dhe “muteshabihen” janë të ngjashme në kuptim.

Kështu që pika e mashkullit të bimët del nga qese të veçanta me rrugë të ndryshme (si erërat apo kafshët) e bie mbi pjesën femërore të bimëve dhe, pas pjalmimit, formohet veza e parë e pjalmuar, e rrethuar me lëndë ushqimore, të ngjashme me përbërësit e saj. Këto lëndë ushqimore ndryshojnë për nga përbërja, shija e veçoritë ushqyese e mjekësore.

Frutat, si rrushi apo shega kanë qindra kokrra dhe secila konsiderohet embrion e farë për një pemë tjetër e që ka një strukturë të komplikuar të çuditshme.

Shpjegimi i ndërtimit të frutave e lëndëve ushqimore e mjekësore është jashtë hapësirës së këtij kërkimi. Por do të ishte mirë që të merrnim si shembull frytin e shegës që ka përmendur Kur'ani e që e veçoi në këtë ajet.

Nëse e shkartisim një shegë, marrim një nga kokrrat e saj dhe e vështrojmë në drejtim të diellit, apo të ndonjë burimi tjetër drite, do të shohim se formohet nga pjesë më të vogla, sikur të ishin shishka të vogla, të mbushura me ujë shege, të shtresuara njëra pas tjetrës. Në një kokërr shege mund të jenë qindra shishka të tilla shumë të vogla. Të gjithë cepat e saj mblidhen nga një cipë e hollë, e tejdukshme. Më pas, në mënyrë që kjo mbulesë të jetë më e plotë, më e qëndrueshme e larg nga rreziqet, formoi një numër kokrrash me një sistem të caktuar, duke i mbështjellë ato me një mbulesë të bardhë, relativisht të trashë. Më pas vjen lëkura e jashtme e shegës, që i mbështjell të gjitha, në mënyrë që të shmangë erërat e mikrobet e ndryshme, për t'i mbrojtur nga goditjet e për të pakësuar avullimin e lëngut të shegës nga kokrrat.

Kjo renditje në mbështjellje nuk kufizohet vetëm te shega. Kemi edhe fruta të tjera, si: portokalli, limoni, që kanë mbështjellje

të ngjashme. Ndërsa te rrushi e shega mbështjellja është më e saktë e më delikate.

Ndoshta njeriu ka ndjekur shembullin e kësaj mbështjelljeje kur ka bërë transportimin e lëngjeve nga një vend në tjetrin. Më e çuditshme nga kjo është qëndrueshmëria e kokrrave të shegës në bazat e tyre të brendshme dhe secila prej tyre merr racionin e vet të ujit e të ushqimit. E gjitha kjo shihet me sy. Nëse i vendosim kokrrat e këtij fryti poshtë mikroskopit, do të shohim një botë të zhurmshme, struktura të çuditshme, që të lënë pa mend, të llogaritura me përpikëri.

E si mundet syri i kërkuesit të së vërtetës të shikojë te ky fryt e më pas të thotë: “Krijuesi i saj nuk ka dije e as njohuri.”? Në të vërtetë, Kur’ani kur thotë: “Shikoni!”, dëshiron që me këtë vështrim e vizion të përpiktë te kjo pjesë e frutit, të arrihet te këto të vërteta.

Kjo, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, etapat e ndryshme në të cilat kalon fryti, që në mbirjen e tij e deri në pjekje, tërheq vëmendjen, sepse “eksperimentet” e brendshme në fryt nuk ndalojnë së vepruari në ndryshimin e strukturës së saj kimike, derisa të arrijë në etapën përfundimtare e të plotësojë përfundimisht strukturën e saj kimike.

Kështu që çdo etapë është argument për madhësinë dhe aftësinë e Krijuesit.

Besimtarët që hedhin vështrimin në këto çështje, i shohin këto të vërteta, ndërsa syri i inatit, i mendjemadhësisë e i nënvlerësimit nuk mund të shohë as të vërtetën më të afërt.

Ajetet 100 - 103

وَجَعَلُوا لِلَّهِ شُرَكَاءَ الْجِنَّ وَخَلَقَهُمْ ^ط وَخَرَقُوا لَهُ بَنِينَ وَبَنَاتٍ بِغَيْرِ
 عِلْمٍ ^ج سُبْحَنَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُصِفُونَ ﴿١٠٠﴾ بَدِيعُ السَّمَوَاتِ
 وَالْأَرْضِ ^ط أَنَّى يَكُونُ لَهُ وَلَدٌ وَلَمْ تَكُن لَّهُ صَاحِبَةٌ ^ط وَخَلَقَ كُلَّ
 شَيْءٍ ^ط وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٠١﴾ ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ ^ط لَا إِلَهَ إِلَّا
 هُوَ ^ط خَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ ^ج فَأَعْبُدُوهُ ^ج وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ
 ﴿١٠٢﴾ لَا تَدْرِكُهُ الْبَصَرُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْبَصَرَ ^ط وَهُوَ اللَّطِيفُ
 الْخَبِيرُ ﴿١٠٣﴾

“Idhujtarët i shohin xhindet si ortakë të All’llahut, ndërkohë që Ai i ka krijuar ata. I kanë veshur Atij djem e vajza me padituri. I lavdëruar qoftë Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia veshin ata!”
 “Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka bashkëshorte?! Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i Dijshëm për çdo gjë.”
 “Ky është All’llahu, Zoti juaj. S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij, Krijuesit të çdo gjëje, andaj adhuroni vetëm Atë! Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje.”

“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë.”

Komentimi

All'Ilahu është Krijuesi i çdo gjëje

Këto ajete flasin për aspekte të ideologjive të sëmura, mitike që besojnë politeistët dhe ata që trumbetojnë rryma jo të vërteta, duke u kthyer përgjigje të logjikshme.

Fillimisht ata thanë se All'Ilahu ka shokë nga xhindet. **“Idhujtarët i shohin xhindet si ortakë të All'Ilahut...”**

Cili është qëllimi i përdorimit të fjalës *xhinde*? A synohet me të kuptimi gjuhësor, që tregon për çdo qenie jonjerëzore e të fshehtë nga shqisat e njeriut, apo përfshin një grup xhindesh që përmenden disa herë në Kur'an? Për komentuesit e Kur'anit ka dy mundësi:

Mundësia e parë: Ajeti mund të flasë për ata që kanë adhuruar melekë a krijesa të tjera që nuk shihen. Ndërsa *mundësia e dytë*, mund të jetë për ata që i konsideronin xhindet si shokë të All'Ilahut apo si gra të Tij.

El-Kelbij, në librin “*El Esnam Idhujt*”, flet për një nga fraksionet arabe si benu Melijh, degë e fisit Khuza'ah. Ky fis ishte adhures i xhindeve.¹ Njihet se adhurimi i xhindeve dhe bindja

¹ Tefsiri “Dhilal El Kur'an”, vëll. 3, f. 326.

ndaj tyre ka qenë e përhapur ndërmjet rrymave e fraksioneve të Greqisë e të Indisë.¹

Në ajetin 158 të sures “Es Safat” thuhet: **“Idhujtarët kanë trilluar farefisni ndërmjet Zotit dhe xhindeve.”**. Ky ajet agumenton veprimet e idhujtarëve.

Ka pasur arabë që kanë kujtuar se ndërmjet All’llahut e xhindeve ka lidhje farefisnore e gjenealogjike. Disa komentues kujtojnë se kurejshët kanë pasur bindjen se All’llahu është martuar me xhind dhe se melekët ishin fryt i kësaj martese.²

Islami ua mohon atyre një gjë të tillë. Si mund të ndodhë një gjë e tillë, në një kohë që Ai i ka krijuar xhindet: **“Ai i ka krijuar ata...”** Si mund të jetë një gjë e krijuar, e njëjtë me Krijuesin, përderisa e njëjta është argument i shëmbëlltyrës e i barazisë? Gjëja e krijuar nuk mund të jetë i të njëjtit standard me Krijuesin.

Paragjykimi i dytë është thënia e tyre, nga injoranca, se All’llahu ka djem e vajza: **“...i kanë veshur Atij djem e vajza.”** Argumenti më i mirë, për t’i hedhur poshtë këto ideologji, se nuk janë gjë tjetër veçse mitologji, është se Ai thotë për ta: **“...me padituri...”**. Pra, ata nuk kanë asnjë argument për këto hamendësime.

Kur’ani ka përdorur termin *“kharreku”* që ka kuptimin e *grisjes së diçkaje pa e parë dhe pa e llogaritur atë*. Kjo është e kundërta e *krijimit*, i cili ngrihet mbi llogari të sakta.

Këto dy terma: *el khalk - krijim* dhe *el khark - grisje* mund të përdoren në rastet e gënjeshtres dhe të sajësës, me një ndryshim ndërmjet tyre, sepse fjalët *“el khalk”* dhe *“el ikhtilak”* përdoren në

¹ Tefsiri “El Manar”, vëll. 8, f. 648.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 125 dhe Tefsiri “Mijzan”, vëll. 7, f. 290.

gënjeshttrat e studiuara, ndërsa fjalët: *“el kharku”* dhe *“el ikhtirak”* përdoren në rastet kur gënjeshttra është e pastudiuar dhe e pallogaritur.

Ata i sajuan këto gënjeshttra pa studiuar aspektet e tematikës dhe pa e llogaritur fare çështjen në fjalë.

Ndërsa grupet që i kanë përshkruar All'llahut djem, Kur'ani i përmend në ajete të tjera.

Emrat e dy grupeve janë:

I pari: Kristianët, të cilët kanë thënë: **“Me të vërtetë, Isai është biri i All'llahut.”**

I dyti: Jehudinjtë, të cilët kanë thënë: **“Uzejri, biri i All'llahut.”**

Nga ajeti 30 i sures “Et Teube” dhe nga ajo që ka arritur nga analistët që janë marrë me studimin e rrënjëve të përbashkëta ndërmjet Kristianizmit e Budizmit, me trinitetin, shohim se kristianët e jehudinjtë nuk janë të vetmit që i kanë përshkruar bij All'llahut, por këto ide kanë ekzistuar edhe te ideologjitë e vjetra mitologjike.

Ndërsa përsa i përket vajzave të All'llahut, vetë Kur'ani e sqaron këtë në ajete të tjera: **“Melekët, të cilët janë robtë e të Gjithëmëshirshmit, ata i bëjnë për femra. A mos vallë ata kanë qenë të pranishëm gjatë krijimit të tyre?! Dëshmia e tyre do të shënohet dhe ata do të përgjigjen (për atë shpifje)!”¹**

Është transmetuar në komentime e në histori se kurejshët kanë qenë ata që i kanë parë melekët si vajzat e All'llahut nga martesat e Tij me xhindet.

¹ Surja “Ez Zuhruf”, Ajeti 19.

Kur'ani i refuzon plotësisht në fund të ajetit të gjitha këto mite, të cilat s'kanë bazë: **"...I lavdëruar qoftë Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia veshin ata!"**

Në ajetin pasardhës ua kthen këtyre ideologjive mitologjike, ku i siguron se All'llahu krijoi qiejt e Tokën: **"Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës..."**

A ka tjetër përveç All'llahut që e ka bërë një gjë të tillë, apo mund ta bëjë dikush tjetër, në mënyrë që të ketë ortak në adhurim? Kurrën e kurrës! Të gjitha krijesat janë të All'llahut, i binden urdhrit të Tij dhe kanë nevojë për Të.

Si mund të ketë All'llahu fëmijë pa pasur një bashkëshorte? **"...E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka bashkëshorte?!..."**

E çfarë nevoje ka All'llahu për një bashkëshorte? Pastaj kush do të jetë bashkëshortja e Tij, kur ato të gjitha janë krijesat e Tij? E mbi të gjitha këto, Vetvetja e Shenjtë e All'llahut është e zhveshur nga të gjitha cilësitë trupore, ndërkohë që nevoja për bashkëshorte e fëmijë është cilësitë trupore e materiale.

Edhe njëherë tjetër ajeti siguron pozitën e All'llahut, duke e konsideruar Atë krijues e gjithëpërfshirës i çdo gjëje: **"...Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i Dijshëm për çdo gjë."**

Ajeti i tretë, me anë të metodës deduktive, vërteton gjithçka që paraprin nga krijimi i All'llahut të çdo gjëje, shpikja e krijimi i qiejve, i tokës, ekzistenca e tyre, qenia e Tij, i zhveshur nga cilësitë e të metat trupore e nga nevoja për bashkëshorte e fëmijë, gjithëpërfshirja e gjithëdija për çdo gjë: **"Ky është All'llahu, Zoti juaj. S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij, Krijuesit të çdo gjëje, prandaj adhuroni vetëm Atë..."** Nuk meriton adhurim gjë tjetër përveç Tij.

Në mënyrë që të ndërpritet çdo shpresë pa All'llahun e të shkulim të gjitha rrënjët e politeizmit e mbështetjen te zotat e tjerë, ajeti mbyllet me thënien: **"...Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje!"**

Pra, çelësi i zgjidhjes së problemeve tuaja është vetëm në dorën e All'llahut. Vetëm Ai është i aftë t'i zgjidhë ato. Të gjithë kanë nevojë për All'llahun, për bujarinë dhe mirësinë e Tij. Atëherë, ti pse ia parashtron problemin tënd tjetërkujt e kërkon zgjidhjen e saj prej tij?

Fjalia thotë: **"Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje!"** dhe nuk thotë për çdo gjë mbikëqyrës. Ndryshimi i kuptimit është i qartë, sepse *mbi* - *ala* tregon pushtet dhe ekzekutim urdhri, ndërsa *për* tregon vartësi, pra përshkrimi i parë tregon posedim e mbikëqyrje, ndërsa i dyti tregon përfaqësim e autorizim.

Ajeti 103 është burim studimi, për arsye të vërtetimit të legjitimitetit të All'llahut, gjithëpërfshirjes së Tij te çdo gjë, ruajtjes e mbrojtjes së Tij të çdo gjëje. Gjithashtu, për të vërtetuar se Ai ndryshon për çdo gjë, thotë: **"Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë."** Pra, All'llahu është i Mirëinforuar për interesat dhe nevojat e njerëzve, ndërvepron me ta në pajtueshmëri me mirësinë e Tij.

Është e vërtetë se ai që do të jetë në mbrojtje të çdo gjëje, edukues e udhërrëfyes i njeriut, patjetër që duhet t'i ketë këto cilësi.

Gjithashtu, ajeti thotë se All'llahu është ndryshe nga të gjitha gjërat në këtë botë, sepse nga gjërat e kësaj bote, disa prej tyre shohin e disa shihen, si njeriu; disa të tjera nuk shohin e disa nuk shihen, si cilësitë tona të brendshme; disa të tjera shihen dhe nuk shohin, si gjërat e ngurta, kështu që i vetmi që nuk shihet, por shikon çdo gjë është All'llahu Një i Vetëm.

Hulumtime

Këtu do të flasim për disa pika:

1- All'Ilahun nuk e perceptojnë shikimet

Argumentet logjike vërtetojnë se All'Ilahu nuk mund të shikohet me sy, sepse syri nuk mund të shikojë veçse trupa, ose më saktë, disa nga llojet e trupave. Nëse sendi nuk është trup, syri nuk mund ta shikojë. Kjo ndodh sepse shikimi ka një gjatësi e masë, ndërkohë që All'Ilahu është më i Lartë që të përshkruhet me këto cilësi. All'Ilahu është ekzistent pa kufi, Ai është më i madh se bota materiale e kufizuar në çdo gjë.

Në shumë ajete e më saktë në ajetet që flasin për Beni Izrailët, lexojmë kërkesën e tyre për të parë All'Ilahun. Menjëherë pas kësaj kërkesë, Kur'ani mohon me qartësi mundësinë e shikimit të All'Ilahut. (Më gjerësisht do ta komentojmë në ajetin 143 të sures "El A'raf")

Është e çuditshme se shumë nga ndjekësit e Ehli Syneetit kanë bindjen se All'Ilahu do të shihet Ditën e Ringjalljes. Autori i komentimit "El Manar" shprehet: *"Kjo është nga medh'hebet e Ehli Syneetit dhe e diturisë për hadithin."*¹

Më e çuditshme se kjo është se disa analistë të kohës sonë, me vetëdije, ngulin këmbë për një gjë të tillë.

¹ Tefsiri "El Manar", vëll. 7, f. 653.

Kjo ide është sqaruar aq mirë, sa të mos ketë më debat për një gjë të tillë, sepse çështja nuk ndryshon ndërmjet kësaj bote dhe Tjetrës, pasi All'llahu është mbi materien dhe nuk ka për të ndryshuar Ditën e Ringjalljes në një qenie materiale, as ka për të dalë nga pafundësia e Tij e të bëhet i kufizueshëm, as nuk ka për t'u shndërruar në trup apo në ndonjë mënyrë nga shndërrimi i trupave. Por, këto argumente logjike, për pamundësinë e shikimit të All'llahut, a janë të ndryshme në këtë botë me ato të Botës Tjetër apo dispozita e logjikës do të ndryshojë atë Ditë?!

Nuk mund të justifikohet kjo ide, pasi njeriu, në Botën Tjetër, mund të ketë një lloj tjetër shikimi e perceptimi. Nëse ky shikim e perceptim, në Botën Tjetër, është ideologjik e logjik, atëherë edhe ne në këtë botë do ta shohim All'llahun, bukurinë e Tij, me syrin e zemrës e forcën e mendjes. Por nëse shikimi është i njëjtë me atë që shohim trupat, atëherë shikimi i All'llahut, me këtë kuptim, është i pamundur në këtë botë dhe në Tjetrën.

Bazuar mbi këtë, thënia se njeriu nuk mund ta shohë All'llahun në këtë botë, ndërsa besimtarët do ta shohin atë në Ditën e Ringjalljes, nuk ka logjikë dhe është e papranueshme.

Ajo që i bëri ata të shkojnë në këtë drejtim e të mbrojnë këtë ide është ekzistenca e haditheve në librat e tyre të njohur, që, në lidhje me mundësinë e shikimit të All'llahut, thonë se mund ta shohin Atë Ditën e Ringjalljes. Por, a nuk është më mirë që ta hedhim poshtë këtë mendim me argument logjik e të mos krijojmë shembuj të marrë nga librat që transmetojnë të tilla transmetime? A mund të anashkalohet gjykimi i mendjes e mençuria, për hir të shembujve të këtyre haditheve?!

Ajetet e Kur'anit, **“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin.”**¹ dhe **“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri All'llahut. Dora e All'llahut është mbi duart e tyre! Ai që e prish betimin, e prish në dëm të vetes, por, nëse e mban besën ndaj All'llahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh.”**², në pamje të parë, duken sikur tregojnë shikim e trupëzim. Në këtë rast kemi të bëjmë me figurën letrare të simbolit, sepse ne e dimë se çfarëdolloj ajeti kur'anor nuk mund të bjerë në kundërshtim me gjykimin e mendjes dhe logjikën e shëndoshë.

Ajo që tërheq vëmendjen është se transmetimet dhe hadithet e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) e mohojnë me forcë këtë lloj bindjeje mitologjike dhe i kritikon ashpër ata që thonë thënie të tilla. Një nga bashkëkohësit e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Hishami, thotë: *“Kur isha te Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), hyri Muavije ibn Ueheb (edhe ai ishte nga bashkëkohësit e Imamit) dhe e pyeti atë: ‘O biri i të Dërguarit të All'llahut, çfarë mund të na thuash për çështjen e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe shpëtimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ku e ka parë ai All'llahun? Si e ka parë Atë?’”*

Gjithashtu, në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë: *“Besimtarët e shohin All'llahun në Xhennet.”*

Muavije ibn Uehe e pyeti Imamin: *“Atëherë, në ç'formë e shohin Atë?”*

¹ Sure “El Kijame”, ajetet 22-23.

² Sure “El Fet’h”, ajeti 10.

Imami me një buzëqeshje të trishtë i tha: *“O Muavije ibn Ueheb! Sa keq është që njeriu të jetojë 70 apo 80 vjet në mbretërinë e All’llahut, të begatohet me begatitë e Tij e më pas të mos e njohë Atë realisht. O Muavije, me të vërtetë, i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk e ka parë me sy All’llahun. Në të vërtetë, shikimi është dy llojesh, shikim me zemër e shikim me sy. Ai që thotë se e ka parë me syrin e zemrës, ka thënë të vërtetën dhe ai që thotë se e ka parë me sy, ka gënjyer, ka mohuar All’llahun dhe ajetet e Tij, sepse i Dërguari i All’llahut (Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: ‘Ai që e krahason All’llahun me njerëzit, ka mohuar.’”¹*

Te libri *“Emalij Es Suduk”*, me zinxhir transmetimi, Ismail bin El Fadl ka thënë: *“E kam pyetur Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) për All’llahun e Bekuar e të Lartësuar, nëse do të mund të shikohet në Botën Tjetër. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) m’u përgjigj: ‘I Lavdishëm dhe i Lartësuar është All’llahu nga çdo gjë që thuhet! O ibn Fadli, sytë perceptojnë ngjyrën e format. All’llahu i Lartësuar është krijuesi i ngjyrave e i formave.’”²*

Duhet të kujtojmë se ky hadith përforcon fjalën *“leunun”*, *“ngjyrë”*. Sot e dimë se trupi, në vetvete, nuk shihet, por ajo që shohim është ngjyra e tij. Kështu që, nëse një trup nuk ka ngjyrë, atëherë ai nuk shihet asnjëherë.

(Në vëllimin e parë të këtij komentimi ka një kërkim për këtë çështje, komentimi i ajetit 46 të sures *“El Bekare”*)

¹ Tefsiri *“El Mijzan”*, vëll. 8, f. 255 dhe Tefsiri *“Biharul Enuar”*, vëll. 4, f. 54.

² Tefsiri *“Nuruth Thekalijn”*, vëll. 1, f. 753.

2- All'Ilahu, Krijues i çdo gjëje

Disa komentues të Ehli Syneetit, nga ata që shkojnë pas idesë së “el xhebr” (detyrimit), thënie e All'Ilahut të Lartësuar **“Krijuesi i çdo gjëje”** argumenti për saktësinë e medh'hebit të tyre që besojnë në teorinë e “el xhebr” (detyrimit) dhe thonë: Në të vërtetë, punët e veprat tona, gjithashtu, janë prej ‘gjërave’ të kësaj bote, sepse fjala ‘shej’un’, ‘gjë’ përdoret për çdo gjë që ekziston, materiale apo jo materiale. Për këtë, kur themi se All'Ilahu është Krijuesi i çdo gjëje, duhet të pranojmë se Ai është krijuesi i veprave tona. Ky është detyrim (el xhebru) me plot kuptimin e fjalës.

Ata që thonë për lirinë e dëshirës e të zgjedhjes, i kthejnë një përgjigje të qartë shembujve të këtyre argumentimeve, sepse krijimi i All'Ilahut, deri edhe për veprat tona, nuk bie në kundërshtim me lirinë tonë të zgjedhjes, përderisa veprat tona mund të na përkasin ne dhe All'Ilahut. All'Ilahu ka vendosur të gjitha bazat e parametrat nën sjelljen tonë, kështu që Ai na dhuroi ne forcën, aftësinë, dëshirën e zgjedhjen. Përderisa këto paranteza janë nga krijimi i All'Ilahut, mund t’ia dedikojmë Atij veprat tona, duke marrë në konsideratë se Ai është krijuesi i tyre. Kështu që ne, duke përfituar nga ajo që na ka dhuruar All'Ilahu, nga posedimi i dëshirës e i zgjedhjes, marrim vendimin e kryerjes së veprës ose të moskryerjes së saj. Që këtu ia dedikojmë këto vepra vetes dhe jemi përgjegjës për to.

Kjo fjalë është e ngjashme me atë që dëshiron të testojë punëtorët e tij, duke i lënë ata të lirë në punën e në zgjedhjen e tyre. Vendos në dispozicion të tyre gjithçka që u nevojitet për

punën e tyre, materialet bazë e mjetet e tjera ndihmëse. Është e natyrshme që veprat e tyre të lidhen me të zotin e punës. Por kjo nuk u heq atyre lirinë e veprimit e të zgjedhjes, përkundrazi, ata janë përgjegjës për veprat e tyre.

3- Çfarë do të thotë “*bedij’un*”?

Kemi përmendur edhe më parë se “*bedij’un*” do të thotë ekzistenca e diçkaje pa ekzistuar më parë, pra, All’Ilahu solli në ekzistencë “qiejt e Tokën” pa ekzistuar më parë ndonjë lëndë apo plan.

Këtu, disa kundërshtojnë: “Si mund të ekzistojë diçka nga hiçi?”

Këtë temë e kemi studiuar në komentimin e ajetit 117 të sures “El Bekare”. Përmendim shkurtimisht: Kur themi që All’Ilahu solli në ekzistencë gjërat nga asgjëja, nuk nënkuptojmë që lënda e parë për krijimin e saj është hiçi. Po japim një shembull: Marangozi e prodhoi karrigen nga druri e jo nga hiçi, se hiçi nuk mund të jetë lëndë ekzistente.

Por synimi është se gjërat ekzistente të kësaj bote nuk kanë qenë të tilla më parë. Më pas u bënë ekzistente. Këtu nuk ka gjë të vështirë për t’u kuptuar. Për ta komentuar dhe për ta sqaruar më mirë ajetin 117 të sures “El Bekare” kemi marrë disa shembuj. Përveç atyre shtojmë se ne jemi të aftë të gjejmë në trurin tonë gjëra që nuk kanë qenë më parë. S’ka dyshim se për këto gjëra ekzistuese trunore ka një lloj ekzistencializmi e qenësie, pavarësisht se nuk është ekzistencë e jashtme, por ajo është ekzistente në horizontet e trurit tonë. Nëse ekzistenca e diçkaje

pas asgjësë është e pamundur, atëherë cili është dallimi ndërmjet ekzistencës trunore dhe ekzistencës së jashtme?

Bazuar mbi këtë, përderisa ne mund të krijojmë në trurin tonë qenie që nuk kanë ekzistuar më parë, në të njëjtën mënyrë vepron All'Ilahu në botën e jashtme. Po të meditojmë pak mbi këtë shembull, do ta zgjidhnim këtë çështje.

4- Çfarë do të thotë “latijf”?

Fjala “*el latijf*” rrjedh nga rrënja “*lutf*” që do të thotë “*sjellje*”, “*butësi*”, “*bukuri*” etj. Kjo cilësi është transmetuar në ajetet e mëparshme si një nga cilësitë e All'Ilahut. Nëse me fjalën “*latijf*”¹ përshkruhet një trup, tregon se është i lehtë. Përshkruhet si i lehtë nga lëvizjet e lehta e të qeta dhe nga dhurimi i çështjeve të mprehta të cilat mund të mos i perceptojnë shqisat.

Cilësimi i All'Ilahut të Lartësuar, për njohurinë e Tij, është i saktë, për gjërat e hollësishme të çështjeve dhe për krijimin e gjërave shumë të vogla që nuk shihen. Veprimi i Tij karakterizohet nga saktësia përtej aftësisë perceptuese.

El Feth ibn Jezijd El Xherxhanij transmeton një hadith nga Imam Ali ibn Musa Er Rida (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “...Vërtet, ne themi “*El Latijf*”, për shkak të krijimit të bukur, për diturinë e Tij për gjënë e bukur. A nuk i shikon (All'Ilahu të mbarësoftë dhe të forcoftë ty!) gjurmët e krijimit të Tij, te bimët e brishta e jo të brishta, te kafshët e vogla, te mushkonjat e morrat, te ato që shihen e që nuk dallohen me sy. Madje, për shkak të vogëlsisë së tyre, nuk mund të dallohet mashkulli nga femra, i sapolinduri me të rriturin... Çfarë ka në

¹ “*Usulul Kafij*”, vëll. 1, f. 118.

thellësitë e deteve, në lëvoret e pemëve, në shkretëtira apo në toka të vdekura? A mund ta kuptojmë jetën e të vegjëlve e transportimin e ushqimit te to. A mund ta kuptojmë harmonizimin e ngjyrave: të kuqe, të verdhë e të bardhë? Sytë tanë nuk i shohin dhe nuk i prekim me dorë. Mësuam se Krijuesi ynë është i Dëlirë, i Butë, i Dashur, i Bukur, i Saktë e Mëshirues me krijesën..."

Ky hadith na tregon për mikrobe e qenie mikroskopike, përpara se të lindin, para shumë shekujve, duke komentuar kuptimin e fjalës "*latijf*".

Është e mundur, gjithashtu, që me fjalën "*latijf*" të përshkruhet mëshira e All'llahut të Madhëruar, pasi nuk mund të perceptohet me shqisa. Ai është Mëshirues, sepse asnjëri nuk ka dituri për Të e sa Ai. All'llahu është i Mirëinformuar, sepse Ai është i ditur me çdo gjë.

Ky kuptim është transmetuar gjithashtu,¹ në disa transmetime të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Nuk ka ndonjë gjë që kundërshton dy kuptimet e kësaj fjale.

¹ Tefsiri "El Burhan", vëll. 1, f. 548, dhe Tefsiri "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 100 dhe 122.

Ajetet 104 - 107

قَدْ جَاءَكُمْ بَصَائِرُ مِنْ رَبِّكُمْ ۖ فَمَنْ أَبْصَرَ فَلِنَفْسِهِ ۖ وَمَنْ عَمِيَ
فَعَلَيْهَا ۚ وَمَا أَنَا عَلَيْكُمْ بِحَفِيظٍ ﴿١٠٤﴾ وَكَذَلِكَ نُصَرِّفُ الْآيَاتِ
وَلِيَقُولُوا دَرَسْتَ وَلِنُبَيِّنَهُ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿١٠٥﴾ اتَّبِعْ مَا أُوحِيَ
إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۚ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ وَأَعْرِضْ عَنِ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٠٦﴾
وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَشْرَكُوا ۚ وَمَا جَعَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ حَفِيظًا ۚ وَمَا أَنتَ
عَلَيْهِمْ بِوَكِيلٍ ﴿١٠٧﴾

“(Thuaju o Muhammed): ‘Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj.’”
“Kështu, Ne i shpjegojmë shpalljet Tona që ata të thonë: ‘Ti i ke mësuar këto!’ dhe që t’ua bëjmë të qarta njerëzve që dinë (të drejtën).”
“Prandaj ndiq atë që të ka shpallur Zoti yt. S’ka zot të vërtetë veç Tij. Shmangu prej idhujtarëve.”
“Sikur të donte All’lillahu, ata nuk do të ishin idhujtarë. Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre e as që je përgjegjës për ta.”

Komentimi

Dhuna nuk është detyra jote

Këto ajete janë vazhdim i ajeteve të mëparshme. Në fillim të ajetit 104, All'illahu thotë: **“(Thuaju o Muhammed): ‘Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta...’”**.

Fjala *“basair”* është shumësi i fjalës *“basijreh”*, *“mprehtësi”*, që rrjedh prej fjalës *“basar”*, *“largpamësi”*. Por, ajo, në të shumtën e rasteve, përdoret edhe në kontekstin e shikimit mendor. Mund të përdoret për këdo që arrin të kuptojë e të perceptojë. Kjo fjalë, në këto ajete, nënkupton argumentin dhe pamjen, përmbledhin të gjitha argumentet e transmetuara në ajetet e mëparshme, madje përfshijnë e përmbledhin edhe vetë Kur'anin.

Më pas, në mënyrë që të sqarojë vërtetësinë e këtyre argumenteve e fakteve, ngaqë janë logjike, thotë: **“...Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes...”** Pra, largpamësia është në dobi të tyre, kurse verbëria u shkakton dëme.

Në fund të ajetit, për Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'illahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: **“...Unë nuk jam rojtari juaj.”**.

Komentuesit, këtë pjesë të ajetit, e komentojnë në dy mënyra:

E para: Profeti nuk është përgjegjës për mbikëqyrjen, vëzhgimin, ruajtjen dhe vërejtjet e veprave të njerëzve, sepse All'lahu i vëzhgon të gjithë, i ndëshkon e i shpërblen të gjithë. Detyra e Profetit është transmetimi i mesazhit dhe udhëzimi i njerëzve.

E dyta: Profeti nuk është urdhëruar t'i ngarkojë njerëzit me detyrim e me dhunë, që të pranojnë besimin. Detyra e Profetit është ftesa në fe, qartësimi i të vërtetave, me logjikë e argument. Më pas janë njerëzit ata që marrin vendimin përfundimtar.

Ajeti 105 që e kemi edhe objekt studimi, siguron se marrja e vendimit përfundimtar në zgjedhjen e rrugës së drejtë ose të shtrembër, u takon vetë njerëzve. **“Kështu, Ne i shpjegojmë shpalljet Tona...”¹**

Kështu i sqarojmë argumentet e faktet, me mënyra e forma të ndryshme.

Por një grup kundërshtoi pa argumente e fakte, duke i thënë: **“...që ata të thonë: ‘Ti i ke mësuar këto (nga librat, por fjalës së tyre nuk i vihet veshi).’”²**

¹ “Nusarifu”, “i sqarojmë” vjen nga fjala “tesaruf”, “sqarim”, “shtjellim” me kuptimin: kthimin e diçkaje nga një gjendje apo tjetërsimin e saj në një tjetër; pra, ajetet zbresin në pamje dhe forma të ndryshme, për grada e nivele të ndryshme intelektuale, ideologjike dhe shoqërore.

² Pjesëza e “lamit” te fjala “lejekulu”, “atë që ata thonë” është “lami i ndëshkimit”, për të sqaruar ndëshkimin që do të marrin e duke mos qenë qëllimi real i tij. Kjo akuzë i është drejtuar të Dërguarit të All'lahut (Paqja dhe shpëtimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nga politeistët.

Por nga ana tjetër, një grup është i gatshëm të pranojë të vërtetën, ngaqë ka vizion, koncept e dituri, e sheh fytyrën e së vërtetës dhe e pranon atë: **“...dhe që t’ua bëjmë të qarta njerëzve që dinë (të drejtën)...”**

Akuza ndaj të Dërguarit të All’llahut (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai i ka mësuar mësimet e tij nga jehudinjtë e nga kristianët është përsëritur nga politeistët. Akoma sot, kundërshtarët e arrogantët vazhdojnë me një gjë të tillë. Duhet të theksojmë se në Gadishullin Arabik nuk kishte shkollë e as mësim, ku të mësonte i Dërguari i All’llahut.

Gjithashtu, edhe udhëtimet e tij jashtë gadishullit kanë qenë të shkurtra dhe nuk ka pasur kohë për një gjë të tillë. Pastaj njohuritë e jehudinjëve e të kristianëve që kanë banuar në Hixhaz, kanë qenë në një nivel të ulët e mbizotëronin mitologjitë. Nuk mund të krahasohen, në fakt, me ato që vinin nga Kur’ani dhe as me mësimet e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Do ta shpjegojmë këtë temë, në qoftë se do All’llahu, te komentimi i ajetit 103, të sures “En Nahl”.

Më pas ajeti sqaron detyrën e të Dërguarit të All’llahut përballjen e arrogancës së kundërshtarëve, urrejtjen e akuzat e tyre: **“Ti (Muhammed) praktiko atë që t’u shpall nga Zoti yt. S’ka Zot, përveç Tij.”** Detyra jote, gjithashtu, është shmangia nga politeistët: **“...Shmangu prej idhujtarëve.”**

Kjo, në të vërtetë, është një lloj përkrahjeje e forcimi moral ndaj Profetit (*Paqja dhe shpëtimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi*

familjen e tij!), në mënyrë që të mos përkulet, të mos dobësohet e të mos plogështohet në përballjen me këta kundërshtarë.

Në këtë mënyrë sqarohet se shprehja: **“Shmangu prej idhujtarëve”**, nuk bie në kundërshtim me çështjen e ftesës së tyre në Islam dhe as me luftën kundër tyre. Me këtë synohet që ai të mos i japë rëndësi thënieve të pavërteta e as akuzave të tyre gënjeshtare, madje të vazhdojë, me qëndresë, në rrugën e tij.

Në ajetin 107 të cilin e kemi objekt studimi Kur’ani përsërit edhe një herë tjetër thënien se All’llahu nuk dëshiron t’i dhunojë politeistët e t’i detyrojë ata me Islam, sepse, sikur të donte një gjë të tillë, nuk do të kishte asnjë politeist: **“Sikur të donte All’llahu, ata nuk do të ishin idhujtarë...”** Gjithashtu, përforcon thënien për të Dërguarin e All’llahut (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se nuk është përgjegjës për veprat e tyre, se nuk është dërguar për t’i dhunuar ata në besim, si dhe nuk është detyrë e tij që t’i ngarkojë ata për veprën e mirë: **“...Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre e as që je përgjegjës për ta.”**

Kuptimi i fjalës *“el hafijdh”*, *“rojtar”* është ai që mbikëqyr një çështje apo një person, në mënyrë që ta ruajë atë që të mos dëmtohet, ndërsa *“el uekijl”*, *“i autorizuar”*, është ai që punon për përfitim të dobisë për punëdhënësin e tij.

Është e vlefshme të themi se mohimi i këtyre dy cilësive: *“mbikëqyrës”* e *“i autorizuar”*, për të Dërguarin e All’llahut (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do të thotë mohim i detyrimit për largimin e dëmit e përfitim të dobisë. Nga ana tjetër, i Dërguari i All’llahut i ftonte ata, në zbatim të

transmetimit të mesazhit, për vepra të mira e lënien e së keqes në mënyrë të natyrshme e me zgjedhje.

Të tërheq vëmendjen ideja që mbizotëron në këto ajete: Besimi në Zot dhe në mësimet islame nuk bëhet me zor e me dhunë. Madje janë me logjikë e argumentim, të realizuara në mendimet e njerëzve e në shpirtrat e tyre. Kështu që, besimi me dhunë nuk ka vlerë. E rëndësishme është që njerëzit ta perceptojnë realitetin e ta pranojnë atë me dëshirën dhe zgjedhjen e tyre.

Kur'ani shpesh e përsërit mesazhin e paqes që transmeton Islami, larg çdo dhune e ashpërsie, larg veprave që ka pas ndërmarrë kisha në Mesjetë¹ e gjykatat e inkuizicionit.

Ndërsa qëndresën e Islamit, në përballjen me politeistët, do t'i studiojmë në fillimet e komentimit të sures "El Teube".

¹ "El Kurun El Vusta (mesjeta)", e cila është periudha njëmijëvjeçare, shtrihet nga shekulli i gjashtë deri në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë. Njihet ndryshe me emrin "Periudha e zymtë", që kaploi Evropën dhe Kristianizmin. Vlen të përmendim këtu se Epoka e Artë Islame qëndron në mes të shekujve të Mesjetës.

Ajeti 108

وَلَا تَسُبُّوا الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ فَيَسُبُّوا اللَّهَ عَدَوًّا بِغَيْرِ
 عِلْمٍ ۚ كَذَلِكَ زَيْنًا لِكُلِّ أُمَّةٍ عَمَلُهُمْ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ مَرْجِعُهُمْ فَيُنَبِّئُهُمْ
 بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٠٨﴾

“Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të All’llahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë All’llahun armiqësisht nga padija. Kështu, Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta. Pastaj, ata do të kthehen te Zoti i tyre, i Cili do t’i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë.”

Komentimi

Ajetet e mëparshme folën për përçimin e mësimëve islame mbi baza logjike, përçimin e thirrjes së tij mbi bazën e argumentimit, të bindjes e jo të dhunës. Edhe ky ajet përçon të njëjtat udhëzime, duke ndaluar sharjen e adhuresve të tjerë, politeistëve, sepse kjo do t’i nxisë ata, me pa të drejtë, në armiqësi e injorancë, të shajnë All’llahun e Madhëruar: “Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të All’llahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë All’llahun armiqësisht nga padija...”

Transmetohet se disa besimtarë ndiheshin keq kur shihnin adhurimin e idhujve dhe nganjëherë i shanin idhujt para politeistëve. Ndërkohë Kur’ani i ndaloi ata në mënyrë të prerë dhe

i urdhëroi të zbatonin rregullat e edukatës e të sjelljes, deri edhe në me shumë rryma të pavërteta e mitike.¹

Shkaku është i qartë. Fyerja dhe sharja nuk pengojnë njeri që të ecë në rrugën e gabuar. Madje fanatizmi i fortë e zbatimi i injorancës së tyre e shtojnë më shumë urrejtjen, arrogancën e këmbënguljen e tyre në të pavërtetën. Si rrjedhojë, ata shajnë All'llahun e Lartësuar, sepse çdo komb, zakonisht, bëhet fanatik i bindjeve e veprave të tij. Këtë e përforcon fraza e dytë e ajetit: **“...Kështu, Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta...”**

Ajeti mbyllet: **“...Pastaj, ata do të kthehen te Zoti i tyre, i Cili do t'i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë.”**

Hulumtime

1- Në këtë ajet All'llahu flet për zbukurimin e veprave të mira e të këqija për çdo person. Kjo mund të duket e çuditshme për disa, se si ka mundësi që All'llahu t'ia zbukurojë veprat e këqija njeriut përpara syve të Tij.

U jemi përgjigjur disa herë pyetjeve të tilla. Shembujt e këtyre frazave na mësojnë cilësinë e veprimit dhe ndikimin e tij. Pra, në momentin që njeriu kryen në mënyrë të përsëritur një veprim, sipas këndvështrimit të tij, e keqja e veprës së tij “koklavitet” dhe merr një formë tërheqëse. Meqenëse Krijuesi i

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 132; Tefsiri “Xhamiul Bejjan”, vëll. 7, f. 404.

çdo gjëje është All'llahu e gjithçka kthehet te Ai, nganjëherë këto gjurmë i mvishen Kur'anit e All'llahut. (Medito thellë).

Fjalja e ajetit: **“Kështu, Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta.”** komentohet: Ne ndërhyrë te rezultatet e veprave të tyre të këqija, saqë e keqja u bë e bukur në sytë e tyre.

Nga kjo del e qartë se Kur'ani ia atribuon, nganjëherë, zbukurimin e veprave shejtanëve. Kjo nuk bie në kundërshtim me atë që thamë, sepse shejtani i nxit ata që të bëjnë vepra të këqija, kështu që ata i dorëzohen cytjeve të tij. Rezultati do të jetë përballja me ndëshkimin e veprave të tyre të këqija.¹

2- Hadithet ecin në të njëjtën rrugë me logjikën e Kur'anit, për të mos sharë të humburit e të larguarit. Kjo është arsyeja që komandantët e prijësit e mëdhenj të Islamit kanë urdhëruar domosdoshmërinë e lidhjes së logjikës me argumentin, si dhe largimin nga sharjet apo ofendimet e ideologjive dhe bindjeve të tjera.

Në librin “Nehxhul Balaga” transmetohet se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka folur një grupi shokësh që shanin ndjekësit e Muavijes në luftën e Sifijnit: *“Unë urrej që ju të jeni sharës. Do të ishte më e drejtë e më e justifikueshme, sikur ju të përshkruanit veprat e tyre e të përmendnit gjendjen e tyre.”*²

3- Disa të tjerë mund të kundërshtojnë e mund të thonë: Si mund të shajnë All'llahun ata që adhurojnë idhujt, pavarësisht se ata, në të shumtën e rasteve, besojnë All'llahun dhe idhujt i konsiderojnë ndërmjetës për te All'llahu?

¹ Në tetë vende në Kur'an zbukurimi i veprave i atribuohet shejtanit. Në dhjetë vende fjala zbukurim ka ardhur në mënyrë të papërcaktuar. Në dy raste i atribuohen All'llahut. Por nga ato që kemi përmendur edhe më parë bëhen të qarta të tri rastet.

² “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 206.

Por, nëse ne e shohim më me largpamësi gjendjen e përgjithshme të arrogantëve e të fanatikëve, do të perceptojmë se kjo është e mundur.

Nëse nxitet zemërimi i tyre, hakmerren e irritohen, cilido qoftë çmimi, edhe sikur kjo të dëmtojë ideologjitë e përbashkëta.

El Alusij, në librin “Ruhul Meanij”, thotë: “Me të vërtetë, disa njerëz të zakonshëm të Ehli Synetit, nga padituria e tyre, në momentin që dëgjojnë disa shi’itë të zakonshëm e të paditur duke sharë dy shejkhët (Ebu Bekrin dhe Omerin), zemërohen nga kjo dhe ata e shajnë Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). Kur pyeten se çfarë i shtyu ta shanin Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilin e respektonin, thanë: “Deshëm të hakmerreshim nga ky shi’it dhe nuk gjenim gjë tjetër që ta zemëronim e ta irritonim atë më shumë se sharja e prijësit të tij.”¹

¹ Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 7, f. 218.

Ajetet 109 - 110

وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَنِهِمْ لَئِنْ جَاءَتْهُمْ آيَةٌ لِّيُؤْمِنُوا بِهَا قُلْ إِنَّمَا
 الْآيَاتُ عِنْدَ اللَّهِ ^ط وَمَا يُشْعِرُكُمْ أَنَّهَا إِذَا جَاءَتْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٠٩﴾
 وَنُقَلِّبُ أَفْعَادَهُمْ وَأَبْصَرَهُمْ كَمَا لَمْ يُؤْمِنُوا بِهِ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَنَذَرُهُمْ
 فِي طُعَيْنِهِمْ يَعْزَمُونُ ﴿١١٠﴾

“Ata betohen solemnisht në All’llahun se, nëse iu vjen një mrekulli, ata me siguri do të besojnë. Thuaj: ‘Mrekullitë janë vetëm te All’llahu!’ E kush ju siguron se ata, kur t’u vijë një mrekulli, do të besojnë?”

“Ne do t’ua largojmë zemrat dhe shikimet e tyre nga e vërteta, sepse ata nuk e besuan atë (Kur’anin) herën e parë. Ne do t’i lëmë ata që të bredhin të verbër në humbje e mosbesim.”

Shkaku i zbritjes

Për shkaku të zbritjes së këtij ajeti thuhet: “Kurejshët kanë thënë: ‘O Muhammed, na thua se Musai kishte bastunin me të cilin godiste shkëmbin dhe shpërthenin dymbëdhjetë burime prej tij. Na thua se Isai i ringjallte të vdekurit. Na thua se populli i Themudit kishin

devenë. Atëherë, na sill një argument nga argumentet që të të besojmë ty!”

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Çfarë doni që t’ju sjell juve?”

Ata thanë: “Bëje për ne Saffanë me flori. Ringjall për ne disa nga të vdekurit tanë që t’i pyesim për ty, nëse është e vërtetë kjo që thua. T’i shohim melekët që të dëshmojnë për ty, ose hajde ti me All’llahun e melekët që të jenë dorëzanë për ty.”

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe shpëtimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i thotë: “Nëse unë i bëj disa nga ato që thoni, a do të më besoni mua?”

Ata thanë: “Po, pasha All’llahun! Nëse ti e bën, do të ndjekim ty të gjithë së bashku.”

Myslیمانët e lutën të Dërguarin e All’llahut që t’i zbresë ato, në mënyrë që të besojnë.

Kur i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe shpëtimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po i lutej All’llahut të Lartësuar që ta bënte Saffanë flori, i shkoi Xhebraili (*Paqja qoftë mbi të!*) e i tha: “Nëse dëshiron, Saffaja bëhet flori. Por, nëse nuk të besojnë, i ndëshkon ata. Nëse do, i lë ata derisa të pendohet i penduari prej tyre.”

I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe shpëtimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Atëherë le të pendohet i penduari prej tyre!”

Më pas, All’llahu i Lartësuar zbret këto dy ajete.¹

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 135. Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 7, f. 324.

Komentimi

Në ajetet e mëparshme u transmetuan argumente të shumta e të mjaftueshme mbi njësimin, kundërshtimin e politeizmit, adhurimin e idhujve. Megjithëkëtë, një grup politeistësh arrogantë e fanatikë nuk e pranorin të vërtetën, kundërshtonin e kritikonin. Për më tepër, filluan të kërkonin nga i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të vinte me mrekulli të çuditshme e të panjohura më parë. Për disa nga këto kërkesa ishte e pamundur (si p.sh. shikimi i All'Ilahut), duke pretenduar me gënjeshtër, se qëllimi i dhënies së këtyre mrekullive është forcimi i besimit. Këtë e përforcon ajeti 109: **“Ata betohen solemnisht në All'Ilahun se, nëse u vjen një mrekulli, ata me siguri do të besojnë...”**¹

Si kundërpërgjigje ndaj tyre, Kur'ani flet për dy të vërteta:

Urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), së pari, t'u thotë atyre: **“...Thuaj: ‘Mrekullitë janë vetëm te All'Ilahu...’**, pra, realizimi i mrekullisë nuk bëhet në përputhje me shijet e tyre, përkundrazi ato janë në dorën e All'Ilahut e me urdhrin e Tij.

Më pas u drejtohet myslimanëve të thjeshtë, të cilët u irrituan nga besimi i politeistëve, duke u thënë: **“...E kush ju siguron se ata, kur t'u vijë një mrekulli, do të besojnë?”**², i sigurt se politeistët janë gënjeshtarë në betimin e tyre.

¹ “*El Xhuhd*”, me kuptimin e ndjekjes së problemit dhe përpjekjes së shpenzimit të energjive. Këtu synohet përkushtimi në përforsimin e betimit.

² Komentuesit kanë mendime të ndryshme për pjesëzën “*ma*”, a është pyetëse apo mohuese? Po ashtu kanë mendime të ndryshme përse i përket formës së fjalisë. Disa prej tyre thonë se ajo është një pjesëz pyetëse mohuese. Nëse është kështu, kuptimi i ajetit është: Nga ta dini ju se ata nuk besojnë po të shohin një

Gjithashtu, ngjarjet e ndryshme të ndodhura ndërmjet tyre e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vërtetojnë realitetin se ata nuk po kërkonin për të vërtetën. Madje, qëllimi i tyre ishte të tërhiqnin vëmendjen e njerëzve e të rrënjosnin tek ata dyshimin e lëkundjen.

Ajeti pasardhës sqaron shkakun e arrogancës e të fanatizmit të tyre: **“Ne do t’ua largojmë zemrat dhe shikimet e tyre nga e vërteta, sepse ata nuk e besuan atë (Kur’anin) herën e parë...”**

Ata, me këmbënguljen dhe me fanatizmin e tyre i larguan njerëzit nga rruga e drejtë dhe i drejtuan për në rrugën e gabuar. Si rezultat i injorancës, duke refuzuar të njihnin të vërtetën, humbën aftësinë e tyre për pamjen e vërtetë e perceptimin e shëndoshë. Kështu që vazhduan të jetonin në ngrehina të errëta e në iluzione.

Këtu, gjithashtu, veprimi i atribuohet All'llahut, siç ndodhi edhe më parë. Në realitet, ky veprim është rezultati i veprave të tyre të këqija. Kurse atribuiimi i kësaj All'llahut, s’është gjë tjetër veçse se Ai, me të vërtetë, është Shkaktari i shkaqeve dhe Krijuesi i botës ekzistuese. Çdo specifikë që gjendet në çdo krijesë është me dëshirën e vullnetin e Tij.

Në mbyllje, ajeti na tregon se All'llahu i Lartësuar i lë ata në po atë gjendje, në mënyrë që humbja e tyre të largohet e të shtohet

mrekulli? Pra, ata mund të besojnë. Por kjo është në kundërshtim me atë që kërkon ajeti. Për këtë disa të tjerë e konsiderojnë pjesëzën “ma” mohuese. Ky mendim është më afër logjikës. Në këtë rast, kuptimi i ajetit është: Ju nuk e dini se, edhe nëse atyre u realizohen mrekullitë, ata nuk besojnë.

iluzioni i tyre: “...Ne do t’i lëmë ata që të bredhin të verbër në humbje e mosbesim.”¹

E lusim All’llahun që të na shmangë nga kjo sprovë humbjeje e iluzioni, që është si pasojë e veprave tona të këqija e të na dhurojë një vizion të shëndoshë e të plotë, në mënyrë që ta shohim të vërtetën të kulluar, pa asnjë papastërti.

¹ Fjala “je'mehun” rrjedh nga fjala “amhun” dhe ka kuptimin e “iluzionit”, të “vegimit” e të “dyshimit”.

PËRMAJTJA E LIBRIT

TEMA

Ajeti 82	5
Emigruesit janë të parët që e kanë pranuar Islamin.....	5
Komentimi.....	11
Urrejtja e jehudinjve, dashamirësia e të krishterëve.....	11
Ajetet 83 - 86	13
Komentimi.....	14
Ajetet 87 - 89	16
Shkaku i zbritjes.....	17
Mos i tejkaloni kufijtë.....	17
Komentimi.....	19
Betimi dhe shpagimi i tij.....	19
Ajetet 90 - 92	25
Shkaku i zbritjes.....	26
Komentimi.....	27
Periudhat e ndalimit të alkoolit dhe rregulli i tij përfundimtar.....	27
Hulumtime.....	31
Ndikimet shkatërruese të alkoolit dhe të bixhozit.....	31
Ajeti 93	34
Shkaku i zbritjes.....	34
Komentimi.....	35
Ajetet 94 - 96	37
Shkaku i zbritjes.....	38

Komentimi.....	39
Rregullat e gjuetisë kur vishet ihrami.....	39
Hulumtime.....	46
Urtësia e ndalimit të gjuetisë në gjendjen e ihramit.....	46
Ajetet 97 - 99.....	48
Komentimi.....	49
Hulumtime.....	51
Rëndësia e Qabesë	51
Ajeti 100.....	53
Komentimi.....	53
Mazhoranca nuk është argument i së drejtës dhe i së vërtetës.....	53
Ajetet 101 - 102.....	56
Shkaku i zbritjes.....	56
Komentimi.....	58
Pyetjet kureshtare	58
Ajetet 103 - 104	63
Komentimi.....	63
Hulumtime.....	64
Dy hulumtime.....	67
1- Idhulli, që quhej “El Eslaf”	67
2- Papajtueshmëri pa justifikim.....	68
Ajeti 105.....	69
Komentimi.....	69
Çdo njeri është përgjegjës për veprat e tij.....	69
Përgjigja e kundërshtimit	70
Ajetet 106 - 108.....	73
Shkaku i zbritjes.....	74
Komentimi.....	75
Ajeti 109.....	81
Komentimi.....	81

Ajeti 110	84
Komentimi.....	85
Mirësia e All'Ilahut ndaj Mesihut.....	85
Ajetet 111 - 115	89
Komentimi.....	90
Tregimi i zbritjes së sofrës për dishepujt.....	90
Hulumtime.....	93
1- Cili është qëllimi i kërkesës së sofrës?.....	93
2 - Cili është qëllimi i thënies “A mundet Zoti yt”?.....	94
3-Cila është ajo sofër që ka zbritur nga qielli?.....	94
4- A i zbriti atyre sofa?	95
5- Çfarë është festa?.....	95
6- Përse ndëshkimi është i rreptë?.....	96
7- Dhjata e Re dhe sofa.....	96
Ajetet 116 - 118	98
Komentimi.....	99
Pafajësia e Isait nga shirku i ndjekësve të tij.....	99
Ajetet 119 - 120	104
Komentimi.....	104
Fitorja e madhe.....	104
Surja “El En’am”	108
Lufta kundër politeizmit dhe idhujtarisë.....	109
Ajetet 1 - 2	111
Komentimi.....	111
A është errësira prej krijesave?.....	113
Drita është simbol i unitetit, kurse errësira është simbol i përçarjes.....	114
Çfarë kuptimi ka fraza “exhelun musemma”?.....	116
Ajeti 3	119
Komentimi.....	119

Ajetet 4 - 5	121
Komentimi.....	121
Ajeti 6	124
Komentimi.....	124
Fundi i të padrejtëve.....	124
Hulumtime	125
Ajeti 7	127
Komentimi.....	127
Fundi i kokëfortësisë.....	127
Ajetet 8 - 10	129
Komentimi.....	130
Shpikja e shfajësimeve.....	130
Ajeti 11	134
Komentimi.....	134
Ajetet 12 - 13	136
Komentimi.....	136
Ajetet 14 - 16	142
Komentimi.....	143
S'ka mbrojtje, përveç mbrojtjes së All'llahut.....	143
Ajetet 17 - 18	147
Komentimi.....	147
Fuqia mposhtëse e All'llahut.....	147
Ajetet 19 - 20	151
Komentimi.....	152
Dëshmitarët më të mëdhenj.....	152
Ajetet 21 - 24	157
Komentimi.....	158
Padrejtësia më e madhe.....	158
Hulumtime	161
Ajetet 25 - 26	164
Komentimi.....	164
Perde që nuk pranojnë çarje.....	164

Akuza e madhe ndaj Ebu Talibit, besimtarit të kurejshëve.....	166
Ajetet 27 - 28	173
Komentimi.....	173
Zgjim i padobishëm.....	173
Hulumtime	174
Ajetet 29 - 32	177
Komentimi.....	178
Për komentin e ajetit të parë ka dy alternativa.....	178
Ajetet 33 - 34	183
Komentimi.....	183
Reformatoret gjithmonë përballen me vështirësitë.....	183
Ajetet 35 - 36	189
Komentimi.....	189
Ajeti 37	194
Komentimi.....	194
Ajeti 38	199
Komentimi.....	199
Hulumtime.....	202
1- A ka ringjallje për kafshët?.....	202
2- Tubimi dhe detyrimi (teklifi).....	204
3- A tregon ky ajet për rimishërimin?.....	205
Ajeti 39	207
Komentimi.....	207
I shurdhri dhe memeci.....	207
Ajetet 40 - 41	210
Komentimi.....	210
Njësimi (<i>Teuhidi</i>) i natyrshëm (<i>fitrij</i>).....	210
Hulumtime.....	211
Ajetet 42 - 45	213
Komentimi.....	214
Fundi i atyre që nuk nxjerrin (marrin) mësimë.....	214
Hulumtime.....	215

Ajetet 46 - 49	219
Komentimi.....	220
Njiheni Dhuruesin e mirësive!.....	220
Ajeti 50	224
Komentimi.....	224
Njohja e Gajbit	224
Ajeti 51	228
Komentimi.....	228
Ajetet 52 - 53	231
Shkaku i zbritjes.....	231
Ndalimi i të menduarit për ndarje shtresore.....	233
Dallimi i madh i Islamit.....	236
Ajetet 54 - 55	238
Komentimi.....	238
Ajeti 56 - 58	241
Komentimi.....	242
Këmbëngulja e kotë.....	242
Hulumtime.....	244
Ajetet 59 - 62	247
Komentimi.....	248
Sekretet e të padukshmes (Gajb)	248
Ajetet 63 - 64	256
Komentimi.....	256
Drita që ndriçon në errësirë.....	256
Hulumtime.....	258
Ajeti 65	261
Komentimi.....	261
Ngjyrat e dënimit.....	261
Ajetet 66 - 67	265
Komentimi.....	265
Ajetet 68 - 69	267
Shkaku i zbritjes.....	267

Komentimi.....	268
Braktisja e qëndrimit me të devijuarit.....	268
Ajeti 70.....	271
Komentimi.....	271
Ata që e kanë marrë fenë si lojë.....	271
Ajeti 71 - 72.....	275
Komentimi.....	275
Ajetet 73.....	278
Komentimi.....	278
Ajeti 74.....	281
Komentimi.....	281
Ai ishte Azeri babai i Ibrahimit?.....	282
Ajetet 75 - 79.....	287
Komentimi.....	288
Argumentet e Njësimit (<i>Teuhidit</i>) në qiej.....	288
Ajetet 80 - 83.....	292
Komentimi.....	292
Çfarë kuptimi ka këtu fjala “dhulmun”?.....	296
Ajetet 84 - 87.....	299
Komentimi.....	300
Hulumtime.....	302
1- Fëmijët e Profetit Ibrahim.....	302
2- Përse përmenden emrat e Profetëve në tre grupe në tre ajete?....	305
3- Rëndësia e fëmijëve punëmirë në njojhjen e personalitetit të njeriut.....	306
4- Përgjigje kundërshtimit.....	306
Ajetet 88 - 90.....	308
Komentimi.....	309
Tri veçanti të rëndësishme.....	309
Ajeti 91.....	313
Shkaku i zbritjes.....	313
Komentimi.....	314

Të pavëmendshmit ndaj All'llahut.....	314
Hulumtime.....	317
Ajeti 92.....	319
Komentimi.....	319
Hulumtime.....	320
Islami - fe mbarëbotërore.....	320
Lidhja mes besimit në Kur'an dhe në Jetën Tjetër.....	323
Rëndësia e namazit.....	323
Ajeti 93.....	324
Shkaku i zbritjes.....	324
Komentimi.....	325
Hulumtime.....	327
Ajeti 94.....	328
Shkaku i zbritjes.....	328
Komentimi.....	329
Të humburit.....	329
Dy hulumtime.....	330
Ajetet 95 - 96.....	331
Komentimi.....	331
Çarësi i dritës së mëngjesit.....	331
Ajeti 97.....	340
Komentimi.....	341
Ajetet 98 - 99.....	342
Komentimi.....	343
Ajetet 100 - 103.....	351
Komentimi.....	352
All'llahu është Krijuesi i çdo gjëje.....	352
Hulumtime.....	357
1- All'llahun nuk e perceptojnë shikimet.....	357
2- All'llahu, Krijues i çdo gjëje.....	361
3- Çfarë do të thotë "bedij'un"?.....	362
4- Çfarë do të thotë "latijf"?.....	363

Ajetet 104 - 107.....	365
Komentimi.....	366
Dhuna nuk është detyra jote.....	366
Ajeti 108.....	371
Komentimi.....	371
Hulumtime.....	372
Ajetet 109 - 110.....	375
Shkaku i zbritjes.....	375
Komentimi.....	377

الأمثل في تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازي

الجزء السابع

الترجمة الى اللغة الألبانية: وُلِّتْ مَرْيَا

تيرانا: 2016

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب اللہ المنزل (جزء ہفتم)

نویسنده: فقیہ مفسر حضرت آیۃ اللہ العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلہ)

ترجمہ بہ زبان آلبانی: وُلُنْتُ مَرِيَا

زیر نظر: وُلُنْتُ مَرِيَا

ویرایش: لیسدا رامای

مقابلہ: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریہ فرا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2016